Adam Roberts, "NATO's 'Humanitarian War' over Kosovo," *Survival* 41, no. 3, Autumn 1999.

Adam Roberts, *Humanitarian War: Military Intervention and Human Rights*, International Affairs, Vol. 69, No. 3, July 1993.

Bruno Simma, ed., *The Charter of the United Nations: A Commentary*, (New York: Oxford University Press, Inc., 1994).

Bryan J. Hehir, *Kosovo: A War of Values and the Values of War*, America 180, no.17, 15 May 1999.

Catherine Guicherd, International Law and the War in Kosovo, Survival 41, no. 2 (Summer 1999).

Denisa Kostovicova, Parallel Words: Response of Kosovo Albanians to Loss of Autonomy in Serbia, 1989-1996, Keele, 1997.

Fernando Teson, Humanitarian Intervention: An Inquiry into Law and Morality, Dobbs Ferry, NY: Transnational Publishers, 1988.

Immanuel Kant, Critique of Practical Reason New York-Toronto: Macmillan, Maxwell Macmillan, 3rd ed. 1993, Book I.

Jan Nederveen Pieterse (ed.), World Orders in the Making, London, Macmillan Press Ltd, 1998.

Ken Booth, The Kosovo Tragedy: The Human Rights Dimensions, London: Frank Cass, 2001.

Kofi Annan, 'Two Concepts of Sovereignty', Address to the 54th Session of the General Assembly, reprinted in *The Question of Intervention: Statements of the Secretary-General*, 1999.

Lewis White Beck, *On History: Immanuel Kant*, Prentice Hall, 2001.

Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, London, 1998.

Paul Christopher, The Ethics of War and Peace: An Introduction to Legal and Moral Issues, Prentice Hall, Upper Saddle River, New Jersey, 1999.

Press Statement by Dr. Javier Solana, Secretary General of NATO, 23 March 1999, http://www.nato.int/docu/pr/1999 /p99-040e.htm.

Peter Malanczuk, *MODER INTRODUCTION TO INTERNATIONAL LAW*, London 1997.

Robert Lee Wolff, *THE BALKANS IN OUR TIME*, Harvard University Press, 1956.

The Oxford Dictionary of Law, (Oxford University Press, 4th ed 1997).

Tim Judah, *Kosovo: War and Revenge*, Yale University Press, 2000.

Warren Zimmerman, *Origins of a Catastrophe*, Random House Inc., 1996.

Walters, L.R.B. *Five Classic Just-War Theories: A Study in the Thought of Thomas Aquinas, Vitoria, Suárez, Gentili and Grotius*, Michigan, University Microfilms, 1971.

E Drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuadër të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit shqiptar

Dritan Palnikaj

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Shqiperi

Abstrakt

Respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut qëndron në themel të një shteti demokratik dhe ligjor. Sot të drejtat e njeriut janë të sanksionuara në një sërë konventash të ndryshme ndërkombëtare, një pjesë e të cilave janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm të shteteve të ndryshme. Të drejtat e njeriut janë të larmishme dhe secila ka rëndësinë dhe vlerën e saj. E drejta për një proces të rregullt ligjor, është një ndër të drejtat thelbësore që është e sanksionuar në aktet e ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si garant për një sërë të drejtash të tjera.

Në njerën prej akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, *thuhet se në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë ,të pavarur dhe të paanshëm. Në këtë Konventë sanksionohet se* çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht etj. Të gjitha këto parime të së drejtës janë në funksion të së drejtës për një proçes të rregullt ligjor, e drejtë kjo që krahas Konventës Europiane Për Të Drejtat e Njeriut është e sanksionuar dhe në Kushtetutën e Shqipërisë.

Ajo çfarë vihet re në shumë shtete duke përfshirë dhe vendin tonë, nuk është mungesa e të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kushtetutë apo akte të tjera ligjore, por vihet re prezenca e problematikës së aplikimit konkret të tyre. Dhe kjo për mendimin tim përbën dhe një ndër sfidat më të mëdha të sistemit tonë ligjor. Respektimin e të drejtave të njeriut e ndeshim në veprimtari të ndryshme, por objekti i temës së trajtuar në këtë punim lidhet pikërisht me mekanizmat mbrojtës të së drejtave të individit në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, në veçanti në procesin administrativ.

Keywords: Konvente, system ligjore, kushtetuta, gjykata, proces

Respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut qëndron në themell të një shteti demokratik dhe ligjor. Sot të drejtat e njeriut janë të saksionuara në një sërë konventash të ndryshme ndërkombëtare, një pjesë e të cilave janë bërë pjesë e legjislacionit të brëndshëm të shteteve të ndryshme. Ajo çfarë vihet re në shumë shtete duke përfshirë dhe vendin tonë, nuk është mungesa e të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kushtetutë apo akte të tjera ligjore, por vihet re prezenca e problematikës së aplikimit konkret të tyre. Dhe kjo për mendimin tim përbën dhe një ndër sfidat më të mëdha të sistemit tonë ligjor. Respektimin e të drejtave të njeriut e ndeshim në veprimtari të ndryshme, por objekti i temës së trajtuar në këtë punim lidhet pikërisht me elementwt e proçesit të rregullt gjygjësor dhe mekanizmat mbrojtës të drejtave të individit në kuadrin e proçesit të rregullt ligjor, në vëçanti në proçesin administrative në bazë të legjislacionit shqiptar dhe Konventes Europiane të Drejtave të Njeriut.

Tranzicioni në Shqipëri ashtu siç ka përfshirë shumë dimensione të veprimatrisë së shoqerisë shqiptare, ka përfshirë dhe mënyren e funksionimit dhe organizimit të shtetit duke përfshirë kështu dhe sistemin e drejtësisë. Sistemi i drejtësisë përbën garantuesin kryesor të mrojtjes të së drejtave të njeriut, dhe ashtu sikurse dhe fushat e tjera të veprimtarisë shtetërore, ai i është nënshtruar reformave të ndryshme duke u përpjekur gjithnjë e më tepër për të përshtatur standarte të ngjashme me ato të vendeve më të zhvilluara perëndimore. Shqipëria është përfshirë në organizata të ndryshme ndërkombetare, është nëshkruesë e një sërë konventash ndërkombëtarë dhe është bërë pjesë e proçesit të asocim stabilizimit në BE, një ndër kërkesat e të cilit është dhe reforma në sistemin e drejtësisë. Dhe jo më kot janë të pranishme kërkesa të tilla, pasi vihet re një ngërç shumë i madh i implementimit të se drejtës në parktikë, i respektimit të të drejtave të njeriut në një proçes të rregullt ligjor, vetë zhvillimit të një proçesi të rregullt ligjor, pavarsisë së gjykatave etj.

Një nga qëllimet e reformës në fushn e drejtësisë është pra përmirësimi i të metave të konstatuara në veprimtarinë e tij, si dhe rritja e efektivitetit, nëpërmjet garantimit të pavarsisë së gjykatave dhe rritjes së përgjegjshmërisë së tyre për të përvetësuar standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.[238]

Rrespektimi i të drejtave të njeriut në një proçes të rregullt ligjor, lidhet me vetë zhvillimin e proçesit të drejtë dhe të ndershëm ligjor. Nga njera anë kjo e drejtë kushtetuese paraqitet si një garanci për shtetasit kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit shtetëror dhe, nga ana tjetër, ajo përbën një detyrim për këto të fundit që të mos cënojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa

[238] Komiteti Shqiptar i Helsingit, "*Rregulshmëria e proçesit gjygjësor*", f.10, Tiranë 2010

ua siguruar respektimin e proçedurave të rregullta ligjore.[239] Kjo si e drejtë është sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Shqipërisë i cili thotë:

> *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshmë e caktuar me ligj.*

Kështu së pari kjo e drejtë nënkupton të drejtën e kujdo për të ngritur padi në gjykatë. Kjo e drejtë, gjithsesi nënkupton jo vetem të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë këtë mundësi. [240]

Duke ju referuar këtij neni, dalin lehtësisht kriteret që duhen plotësuar për të pasur një proçes të rregullt ligjoj të cilat janë në përputhje të plotë me përmbajtjen e Konventës Europianë të Drejtave të Njeriut :

a. Gjykimi i drejtë dhe publik- gjykimi i drejtë lidhet me rrespektimin në mënyrë rigoroze të ligjit duke përfshirë të gjitha proçedurat e nevojshme për të pasur një gjykim sa më të drejtë. Ndërsa përsa i përket publicitetit të seancës gjygjsore, kjo lidhet me transparencen e vendimeve që mer gjygjësori, me rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare. Gjithashtu i jepet mundësi publikut dhe medias që të marri pjesë. Megjithatë, ka disa rrethana të posaçme ku pubiku mund të përjashtohet të tilla si morali, rendi publik, sigurimi kombëtar, jeta private. Në këto raste gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Duke ju referuar më konkretisht Konventes Europiane të Drejtave të Njeriut në nenin 6 shprehet se prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë proçesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proçes ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.[241]

b. Gjykimi branda një afati të caktuar- rrespektimi i afateve është shumë i rëndësishëm. Legjislacioni qoftë penal, civil apo administrative ka përcaktuar afate për zhvillimin e proçedimit duke u kujdesur që palët në proçes të kenë mundësi të përgatiten. Ky kusht bëhet shumë i ndjeshëm sidomos në çështjet penale.[242] Këtu përfshihet e drejta për t'u gjykuar pa tejzgjatje të kohës, e drejta për të pasur kohë të mjaftueshme për paraqitjen e padisë, për te mbledhur provat, për të përgatitur mbrojtjen etj.

---

[239] Sokol Sadushi, " Kontrolli Kushtetues", f.152, Tiranë, 2004

[240] *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.04.2003; nr. 9, datë 02.04.2003; nr. 17, datë 18.07.2008; nr. 5, datë 06.03.2009, nr. 18, datë 08.07.2009 në http://www.gjk.gov.al/*

[241] Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut, neni 6/1

[242] Aurela Anastasi, " E drejta kushtetuese", f.106, Tiranë 2004

c. Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme- gjykimi i një çështje duhet të ndjekë të gjitha etapat në bazë të gjykates kompetente. Gjykata gjatë gjykimit duhet të jetë e pavarur, pra të mos jetë e ndikuar nga pushtetet e tjera apo faktorë të tjere. Për ti shërbyer pavarsisë së saj janë hartuar një sërë dispozitash ligjore. Pra vendimet gjygjsore nuk meren nga instuticione politike dhe kjo është garancia që qëndron në themel të gjykimeve të paanshme. Është pikërisht ndarja e pushteteve embrioni i pavarsisë së gjygjësorit. Në themel të një proçesi të rregullt ligjor qendron gjykata e paanshme, kjo lidhet me parimin e barazisë midis palëve, pra nuk mund të favorizohet apo diskriminohet njera palë kundrejt tjetres. Me këtë lidhet dhe fakti që trupi gjykues duhet të jetë i lirë të veprojë në pajtim me ligjin jashtë presioneve të jashtme. Paanshmëria kërkon gjithshtu që gjyqtarët të mos kenë interesa në lidhje me çështjen që ata shqyrtojnë.

d. Ne Konventen Europiane të Drejtave të Njeriut është e specifikuar shprehimisht se çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Ky element përbërës i proçesit të rregullt gjygjësor është i parashikuar dhe në nenin 30 të Kushtëtutës së vendit tonë i cili thotë se: *"Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjygjësor të formës së prerë.* Prezumimi i pafajsisë paraqitet kështu si një parim i shprehur në Kushtetutë.

Një ndër të drejtat kryesorë që garanton mbrojtjen e të pandehurit është ajo e njoftimit të akuzës i cili duhet të jetë i hollësishëm duke parashtruar në mënyrë korrekte dhe të përmbledhur faktin që rezulton nga hetimet e bëra.

I pandehuri ka te drejtë të mari pjesë në sigurimin e provave. Kështu në bazë të nenit 31/d të Kushtetutës, ai ka të drejtë " t'u bëjë pyetje deshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e deshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë të cilët mund të sqarojnë faktet.

E drejta për tu mbrojtur. Kjo e drejtë shfaqet në dimensione të ndryshme, si për shembull e drejta për t'u njoftuar në lidhje me çështjen, apo njohur me materialet e çështjes në gjykim, për t'u mbrojtur, për t'u mbrojtur nga avokati, tej.[243] E drejta për tu mbrojtur mund të realizohet si personalisht ose me avokat. Rrespektimi i kësaj të drejtë përbën thelbin e një proçesi të rregullt ligjor. Kjo garanci është e parashikuar në Kushtetutë (neni 31) por dhe në nenin 6 të Konventes Europiane dhe është një siguri e rëndësishme e mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Avokati duhet të veprojë në përputhje me interesat e klientit që ai mbron duke mbrojtur te drejtat e tij dhe duke vepruar gjithnjë në pëputhje me etikën e juristit. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht më klientin që mbron, të mari pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore ku është i parnishëm i pandehuri. Ai duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e paligjshme që e pengon në punën e tij, gjithashtu

[243] Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda (Methasani) Çani, "Shteti i se drejtës në Kushtetutën e Shqipërisë", fq. 96 , Tiranë, 2011

ruan të drejtën e koifidencialitetit. Është e drejta e çdo të akuzuari të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

Të pandehurit të mitur i duhet siguruar ndihmë juridike dhe psikologjike dhe kjo është e përcaktuar në nenin 49 të Kodit të Proçedurës Penale.

E drejta për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, pra t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes, kjo lidhet me të drejtën e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme. Është e nevojshme krijimi i një lehtësie të tillë në mënyrë që të mblidhet informacioni nevojshëm, dokumentat, provat për të realizuar një mbrojtje të drejtë. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij.[244]

E drejta për të qënën i pranishëm në gjykim, i ngarkon autoritetet me detyra që të njoftojnë të akuzuarin dhe mbrojtësit në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendmbajtjen e proçedurave gjygjsore, për të kërkuar praninë në to të akuzuarit dhe për të mos përjashtuar padrejtësisht të akuzuarin nga gjykimi.[245]

E drejta për tu dëgjuar, është një ndër të drejtat kruesore që i jep forme një proçesi të rregullt ligjor. Kjo e drejtë është e pranishme si në proçedurat penale, civile ashtu dhe në ato administraive. Gjithashtu ka të drejtë të të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.[246]

I akuzuari ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq. Ky parim është i lidhur ngushtë me të drejte e të akuzuarit për një mbrojtje të rregullt. Parimi në fjalë kërkon që autoriteti procedures duhet t'ia bëjë të përdorshëm gjithë informacionin të dyshuarit që me fillimin e proçedimit penal ku kërkohet edhe bërja e përkthimeve. Ky informacion duhet të plotësohet me informacione të tjera nëse akuzes i shtohen fakte apo ndonjë bazë tjeter ligjore. Në çështjen "Kamasimski kundër Austrisë" (1989), Gjykata Europiane ka hedhur poshtë kërkesat e paditësit për të cilat gjoja nuk i ishin dhënë disa informata lidhur me akuzen e bërë kundër tij, zhvillimin e hetimit, verdiktin apo gjykimin në një gjyhë që ai e kuptonte. Në fakt, gjykata deklaroi se caktimi nga shteti i një avokati mbrojtës të aftë për të

[244] Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6/3a

[245] Sokol Sadushi, " Kontrolli Kushtetues", f.171, Tiranë, 2004

[246] Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6/3d

komunikuar njëherësh në gjuhën që përdorte gjykata dhe në gjuhën e paditësit, i plotësonte kushtet ligjore të parashikuara në nenin 6/3 të Konventes Europiane të Drejtave të Njeriut.[247]

Në shërbim të drejtave të njeriut si një garanci mbrojtëse kushtetuese ndaj privimit të këtyre të drejtave nga organet vendimmarrëse është dhe neni 131 i Kushtetutës i cili thotë që Gjykata Kushtetuese është organi që bën gjykimin përfundimatar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proçes të rregully ligjor, pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyrë të drejtave. Sanksionimi i një të drejtë të tillë në Kushtetutë tregon më së miri rëndësinë e kësaj të drejte e cila është e pakufizueshme.

Proçesi i rregullt ligjor, parashikuar nga neni 41 dhe 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është një parim i cili shtrihet përtej proçeseve gjygjësore; jo më kot edhe termi është "ligjor" e jo "gjygjesor". Ne reflektim të këtyre neneve kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e ka shtrirë detyrimin për respektimin e të drejtës për një proçes të regullt sa në proçeset gjygjësore aq edhe administrative, apo edhe në rastet e shqyrtimit të çështjeve nga komisionet parlamentare. Pra, individët edhe nëse kjo e drejtë e tyre është cënuar përgjatë proçeseve administrative dhe nuk kanë arritur të "rikuperojnë" këtë të drejtë në gjygjësor, mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Të njejtin interpretim, GjK ka bërë edhe për komisionet hetimore parlamentare.[248] Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet analizës që i ka bërë nenit 42/1 të Kushtetutës, ka zgjeruar më tej fushën e shtrirjes së procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë detyrimin për respektimin e elementëve të këtij neni edhe në proceset administrative.[249]

Ankimi administrativ është mjeti fillestar i mbrojtjes të drejave dhe lirive të individit të cilat janë cënuar nga veprimtaria e paligjhme e organeve të administratës publike. Pra, është një mjet që i vendos këto organe nën presionin e kontrollit të vazhdueshëm. Ky realizim i kontrollit mbi administratën është një garanci për moscenimin e të drejtave të shtetasve. Kontrolli na paraqitet në dy forma : kontrolli i brëndshëm dhe kontrolli i jashtëm. Nëpërmjet ankimit, çdo palë e intreresuar kundërshton paligjshmërinë ose parregullsinë e një akti administrativ, si dhe refuzimin e paligjshëm të organit administrativ për nxjerrjen e aktit.[250] E drejta për të ankimuar është e parashikuar dhe në nenin 18 të Kodit të Proçedurës Administrative. Në një seksion të veçantë të Kodit të Proçedurës administrative është parashikuar forma e realizimit të ankimit administrative, efektet e e tij, shqyrtimi, afatet etj. Afati për paraqitjen e ankimit është 1 mua dhe fillon nga dita që ankuesi ka marë njoftimin për aktin. Kur organi nuk nxjerr aktin, proçedura fillon 3 muaj nga dita e depozitimit të kërkesës për nxjerrjen e aktit. Njeri ankim paraqitet tek organi që ka nxjerrë aktin apo ka refuzuar

[247] www.drejtesiashqiptare.com
[248] Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda (Methasani) Çani, "Shteti i se drejtës në Kushtetutën e Shqipërisë", fq. 88 , Tiranë, 2011
[249] Po aty, fq. 89
[250] Sokol Sadushi, " Kontrolli Kushtetues", f.182, Tiranë, 2004

nxjerrjen e ti dhe tjetri i drejtohet organit epror. Kjo e drejtë është e përcaktuar edhe në nenin 48 të Kushtetutës i cili thotë:

> *Kushdo, vetë ose sëbashku me të tjerë mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.*

Pra, në këtë rast kemi përballjen e së drejtës të qytëtarëve për t'ju drejtuar organeve administrative për çështjet që i interesojnë me detyrimin e këtyre organeve për të marrë vendim brenda një afati të cakuar. Kjo proçedurë është e nevojshme të ezaurohet përpara se pala të drejtohet në gjykatë. E drejta e ankimit është pjesë e së drejtës së mbrojtjes dhe mosrealizimi i saj cënon të drejtat ligjore të ankuesit dhe çon në deformimin e nje proçesi të rregullt ligjor.

Duke ju referuar nenit 46 te Kodit të Proçedurave Administrative, iniecimi i proçesit administrativ mund të fillojë me kërkesen e palës ose me nismen e organit administrativ, që në këtë rast ka detyrimin të vërë në dijeni palën e interesuar. Pjesmarrësit në një proçedim administrative mund te jetë çdo kush që ka një interest të ligjshëm. Këtu mund të përfshihet individi, publiku i gjërë, shoqatat dhe organizatat që veprojnë në interes të publikut, Avokati i Popullit etj. Ky proçedim përfundon brenda një afati prej 3 muajsh, me përjashtim të disa sitautave të veçanta.

Gjatë prçedurës hetimorë, organi që e zhvillon ju kërkon palëve që janë të interesuara të paraqesin të gjithë dokumentave, informacioneve apo fakteve të ndryshmë mbi të cilat bazohet pretendimi i tyre në mënyrë që ti nënshtrohen hetimit. Dhe në bazë të shqyrtimit të tyrë të merret një vendim i drejtë dhe objektiv. Ashtu sikurse dhe në proçedurën civile barra e të provuarit edhe në proçedurën administrative i takon palës që pretendon një fakt.

Pas përfundimit të të gjitha proçedurave të nevojshme në përputhje me dispozitat ligjore, organi merr vendimin përfundimtar i cili është dhe shkaku i përfundimit të proçedimit administrativ. Megjithatë, shkak për përfundimin mund të jetë dhe prania e disa fakteve që parashikohen në ligj të tilla si tërheqja e pretendimeve apo heqja dorë prej tyre, braktisja dhe pamundësia. Vendimi përfundimtar i nxjerrë nga organi kompetent duhet të përmbajë të gjitha elementët formale që kërkon ligji, pas këtij veprimi pala e interesuar nqs nuk është dakort me përmbajtjen e tij, ka të drejtë ta kundërshtojë nëpërmjet ankimit administrative ose gjygjsor.

Siç e kam përmendur dhe më lart veprimtaria e administratës publike i nënështrohet si kontrollit të brendshëm, ashtu dhe atij të jashtëm që është kontrolli gjygjësor. Kështu rishikimi gjygjësor i akteve administrative, përbën një tjetër mjet për garantimin e të drejtave të individit

nëpërmjet një gjykimi të drejtë. Kushdo ka të drejtë ti drejtohet gjykatës për anulimin e një akti i cili është i paligjshëm.

Një tjetër mjet që garanton rrespektimin e të drejtave të njeriut në një proçes të rregullt ligjor është dhe shërbimi i Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj.[251]

Si përfundim mund të them se e drejta për një proçes të rregully ligjor është shumë e rendësishme prandaj ajo është një e drejtë absolute si në proçesin penal, civil apo administrativ. Janë një sërë të drejtash të tjera si ajo e njoftimit te padise, e mbrojtjes e kohes se mjaftueshme etj të cilat janë të lidhura dhe plotësojnë një proçes të rregullt ligjor. Prandaj për garantimin e tyrë legjislacioni shqiptar qoftë në Kushtëtutë apo në kode dhe ligje të ndryshmë kanë parashikuar mekanizmat mbrojtës të tyre si e drejta e ankimit, ngritja e padisë, shqyrtimi gjygjsor, Avokati i Popullit etj dhe një sërë rregullash të sanksionuara në shërbim në zbatimit të tyre.

[251] Eralda (Meht-Hasani) Cani, "Përmbledhje Ligjesh të së drejtës administrative", f.115, Tiranë, 2007

Bibliografia.

Anastasi, A. “ E drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2004

Met-Hasani, E. “ Përmbledhje Ligjes të së drejtës administrative”, Tiranë, 2007

Sadushi, S. “ Kontrolli Kushtetues”, Tiranë, 2004

Sadushi, S.” E drejta administrative 2”, Tiranë, 2005

Zaganjori, Xh. Anastasi, A. Met-Hasani, E. “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2011

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998

Komiteti Shqiptar i Helsingit, “*Rregulshmëria e proçesit gjygjësor*”, f.10, Tiranë 2010

Deklarata Universale të Drejtave të Njeriut.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.04.2003; nr. 9, datë 02.04.2003; nr. 17, date 18.07.2008; nr. 5, datë 06.03.2009, nr. 18, datë 08.07.2009 në http://www.gjk.gov.al/

Ndërmjetësimi në procesin penal dhe të drejtat e njeriut

Nevila Kullojka

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ndërmjetësimi është një ndër elementët më të rëndësishëm të drejtësisë restauruese. Ai mishëron rekomandimet e politikës penale europiane e më gjërë, dhe njëkohësisht përfaqëson pa dyshim tendencën *in futures* për zgjidhjen e konflikteve pa investimin e gjykatës për një sërë veprash penale.Ky artikull synon të na prezantojë një dimension të plotë të Ndërmjetësimit, duke u ndalur fillimisht në disa aspekte historike. Më pas do të trajtojmë (me anë të metodave hermeneutike dhe interpretative) *inter alia* parimet që e udhëheqin dhe standartet që ky proces duhet të reflektojë. Natyrisht ky artikull synon të na prezantojë rëndësinë dhe avantazhet e Ndërmjetësimit, arsyet se pse ai është shndërruar në një mekanizëm sundues në rekomandimet më të fundit të politikës penale, duke integruar siguristh dhe kufijtë e shtrirjes së tij.Por jo vetëm kaq, gjithashtu një pjesë thelbësore e këtij punimi është fakti se a mund të sigurohet në procesin e Ndërmjetësimit respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, sa arrihet kjo realisht, cilat janë garancitë që na reflekton ky proces dhe a janë ato të mjaftueshme për të na reflektuar standarte? Hulumtimi i legjislacionit vendas *vis a vis* atij ndërkombëtar *supra* do të na ndihmojë për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve përgjatë artikullit, duke na dhënë kështu një trajtim të gjithanshëm të këtij mekanizmi dhe duke nxjerrë në pah rolin që ai luan në promovimin e të drejtave të njeriut. Analiza ka një karakter të dyfishtë, pasi do të ndalet në trajtimin e të drejtave të viktimës e njëkohësisht dhe në të drejtat e të akuzuarit[252] të veprës penale.

Ndërmjetësimi është një alternative komplementare opsionale që qëndron përkundrejt procedimit penal tradicional. Roli dhe rëndësia e tij ka ardhur gjithmonë e në rritje. Si rrjedhojë ai është shndërruar në një kusht *sine qua non* për një politikë penale efikase dhe gjithashtu udhëheqësi i saj, prandaj është e nevojshme t'i kushtojmë rëndësinë e duhur, për të patur një rregullim sa më të mirë dhe konform peshës që ai përfaqëson.

Fjalet kyçe: *Ndërmjetësimi, tendencë, të drejtat e njeriut, të drejtat e viktimës, të drejtat e të akuzuarit të veprës penale.*

[252] Jemi referuar ketij termi për arsye praktike, për të patur më të thjeshtë analizën gjatë artikullit. Ky term do t'i referohet të "pandehurit", personit në ngarkim të të cilit qëndron një akuzë penale,

Hyrje

Sistemi i drejtësisë i konsideron dhe i trajton sot krimet si veprime kundër shtetit, dhe jo si veprime kundër individëve apo komunitetit në tërësi. Në këtë mënyrë, ne, i lëmë mënjanë nevojat e viktimave dhe shoqërisë pas kryerjes së krimit, duke u shqetësuar më shumë për dënimin e autorit sesa për rehabilitimin e viktimës dhe ndreqjen e dëmit të shkaktuar. Pavarësisht se sistemi tradicional i drejtësisë ekziston pikërisht prej faktit se qytetarët kanë qënë subjekt i sjelljeve kriminale, viktimat nuk kanë një rol në procesin e dhënies së drejtësisë brenda gjykatës.[253] Në këtë mënyrë ato viktimizohen për së dyti; së pari nga autori, dhe së dyti nga sistemi i drejtësisë.

Prej këtu lind dhe koncepti i ndërmjetësimit: një alternativë ndaj sistemit tipik të procesit të dhënies së drejtësisë[254]. Dekadat e fundit kanë treguar një rritje të përdorimit të tij si një alternative ndaj këtij sistemi. Ndërmjetësimi si i tillë përfaqëson një tendencë lider në politikën penale që udhëheq sistemin e drejtësisë, prandaj dhe siç e kemi përmendur *supra* ky artikull synon të na prezantojë një dimension të plotë të tij duke integruar parimet në të cilat bazohet, përparësitë e këtij insituti dhe sigurisht kufijtë e tij. Por qëllimi i këtij artikulli nuk ndalet vetëm këtu, pasi ai synon të na paraqesë *inter alia* dhe lidhjen e ngushtë midis ndërmjetësimit dhe të drejtave të njeriut, duke cekur kështu një aspekt mjaft delikat dhe në të njëjtën kohë të rëndësishëm.

Aspekte historike

Sigurisht që fillimisht do të ndalemi në disa aspekte historike të zhvillimit të ndërmjetësimit, si shprehje e drejtësisë restauruese, për ta patur më të thjeshtë analizën e tij gjatë artikullit. Ndërmjetësimi haset fillimisht tek Sumerët[255] të cilët e parashikonin aplikimin e tij në krimet e dhunshme, ndërsa në Babiloni aplikohej për krimet që kishin të bënin me pasurinë[256], në Romë ai parashikohej në ligjin e XII Tabelave, ku autorët e veprave penale detyroheshin të paguanin dyfishin e të mirave të vjedhura. Në formën e tij klasike ndërmjetësimi haset në vitin 1974 në shtetin e Kanadasë[257], ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmjetësimi haset në vitin 1978, proces që realizohej me iniciativën e gjykatës, ndërkohë në Angli aplikohet në vitin 1979 me

[253] Cited in Howard Zehr '*Krimi është cënim i personave dhe marrëdhënieve, Drejtësia përfshin viktimën, autorin, komunitetin*'.
[254] Ligji ynë parashikon se: ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanës (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin,
[255] Ai është parashikuar në Kodin Ur-Nammu, viti 2960 p.e.s,
[256] Kodi i Hamurabit, viti 1700 p.e.s,
[257] Eksperimenti Kitchener që u zhvillua në Ontario (Elmira), ishte ai që i dha shtysën zhvillimit të procesit të ndërmjetësimit në procesin penal,

iniciativën e policisë. Ky historik i shkurtër na tregon se ndërmjetësimi është një insitut i vjetër që i ka rezistuar kohës i palëkundur në rëndësinë e tij.

Ndërmjetësimi është një insitut që paraqet historinë e tij dhe në vendin tonë. Kështu së pari ndërmjetësimin e vërejmë tek kanunet[258], si ai Lekë Dukagjinit[259], Kanunin e Skënderbeut, Kanunin e Labërisë, dhe Kanunet vendore. Edhe pas krijimit të shtetit shqiptar, zgjidhjes së konflikteve me anë të ndërmjetësimit iu kushtua rëndësi e veçantë.[260] Në periudhën e viteve 1945-1990 gjithashtu kemi zhvillim të këtij insituti, u krijuan fillimisht komisionet e pajtimit të gjaqeve që vepruan gjate gjithë viteve 1945-1960. Më pas kemi krijimin e gjykatave të fshatrave, qyteteve dhe lagjeve të qyteteve[261], të cilat kishin një rol të rëndësishëm për pajtimin e palëve. Këto gjykata u suprimuan në vitin 1990[262] dhe në vend të tyre u krijuan "gjykatat shoqërore" veprimtaria e të cilave mbeti vetëm në ligj. Nevoja për rregullimin specific të këtij insituti çoi në miratimin e ligjit " Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve"[263], në të cilin ishin jetësuar parimet kryesore, procedurat, dhe fusha e zbatimit të procesit të ndërmjetësimit. Ky ligj u zëvëndësua nga ligji nr.9090 datë 26.06.2003, "Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve", i cili u zëvëndësua nga ligji nr.10385 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", ligj i cili u përafrua me direktivat e Bashkimit Europian *infra*.[264]

Ndërmjetësimi në procesin penal

Pasi kemi trajtuar shkurtimisht zhvillimin historik të këtij insituti sigurisht që e kemi më të thjeshtë analizën e tij. Ndërmjetësimi, siç e kemi përmendur dhe *supra* mund të përkufizohet si një mënyrë alternativë e zgjidhjes së konflikteve[265], i dizenjuar si një procedurë fleksible, efiçenca e të cilit qëndron përballë problemeve të sistemit gjyqësor. Në procesin penal, ndërmjetësimi është pjesë e konceptit të gjërë të drejtësisë restauruese, qëllimi i së cilës është rehabilitimi i viktimës. Ai përfaqëson mjetin më të vjetër dhe më gjërësisht të përhapur të shprehjes së drejtësisë restauruese. Ndërmjetësimi pasqyron përgjigjen e shoqërisë civile bashkëkohore ndaj politikave të ashpra ndëshkuese, dhe qëllimi kryesor i këtij koncepti siç e theksuam më lart është rehabilitimi i viktimës

[258] Insitutit të ndërmjetësimit i kushtohej rëndësi e veçantë në secilin prej këtyre kanuneve. Rregullimi i tij ishte bërë pothuajse në mënyrë të ngjashme, duke u ndalur kryesisht në çështjen e gjakmarrjes, sigurisht me specifikat e krahinave përkatëse,
[259] Kështu Kanuni i Lekë Dukagjinit i kushton nyjet 134-140 pajtimit të gjaqeve,
[260] Pas shpalljes së pavarësisë kemi krijimin e një komisie e cila do të zgjidhte në bashkëpunim me qeveritarët në menyrë paqësore konfliktet në lidhje më gjakmarrjen, përpjekje e cila u shtri ndër vite,
[261] Këto gjykata u krijuan me anë të dekretit nr.4426, datë 23.09.1968, ndryshuar më vonë me dekretin nr.4475, datë 14.01.1969, nr.5634, datë 30.09.1977 dhe me dekretin nr.5913, datë 26.06.1979 "Mbi gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe lagjeve të qyteteve,
[262] Ligji nr.7378, datë 8.05.1990.
[263] Ligji nr.8465, datë 11.03.1999.
[264] Për më shumë rreth zhvillimit të ndërmjetësimit në Shqipëri lexo: Ismet Elezi, "Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale", Tiranë 2004.
[265] Kuptimi i tij në *lato sensu*.

infra, një pjesëmarrës shpesh-herë i lënë mënjanë në procesin penal. Synimi i kësaj tendence nuk është ndëshkimi i të akuzuarit të veprës penale, por ndreqja e dëmit që i është shkaktuar viktimës, dhe si pasojë ajo nxit inkurajimin e të akuzuarit të veprës penale për të pranuar fajin, për të marrë përsipër përgjegjësitë dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në ndreqjen e pasojave *infra*. Pra synimi final është riintegrimi i autorit në shoqëri dhe si pasojë reduktimi i recidivizmit si dukuri. Kjo gjë arrihet duke i kushtuar kujdes dhe duke mbajtur në balancë nevojat e viktimës e të shoqërisë nga njëra anë dhe integrimin e të akuzuarit të veprës penale në shoqëri nga ana tjetër.

Parimet që udhëheqin ndërmjetësimin

Ndërmjetësimi në *strico sensu* pra mund të përkufizohet si një proces ku viktima dhe i akuzuari i veprës penale kanë mundësi që vullnetarisht të marrin pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e çështjeve që janë atribut i veprës penale nëpërmjet ndihmës që ofrohet nga një palë e tretë (ndërmjetësi).[266] Ai sot është një proces esencial për shoqërinë, duke u shndërruar në standart, prandaj është e rëndësishme të analizojmë cilët janë parimet që janë jetësuar në këtë insitut, cilat janë bazat që përbëjnë themelet e tij duke e shndërruar në promovues të respektimit të të drejtave të njeriut. Janë pikërisht këto parime që reflektojnë elementët thelbësorë të këtij procesi, që sqarojnë rëndësinë e tij brenda sistemit të drejtësisë, dhe në të njëjtën kohë pasqyrojnë karakteristikat e tij.

Por le t'i sqarojmë me radhë këto parime. Së pari duhet të theksojmë se ndërmjetësimi është një proces i cili bazohet në vullnetin e palëve, pra ai mund të zhvillohet vetëm nëse palët japin pëlqimin e tyre.[267] Është pikërisht kjo karakteristikë që e dallon më së shumti ndërmjetësimin nga procesi tradicional, dhe na tregon se palët e zotërojnë procesin në një shtrirje më të madhe. Në të njëjtën kohë palët kanë palët kanë të drejtë të heqin dorë në çdo kohë nga pëlqimi i dhënë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, e drejtë e cila duhet tu bëhet e ditur dhe sqaruar palëve.

Respektimi i parimit të konfidencialitetit është një kusht *sine qua non* për procesin e ndërmjetësimit[268]. Konfidencialiteti është një premisë për zgjidhje konstruktive, ai lehtëson krijimin

[266] Ky përkufizim jepet nga raporti shpjegues i Rekomandimit nr.99 (19), miratuar nga Këshilli i Europës më 15 shtator 1999.

[267] Dhe në ligjin tonë është reflektuar ky parim. Kështu në nenin 3 paragrafi 3 të ligjit nr.10385 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", parashikohet se: Ndërmjetësimi është vullnetar dhe palët në mosmarrëveshje janë të lira:
a) të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë ligj;
b) të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme;
c) të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

[268] Edhe në ligjin tonë është parashikuar se ndërmjetësimi bazohet në parimin e konfidencialitetit të të dhënave. Në nenin 19 është përcaktuar se:
1. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten konfidenciale.
2. Pavarësisht nga rregulli i ruajtjes së konfidencialitetit, bëhen publike të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes së arritur në rastet kur:
a) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelorë të shtetit dhe/apo interesit publik;

e një ambjenti ku palët mund të sjellin aspekte që nuk preken në gjykatë, dhe janë pikërisht këto informacione shtesë që na çojnë në gjetjen e një zgjidhjeje jashtë dyerve të gjykatës. Nga ana tjetër ky parim mbron dhe interesat e palëve, pasi diskutimet që bëhen gjatë procesit nuk mund të bëhen publike, vetëm në rast se palët bien dakord për të kundërtën. Kjo është një karakteristikë e cila qëndron në kontrast me gjykimin me dyer të hapura në procesin tradicional, dhe nxjerr në pah karakterin privat të ndërmjetësimit. Konfidencialiteti është një parim që aplikohet kundrejt publikut të gjërë *vis-a vis* edhe ndaj autoriteteve përkatëse.[269]

Ndërmjetësimi në procesin penal duhet të jetë një shërbim gjërësisht i aksesueshëm për të gjithë dhe lehtësisht i kuptueshëm. Është shumë e rëndësishmë që ky shërbim të jetë i qartë, për shkak të barazisë në akses dhe barazisë në cilësinë e shërbimit. Prandaj është tejet e domosdoshme që procesi i ndërmjetësimit të promovohet dhe të njihet si një mundësi komplementare ndaj procesit penal tradicional.

Ndërmjetësimi është një procedurë e cila si rregull është e aksesueshme në stade të ndryshme të procesit, aplikimi i të cilit varet nga sistemi që është implementuar.[270] Procedura më frytdhënëse do të ishte ajo në të cilën ndërmjetësimi të ishte i aksesueshëm në çdo stad të procesit, pavarësisht se në disa raste është e rekomandueshme aplikimi i tij imediat, në pjesën më të madhe të rasteve palët nuk janë të prirura dhe nuk janë gati të pranojnë avantazhet e ndërmjetësimit që në fazat fillestare të procesit penal.

Ndërmjetësimi është një proces që reflekton pavarësi brenda sistemit të drejtësisë.[271] Pavarësia e këtij procesi është e nevojshme për të vepruar me fleksibilitet dhe përgjegjshmëri përkundrejt palëve. Sigurisht që kjo pavarësi nuk mund të jetë absolute, ndërmjetësimi nuk mund të ekzistojë plotësisht i shkëputur nga sistemi i drejtësisë penale, pasi ky proces duhet të reflektojë përgjatë tij marrjen parasysh të interesave publike dhe të drejtat procedurale të palëve. Në të njëjtën kohë, mbrojtja e të drejtave të njeriut gjatë procesit, është një çështje e cila detyrimisht sjell implikimin e autoriteteve shteterore për monitorimin e ndërmjetësimit.

Avantazhet e ndërmjetësimit dhe kufijtë e tij

---

b) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;
c) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;
ç) nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje,

[269] Pavarësisht nga parimi konfidencialitetit, ndërmjetësi duhet të bëjë të ditur cdo të dhënë autoriteteve përkatëse për mundësinë e kryerjes së krimeve serioze, të dhëna që mund të dalin gjatë procesit të ndërmjetësimit,

[270] Kështu disa sisteme lejojnë aplikimin e ndërmjetësimit në çdo stad të procesit, në disa sisteme ai është lënë në dorë të prokurorisë apo policisë dhe si pasojë para fillimit të procesit gjyqësor, në disa sisteme është gjykata ajo që e propozon aplikimin e tij, në të tjerë ai është pjesë e vendimit përfundimtar gjyqësor. Në vendin tonë gjykata ka detyrimin të ftojë palët për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim në rastet e përcaktuara në ligj,

[271] Ligji ynë përcakton në nenin 1 se: Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur; dhe në nenin 3, paragrafi 2 se: Ndërmjetësi, në ushtrimin e funksionit të tij, siguron zgjidhjen e çështjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes, objekt ndërmjetësimi,

Pasi kemi trajtuar parimet mbi të cilat shtrihet ndërmjetësimi, ne, e shohim të arsyeshme të analizojme dhe avantazhet që paraqet ky insitut. Do të ndalemi në këtë trajtesë, pasi duke analizuar avantazhet, del në pah jo vetëm rëndësia e tij, por sigurisht dhe fakti se pse ai është shndërruar në një tendencë.

Një ndër avantazhet kryesore dhe njëkohësisht karakteristikë thelbësore e ndërmjetësimit është pikërisht karakteri vullnetar i tij *supra*. Kjo karakteristikë e shndërron ndërmjetësimin në një tendencë lider për zgjidhjen e konflikteve penale. Sigurisht që për një pjesë të mirë të juristëve kjo shihet më shumë si një disavantazh, pasi sipas tyre, pikërisht karakteri i tij opsional e shndërron atë në shumë pak të aplikueshëm nga palët. Por këtyre zërave skeptikë mund tu përgjigjemi me vendosmëri se kjo karakteristikë është ajo që e bën unik këtë insitut, pasi duke theksuar karakterin e tij vullnetar, palët nuk do të jenë të frikësuara për të aplikuar ndërmjetësimin si një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve të tyre. Ky avantazh, i kombinuar dhe me përparësitë e tjera *infra* e shndërron ndërmjetësimin në një lider në metodat alternative të zgjidhjes së konflikteve. Për më tepër theksojmë këtu se bëhet fjalë për një kategori të caktuar veprash penale, në të cilat vetë palët janë të interesuara në benefitet që sjell ky insitut. Në të njëjtën kohë studime të ndryshme e kanë lidhur suksesin që ka ndërmjetësimi me faktin që palët kanë të mundësi ta zgjedhin vetë alternativën për zgjidhjen e konfliktit.

Sigurisht që një ndër aspektet më pozitive të ndërmjetësimit është fuqizimi i pozitave të viktimës duke i ofruar atyre zë në këtë proces, një mundësi për të bërë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje, i jep atyre një rol në vendimmarrje.[272] Ndëshkimi i rreptë i të akuzuarit të veprës penale nuk i rikthen viktimës atë që ka humbur prej krimit, nuk e çliron nga frika,[273] nuk e mbyll në mënyrë përfundimtare çështjen[274]. Procesi i ndërmjetësimit është i fokusuar në këto çështje dhe synon zgjidhjen e tyre. Për më tepër falja e të akuzuarit nga ana e viktimës, shkakton tek kjo e fundit një ndjenjë shërimi, arritje që bëhet e mundur vetëm nëpërmjet ndërmjetësimit.

Në të njëjtën kohë për mendimin tonë është i gabuar koncepti i skeptikëve sipas të cilëve ndërmjetësimi i kushton rëndësi dhe benefite vetëm viktimës, pasi dhe të akuzuarit të veprës penale i jepet mundësia për tu përballur me situatën dhe për ta ndrequr atë.[275] Nëpërmjet këtij procesi ai mund të marrë përsipër përgjegjësitë e krimit që ka kryer, dhe në të njëjtën kohë të marrë faljen nga viktimat e tij, gjë e cila mungon në procedimin tradicional, dhe është pikërisht kjo falje e cila i jep

[272] Kjo është një ndër arsyet që propagandohet ndërmjetësimi në rekomandimet e Keshillit të Europës, shiko Rekomandimin nr.99(19), miratuar nga Këshilli i Europës më 15 shtator 1999,
[273] Pasi sistemi tradicional i kushton rëndësi më së shumti gjetjes së formës së përshtatshme të dënimit për veprën e kryer dhe dënimit të autorit të veprës penale, duke mos u fokusuar tek nevojat e viktimës së veprës penale dhe nevojat e të akuzuarit të veprës penale,
[274] I referohemi faktit se në pjesën më të madhe të rasteve, dënimi i autorit të veprës penale nuk sjell domosdoshmërisht rehabilitimin e marrëdhenies autor-viktimë,
[275] Shiko Rekomandimin nr.99(19), miratuar nga Këshilli i Europës më 15 shtator 1999,

atyre mundësinë për tu riintegruar dhe shkëputur nga veprimet e mëparshme kriminale, duke mënjanuar kështu recidivizmin. Në procesin tradicional pushteti i plotë i lihet gjykatësit duke krijuar një formë tensioni tek palët, ndërsa procesi i ndërmjetësimit i jep të dyja palëve një ndjenjë fuqie direkte mbi procesin, duke mënjanuar stresin e procesit gjyqësor.[276]

Por a është i aftë ndërmjetësimi që produktin final, pra marrëveshjen e nënshkruar ta vërë në jetë? Këtë pyetje e kanë ngritur shumë kritikë të kësaj alternative, dukë vënë në dyshim efikasitetin e saj. Sigurisht që dhe në sistemin tradicional ka probleme në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi gjyqësor, por në ndërmjetësim, fakti që procesi bazohet në vullnetin e palëve, për mendimin tonë e favorizon më së shumti përmbushjen e detyrimeve, pasi është një procedurë e cila ka filluar dhe është finalizuar me konsensusin e tyre.[277] Vetë ndërmjetësimi reflekton drejtësi tek palët, dhe mbylljen e konfliktit përfundimisht si për viktimën ashtu dhe për të akuzuarin e veprës penale, dhe është pikërisht kjo arritje që i motivon ato për përmbushjen e detyrimeve.[278]

Një ndër efektet më pozitive të ndërmjetësimit është fakti se ai luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e recidivizmit. Përfshirja në një procedurë gjyqësore, përballja me institucionet e vuajtjes së dënimit, vënia në kontakt me persona me karrierë kriminale, janë të gjithë faktorë që ndikojnë në shmangien e rehabilitimit dhe mungesën e integrimit të autorit në jetën sociale. Pikërisht ndërmjetësimi i shmang këto efekte anësore, dhe fokusohet më së shumti në riparimin e pasojave të shkaktuara nga vepra penale.

Ndërmjetësimi në të njëjtën kohë është një alternativë që i minimizon kostot kohore[279] dhe financiare[280], prandaj ai rezulton një procedurë efikase dhe efiçente për zgjidhjen e konflikteve.

Pavarësisht se komunikimi është një nga kërkesat e procesit penal, në të shumtën e rasteve komunikimi ndërmjet palëve është i predispozuar të dështojë. Si i akuzuari i veprës penale ashtu dhe prokurori janë të prirur për të mos bërë të njohura informacione të caktuara, që përbëjnë elemente kyçe për çështjen. Ndërmjetësimi i eliminon këto, duke na siguruar negociata të ndershme. Kështu një ndërmjetës i mirë sigurohet që i akuzuari të kuptojë qartësisht çështjen e tij, statusin e tij, pasojat, opsionet që mund të zgjedhë, duke i hapur rrugën mundësisë që i akuzuari të jetë më i prirur për të komunikuar dhe duke i dhënë në këtë mënyrë një drejtim tjetër çështjes.

---

[276] Umbreit, M.S, Coates R.B. and Vos, B., *The Impact of victim offender mediation: Two decades of research*, pp 30-31. Kështu në bazë të një studimi rreth 79% e pjesmarrësve në ndërmjetësim shprehen të kënaqur kundrejt këtij procesi, ndërsa vetëm 57% nga personat që kanë zgjedhur gjykatën për zgjidhjen e konfliktit shprehen të kënaqur.

[277] Ibid, pp 30-31. Një studim statistikor ka treguar se në ndërmjetësimet ku autori ishte i mitur, rreth 81% e tyre i kanë zbatuar me korrektësi detyrimet e marrëveshjes, ndërsa vetëm 57% e të miturve që i ishin nënshtruar procesit gjyqësor i kanë përmbushur detyrimet e vendimit gjyqësor.

[278] Praktika e përditshme tregon se palët të cilat i vendosin vetë kushtet dhe rregullat janë më të prirur për t'i zbatuar ato,

[279] Për shembul në Karolinën e Veriut (SHBA), aplikimi i ndërmjetësimit ka ulur me 2/3 proceset gjyqësore, në të njejën kohë në Xheorxhia (SHBA), ka rezultuar se kohëzgjatja e ndërmjetësimit është sa 1/3 e procesit gjyqësor,

[280] Kështu reduktimi i dënimeve me burgim apo masës së dënimit sjell një impakt të menjëhershëm në kursimin e parave të shpenzuara në "industrinë e burgut",

Janë pikërisht këto disa nga avantazhet e ndërmjetësimit që e kanë shndërruar atë në tendencë dhe në lider të rekomandimeve të politikës penale, dhe në një mekanizëm sundues në zgjidhjen e konflikteve penale. Ne, në këtë artikull duam të ndalemi pak dhe në trajtimin e kufijve të ndërmjetësimit, pasi vetëm në këtë mënyrë sipas mendimit tonë mund të arrihet një përshkrim i plotë i tij.

Kështu fillimisht duhet të theksojmë se fusha e veprimit të ndërmjetësimit është e reduktuar, pasi me anë të tij mund të zgjidhen vetëm një kategori e caktuar konfliktesh penale.[281] Sigurisht që kjo është diçka mëse e kuptueshme, pasi do të ishte *non sens* të kërkosh që ndërmjetësimi të aplikohet për të gjitha llojet e veprave penale. Një kufi i tillë për mendimin tonë është mëse i justifikueshëm duke marrë parasysh parimet mbi të cilat bazohet ndërmjetësimi *supra.* [282]

Një pengesë/kufi për ndërmjetësimin është dhe fakti se në disa vende referimi për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim bëhet vetëm nga një autoritet i caktuar. Kështu për shembull në vendin tonë është vetëm gjykata që ka të drejtën dhe detyrimin[283] për të ftuar palët për të zgjidhur çështjen me ndërmjetësim. Pavarësisht se palët mund të kërkojnë dhe pranojnë zgjidhjen e tyre me ndërmjetësim, orientimi dhe ftesa e bërë nga autoritetet përkatëse për zgjedhjen e ndërmjetësimit që në fazën fillestare, do të ishte tepër produktive.[284]

Nga kritikët shpesh-herë fakti se ndërmjetësimi bazohet në vullnetin e palëve, është reflektuar si një kufi i kësaj alternative. Siç e kemi thënë dhe më parë në këtë artikull kjo karakteristikë është më shumë pozitive sesa negative për këtë proces. Sigurisht që vullneti është një kusht *sine qua non* për ekzistencën e ndërmjetësimit, dhe sigurisht që duhet të pranojmë faktin që ajo përbën një pengesë që duhet kapërcyer, por koha ka treguar që kjo pengesë nuk ka qënë një barrierë e pakapërcyeshme, madje ka ndikuar më së shumti në përdorimin gjërësisht të tij *supra*.

Vënia në pah e kufijve të ndërmjetësimit, i shërben jo vetëm paraqitjes së plotë të insitutit të ndërmjetësimit dhe analizës koherente të tij, por në të njëjtën kohë i shërben zhvillimit dhe perfeksionimit të mëtejshëm të tij. Kështu ne jemi në gjendje që duke u nisur nga kufijtë e ndërmjetësimit të synojmë shtrirjen më të gjërë të tij[285], inkorporimin e procedurave sa më të

Although the principle of complementarity solves many of the problems raised in relation to constitutional conflict[322], it does not solve all the problems, and some states may have to defer to international laws about certain rights and obligations. This submission, even though necessary for the effective functioning of the Court, will lead to some resistance to the ICC, due to its

[319]See: http://www.icc-cpi.int/en_menus/icc/situations%20and%20cases/situations/situation%20icc%200205/Pages/situation%20icc-0205.aspx, accessed in April 2013
[320]See: http://www.un.org/en/preventgenocide/adviser/, accessed in April 2013
[321]Duffy, H. & Suhr, B. (2000) The Debate on the Constitutional Compatibility with the ICC, June, found at http://www.iccnow.org/resourcestools/ratimptoolkit/generaltools/constitutionalissues/TheDebateonConstitutEng.pdf, accessed in April 2013
[322]Human Rights Watch, The Compatibility of the ICC Statute with certain Constitutional Provisions around the Globe, found at http://www.hrw.org/campaigns/icc/compatibility.htm, accessed in April 2013

encroachment on national sovereignty. Unfortunately the harmonization of laws is vital to the successful application of international law in general.

Though the concept of national sovereignty has been improved over the years, many of the fundamental issues that emerged from the Peace of Westphalia have remained unsolved. Prominent It can be mentioned here the tension between respecting a state's right to make decisions regarding its own citizens and interests and recognizing that some common basic rules that apply to all may be necessary for the prosperous ongoing of civilization.

That tension is built into the very creation of the U.N. Article 2 paragraph 7 of the U.N. Charter declares that "Nothing contained in the present Charter shall authorize the U.N. to intervene in matters which are essentially within the domestic jurisdiction of any state...." and Article 1, paragraph 1 of the U.N. Charter had made it clear that the purpose of the United Nations was "to take effective collective measures for the...suppression of acts of aggression and other breaches of the peace."

Human rights violations, on the other hand, were completely another thing. Even long after the adoption of the Universal Declaration of Human Rights (UDHR), the way a government treated its own citizens was regarded as "essentially within the domestic jurisdiction" of the state. Despite the growing body of international human rights law, countries, with the excuse of national sovereignty, could harass, persecute, torture, starve, and even kill large segments of their own populations and have no fear of being condemned.

Over the last ten or fifteen years, however, the balance between national sovereignty and international authority has started to change. Growing recognition of the global nature of both environmental threats and economic opportunities resulted in a growing recognition of the interdependence of the world. Guilt over the genocide in Rwanda in 1994, a genocide that took place under the United Nations eyes, urged a reexamination of when military intervention was justified. The decision of the Law Lords in the United Kingdom in 1999 that Augusto Pinochet could be held accountable by Spain for crimes committed in Chile prompted the movement to invoke the doctrine of "universal jurisdiction," the principle that any country may prosecute those who are accused of certain international human rights crimes. Belgium cited that doctrine in 2001 when it convicted four Rwandan citizens of crimes committed in the 1994 genocide. And the same thing did the International War Crimes Tribunals for the former Yugoslavia and for Rwanda when they tried those accused of atrocities in those tragic places.

As it is seen above, with the passing of time states have become aware of the necessity of an international intervention in some problematic situations, which affect not only the country where the atrocities occur, but also the whole world. This is why they have accepted to resign a part of

their sovereignty to the international institutions, in order to better protect their nations and for a more fair and unbiased judgment of crimes of an international impact.

However, in order not to suppress the sovereignty of states, the Rome Statute of the ICC provides that the Court cannot start an investigation about a case which is being investigated by a State which has jurisdiction over it, unless the State does not want or is unable to hold the case and when the case has been investigated by a State and the State has decided not to prosecute the person concerned, unless this decision is a result of the inability or unwillingness of the State to prosecute.[323] This provision is an assertion for the states that their sovereignty will not be suppressed by the international institutions unless in those specified cases.

Conclusion

Genocide has been and is still one of the international communities' greatest concerns. Due to its cruelty and austerity it is considered as "the crime of crimes". It is a crime that has existed since long time ago, before it was even named, and it still continues to take place much more often than anyone can imagine or would like to admit.

This is the reason that over the past century, it has been given a lot of importance to this crime. The widespread acts of genocide in many states, as in Rwanda and Bosnia, and lately also in Sudan, have given a great impact in the international conscience resulting in some legal changes and developments. Two *ad hoc* tribunals were created, three genocide cases were sent before the International Court of Justice, the International Criminal Court was created, whose jurisdiction includes the crime of genocide, and lately the Office of the Special Adviser on the Prevention of Genocide was established.

These institutions had a great role in the definition of the crime of genocide and in the creation of the necessary mechanisms for the prosecution and punishment of its perpetrators. From one court to another, it can be noticed a development in the definition of the crime of genocide as an international crime, and in the methods of its prosecution and punishment.

It cannot left without mentioning here the contribution of States in the prevention, prosecution and punishment of genocide. They have agreed to relinquish a part of their sovereignty and have implemented the international provisions into their domestic law in order to create a

[323] Rome Statute of the International Criminal Court, (1998), Article 17 "Having regard to paragraph 10 of the Preamble and article 1, the Court shall determine that a case is inadmissible where: (a) The case is being investigated or prosecuted by a State which has jurisdiction over it, unless the State is unwilling or unable genuinely to carry out the investigation or prosecution; (b) The case has been investigated by a State which has jurisdiction over it and the State has decided not to prosecute the person concerned, unless the decision resulted from the unwillingness or inability of the State genuinely to prosecute; (c) The person concerned has already been tried for conduct which is the subject of the complaint, and a trial by the Court is not permitted under article 20, paragraph 3; (d) The case is not of sufficient gravity to justify further action by the Court.", found at http://untreaty.un.org/cod/icc/statute/romefra.htm, accessed in April 2013.

strong cooperation with other States and with the international organisms in the fight against genocide.

These developments have had their effects in the prevention of the crime of genocide, however, breaches of the international humanitarian law still continue to happen. This shows that these measures are not enough. Greater action must be taken. The ICC should revise its Statute and adopt it to the new needs of the world. States should increase their cooperation, an action that can be reached only by leaving apart the national interests of each state and giving more importance to, or better saying, putting into first place the international interests.

Another very important thing that should be done is the international community awareness about the risks of acts of genocide in their nations, and the reasons that cause it. Also the states themselves should be aware of the factors that can lead someone to commit genocide in their country and take measures to prevent those actions.

Especially in countries where the population is heterogeneous, consisting of different groups of people, and where one group may feel inferior than the others, governments should be very careful and take measures to prevent the partition among people of different groups, by not allowing the separation of them into categories based on race, ethnicity, religion or any other division. When these divisions are made in the eyes, ears, and minds of a people they may begin to fear each other, fear what is different and fear what they do not understand. This fear can become hate, and if assimilated by a government or any powerful enough group, it can lead to horrifying results. This is why governments should make great efforts to prevent and stop discrimination among groups, in order to prevent hatred which leads to actions of genocide. Governments should work for the awareness of their people against discrimination and hatred and should ensure the equity and equal treatment of all groups of society.

Bibliography

Morton J. S., Vijay Singh N., (2003), *The international legal regime on genocide*, Journal of Genocide Research, **5**(1);

Stone D., (2005), *Raphael Lemkin on the Holocaust*, Journal of Genocide Research, 7(4), December;

Xhafo J., *E drejta penale nderkombetare*, GEER, Tirane, (2009);

What is genocide? An evolving International framework, United States Holocaust Memorial Museum, found at http://www.ushmm.org/genocide/take_action/genocide , accessed in April 2013;

Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide, (1948);

Duffy H. & Suhr B. (2000) The Debate on the Constitutional Compatibility with the ICC, June, found athttp://www.iccnow.org/resourcestools/ratimptoolkit/generaltools/constitutionalissues/TheDebateonConstitutEng.pdf, accessed in April 2013;

Human Rights Watch, The Compatibility of the ICC Statute with certain Constitutional Provisions around the Globe, found at http://www.hrw.org/campaigns/icc/compatibility.htm, accessed in April 2013;

Rome Statute of the International Criminal Court, (1998), found at http://untreaty.un.org/cod/icc/statute/romefra.htm, accessed in April 2013.

http://www.oxfordbibliographies.com/view/document/obo-9780199796953/obo-9780199796953-0035.xml;

http://en.wikipedia.org/wiki/International_Criminal_Tribunal_for_the_former_Yugoslavia, accessed in April 2013;

http://www.icty.org/action/timeline/254, accessed in April 2013;

http://www.icty.org/sid/10250, accessed in April 2013;

http://www.icc-cpi.int/en_menus/icc/about%20the%20court/Pages/about%20the%20court.aspx, accessed in April 2013

http://www.icccpi.int/en_menus/icc/situations%20and%20cases/situations/situation%20icc%200205/Pages/situation%20icc-0205.aspx,accessed in April 2013

http://www.un.org/en/preventgenocide/adviser/, accessed in April 2013

Drejt një të Drejte Ndërkombëtare Penale të Mjedisit?

Valbona Ndrepepaj

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Procesi i Globalizimit, përveç pasojave pozitive, është shoqëruar më pasoja të shumta negative të cilat kanë shkelur të Drejtën Ndërkombëtare në përgjithësi e të Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit në veçanti. Si pasojë e kësaj akademikët e së drejtës gjithnjë e më tepër po intensifikojnë përpjekjet për krijimin e mekanizmave të rinj, jo vetëm për parandalimin e këtyrë shkeljeve, por dhe për procedimin penal të autorëve të tyrë. Natyrshëm, pra kuptohet se në qarqet akademike po flitet për të ashtëquajturën E Drejte Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, *inter alia*, po shtohen zërat për krijimin e Juridiksioneve Ndërkombëtare Penale për çdo shkelje më karakter penal që do të pësojë E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit, si kundërpërgjigje e mosefiçencës së juridiksioneve kombëtare në këtë drejtim. Pikërisht dhe fokusi i këtij artikulli është mbështetja e kësaj teorie, bërja e njohur për/në qarqet akademikë shqiptare; sigurisht i tërë ky proces do të shoqërohet dhe më kontributin tonë në konsolidimin e kësaj teorie si mekanizmi më efikas për parandalimin *in futures* të katastrofa të tilla natyrore si ajo e Cernobillit apo ajo e gjirit të Golfit në Meksikë. Për materializimin e këtij artikulli janë përdorur metodat hermeneutike dhe interpretative/analitike. Në artikull do të trajtohen çështjet e mëposhtme si: artikulli do të nisë me një trajtim të shkurtër të së Drejtës Ndërkombëtare të Mjedisit në aspektin pozitiv dhe doktrinor, problemet më shqetësuese të Mjedisit sot, mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e Mjedisit dhe mosefiçenca e tyre. Për të kaluar tek pika kyçe e artikullit: avantazhet dhe argumentet pro krijimit te një degë të re të së drejtës, E Drejta Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, trajtimi pozitiv dhe doktrinor i saj për aq sa është e mundur, trajtimi juridiko-shkencor i çështjës se cili mund të jetë mekanizmi më efikas për garantimin e kësaj të drejtë në praktikë *supra*. Për aq sa është e mundur ana teorike do të shoqërohet dhe me kazuse praktikë. Artikulli mbyllet me Konkluzione. Mbi të gjitha, ne, më anë të këtij artikulli synojmë të nxisim debat në rradhët e akademikëve të së Drejtës në përgjithësi, e asaj Penale në veçanti.

Fjalët kyçe: *Globalizimi, E Drejta Ndërkombëtare, E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit, E Drejtë Ndërkombëtare Penale, E Drejtë Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, Juridiksione Ndërkombëtare Penale.*

"We have forgotten how to be good guests, how to walk lightly on the earth as its other creatures do."

- **Barbara Ward**, *Only One Earth*, 1972.

Në vend të hyrjes

Procesi i Globalizimit, përveç pasojave pozitive, është shoqëruar më pasoja të shumta negative të cilat kanë shkelur të Drejtën Ndërkombëtare në përgjithësi e të Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit në veçanti. Si pasojë e kësaj akademikët e së drejtës gjithnjë e më tepër po intensifikojnë përpjekjet për krijimin e mekanizmave të rinj, jo vetëm për parandalimin e këtyrë shkeljeve, por dhe për procedimin penal të autorëve të tyre. Natyrshëm, pra kuptohet se në qarqet akademike po flitet për të ashtëquajturën E Drejte Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, *inter alia*, po shtohen zërat për krijimin e Juridiksioneve Ndërkombëtare Penale për çdo shkelje më karakter penal që do të pësojë E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit, si kundërpërgjigje e mosefiçencës së juridiksioneve kombëtare në këtë drejtim.

Pikërisht dhe fokusi i këtij artikulli është mbështetja e kësaj teorie, bërja e njohur për/në qarqet akademikë shqiptare; sigurisht i tërë ky proces do të shoqërohet dhe më kontributin tonë në konsolidimin e kësaj teorie si mekanizmi më efikas për parandalimin *in futures* të katastrofave të tilla natyrore si ajo e Cernobillit apo ajo e gjirit të Golfit në Meksikë. Për materializimin e këtij artikulli janë përdorur metodat hermeneutike dhe interpretative/analitike.

Në artikull do të trajtohen çështjet e mëposhtme: një trajtim i shkurtër i së Drejtës Ndërkombëtare të Mjedisit në aspektin pozitiv dhe doktrinor, problemet më shqetësuese të Mjedisit sot, mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e Mjedisit dhe mosefiçenca e tyre. Për të kaluar tek pika kyçe e artikullit: avantazhet dhe argumentet pro krijimit te një degë të re të së drejtës, E Drejta Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, trajtimi pozitiv dhe doktrinor i saj për aq sa është e mundur, trajtimi juridiko-shkencor i çështjës se cili mund të jetë mekanizmi më efikas për garantimin e kësaj të drejtë në praktikë *supra*.Për aq sa është e mundur ana teorike është shoqëruar dhe më kazuse praktikë.

Sigurisht kjo është një fushë e gjërë e së drejtës, po aq dhe sensitive. Kështu që, ne, nuk pretendojmë të ezaurojmë çdo element dhe t'i japim zgjidhje çdo problematike që shfaq ajo sot me anë të këtij artikulli. Mbi të gjitha, ne, më anë të tij synojmë të tërheqim vëmendjën e studiuesve të rinj të ligjit, që të përqendrojnë punën e tyre kërkimore, studimore në çështjet e mjedisit. Do të ishim të kënaqur dhe sikur ky artikull vetëm të nxiste debat në rradhët e akademikëve të së Drejtës në përgjithësi, e asaj Penale në veçanti. Natyrshëm kuptohet se, ne, me anë të këtij artikulli mbështesim dhe një hërë tendencen aktuale të ndarjës së të Drejtës Penale në degë të veçanta të saj *infra*.

E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit

Hyrje

Siç e cekem *supra* qëllimi i këtij artikulli është E Drejta Ndërkombëtare Penale e Mjedisit, por përpara se të kalojmë në trajtimin e saj e shohim më vend të trajtojmë çështje të tilla si: çfarë është Mjedisi, shkenca e Mjedisit, E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit etj. Kuptohet se këto çështje do të trajtohen aq sa është e nevojshme për të realizuar qëllimin e këtij artikulli. Sigurisht vetëm pasi të kemi një ide, përfytyrim të saktë rreth koncepteve *supra*, kryesisht të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, do të jemi më komodë të trajtojmë në mënyrë juridiko-shkencore të drejtën ndërkombëtare penale të mjedisit, pra a kemi një të tillë sot, në rast se jo a duhet të ekzistojë?

Të japësh një përkufizim për Mjedisin është sa e thjeshtë, aq dhe e vështire. Burimet në këtë drejtim janë të shumta. Pas një leximi të kombinuar të këtyrë burimeve më mjedis në *lato sensu* kuptojmë gjithçka që na rrethon, ndërsa në *strictu sensu* mjedisi është *tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër , ndodhet e ndryshon një send, zhvillohet një dukuri etj; gjithçka që rrethon një organizëm, një dukuri etj; hapësira a sendet që na rrethojnë; ambienti*[324].Sigurisht koncepti i njeriut për Mjedisin nuk ka qënë gjithmonë ky që është sot[325].

Dëshira e Njeriut për të njohur mjedisin në të cilën jeton, e mbi të gjitha për të ndikuar mbi të, bëri që të lindë Shkenca e Mjedisit, e cila është studimi i ndërveprimit të komponenteve të gjallë dhe jo të gjallë që përbëjnë mjedisin *supra*. Kjo shkencë, kryesisht, studion në mënyrë të theksuar impaktin që ka veprimtaria e njeriut mbi këta komponentë. Kuptohet se kjo shkencë është dinamike dhe përfshin në gjirin e saj ekspertë të fushave të ndryshmë, përshembull biologu studion biodiversitetin, një ekologjist studion sesi bimët dhe kafshët ndërveprojnë më mjedisin etj[326]. Por mjedisi nuk studiohet vetëm nga shkencat ekzakte *supra*, ka qënë dhe mbetet objekt i studimit të ekonomistëve, sociologëvë, politologëvë, filozofëvë, teologëvë, studime të gjitha këto për të kuptuar sesa, ne, e vleresojmë dhe si ndërveprojmë me mjedisin që na rrethon; sigurisht studimi i mjedisit nga fusha të ndryshme është i nevojshëm për të patur një kuptim të plotë dhe objektiv mbi mjedisin, si e vetmja mënyrë për të qënë në paqe me të[327].

Në vazhdën e kësaj panorame do të ishte *nonsens* të mendonim se mjedisi nuk është dhe objekt i së Drejtës. Jo vetëm fakti se është objekt studimi nga shumë fusha, por mbi të gjitha nevoja për të kufizuar aftësinë njeriut për ta manaxhuar mjedisin sipas dëshirës së tij, nevoja që gjatë punës se tyre kërkimore, studimore ekspertët e fushave të tjera ta trajtojnë mjedisin me respekt, ka bërë që

[324] Fjalori I Gjuhës së sotme shqipe i vitit 1982, faqe 1154
[325] Për më shumë lexo Kumar Mayank ,*What is environment* ?, <www.du.ac.in/fileadmin/DU/Academics/course_material/SE_01.pdf> last accessed in 1 March 2013.
[326] lexo për më shumë në <http://www.hartwick.edu/academics/majors-and-minors/special-minors/environmental-science-and-policy-minor/what-is-environmental-science> last accessed in 1 March 2013.
[327] Do të thotë të ndërveprojmë më mjedisin pa e dëmtuar atë.

mjedisi te jetë dhe objekt i së drejtës. E drejta interesohet për mjedisin jo vetëm në mënyrë të përgjithshme, por dhe në mënyrë të posacme.

E Drejta Ndërkombëtare e Mjedisit

Përpara se të trajtojme të drejtën ndërkombëtare të mjedisit e shohim më vend të themi dy fjalë për të drejtën e mjedisit në përgjithësi. Me të drejte te mjedisit[328] kuptohen standartet[329] e krijuara nga qeveritë për të manaxhuar burimet natyrore dhe cilësinë e mjedisit[330]. Sigurisht këto standartë aplikohen si ndaj personave fizikë, ashtu dhe ndaj atyrë juridikë (publikë dhe privatë)[331]. Pas këtij sqarimi jemi më komodë të trajtojmë tashmë të drejtën ndërkombëtare të mjedisit, por dhe në këtë moment lind nevoja të bëjmë një sqarim tjetër; diferenca që ekziston ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare, kjo për të patur të qartë kufinjtë e tyre. E drejta kombëtare e mjedisit është tërësia e normave të dala nga organet legjislative[332] të një shteti, që rregullojnë sferën e mjedisit *supra* dhe veprojnë brenda territorit të tij, këtu futet dhe koncepti i ekstraterritorialitetit[333].

Duke e marrë të mirëqenë konceptin e të drejtës ndërkombëtare publike në përgjithësi, me te drejtë ndërkombëtare te mjedisit *in lato sensu* kuptojmë marrëveshjet multilaterale ose disalaterale që lidhen ndërmjet shteteve të ndryshmë apo janë produkt i një organizmi ndërkombëtar *infra* që rregullojnë çdo çështje që prek mjedisin në nivel ndërkombëtar. Por që të japim një kuptim të saktë të termit e drejtë ndërkombëtare e mjedisit duhet të analizojmë tre elementet që e përbëjnë këtë koncept; e drejte, ndërkombëtare dhe mjedis.

Supra kemi përkufizuar termin mjedis[334], por tani do të shohim sesi përkufizohet ky term nga ligji: *" Mjedisi është lidhja e njeriut me ujin, ajrin, tokën dhe forma të tjera biologjike".*[335]

---

[328] Sigurisht mund ta përkufizojmë dhe në mënyrën klasike sipas kuptimit pozitiv, tërësi normash dhe rregullash të dala nga organet legjislative të një shteti për të rregulluar marrëdhëniet në këtë fushë; sipas kuptimit doktrinor, analiza dhe interpretimi që i bëhet këtij kuadri ligjor nga studiuesit e së drejtës. Madje mund ta shohim dhe si e drejtë subjektive, pra secili, nga ne, gëzon të drejtën të jetojë në një mjedis të shendoshë apo për të ndërvepruar me mjedisin, kuptohet brenda kuadrit ligjor *supra* (shenim i autorit)

[329] Përshembull standartë të tilla në Republikën e Shqipërisë i gjeni të përmbledhura në Akte legjislative mjedisore në Shqipëri, Tiranë 2010, botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, në Shqipëri; kurse disa akte të tilla Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë Akti mbi pastërtinë e ujit, Akti mbi pastërtinë e ajrit, Akti mbi politikat kombëtare të mjedisit etj

[330] Me burime natyrore dhe cilësi e mjedisit duhet kuptuar fusha të tilla si ajri, toka, uji, pyjet, kafshët etj

[331] Lexo për këtë *What is International Environmental Law*? <www.ucar.edu/communications/gcip/m3e**law**/m3pdfc1.pdf> last accessed in 1 March 2013.

[332] sqarojmë se është përdorur në numrin shumës në kontekstin për të mos përjashtuar normat që dalin nga qeveria, në vendin tonë vendimet e Këshillit të Ministrave përshembull, në numrin shumës mund të kihet në konsideratë për vendet federative si Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj

[333] ibid

[334] ibid

[335] Kështu përkufizohet mjedisi nga Bashkimi Europian në Direktiven 79/117, neni 2/10, 1979 O.J. (L 33) 36 (EC).

Eshtë pikërisht kjo lidhje e njeriut me mjedisin që merret nga e drejta[336] dhe bëhet objekt i saj. Duhet të theksojmë se ndryshimet që pëson mjedisi në mënyrë të natyrshme, jo të shkaktuara nga dora e njeriut, si përshembull termetet, vullkanet etj, janë jashtë fushës së veprimit të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, e cila bën objekt të saj vetëm ato ndryshime të mjedisit që diktohen nga njeriu[337].

Natyrshem lind pyetja çfarë e bën një çështje mjedisore të ketë karakter ndërkombëtar? Dhe në këtë rast do të përgjigjemi duke mbajtur në konsideratë parimin e përgjitshem se një çështje bëhet objekt i së drejtës ndërkombëtare sa herë që preken interesat e disa shteteve nga një veprim i vetëm, i caktuar, pra sa herë që si rezultat i këtij veprimi cënohet interesi publik ndërkombëtar. Ta ilustrojmë në rastin e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit më një shembull të thjeshte dhe hipotetik, kemi një lumë që kalon në territorin e disa shteteve(përshembull lumi Danub kalon në Rumani, Hungari dhe Serbi), në rast se në një moment eventual ndotet si rezultat i derdhjes në të, të mbeturinave të një fabrike në shtetin A, apsolutisht që kjo nuk është çështje vetëm brenda juridiksionit të shtetit A, bëhet objekt i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit. Pikërisht sepse është ndotur një lumë ndërkombëtar, janë cenuar interesat e disa shteteve(e qytetarëve të disa shtetëve). Për të njëjtën logjikë shiu acid, ngrohja globale janë objekt i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, sepse cenojnë interesin publik ndërkombëtar.[338]

Në vazhdën e kësaj analizë për shumë studiues në togëfjalëshin e drejtë ndërkombëtare e mjedisit termi ligj është më problematiku për faktin se ky term nënkupton ekzistencen e mekanizmave të forcës, e thënë më thjeshtë në rast se një shtet shkel të drejtën ndërkombëtare të mjedisit te këtë jo vetëm përgjegjësi morale apo politike, por dhe ligjore. Këto mekanizma force mungojnë në të drejtën ndërkombëtare të mjedisit, stanadartët e se cilës janë më tepër moralë dhe politikë. Sigurisht një konkluzion të tillë mund ta themi dhe pasi kemi marrë në konsideratë ndarjen kuadrit ligjor ndërkombëtar të mjedisit në *hard law* dhe *soft law*[339].

Natyrshëm lind pyetja se a duhet që këto standartë *supra* të quhen e drejtë/ligj? Për t'ju përgjigjiur në mënyrë shkencoro-juridike kësaj pyetje duhet të analizojmë shkurtimisht se çfarë është e drejta/ligji dhe elementet përbërës të një norme ligjore. Pasi kemi lexuar në mënyrë të kombinuar një sërë doktrinash në këtë drejtim arrijmë në konkluzionin se e drejta në përgjithësi dhe e drejta ndërkombëtare në veçanti janë një tërësi normash, rregullash juridikë që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore, do të veçonim këtu doktrinën ortodokse që thotë se e drejta ndërkombëtare

[336] Të kuptohet si e drejta ndërkombëtare e mjedisit
[337] Lexo për këtë Daniel M. Bodansky, *What is International Environmental Law*?, fq 17, në <http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1448809##> last accessed on 1 March 2013.
[338] *ut supra*
[339] se çfarë kuptohet më këto koncepte lexo në *What is International Environmental Law*?, faqe 1, në <www.ucar.edu/communications/gcip/m3e**law**/m3pdfc1.pdf> last accessed on 1 March 2013.

definohet kryesisht nga burimet e saj, pra nxjerrja e saj psh nga Organizata e Kombeve te Bashkuara definon jo vetëm karakterin e saj ndërkombëtar, por dhe e definon si normë juridikë. Gjithashtu në doktrinë thuhet se elementet e normës juridikë janë hipoteza, dispozita dhe sanksioni[340], kuptohet që nuk është objekt i këtij artikulli të sqarohen këto koncepte, por për efekt të kësaj analizë duhet të theksojmë se sanksioni, pra elementi i forcës, jo gjithmonë mund të jetë element i normës juridikë, kryesisht është element përcaktues i një normë juridikë penale. Elementi thelbësor i një i normë juridikë është dispozita.[341] Pas kësaj analizë dhe një leximi vertikal të disa traktateve të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit pyetjEs *supra* i përgjigjemi pozitivisht.[342]

Pas këtij vështrimi doktrinor të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit është momenti të përmendim disa nga marrëveshjet kryesore që përbëjnë korpusin e plotë të standartevë të kësaj të drejtë. Duhet të theksohet se numri i këtyrë i marrëveshjeve është shumë i madh, sepse çdo pjesë përbërëse e mjedisit ka rregullimin e vet ligjor, ndaj për efekt të këtij artikulli do të përmendën vetëm ato marrëveshje klasikë e më natyrë të përgjithshme. Numri i tyre i madh është dhe për faktin se kemi marrëveshje multilaterale dhe disalaterale *infra*; rajonale apo ndërkombëtare *infra* në këtë drejtim.[343] Disa nga këto konventa janë: Aarhus, konventa mbi aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe aksesin në Drejtësi për çështjet mjedisore, 1998. Konventa Espoo, 199, Protokolli i Kiotos, i Montrealit, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimaterike etj, fatkeqësisht dhe pse ekzistojnë një numër i madh marrëveshjes në formën e konventave, traktateve etj, që përbëjnë kuadrin ligjor ndërkombëtar për të adresuar problemet mjedisore ato karakterizohen nga implementimi i tyre jo i plotë, nuk kanë mekanizma shtrenguese, dhe shpeshhere nuk përputhen me njëra-tjetren; problematike është kjo situatë kryesisht në vendët në zhvillim.[344]

Në vazhdën e asaj që trajtuam *supra* do të ishte më vend të përmendim dhe disa mekanizma të krijuar për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që konventat e përmendura të gjejnë dhe zbatim në praktikë. Ashtu siç e kemi theksuar dhe here të tjera gjatë këtij artikulli qëllimi i tij është të trajtohet e drejta ndërkombëtare penale e mjedisit ndaj çështjet e tjera do të trajtohen për aq sa i shërbejnë këtij qëllimi. Në këtë artikull termi mekanizma do të merret *in lato sensu* pra do të përfshijmë jo vetëm mekanizma[345] të krijuara nga organizmat ndërkombëtarë për këtë qëllim, mekanizma të tillë

---

[340] për një sqarim të tyre lexo Luan Omari, *Parime dhe institucione të së drejtës publikë*, Tiranë 2007, faqe 186
[341] *ut supra*
[342] për një qasje ndryshe të kësaj problematike lexo në Daniel M. Bodansky ,*What is International Environmental Law*? <http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1448809##> last accessed on 1 March 2013.
[343] lexo për më shumë Lang.W ,*Treaties as a source of International Environmental Law*, Lang. W, faqe 3 në <www.eolss.net/Sample-Chapters/C14/E1-36-05.pdf,> last accessed on 1 March 2013.
[344] Lexo për më shumë në <www.ecovitality.org/bad**law**.htm> last accessed on 1 March 2013.
[345] Mekanizmat e krijuar për mbrojtjen e mjedisit

që parashikohen nga vetë konventat, disa gjykata ndërkombëtare që merren më çështjet mjedisore, por do të përmendim dhe atë çfarë bëhet nga akademikët në këtë drejtim.

Disa nga këto mekanizma të krijuar janë: Organizata Ndërkombëtare e Detit (IMO), Organizata e Ushqimit dhe Agrikulturës (FAO) të cilat janë agjensi të specializuara të krijuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në aktivitet mjedisore. Kombet e Bashkuara kanë krijuar dhe disa institucione si Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP), Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkura (UNDP), tek kjo e fundit për mjedisin është Komsioni për zhvillim të përshtatshem (CSD),[346]. Dukë qënë se këto agjensi dhe institucione ekzistojnë dhe veprojnë të pavarur nga njëri-tjetri, por mbi të gjitha pa e koordinuar punën bashkë ka bërë që puna e tyrë përgjithësisht të karakterizohet nga mosefikasiteti[347], por dhe INTERPOLI luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Juridiksionet Ndërkombëtarë Gjyqësore që trajtojnë çështjet e mjedisit janë Gjykata Ndërkombëtare e Detit, Gjykata Ndërkombëtare Penale, Gjykata Europiane e Drejtësisë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut etj[348]. Lehtësisht kuptohet se si rezultat i mosefikasitetit të plotë të mekanizmave *supra*, por dhe numrit të madh të tyre çfarë e rrit shkallën e veshtirësisë së bashkëpunimit apo koordinimit të punës ndërmjet, numri i madh i marrëveshjeve apo konventave në këtë drejtim, shpeshhere pa patur në brendësi të tyrë mekanizma force/sanksione *supra*, duke mbajtur në konsideratë në këtë çast dhe frazën e famshme të Ciceroni *"Summum ius, summa iniuria"*[349]; duke bërë dhe një analizë të juridiksioneve gjyqësore *supra* ku lehtësisht kuptojmë kompetencat e tyrë territorale dhe lëndore të kufizuara[350], si dhe faktin që qëllimi i tyre primar nuk është të trajtojnë problemet që ka mjedisi, kjo rezulton dhe vetëm po të interpretojmë emertimin e tyre. Në vazhdën e kësaj që thamë, marrë në konsideratë dhe problemet e shumta që has Mjedisi sot (ndryshimet klimaterike, energjia e pastër, ndotje e ajrit dhe ujit, biodiversiteti dhe

[346] Disa mekanizma të tjerë janë IPCC, GEF, por brenda kompetencave të tyrë më çështjet e mjedisit merret dhe Organizata Botërore e Tregtisë (WTO), Banka Botërore etj . Për më shumë rreth këtyrë mekanizmave mund të lexoni në faqet e tyrë zyrtare në internet, ndërsa në aspektin doktrinor mund të lexoni Philippe Sands QC, *Principles of International Environmental* Law , London 2003, faqe 70-123

[347] lexo Donald K. Anton ,'*Treaty Congestion" in Contemporary International Environmental Law* ' faqe 11 në <http://ssrn.com/abstract=1988579> last accessed on 1 March 2013.

[348] Një listë të plotë të jurisprudences së këtyrë juridiksioneve gjyqësore, por jo vetëm e gjeni në librin librin e Philippe Sands QC, *Principles of International Environmental Law* , London 2003, në <www.cambridge.org> last accessed on 1 March 2013.

[349] Sa më shumë ligje, aq më pak Drejtësi.

[350] Përshembull Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kanë kompetence territoriale të kufizuar, e para brenda hapësirës territoriale të Bashkimit Europian, e dyta vepron vetëm brenda shteteve anëtare të Këshillit të Europës, ndërkohë që po flasim për të Drejtë Ndërkombëtare të Mjedisit. Gjykata Penale Ndërkombëtare ka kompetence lëndore të kufizuar që parashikohet taksativisht në nenin 5 të statutit të Romës dhe kryesisht në kohë luftë. Gjykata Ndërkombëtare e Detit kuptohet që nga terminologjia që është e specializuar vetëm për të Drejtën Detare. Natyrshëm lind pyetja se çfarë do të ndodhë për një çështje që është jashtë kompetencës se këtyrë juridiksioneve ? Eshtë debat i hapur

përdorimi i tokës etj[351].) si dhe problemet që shfaq e drejta ndërkombëtare e mjedisit *supra* na bëjnë të mendojmë se ka ardhur koha të mendojmë seriozisht për krijimin e një degë të re të së drejtës ose më saktë e një nën degë brenda së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, të drejtën ndërkombëtare penale të mjedisit. Theksojmë se ideja për krijimin e kësaj degë të re të së drejtës ndërkombëtare, mbi të gjitha autonomia e saj nga e drejta ndërkombëtare e mjedisit nuk është rrjedhojë vetëm e dëshirës së disa studiuesve për të krijuar një degë të rë të së drejtës, apo rrjedhojë e tendencës aktuale të së Drejtës Penale për t'u specializuar[352], por vjen si rezultat i problemeve të shumta më të cilat përballet sot mjedisi në përgjithësi dhe e drejta ndërkombëtare e mjedisit në veçanti që e bëjnë të nevojshme mbrojtjen e mjedisit dhe nga e drejta penale ndërkombëtare (e mjedisit). E thënë në mënyrë figurative është koha që mjedisin në të cilin jetojmë ta mbrojmë më "dhembë"[353].

Përpara se të kalojmë në pikën kryesore të artikullit e gjejmë më vend të theksojmë dhe rolin e madh që kanë luajtur studiuesit e së drejtës për krijimin dhe konsolodimin e të drejtës ndërkombëtare te mjedisit me punimet e tyre dukë bërë që të jetë lënde e veçantë në fakultetet e Drejtësisë në botë, madje ka dhe cikle masteri posaçerisht për këtë degë të së drejtës[354], qendra kerkimore shkencore si dhe revista shkencore specifike në këtë drejtim[355]. Eshtë pikërisht doktrina ajo që do t'i japë lëvizje dhe krijimit, konsolidimit të së drejtës ndërkombëtare penale të mjedisit.

E Drejta Ndërkombëtare Penale e Mjedisit

Siç e kemi theksuar zemra e këtij artikulli është e drejta ndërkombëtare penale e mjedisit, parimisht sot nuk ekziston një degë e tillë e së drejtës, ndaj këtu ne do t'i bashkëngjitemi atij grupi studiuesish të cilët mendojnë se ka ardhur koha që të krijohet kjo degë e re e së drejtës ndërkombëtare publike, si një përzierje e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit me të drejtën ndërkombëtare penale ose thënë më saktë është pika e takimit mes tyre. Të hedhësh një ide të tillë do të thotë se as e drejta ndërkombëtare e mjedisit dhe as ajo penale nuk janë eficente për t'i ofruar mjedisit mbrojtjen e nevojshme. Që e drejta ndërkombëtare e mjedisit nuk është e mjaftueshme në

---

[351] lexo për më shumë në <http://www.fwrgroup.com.au/10-environmental-problems.html dhe në http://wikis.lib.ncsu.edu/index.php/What_are_the_major_environmental_problems_affecting_the_development_of_Africa_today%3F> last accessed on 1 March 2013.

[352] lexo për këto tendenca V Ndrepepaj, N Kullojka, *Drejtësia Elektorale*, (Konference Shkencore Ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Tetor 2012); Jola Xhafo, *I mituri në procesin penal* , Tiranë 2011

[353] "Dhembët" nënkuptojnë të drejtën penale në përgjithësi, forcën e saj ndeshkuese, por kryesisht forcën e saj parandaluese.

[354] Shiko Adam Babich, *The Apolitical Law School Clinic*, (11 Clinical L. Rev. 447 2005). Si dhe këto faqe në internet "US News & World Report"<http://grad-schools.usnews.rankingsandreviews.com/grad/law/environ. last accessed on 1 March 2013. Washington and Lee University School of Law, Law Journal Rankings.

[355] Washington and Lee University School of Law, Law Journal Rankings

këtë drejtim e trajtuam *supra*[356], natyrshëm lind pyetja po e drejta ndërkombëtare penale a ja ofron mjedisit mbrojtjen për të cilën ai ka nevoje sot?

E Drejta Ndërkombëtare Penale

Për t'i dhënë një përgjigje shkencoro-juridike kësaj pyetje duhet të dimë një herë se çfarë është e drejta ndërkombëtare penale, kush janë kufinjtë e saj lëndor? Në këtë moment ajo çfarë ka më rëndësi për efekt të këtij punimi është të kemi të qartë kufinjtë territorialë dhe lëndorë të së drejtës ndërkombëtare penale, kryesisht kufinjtë lëndore. Po ti referohemi doktrinës ekzistojnë disa perkufizime për të drejtën ndërkombëtare penale, ku në mendimin tonë më i sakti është: "*E Drejta Ndërkombëtare Penale është tërësia e normave penale që përcaktojnë veprat penale me elementë ndërkombëtare, mekanizmat mbi të cilat bazohet ndeshkimi i autorëve të tyre si dhe bashkëpunimi ndërmjet shteteve në luftë kundër kriminalitetit ndërkombëtar.*"[357], një përkufizim tjetër e përcakton si:" *tërësia e normave ndërkombëtare, veçanërisht konventat, traktatet, statutet që përcaktojnë sjellje të caktuara si krime ndërkombëtare.*" Pra nga një leximi i kombinuar i këtyre dy përkufizimeve dhe duke avancuar kuptojmë se e E Drejta Ndërkombëtare Penale është një degë e së drejtës ndërkombëtare publike, që përcakton llojet e krimeve ndërkombëtare dhe mënyrën e procedimit të tyre, që përgjithësisht ka karakter ndërkombëtar[358], por jo vetëm[359].

Sigurisht E Drejta Ndërkombëtare Penale[360] *inter alia* Juridiksionet Ndërkombëtare Penale [361] nuk kanë patur pamjen që kanë sot, kanë kaluar në një proces të gjatë evoluimi dhe zhvillimi[362], por për efekt të këtij punimi do të marrim në konsideratë dhe do të analizojmë Statutin e Romës me të cilin u materializua Gjykata Ndërkombëtare Penale. Në mendimin tonë kjo shënon stadin më të lartë të zhvillimit në këtë drejtim, aq sa shumë studiues të kësaj fushë e quajnë Statutin e Romës, Kodi Ndërkombëtar Penal, mendim te cilin, ne, e mbeshtesim plotësisht.

Për qëllim të këtij artikulli më interes është të analizohet Neni 5 i këtij Statuti, që vijon:

1. Juridiksioni i Gjykatës kufizohet në krimet më serioze, që janë shqetësim për bashkësinë

---

[356] sigurisht nuk do të mjaftohemi vetëm me problematikat e përmendura më lart .
[357] shiko Jola Xhafo, *E Drejta Penale Ndërkombëtare,* (Tiranë 2009) fq 11
[358] themi përgjithësisht në varësi të parimit mbi të cilin ngrihet juridiksioni gjyqësor ndërkombëtar, përshembull Tribunali i Hagës në Statutin e tij përcaktin parimin e superioritetit, neni 9.Gjykata Ndërkombëtare Penale në nenin 17/1 përcakton parimin e komplemantaritetit
[359] lexo What is International Criminal Law?, *Supporting the Transfer of Knowledge and Materials of War Crimes Cases from the ICTY to National Jurisdictions, funded by the European Union* , Developed by International Criminal Law Services, faqe 9.
[360] *ibid*
[361] lexo për këtë proces evoluimi Lindsay Raub ,*Positioning hybrid tribunlas in International Criminal justice.*
[362] *ibid*

ndërkombëtare në tërësi. Gjykata, në pajtim me këtë Statut, ka juridiksion për krimet në vijim:
(a) krimin e gjenocidit;
(b) krimet kundër njerëzimit;
(c) krimet e luftës;
(d) krimin e agresionit.
2. Gjykata e ushtron juridiksionin mbi krimin e agresionit, menjëherë sepse të miratohet një dispozitë në pajtim me nenet 121 dhe 123, që përkufizojnë krimin dhe vendosin kushtet në të cilat Gjykata e ushtron juridiksionin në lidhje me atë krim. Një dispozitë e tillë është në pajtim me dispozitat përkatëse të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

si dhe nenet 6,7,8 ku jepet kuptimi i secilës figurë krimi që përmban neni 5. Përdorimi në nenin 5 të togëfjalëshit …*krimet serioze, që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare.*…nuk mund të merret në *lato sensu*, sepse neni në vazhdim të tij përcakton në mënyrë taksative se kush është kompetenca lëndore e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, kjo rezulton nga një interpretim gjuhësor i togëfjalëshit … *ka juridiksion për krimet në vijim:* …, *prima facia* shohim se këtu nuk përfshihet asnjë Krim Mjedisor *infra* pa çka se shumica e tyre kanë jo vetëm karakter ndërkombëtar, por dhe serioz. Vazhdojmë dukë analizuar nenet 6,7,8, kryesisht objektin dhe anën objektive të tyre, sepse këto dy elementë të veprës penale na japin një informacion nëse futet mbrojtja e mjedisit në suazën e këtij Statuti, gjatë interpretimit mbajmë në konsideratë faktin se ligji penal nuk pranon interpretime tepër të zgjeruara për shkak të karakterit të tij sensitiv dhe si garanci.

Neni 6, Genocidi, nuk mbron ose thënë më saktë nuk përfshin në suazën e tij krimet mjedisore, kjo duke patur në konsideratë objektin juridik dhe material të këtij neni, objekti juridik është mbrojtja e jetës dhe shendetit të njeriut nga veprimet të dhunshme, që bëhet subjekt pasiv i kësaj vepre për shkak të grupit ku bën pjesë. Objekti material janë grupet e ndryshme etnike, raciale etj dhe ana objektive[363] e këtij neni nuk thotë asgjë në favor të mbrojtjes së mjedisit nga Kodi Ndërkombëtar Penal. E njëjta linjë logjikë dhe arsyetim përdoret dhe në nenin 7, Krimet kundër Njerëzimit. Këto dy nene në mendimin tonë kanë të ndryshëm objektin material, i cili në nenin 6 është më specifik, kurse në nenin 7 është gjithëpërfshirës, si dhe ana objektive e nenit 7 është më gjërë. Ndërsa në nenin 8, Krimet e Luftës, ndryshon situata, sigurisht as në këtë nen nuk përmendet termi mjedis apo krim mjedisor shprehimisht, por logjika na lejon t'ju bëjmë një interpretim të zgjeruar pikave2/a/ iv, b, b/xvii, b/xviii të këtij neni. Pra këtu mund të flasim për mbrojtje të mjedisit nga Kodi Ndërkombëtar Penal, por vetëm në kohë luftë. Në vazhdën e kësaj analizë mund të themi se E drejta penale ndërkombëtare i ofron mjedisit një mbrojtje penale të paktë dhe kjo madje vetëm në kohë luftë. Shqetësimi shtohet dhe po të mbahet në konsideratë neni 17 i Statutit,

[363] shiko anën objektive të këtij neni

që parashikon parimin e komplementaritetit, çka do të thotë se Gjykata intervenon vetëm kur shteti për arsye objektive apo subjektive dështon të procedojë çështjen, realiteti na tregon se mjedisi si objekt dytësor i nenit 8 dhe periferik mund të anashkalohet pa u marrë në konsideratë.[364] Natyrshëm lind pyetja kush do të përgjigjet penalisht për ngrohjen globale, ndotjen e ajrit, ujit etj dhe përpara kujt duhet të përgjigjet, kjo kryesisht në kohë paqeje?Përgjigjja ka debat.

A duhet një E Drejte Ndërkombëtare Penale e Mjedisit ?

Pas asaj që trajtuam, lehtësisht, mund të themi se as e drejta ndërkombëtare e mjedisit dhe asaj e drejta penale ndërkombëtare nuk kanë forcën e nevojshmë për t'i ofruar mjedisit mbrojtjen e nevojshme *vis a vis* problemeve të shumta që e rrezikojnë. Shumica e studiuesve të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit e pranojnë këtë në studimet e tyrë, ku theksojnë se ka ardhur koha që kjo e drejtë të pajiset më mekanizma forcë[365], por pa trajtuar natyrën juridikë të këtyre mekanizmave. E përkrahim këtë grup studuesish në momentin kur konkludojnë se ka ardhur koha që e drejta ndërkombëtare e mjedisit të forcohet, por i kritikojmë për faktin se heshtin për natyrën jurdike të kësaj forcë. Në këtë pikë bashkohemi me atë grup studiuesish[366] që gjithnjë e në rritje po flasin për të ashtëquajturën e drejtë ndërkombëtare penale e mjedisit. Pra në mendimin tonë patjeter që kjo forcë duhet të këtë dhe natyrë juridike penale. Theksojme dhe një herë se këtë nuk e themi thjesht nga dëshira jonë si studiues të së drejtës penale *supra*, apo nga dëshira për të krijuar një *ius novum*, *supra*, por nga problemet e mëdha që ka mjedisi sot *supra*, që cënojnë drejtpërdrejt liritë dhe të drejtat themelore tonat për ujë, ajër dhe një mjedis të pastër, në respekt të numrit të madh të viktimave të krimeve mjedisore gjithnjë e në rritje[367], si dhe nga nevoja që dikush të përgjigjet penalisht për krimet mjedisore[368].

Teza jonë përkrahet jo vetëm nga këta faktorë socialë dhe moralë, por dhe nga kritere formale dhe juridike. Përshembull të marrim të trajtojmë termin krim mjedisor ndërkombëtar si dhe e drejtë ndërkombëtare penale, tek kjo e fundit nuk do të ndalemi sepse vlen ajo çka kemi thënë

---

[364] për më shumë informacion dhe një qasje tjeter të mbrojtjes se mjedisit nga e drejta ndërkombëtare penale lexo *The Role of International Criminal Law in Environmental Protection* në www.google.com

[365] lexo për këtë Kenji Watanabe, Saeko Ikeda, *what future for International Criminal Environmental Law?*, on December 24, 2010 në<http://ourworld.unu.edu/en/what-future-for-international-environmental-law/> last accessed on 1 March 2013.

[366] si një pioner i kësaj lëvizje në mendimin tonë është Frédéric Mégret, Ph.D. , kryesisht më artikullin e tij *The Problem of an International Criminal Law of the Environment*, COLUMBIA JOURNAL OF ENVIRONMENTAL LAW [Vol. 36:2]

[367] lexo për këtë *VICTIMS OF ENVIRONMENTAL CRIME – MAPPING THE ISSUES*, STUDIM NGA The International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy, March 2011, si dhe Rob White ,*Victims of nvironmental Crime*, School of Sociology and Social Work University of Tasmania, Australia

[368] raste të tilla të vënies para përgjegjësisë penale janë tepër të pakta në praktikë, shiko *The Role of International Criminal Law in Environmental Protection*.

supra, nga një lexim i kombinuar i disa burimeve me krim mjedisor *kuptojmë një shkelje të së drejtës së mjedisit dhe që është parashikiuar të mbrojë mjedisin*[369], sigurisht përfshirë karakterin ndërkombëtar, interesant është përkufizimi i këtij koncepti nga INTERPOLI: *krimi mjedisor është një problem ndërkombëtar serioz, gjithnjë e në rritje, që shfaqet në forma të ndryshme*. Marrë në konsideratë dhe kuptimin klasik të së drejtës penale si ligji që parashikon llojet e krimeve, masat dhe llojet e dënimeve për autorët tyre , si dhe llojet e krimeve mjedisore[370], që padyshim lypsin në mendimin tonë dhe procedura zbulimi, hetimi të veçanta për shkak të karakterit të tyre kompleks [371], por dhe gjykimi për shkak të kryrësve të tyre në jo pak raste shtete apo koorporata të fuqishme shtuar dhe gjithçka çfarë kemi trajtuar më lart e bëjnë imediate nevojën e ekzistencës të një teksti të së drejtës ndërkombëtare penale të mjedisit, më të gjithë çfarë e shoqëron këtë proces, sepse dy të drejtat e tjera të analizuara gjatë këtij punimi kanë *in vacuo* në këtë drejtim parimisht *supra*. Mos të harrojmë dhe rëndësinë e maksimës *nullum crimen, nulla poena sine lege*.

Në fund të kësaj analizë mendojmë të sqarojmë dhe një element të fundit, këto krime mjedisore ndërkombëtare do t'i nënshtrohen juridiksionit kombëtar apo një juridiksioni ndërkombëtar, në rast te këtij të fundit mbi çfarë parimi do të ngrihet: parimin e superioritetit apo komplementaritetit? Kjo pyetje ka nevojë për një analizë pak të thelluar, sepse në këtë moment intervenon parimi i sovranitetit, i cili mbetet ende tepër i shenjte. Siç e kemi cekur për shkak të natyrës së këtyre krimeve dhe kryrësve të tyre *supra*, ne, jemi në favor të juridiksionit ndërkombëtar. Sigurisht dhe në këtë rast dukë sjellë në fokus përseri natyrën e krimeve mjedisore, kryrësit e tyre, sa emergjente është situata në të cilën ndodhet mjedisi sot; duke bërë një balance të thjeshtë ndërmjet sovranitetit të një shteti dhe interesit publik ndërkombëtar, në mendimin tonë prevalon ky i fundit. Ndaj, ne, jemi të mendimit të krijohet Gjykata Ndërkombëtare e Mjedisit, si një gjykatë e përhershme, sipas modelit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale; ose të zgjerohet kompetenca lëndore e kësaj të fundit dhe për krimet mjedisore serioze ndërkombëtare. Por duke marrë në konsideratë faktin se termi mjedis është shumë i gjërë dhe kompleks jemi në favor te krijimit të gjykatë ndërkombëtare të mjedisit, e cila duhet të ngrihet mbi parimin e komplementaritetit, kjo jo vetëm në shenje respekti për parimin e sovranitetit, por dhe për faktin e zbulimit, hetimit, gjykimit të suksesshem të këtyre krimeve, sepse prova zbulohet, mblidhet dhe analizohet më mirë,më thjeshtë në vendin ku ka ndodhur krimi. Kur në vendin ku ndodh ose sjell pasojat krimi ky proces dështon atëherë intervenon gjykata ndërkombëtare e mjedisit. Duke sjellë dhe një here në vemendje rastin hipotetik të cituar në fillim të këtij artikulli[372] theksojmë se çdo

[369] <http://definitions.uslegal.com/e/environmental-crime/able> last accessed on 18 February 2013.
[370] ibid
[371] Ibid, ne jo pak raste mund të jene dhe krime të bardha (pa autor), por lind nevoja të mbrojmë viktimën.
[372] ndotja e lumit ndërkombëtar

problem eventual që mund të dalë gjatë procedurave hetimore apo gjyqësore mund të zgjidhet me anë mekanizmave të bashkëpunimit gjyqësor penal ndërkombëtar.

Konkluzione

Nisur nga fakti se të gjithë, ne, e dimë se çfarë është mjedisi, por e kemi të vështirë ta themi me fjalë ka bërë që ai të jetë objekt studimi nga shume shkenca. Sigurisht dhe e drejta e ka bërë mjedisin objekt të saj, për ta mbrojtur nga veprimet e paligjshme te njeriut, fillimisht në nivelin kombëtar. Por si rezultat i proceseve të Globalizimit gjithnjë e më tepër mjedisi po bëhet një problem ndërkombëtar duke bërë të nevojshme lindjen e të drejtës ndërkombëtare të mjedisit, e cila më gjithë zhvillimet e saj si në aspektin pozitiv, institucional ashtu dhe atë doktrinor e akademik *vis a vis* problemeve të shumta që ka mjedisi sot, sidomos me rritjen në cilësi dhe sasi të ashtëquajturëve krime mjedisore ndërkombëtare nuk po e justifikon veten, nuk ka mekanizmat e duhur të forcës për t'ju dhënë një zgjidhje këtyre problemeve/krimeve. Madje as e drejta ndërkombëtare penale nuk ka mekanizmat e duhur për të luftuar krimin mjedisor ndërkombëtar. Si rezultat i mangësive që shfaqin këto dy degë të së drejtës ndërkombëtare publike studiuesit po flasin gjithnjë e më tepër për krijimin e një degë të re të së drejtës ndërkombëtare publike, e drejta ndërkombëtare penale e mjedisit. Si një e drejtë që qendron ndërmjet të drejtës ndërkombëtare të mjedisit dhe të drejtës ndërkombëtare penale, por autonome prej tyre. Theksojmë se ideja për krijimin e kësaj degë të re të së drejtës ndërkombëtare, mbi të gjitha autonomia e saj nga e drejta ndërkombëtare e mjedisit nuk është rrjedhojë vetëm e dëshirës së disa studiuesve për të krijuar një degë të rë të së drejtës, apo rrjedhojë e tendencës aktuale të së Drejtës Penale për t'u specializuar, por vjen si rezultat i problemeve të shumta më të cilat përballet sot mjedisi në përgjithësi dhe e drejta ndërkombëtare e mjedisit në veçanti, që e bëjnë të nevojshme mbrojtjen e mjedisit dhe nga e drejta penale ndërkombëtare (e mjedisit). E thënë në mënyrë figurative është koha që mjedisin në të cilin jetojmë ta mbrojmë më "dhembë".

Ne, më anë të këtij artikulli, synojmë të tërheqim vëmendjën e studiuesve të rinj të ligjit të përqendrojnë punën e tyre kërkimore, studimore në çështjet e mjedisit. Do të ishim të kënaqur dhe sikur ky artikull vetëm të nxiste debat në rradhët e akademikëve të së Drejtës në përgjithësi, e asaj Penale në veçanti.

Bibliografia

Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe i vitit 1982,

O L, 2007, *Parime dhe institucione të së drejtës publikë*, Botimet Elena Gjika,Tiranë

J Xh, 2011 ,*I mituri në procesin penal*, Dr. Jola Xhafo, Botimet GEER, Tiranë

J Xh, 2009, *E Drejta Penale Ndërkombëtare*,Botimet GEER, Tiranë

N V, K N, *Drejtësia Elektorale*, Konference Shkencore Ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Tetor 2012 (nën publikim)

K M, *What is environment*? në <www.du.ac.in/fileadmin/DU/Academics/course_material/SE_01.pdf>

What is International Environmental Law?, në www.ucar.edu/communications/gcip/m3e**law**/m3pdfc1.pdf last accessed on 1 March 2013.

D B ,*What is International Environmental Law*?, në http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1448809## last accessed on 1 March 2013

L W,*Treaties as a source of International Environmental Law*, 3 në www.eolss.net/Sample-Chapters/C14/E1-36-05.pdf last accessed on 1 March 2013

D A, *Treaty Congestion" in Contemporary International Environmental Law* , në http://ssrn.com/abstract=1988579 last accessed on 1 March 2013

P S, *Principles of International Environmental Law* (London 2003)

http://www.fwrgroup.com.au/10-environmental-problems.html last accessed on 1 March 2013

What is International Criminal Law?, *Supporting the Transfer of Knowledge and Materials of War Crimes Cases from the ICTY to National Jurisdictions, funded by the European Union*, Developed by International Criminal Law Services

L R, *Positioning hybrid tribunlas in International Criminal justice*

K W, S I, *What future for International Criminal Environmental Law*?,në http://ourworld.unu.edu/en/what-future-for-international-environmental-law/ last accessed on 1 March 2013

J B, *Enforcement Mechanisms in International Law and International Environmental Law* http://definitions.uslegal.com/e/environmental-crime/able last accessed on 1 March 2013

http://wikis.lib.ncsu.edu/index.php/What_are_the_major_environmental_problems_affecting_the_development_of_Africa_today%3F last accessed on 1 March 2013

http://grad-schools.usnews.rankingsandreviews.com/grad/law/environ last accessed on 1 March 2013

Direktiva 79/117, neni 2/10, 1979 O.J. (L 33) 36 (EC), e Bashkimit Europian

Shtojce

Konventat kryesore në fushën e Mjedisit të ndara sipas pjesëve përbërëse të tij janë:
Atmosphere: Convention on Long-Range Transboundary Air Pollution (LRTAP), Geneva, 1979.Environmental Protection: Aircraft Engine Emissions Annex 16, vol. 2 to the 1944 Chicago Convention on Civil Aviation, Montreal, 1981.Framework Convention on Climate Change (UNFCCC), New York, 1992, including the Kyoto Protocol, 1997.Georgia Basin-Puget Sound International Airshed Strategy, Vancouver, Statement of Intent, 2002.Vienna Convention for the Protection of the Ozone Layer, Vienna, 1985, including the Montreal Protocol on Substances that Deplete the Ozone Layer, Montreal 1987. **Marine environment – regional conventions:** Convention for the Protection of the Marine Environment of the North-east Atlantic OSPAR Convention, Paris, 1992.Convention on the Protection of the Marine Environment of the Baltic Sea Area 1992 Helsinki Convention, Helsinki, 1992. Conventions within the UNEP Regional Seas Programme**.** Convention on the Protection of the Black Sea against Pollution, Bucharest, 1992. Convention for the Protection and Development of the Marine Environment of the Wider Caribbean Region, Cartagena de Indias, 1983. Convention for the Protection, Management and Development of the Marine and Coastal Environment of the Eastern African Region (Nairobi Convention), Nairobi, 1985.Convention for the Protection and Development of the Marine Environment and Coastal Region of the Mediterranean Sea Barcelona Convention, Barcelona, 1976.Convention for the Protection of the Natural Resources and Environment of the South Pacific Region, Nouméa, 1986.Convention for the Protection of the Marine Environment and Coastal Area of th South-east Pacific, Lima, 1981.Convention for Co-operation in the Protection and Development of the Marine and Coastal Environment of the West and Central African Region, Abidjan, 1981.Framework Convention for the Protection of the Marine Environment of the Caspian SeaKuwait Regional Convention for Co-operation on the Protection of the Marine Environment from Pollution, Kuwait, 1978. Regional Convention for the Conservation of the Red Sea and the Gulf of Aden Environment, Jeddah, 1982. **Freshwater resources:** Convention on the Protection and Use of Transboundary Watercourses and International Lakes (ECE Water Convention), Helsinki, 1992. **Hazardous substances:** Convention on the Control of Transboundary Movements of Hazardous Wastes and their Disposal, Basel, 1989. Convention on Civil Liability for Damage Caused during Carriage of Dangerous Goods by Road, Rail, and Inland Navigation Vessels (CRTD), Geneva, 1989. Convention on the ban of the Import into Africa and the Control of Transboundary Movements and Management of Hazardous Wastes within Africa, Bamako, 1991. Convention on the Transboundary

Effects of Industrial Accidents, Helsinki, 1992. Convention on the Prior Informed Consent Procedure for Certain Hazardous Chemicals and Pesticides in International Trade, Rotterdam, 1998. European Agreement Concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Inland Waterways (AND), Geneva, 2000. European Agreement concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Road (ADR), Geneva, 1957. FAO International Code of Conduct on the distribution and use of Pesticides, Rome, 1985. Stockholm Convention Stockholm Convention on Persistent Organic Pollutants Stockholm, 2001. Waigani Convention Convention to Ban the Importation into Forum Island Countries of Hazardous and Radioactive Wastes and to Control the Transboundary Movement and Management of Hazardous Wastes within the South Pacific Region, Waigani, 1995. **Marine living resources:** Convention for the Conservation of Antarctic Marine Living Resources (CCAMLR), Canberra, 1980. Agreed Measures for the Conservation of Antarctic Fauna and Flora Convention for the Conservation of Antarctic Seals Convention for the Conservation of Antarctic Marine Living Resources Protocol on Environmental Protection to the Antarctic Treaty**.** International Convention for the Conservation of Atlantic Tunas (ICCAT), Rio de Janeiro, 1966. International Convention for the Regulation of Whaling (ICRW), Washington, 1946. **Nature conservation and terrestrial living resources:** Antarctic Treaty, Washington DC, 1959. World Heritage Convention Convention Concerning the Protection of the World Cultural and Natural Heritage, Paris, 1972. Convention on Biological Diversity (CBD), Nairobi, 1992. Convention on the Conservation of Migratory Species of Wild Animals (CMS), Bonn, 1979. Convention on the International Trade in Endangered Species of Wild Flora and Fauna, (CITES), Washington DC, 1973. Ramsar Convention Convention on Wetlands of International Importance, especially as Waterfowl Habitat, Ramsar, 1971. Convention to Combat Desertification (CCD), Paris, 1994. FAO International Undertaking on Plant Genetic Resources, Rome, 1983. International Tropical Timber Agreement, (ITTA), Geneva, 1994. **Nuclear safety:** Comprehensive Test Ban Treaty 1996**.** Convention on Assistance in the Case of a Nuclear Accident or Radiological Emergency (Assistance Convention), Vienna, 1986. Convention on Early Notification of a Nuclear Accident (Notification Convention), Vienna, 1986. Convention on Nuclear Safety, Vienna, 1994. Treaty Banning Nuclear Weapon Tests in the Atmosphere, in Outer Space, and Under Water**.** Vienna Convention on Civil Liability for Nuclear Damage, Vienna, 1963. **Marine environment – global conventions:** Convention on the Prevention of Marine Pollution by Dumping of Wastes and Other Matter (London Convention), London, 1972. International Convention for the Prevention of Pollution from Ships, 1973, as modified by the Protocol of 1978 relating thereto (MARPOL 73/78), London 1973 and 1978. International Convention for the Prevention of Pollution of the Sea by Oil, London 1954, 1962 and 1969. International Convention on Civil Liability for Oil Pollution Damage

(CLC), Brussels, 1969, 1976,1984 and 1992. International Convention on the Establishment of an International Fund for Compensation for Oil Pollution Damage(FUND)1971 and 1992, Brussels, 1971/1992. International Convention on Liability and Compensation for Damage in Connection with the Carriage of Hazardous and Noxious Substances by Sea (HNS), London, 1996. International Convention on Oil Pollution Preparedness, Response and Co-operation (OPRC), London, 1990. International Convention Relating to Intervention on the High Seas in Cases of Oil Pollution Casualties Intervention Convention, Brussels, 1969. Protocol on Preparedness, Response and Co-operation to Pollution Incidents by Hazardous and Noxious Substances OPRC-HNS Protocol, London, 2000. United Nations Convention on the Law of the Sea LOS Convention, Montego Bay, 1982.

Ndërmjetësimi dhe Drejtësia Restauruese në Legjislacionin Penal Shqiptar

Alma Bela[1], Blerina Mullisi[2]

[1]Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tirana, Albania

[2] Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tirana, Albania

Abstrakt

Rritja e kriminalitetit është një problem shqetësues jo vetëm për Shqipërinë por për të gjithë botën. Si e tillë, vënde të ndryshme janë përpjekur të gjejnë mënyra të tjera alternative për ta luftuar atë. Të gjithë sot, jemi dëshmitarë ku problemi i kriminalitetit është shqetësues dhe kërkon alternativa të përshtatshme për luftën dhe parandalimin e tij. Fundi i shekullit të XX dhe fillimi i shekullit XXI, i gjeti shtetet e Europës duke përpunuar një alternativë të re, atë të ndërmjetësimit.

Ky institut i faljes dhe pajtimit, ka qenë traditë shekullore e popullit shqiptar e sanksionuar dhe në kanunet e kohës ku historikisht populli shqiptar edhe në kushtet e mungesës së shtetit të pavarur e të pushtimeve të huaja, nuk ka jetuar në anarki por nëpërmjet normave të se drejtës zakonore ka arritur të vetëqeveriset. Pikërisht dhe fokusi i këtij punimi do të jetë dërmjetësimi dhe drejtësia restauruese e zbatuar në legjislacionin penal aktual shqiptar.

Punimi do të përmbajë: Në fillim paraqitet një historik i zbatimit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese në Shqipëri. Për të kaluar më pas në një prezantim të legjislacionit aktual, lidhur me zbatimin e tyre. Më pas paraqiten problematikat e këtyre dy instituteve: Si dhe sa janë zbatuar në praktikë? Çfarë problemesh ka patur? Pse nuk ka patur zbatim të gjerë? A ka patur vendime të Gjykatës Europianë të Drejtave të Njeriut në këtë fushë?

Në këtë punim përveçse bëhet një paraqitje e përgjithshm, gjithashtu evidenton situatën aktuale dhe në fund mbyllet duke paraqitur konkluzionet dhe disa rekomandime.

Ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese, janë mënyra më e mirë për të zgjidhur mosmarrëveshjet në bazë të vullnetit të palëve.

Fjalë kyçe: *Dëmshpërblimi i Gj.E.D.Nj, Legjislacioni penal shqiptar, Ndërmjetësimi dhe Drejtësi Restauruese, Vullnet i palëve.*

Hyrje

Ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese, janë dy nocione jo të panjohura për shqiptarët. Si një formë organizimi jashtëgjyqësore dhe zgjidhjeje të konflikteve midis palëve, kjo mënyrë e menaxhimit të situatave është vlerësuar sot si mjaft e rëndësishme dhe në dimensione europiane.

Për mirëfunksionimin e ndermjetësimit gjejmë një sërë rekomandimesh të Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve evropiane, si *"Parimet bazë të Kombeve të Bashkuara lidhur me përdorimin e programeve të Drejtësisë Restauruese në çështjeve penale"* dhe Rekomandimi i Komiteteve të Ministrave të Këshillit të Evropës (99)19 "*Në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale"*. Dhe, pikërisht fokusi i këtij punimi do të jetë legjislacioni aktual, ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese në përputhje me rekomandimet e lartpërmendura.

Evoluimi i faljes dhe pajtimit në Shqipëri

Instituti i faljes dhe pajtimit, siç përmendëm edhe më lart, ka qenë një traditë për popullin shqiptar dhe këtë e gjejmë të pasqyruar veçanërisht në Kanunin e Lek Dukagjinit, Kanunin e Skëndërbeut, Kanunin e Labërisë etj. Këto kanune përmbajmë një trajtim të hollësishëm, rregulla dhe proçedura të qarta për pajtmin e gjaqeve dhe pasojave që vinin prej tij. Si pasqyrim i karakterit dhe karakteristikave kulturore të banorëve të zonës, në këto kanune shikojmë dhe organizimin e shoqërisë në atë përiudhë duke dokumentuar se, edhe pse nuk funksiononte një shtet ligjor, marrëdhënet shoqërore në popullin shqiptar kanë patur një rregullim të posaçëm. Kanunet paraqiten si institute juridike, ku në themel qëndronte ndjenja e solidaritetit, nevojës për mbrojtje dhe siguri, dhe gjithashtu zemërgjerësia dhe humanizmi i popullit.

Në fillimet e tij instituti i pajtimit dhe faljes gjente zbatim vetëm për hakmarrjen dhe gjakmarrjen, por më vonë zbatimi i tij u shtri edhe në konflikte të tjera me karakter penal, civil, administrativ etj, ku pjesë kryesisht, zinin mosmarrëveshjet në lidhje me pronësinë dhe dëmet.

Pas krijimit të Shtetit të Pavarur Shqiptar në 28 Nëntor 1912, vazhdonte që të ekzistonte dhe të funksiononte ndërmjetësimi për pajtim dhe falje i gjaqeve dhe i konflikteve të tjera. Qeveria e Vlorës, e kryesuar nga atdhetari i madh Ismail Qemali, ndonëse vazhdoi për një kohë jo të gjatë për shkak të Luftës Ballkanike, Luftës së dytë Botërore dhe gjëndjes së ndërlikuar të brendshme, për aq sa qëndroi, kishte në qendër të politikës së saj pajtimin dhe bashkimin e popullit në mbrojtje të ftores së arritur. Në këtë kuadër u hodhën hapat drejt organizimit të drejtësisë, përgatitjes së

legjislacionit ose përshtatjes së tij kushteve të vendit etj.[373] Kjo qeveri në 3 maj 1913 hartoi Kanunin e Dëmeve, në të cilin parashikonte rregulla dhe sanksione për ata që shkaktonin dëme në bujqësi, dëme këto të shkaktuara nga dashja ose nga pakujdesia.

Gjatë viteve në vijim do të kemi baza ligjore të ndryshme si Kodi Civil i viteve 1929, i cili zgjidhte mosmarrëveshjet civile. Ligji nr 83 datë 23 maj 1928 "*Mbi administratën civile të Mbretnis Shqiptare*" ku parashikohej se pleqësia pajton ngatërresat që lindin midis katundeve, por këto ligje nuk kishin një shtrirje gjithpërfshirëse pasi paralelisht me to, në zonat malore zbatoheshin kanunet.

Pas Luftës së Dytë Botërore, pas çlirimit të Shqipërisë, pajtimi i gjaqeve u kthye në një qëllim në vetvete, në një lëvizje popullore. U krijuan gjykatat shoqërore në bazë të dekretit nr. 4426, datë 23.09.1968 ndryshuar më vonë me dekretin nr. 4475, datë 14.01.1969, nr. 5634, datë 30.09.1977 dhe nr. 5913, datë 26.06.1979 "*Mbi gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe lagjeve të qyteteve*"[374]. Neni 15 parashikonte se roli që ato luanin ishte pajtimi i çështjeve civile dhe penale që ndiqen mbi ankimin e të dëmtuarit, gjykata si rregull me të marrë kërkesën, bën të gjitha përpjekjet për të pajtuar palët. Gjithashtu edhe Kodi i Proçedurës Penale i vitit 1979, i cili hyri në fuqi në vitin 1980, në nenin 63, parashikonte mundësinë e të dëmtuarit nga vepra penale që në bazë të vullnetit të tij të hiqte dorë nga ankimi.

Ndërmjetësimi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, ai ushtrohet në përputhje me ligjislacionin aktual shqiptar. Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të konflikteve ka karakter human, pasi kultivon ndjenjën e tolerancës dhe ka për qëllim zgjidhjen e pranueshme prej palëve në konflikt, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara. Në mbështetje të Rekomandimit nr.(99)19 "*Në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale*" dhe ligjit nr. 10 389, datë 24.02.2011 "*Për ndërmjetësimin në zgjidhje të mosmarrëveshjeve*", parashikon disa parime të cilat përbëjnë dhe avantazhin kryesor të ndërmjetësimit, si një alternativë e zgjidhjes së konflikteve.

Ndërmjetësimi gjen zbatim atëherë kur palët në bazë të vullnetit të lirë, bien dakord, të zgjidhin konfliktin e tyre, kjo pasi janë njohur me të drejtat që kanë, natyrën e procedurës të ndërmjetësimit dhe pasojave të mundshme që mund të vijnë. Ndërmjetësimi gjithashtu :

- Inkurajon dhe ndihmon shkëmbimin e informacionit në një mjedis jo armiqësor;

[373] Elezi, I. "Falja dhe pajtimi i gjaqeve, si dhe i konflikteve të tjera pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar", Ndermjetësimi per pajtimin në konfliktet penale, fq 40.
[374] Përmbledhëse e përgjithshme e legjislacionit në fuqi të RPSSH, 1945-1979, vëll.I, fq 546-547.

- Ndihmon palët që të kuptojnë mendimet dhe vështirësitë e njëri-tjetrit;
- Ndihmon palët në promovimin në nivel produktiv të shprehjes emocionale;
- Ndihmon në zbulimin e interesave, të cilat palët ngurojnë që t'i shpalosin njëri-tjetrit, por që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit;
- Ndihmon palët që të vlerësojnë realisht alternativat e tyre në marrëveshje miqësore;
- Bazohet në parimi e barazisë së palëve;
- Ndihmon dhe respekton fleksibilitetin e transparencës së proëesit dhe vullnetit të palëve, nëse ata duan të vazhdojne të zgjidhin konfliktin e tyre në këtë mënyrë alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes apo dëshirojnë që të heqin dorë.

Ndryshe nga gjykimi i cili si parim zhvillohet me dyer të hapura, ndërmjetësimi është konfidencial.

Një tjetër avantazh i ndërmjetësimit është ndërmjetësi, si palë e tretë që zgjidhet nga palët. Për mirëfunksionimin e proçesit të ndërmjetësimit, duhet siguruar zgjidhja e mosmarrëveshjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri.[375] Ndërmjetësi duhet të jetë i pavarur dhe asnjanës në zgjidhjen e konfliktit, dhe nëse ka konflikt interesi, ai duhet të heqë dorë.[376] Gjithashtu, ka detyrimin që të ruajë konfidencialitetin e të gjithë inforamcionit që del nga ndërmjetësimi, përveç kur palët kanë dhënë pëlqimin me shkrim.

Ndërmjetësimi ofron këto përparësi pasi ai është "negocim i asistuar". Prezenca e palës së tretë neutrale që vepron si lehtësues në negociata ndihmon në uljen e barrierave në komunikim, shton prespektiva të ndryshme në kontekst që të ndihmojë palët në procesin e tyre të komunikimit dhe negocimit. Fakti se pala e tretë nuk është gjyqtar, por vetëm përçues informacioni, mundëson palët që të komunikojnë midis tyre. Prezenca dhe kontrolli i proçesit nga një pale e tretë mundëson komuniktimin efektiv dhe zgjidhjen e konflikt.

Gjithsesi, nga ana tjetër mund të themi se ndërmjetësimi nuk do të jetë efektiv kur njëra palë nuk është e ndershme, apo nuk shpalos informatat thelbësore, apo nuk vepron në mirëbesim. Ndërmjetësimi do të jetë më pak efektiv nëse pala kupton se ka mundësi më të mira përpara një forumi tjetër zgjidhjes së konflikteve. Në këtë rast, nuk ka stimulim për këtë palë që të angazhohet në ndërmjetësim efektiv dhe të sinqertë.[377] Gjithashtu ndërmjetësimi nuk është efektiv, edhe atëherë kur palët që kanë marrë pjesë, nuk zbatojnë marrëveshjen e nënshkruar.

---

[375] Kodi Evropian i Etikës për Ndërmjetësit

[376] Kodi Evropian I Etikës për Ndërmjetësit dhe ligji nr 10 389 dt 24.02.2011 *"Për ndërmjetësimin në zgjithje të mosmarrëveshjeve"*

[377] USAID, Manual trajnimi: Ligji për Ndërmjetësimin

Ndërmjetësimi në legjislacionin aktual shqiptar

Ndërmjetësimi është një veprimtari jashtëgjyqësore që nënkupton në përmbajtje të nenit 2/1 të ligjit 10 385 date 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshje" dy situata juridike:

- Rastin kur ndërmjetësimi zgjidhet si alternativë e drejtperdrejtë nga palet, duke mos shfrytëzuar asnjë alternativë tjetër për zgjidhjen e konfliktit, si dhe
- Rastin kur mosmarrëveshja është paraqitur për zgjidhje pranë një organi gjyqësor, administrativ, apo arbitrazhi dhe më pas palët me vullnetin e tyre vlerësojnë se do të ishte më e frytshme shfrytëzimi i alternativës së ndërmjetësimit.

Në këto rastë proçesi i filluar ndërpritet dhe pritet nëse palët do të arrijnë të zgjidhnin konfliktin e tyre duke arritur në një marrëveshje, ku të dyja palët dalin të fituara.Duhet të shtojmë gjithashtu se nuk kemi vetëm ndërmjetësimin në bazë të vullnetit të palëve, por ekziston edhe ndërmjetësimi i detyrueshëm dhe këtë e gjejmë në legjislacionin shqiptar dhe atë kosovar. Më konkretisht, neni 2/5 i ligjit 10 389, dt. 24.02.2011 parashikon se *"në rast mosmarrëveshje në fushën penale, kur procedimi ka nisur, gjykata* ***detyrimisht*** *fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes të parashikuar në nenet 59 dhe 284 të KPrp*". Gjithashtu Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 323/1 parashikon se: "*prokurori i shtetit mund të dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobe ose me burgim deri në tre(3) vjet për nërmjetësim. Para se të veprojë kështu, prokurori i shtetit merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penal, apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij"*, dhe neni323/2 parashikon se"*ndërmjetësimi bëhet nga ndermjetësi i pavarur. Ndërmjetësi* ***detyrohet*** *ta pranojë cështjen e dërguar nga prokurori i shtetit dhe të ndërmarrë masa për të siguruar se përmbajtja e marrëveshjes është në proporcion me seriozitetin dhe pasojat e veprës"*.

Pra në të dy legjislacionet kemi ndërmjëtësim të detyrueshëm. Në rastin e parë, kur procedimi ka nisur gjykata detyrmisht fton palët per zgjidhje me ndermjetësim dhe në rastin e dytë, pasi prokurori publik të referojë kallëzimin penal për ndërmjetësim, ai ndërmjetësim është i detyrueshëm në kuptimin e krijimit të detyrimit për ndërmjetësim.

Kjo do të thotë që në kuptimin e ketij neni shërbimi i ndërmjetësimit realizohet me ndihmën e subjekteve jashtëgjyqësore që nuk kanë autoritet gjyqësor por janë thjesht ndërmjetës që plotësojnë kushtet këtij ligji. Si një formë bashkëkohore pajtimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes

midis palëve, ndërmjetësimi gjen zbatim edhe ne fushën penale. Në legjislacionin aktual, sfera e veprave penale që mund të trajtohen me ndermjetësim janë të kufizuara dhe specifike. Kjo duke u bazuar në rëndësinë e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të saj, rrezikshmërinë e autorit të veprës pnale dhe pasojave që kanë ardhur. Në këtë mënyrë ligjvënësi ynë ka vlerësuar si të arsyeshme që veprat penale që mund t'i nënshtrohen ndërmjetësimit janë ato të cilat ndiqen mbi ankimin e të dëmtuarit nga vepra penale duke i dhënë liri përsonit të vendos, si fillim, nëse do të bëjë ankim ose jo dhe nëse dëshiron që çështja të zgjidhet nga gjykata, me pajtim apo dëshiron që të heqë dorë.

Në bazë të nenit 59 i dëmtuari akuzues mund të paraqesë në gjykatë ankimin dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit për veprat penale si vijojnë: neni 90(Dëmtime të tjera me dashje); neni 91(Plagosje e rëndë nga pakujdesia); neni 92 (Plagosje e lehtë nga pakujdesia); neni 112 (Dhunimi i banesës); neni 119 (Fyerja); neni 119/b (Fyerje me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik); neni 120 (Shpifja); neni 121 (Ndërhyrje të padrejta në jetën private); neni122 (Përhapja e sekreteve vetjake); neni 125 (Mosdhënia e mjeteve për jetesë); neni 127 (Marrja e padrejtë e fëmijës); neni 148 (Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet); neni149 (Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit); neni 254 (Shkelja e paprekshmërisë së banesës).

Gjithashtu parashikohet edhe neni 284 i Kodit të Procedurës Penale, ku i dëmtuari ndryshe nga neni 59 e bën ankimin në prokurori ose në policinë gjyqësore. Një parashikim i tillë në këtë dispozitë vjen, pasi për të patur ndjekje penale në fillim duhet të kryhen hetimet nga ana e organit procedures. Veprat penale që përmban neni 284 i KPrP janë: neni 89 (Plagosje e lehtë me dashje);neni 102/1 (Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura); neni 105 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën); neni 106 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari); neni 130 (Shtrëmgimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë); neni 239 (Fyerje për shkak të detyrës); neni 240 (Shpifja për shkak të detyres); neni 241 (Shpifja ndaj Presidentiti të Republikës); neni 243 (Goditja ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore); neni 264 (Detyrimi për të marrë pjesë në greve ose jo); neni 275 (Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike); neni 318 (Fyrja e gjyqtarit). Pra në të dy këto nene 59 dhe 284, ankimi përbën kusht pa të cilin nuk mund të nisë procedimi penal.

Heqja dorë nga e drejta e ankimit, me kusht ose me afat nuk është e vlefshme, kur është përkohësisht apo si rezultat i një kushti të caktuar. Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit deri ne momentin që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Heqja dorë bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, me deklaratë të nënshkruar ose me gojë para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, i cili mban procesverbal të nënshkruar detyrimisht nga deklaruesi.

Lidhur me këtë rast lind pyetja nëse hetimi fillon për një vepër penale që ndiqet kryesisht, por gjatë hetimit ose në përfundim prokurori ndryshon cilësimin juridik të veprës penale duke e konsideruar si një vepër e cila parashikohet nga neni 284 i KPrP. Si duhet të veprojë prokurori dhe gjykata në këtë rast? Prokurori në këto raste duhet të pyesë të dëmtuarin nëse ka ankim, gjithashtu edhe gjykata nuk duhet që ta shqyrtojë çështjen pa u siguruar që i dëmtuari ka bërë ankim.[378] Ashtu sic parashtruam edhe mesipër rëndësi ka vullneti i të dëmtuarit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirkuptim dhe/ose pajtim.

Drejtësia restauruese dhe programet e saj në të drejtën penale.

Drejtësia restauruese është një metodë, një rrugë për të arritur në zgjidhje që synon realizimin e objektivit të ndërtimit të një bote më të mirë, ku jetojnë dhe punojnë individë të mirë dhe ku çdo e keqe korrigjohet e ndryshohet në të gjitha format.

Ndërmjetësimi është metoda dhe drejtësia restauruese është finalizimi i kësaj mëtode. Të dyja të lidhura pazgjithshmërisht me njëra-tjetrën. Synimi i drejtësisë restauruese është ndëshkimi i të akuzuarit të luajë rol riedukues dhe rehabilitues, me qëllimin për ta kthyer të akuzuarin mbas vuajtjes së dënimit në një pjestar të qytetëruar të komunitetit, që nuk di t'i rikthehet krimit dhe burgut[379].

Duhet theksuar se drejtësia restauruese është një kundërpërgjigje ndaj krimit, që ka evoluar në kohë e që respekton dinjitetin dhe barazinë e çdo individi, sjell mirkuptim si dhe nxit harmoninë sociale mëpërmjet rimëkëmbjes së viktimave, kundërvajtësve dhe komuniteteve. Kjo metodë u jep mundësi të prekurve nga krimi të flasin hapur me njëri-tjetrin për përvojat e tyre dhe ka si synim të plotësojnë nevojat e tyre. Viktimat kanë mundësi që të kërkojnë dhe të marrin dëmshpërblim, e në Kodin tone të Procedurës Penale e gjejmë të parashikuar në nenet 59 dhe 58/1. Gjithashtu drejtësia restauruese u ofron mundësi viktimave që të ndihen të sigurtë dhe të kërkojnë mbylljen e konfliktit: u jep mundësi kundërvajtësve të kuptojnë shkaqet dhe pasojat e sjelljes së tyre dhe të pranojnë përgjegjësinë në mënyrë të plotë; u jep mundësi komunitetit të kuptojë shkaqet themelore të krimit, të ndihmojë në rritjen e mirëqenies së komunitetit dhe të parandalojë krimin[380].

Për të arritur në këto rezultate paraqiten programe të posaçme të drejtësisë restauruese ku synimi është restaurimi, rikuperimi në bazë të marrëveshjeve midis palëve. Hapësirë të tillë zbatimi drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi parashikohet nga ana e organeve të ngarkuara me

[378] Islami, H. , Hoxha, A. , Panda, I. "*Procedura Penale*", Tiranë 2010, f q, 405.
[379] Prof.Dr..Semini-Tutulani, M. *"Parimet bazë të përdorimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale. Roli I ndërmjetësitdhe qftësitë e tij"*, Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të mitur fq, 10.
[380] Parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, lidhur me Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese për Cështjet penale.

mbikëqyrjen e të liruarve me kusht para fillimit të procesit gjyqësor, si p.sh: në Japoni, kur i akuzuari është liruar me kusht, mbikëqyrësi mund të sigurojë takime të të akuzuarit me viktimën, në mënyrë që i akuzuari të kërkojë falje dhe të bëjë kompensim[381].

KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është instrumeti më bashkëkohor dhe më irëndësishëm. Ajo nuk trajton vetëm të drejtën penale apo procedurën penale, por përmban një trajtim të së drejtës penale në *lato sensu.* Konventa gjithashtu i kushton tepër rëndësi mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut, për këtë arsye edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e thërret drejtëpërdrejtë në nenin 17 të Kushtetutës[382].

Përsa i përket ndërmjetësimit si një alternativë e zgjidhjes së konfliktit me mirkuptim KEDNJ parashikon se pasi gjykata të pranueshme kërkesën, ajo vihet në shërbim të të interesuarve me qëllim që të sigurojë një zgjidhje, me pajtim të cështjes, mbi bazën e respektit për të drejtat e njeriut, siç përcaktohen nga konventa dhe nga protokollet e saj(neni 38/1/b), kjo procedurë është konfidenciale (neni 38/2). Në rast së gjendet një zgjidhje me pajtim, gjykata e hap çështjen nëpërmjet një vendimi, i cili përmban paraqitje të shkurtër të fakteve dhe zgjidhjes së arritur (neni 39/1).

KEDNJ nuk mjaftohet vetëm me shpalljen e të drejtave, por gjithashtu kujdeset për sigurimin dhe respektimin e detyrimeve të marra nga shtetet që i firmosin. Në përputhje me sa thamë, nëse e drejta e brendshme e shtetit të dënuar lejon të bëhet vetëm një ndarje e pjesshme e pasojave të kësaj shkelje, gjykata vendos se kur është e nevojshme dhënia e një shpërblimi të drejtë palës së dëmtuar (neni 41 i KEDNJ) duke bërë të mundur në këtë mënyrë shpërblimin e dëmit të shkelur, pra restaurimin e palës së dëmtuar.

Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ në përputhje me KEDNJ parashikon se ka dy lloj zgjidhjesh me mirëkuptim. Shumica e tyre mjaftohen me faktin që ankuesit i sigurohet riparimi i dëmit që ka pësuar. Të tjera, më interesante kanë efekt me të gjerë duke parashikuar zotimin e shtetit per të modifikuar legjislacionin e brenshëm me qëllim vënien e tij përputhje me KEDNJ. Me vendime "pilote" zgjidhja me mirëkuptim ka domosdoshmërisht efekt të gjerë.[383] Dhe këtë shtrirje më të gjerë të efekteve që vendimet e GJEDNJ e gjejmë të aplikuar në vendimin *Bronioëski vs Pologne* i datës 28 shtator 2005, ku shteti Polak përvec se ka shpërblyer z,Bronioëski për dëmin e

[381] Gjoka, R. "*Roli dhe nevojat e viktimave, autorëve të veprave penale dhe komunitetit në programet e drejtësisë restauruese. Fushat e zbatimit"*, Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të mitur, fq,79.
[382] Omari, L. , Anastasi, A. "*E drejta kushtetuese*",Tiranë 2008, fq 114.
[383] Pradel, J. Corstens, G. , Vermeulen, G. "*E drejta evropiane*" 2009, fq 247.

shkaktuar, por gjithashtu kanë ndryshuar legjislacionin e brendshëm duke e përshtatur më Konventen Evropiane te te Drejatve të Njeriut.

Konkluzione

Në përfundim të trajtimit të mësipërm, *supra,* vërejmë se drejtësia restauruese dhe ndermjetësimi janë vërtet alternativa të reja për Evropën, por jo për Shqipërinë. Në ndryshim nga alternativat e tjera, ndërmjetësimi dhe drejtësia restaurruese paraqesin një mënyrë më fleksibël, efikase dhe të dobishme të zgjidhjes se mosmarrëveshjeve. Gjithashtu arrijmë në konkluzionin se ndërmjetësimi, pajtimi dhe restaurimi janë institute qe kanë patur zbatim dhe ende aktualisht kanë, kjo bazuar në mbështetjen e gjerë ligjore që kanë patur në vite, që nga kanunet deri në ligjin e fundit të 2011-ës. Zbatimi i tyre në praktikë herë pas here ka patur probleme, kjo duke u ndikuar nga kushtet historike, social-politike, por duhet të themi se në bazë të vullnetit të mirë dhe dëshirës për të superuar mosmarrëveshjet, ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese kanë gjetur zbatim.

Avantazhi kryesor, i zgjidhjes me mirëkuptim, qëndron se të dyja palët dalin të fituara.

Bibliografia

Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit, Tiranë 2011

ELEZI, I. "Ndërmjetësimi për pajtimin në konfliktet penale"

GJEDNJ, 28 shtator 2005, *Bronioëski vs Pologne,*

HALIM, I. HOXHA, A. PANDA, I. "Procedura Penale",Tiranë 2010

Kodi Evropian i Etikës Për Ndërmjetësit

Kodi i Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Dhjetor 2012

Kodi Penal

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr 10389 dt 24.02.2011 *"Për ndërmjetësimin në zgjidhjen mosmarrëveshjeve"*.

OMARI, L. ANASTASI, A. "E drejta Kushtetuese"

Parimet e Kombeve të Bashkuara, *"Lidhur me Përdorimin e Programeve të drejtësisë restauruese për çështjet penale*"

PRADEL, J. CORSTENS, G. VERMEULEN, G. "*E drejta evropiane*" 2009

Rekomandimi nr (99)19 në lidhje me "*Ndërmjetësimi në çështjet penale"*

USAID, Manual trajnimi: *Ligji për ndërmjetësimin*

National Perception and the Right to Self-Determination

Mr.Sc.Petrit NIMANI[1], PhD.c, Mr.sc Denis SPAHIJA[2],

PhD Cand. *Lecturer at the University of Prishtina Faculty of Education and Faculty of Law, "BIZNESI" College[1]*

Faculty of Economics, "BIZNESI" College, Gjakovë[2]

Abstract

Security and peace in the world have always been addicted by reports of peace or hostilities between states and people. Constantly the world has been accompanied by efforts to domination of some states to other states or nations against other nations. These efforts have consistently encountered resistance states and peoples not to be subjected.

As a result of these efforts there have been developed numerous wars, with bloody and tragic consequences for humanity.Therefore the history of states and nationes, mainly is a history of violence and attempts to dominate and not to be imperiled.Throughout history have been invented and built many systems that have tried to regulate these relations. Some of them have collapsed quickly some have resisted longer time.For the first time as a loosely rule, Peace of Westfalia is inaugurated year 1648, and a broad knowledge and as a principle universally recognized but unrealized in this measure practically known in the twentieth century. Therefore, the principle of self-determination has become an integral part of the Charter of the United Nations.

What does the principle of the right for self-determination? How is it being implemented? What is the perception of ethnic entities of this principle? How it is implemented in the case of the former Yugoslavia? Why is not applied in the case of Kosovo? Are just some of the questions that need to be answered.

Keywords: *security, peace, self-determination, history, right.*

The principle of self-determination

Viewed in historical terms, the principle of self-determination goes through three periods of development. The first period begins with the Peace of Westphalia, 1648 and ends with the Congress of Vienna in 1815. This stage is also known as the legitimation stage of monarchical dynasties. Second Period, or otherwise known as the period of equilibrium of forces in the Congress of Vienna begins and ends with the Second World War. While the third phase of development of this principle, which is at once the most important phase, which begins this principle to find a wider application, is phase after World War II[384]. Although the principle of self-determination applies relatively recently, the basis of this principle we find, since the Peace of Westphalia of 1648.[385] After the terrible wars of the Reformation, the states involved in these wars, in 1648 set of principles which will be the basis of the international relations.

Under this agreement the four principles that will determinate international relations would be:

- The principle of sovereignty of the nation-state and the fundamental right of political self-determination:
- Equality (legal) principle between states:
- The principle of international agreements between countries:
- The principle of non-intervention of one state in the internal affairs of another state.

However, these principles do not find wide application and were referred almost exclusively for the most powerful states of the time. The agreement was reached as the need to end the wars and to secure a peace that will ensure recovery of the affected states[386].

Although these principles did not found wide application, monarchical systems of the time, with those agreements reached to legitimize their governance systems.

Although the Peace of Westphalia, provided a relatively long peace, the strengthening of some states and the increase of appetites for territories, these principles were seriously jeopardized.

As a result, less powerful states saw the need to build a system that will protect them from other more powerful states. The construction of this system, which would later be called the balance of power system will reached and build at the Congress of Vienna in 1815. However, even this system is not clearly defined rules for the implementation of the principle of self-determination[387].

[384] Enver Hasani, *Self-Determination* (Vienna, National Defence Academy 2003).
[385] Bekim Baliqi, Hyrje në Diplomaci dhe Politike të Jashtme, (Prishtinë, 2010).
[386] Resolution of the General Assembly, 1514 (XV).
[387] Baliqi (n 2).

Even in this system the principle of self-determination effort refers only to maintain existing states and not peoples and ethnicities who were trying to build their country. The first occurrence of those powerful systems came after World War I, when the Axis State, rejected the principles and striving for territorial expansion at the expense of other states. Losing Axis countries, created a space to attempt to return to international peace and stability. Numerous attempts were made to create a stable base of regulating international relations. In this spirit was the 14-point proposal of U.S. President Wilson Woodrow. That "based on three main criteria, which were:

- Democracy
- Group insurance and
- Self-determination - none of which was used earlier for a European solution[388]

One of the important points of Wilson that had to do with the principle of self-determination, was his demand for "objective resolution of territorial claims."

But even though, Wilson's proposals were an important step forward, that would help little nations to determine their own destiny, through the principle of self-determination, disregard of the agreement by the U.S. Senate, made these proposals not wide applicable in practice. Just as America's withdrawal from this agreement and "return" to its previous policy isolationist, increased the appetite of Germany and Italy for territorial expansion. It ended with World War II. The need for recuperation, peace and safety led to the creation of United Nations (UN), as a body with universal character which will have the task of maintaining peace and security in the world. In the basic document of the UN, among other things included the principle of self-determination and the right of nations to self-determination.

Perceived ethnic entities

Although the UN Charter recognized the right of nations to self-determination, not all nations were able to squeeze this right. Major powers used the principle of self-determination for their interests. So many nations failed to realize this right. Victorious states and their allies followed as a key principle, so they would not have any territorial losses. Here the ethnic-national played a second hand, which once again illustrates his relativity[389]. Although many of the movements state – establishing had the ethnic entities element, strained international relations and interests of the great powers, made within the new states to not reflect composition of ethnic entities population. Thus, in setting of the boundaries of new states they were based on more administrative old boundaries,

[388] Henry Kissinger, *Diplomacia* (trans. P. Pojani, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve 1999).
[389] Urs Alttermat, *Etnonacionalizmi në Evropë*, (trans. Ardian Klosi, Tiranë, PHONIX 2002).

that had established colonial states, or otherwise known as the principle of *uti possiditis*. Within the newly created states there were included populations with different ethnic entities, religious and linguistic[390], etc.

This diversity of composition made within population of a state, caused many inside problems for newly created states. Within these countries started bloody wars for domination of little ethnic groups of the same state. This is evidenced by the numerous wars in Nigeria ethnic domination, the former Yugoslavia, Rwanda, Sudan, Turkey etc..

However, numerous wars within states and subjected nations efforts to realize the right of self-determination under the principle minorities, continues to promote the principles of the French Revolution of the nation-state, which does not bind the nation with an ethnic element, but with the state one. The UN continues to promote these principals. All this is due to the fact that if there would be recognized based on self-determination of ethno-national element, then the system of all states would collapse, since almost all states of the world have a population heterogeneity.

However, despite this many majority of federal states, which had a large heterogeneous nationality faced with many consequences and with bloody wars for breakdown by ethno-national principle. The ’90 years of the last century were dominated with ethnic and territory bloody wars. Ambitions to build nationality states were also helped from the collapse of communism in the East. Despite initial efforts to save these countries, the determination of different national groups were crowned with success. So from among the communist countries (USSR, Yugoslavia, Czechoslovakia) dissolved, came up many new national countries.

Application of the Principle of Self-Determination in the former Yugoslavia

The collapse of the communism in USSR, had a wide effect on other European communist states. Collapse of the USSR, in 1990, followed by collapse of the communism on all European states. The collapse of this system had been associated with numerous problems. Some states, faced the collapse of communism very easy and immediately began the process of democratic transition. Most problems were experienced by countries that had a heterogeneous composition of the population and that when they were created , they violently included within their various national groups. One of the countries that had numerous problems post-communist was Yugoslavia. With the communist system fell, Yugoslavia was engulfed by a powerful wave of nationalism. All ethnic groups began their national movements to build their states based on element of the ethnic entities.

[390] Erik Hobsbaum, *Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1780-Ta*, (trans. Bashkim Shehu, Tiranë, Toena 1996).

Serbian nationalist ambitions to dominate Yugoslavia and forcibly keep those nations led to a bloody war and multiple victims.

Thus began a bloody process of disintegration of Yugoslavia and the construction of new states. Despite the early resistance of international community to stop the disintegration of Yugoslavia, insistence and war finally made that the nations within Yugoslavia to recognize the right to self-determination. To give international legitimacy to that right, was created a committee that established the conditions of implementation to the right of self-determination for the nations of the former Yugoslavia. This committee was known as the Badinter Committee.

According to this committee the right of knowing the principal of self-determination in former Yugoslavia have the nations that the constitution of 1974 ere once known as the Republic and the nations who complete the criteria of being a nation.

Based on these criteria, this right was won by: Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia and Montenegro. But from this right were expelled Kosovo and Vojvodina.

Kosovo and the principle of self-determination

In order to handle the principle of self-determination and how this principle has not found wide application in practice it is very illustrative the case of Kosovo and Albania in former Yugoslavia. When on 1912, Albania declared independence, it meant that it would include all Albanian-inhabited territories. But the London Congress in 1913, internationally recognized Albania as a country, only less than half of the territory and its population. Kosovo constituted the largest and most important territory outside the “London” Albania, so the Congress recognized Kosovo as part of Serbia. In 1918, there were established the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenians, which included Kosovo within it, without taking into account the structure of the population and its will[391]. However, despite the invasion of Kosovo from Serbia and "international recognition" of this occupation, Albanians fought constantly strived for self-determination. So in 1943-44, Albanian representatives of Kosovo in Bujane issued a resolution, which required that after the War, Kosovo will recognize right to self-determination up to secession and union with Albania. But after World War II, Yugoslav- Serb leadership violated and dismissed the resolution as invalid, by which the people of Kosovo unjustly were denied from the expression of free will. This "will" forge, as the people of Kosovo want to join the Yugoslav federation. Within the federation, Kosovo was an unequal status with six other federal entities. The position deteriorated further with the suppression of the 1974 autonomy. Kosovo's right to have self-determination, was once again

[391] Petrit Nimani, *Bazat e Shtetit dhe së Drejtes*, (KUB, Prishtinë 2012).

denied by the Badinter committee, which did not recognized Kosovo's right to self-determination. Albanians tried to recognize this right through the referendum that was held on 1992, but this referendum was never officially known by the national mechanisms. However, despite this discrimination, Albanians of Kosovo constantly tried to achieve their right for self-determination. These tries led even with armed war of UÇK, which with the help of national community ended with the removal of Serbia from Kosovo.

But, despite of the forced removal of Serbia from Kosovo, the latter again was prevailed from the right of self-determination. Kosovo was placed under UN administration and continues its journey under a so-called temporary status, which is being more than 9 years, whereas on 17 February 2008 Kosovo declared its independence and was recognized nationally by more than 90 countries around the world so far, and continues its path towards integration into Euro-Atlantic structures.

Closure

[438] Ideja se kultura të ndryshme kanë koncepte të ndryshme vlerash, për rrjedhojë dhe të Drejtat e Njeriut nuk mund të jenë kudo njëlloj. Teoritë universaliste kanë gjetur më tepër përkrahje dhe dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare bazohen tek to.

[439] Konflikti i vazhdueshëm mes të cilave është rënduar pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001, pasi masat e marra për "Sigurinë Kombëtare" në kuadër të Luftës Ndaj Terrorizimit, kërkojnë shpesh derogime të shumta nga të Drejtat e Njeriut.

[440] Daci J. "*Të Drejtat e Njeriut*", Shtëpia Botuese Erik, ISBN 99943-47-93-3, Tiranë 2008, fq. 35, Parag. 2.

[441] "Organon" i Aristotelit, "Republika" e Platonit, "Etika" e Ciceronit, etj.

C) Për epokën e **Mesjetë**s mund të thuhet se ndër arritjet më të mëdha në planin filozofik ishte përhapja e koncepteve të tilla si '**e mira'** dhe '**e keqja'**[442], '**e drejta'** dhe '**e gabuara'** nga ana e filozofive fetare monoteiste mbizotëruese në këtë kohë, koncepte të cilat bazoheshin në prejardhjen dhe mbështetjen 'hyjnore' të disa të drejtave njerëzore. Arritje të tjera në fushën e sigurimit dhe mbrojtjes së të drejtave ishin dhe Kartat e ndryshme të të drejtave, me anë të të cilave sundimtari i njihte grupimeve të ndryshme shoqërore një numër të caktuar të drejtash në rrethana të caktuara[443]. Një ndër to ishte dhe Magna Charta Libertatum[444], të drejtat e parashikuara në të cilën do të shërbenin dhe si fillimi i lirive të sotme[445].

D) Rilindja dhe Iluminizmi janë periudhat në të cilat lindën dhe u përhapën teoritë e të Drejtave të Njeriut, duke filluar me "12 Nenet" e vitit 1525[446]. Rreth gjysmës së dytë të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII do të zhvillohej dhe shkolla e mendimit filozofik të së Drejtës Natyrore. Veprat e Hobsi, Locke, Ruso[447], etj., interpretohen si mbështetje dhe baza të teorive, kërkesave dhe legjislacioneve të frymëzuara nga dhe mbështetura në idetë e të Drejtave të Njeriut.

Ndër aktet kryesore të miratuara në këtë periudhë dhe që përbëjnë një hap të rëndësishëm në lidhje me Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, mund të përmendim:

a) Petition of Rigts[448];
b) Habeas Corpus Act[449];
c) Bill of Rights[450]; dhe
d) Claim of Rights[451]

Gjithashtu, zhvillim pozitiv përbënin dhe Revolucionet e fundshekullit të XVIII-të: ai Amerikan, në Deklaratën e Pavarësisë së të cilit të gjithë njerëzve i njiheshin të drejta të cilat deklaroheshin si të vërteta, të vetëkuptueshme dhe të patjetërsueshme si: Barazia, e Drejta e Jetës,

[442] Megjithëse, këto janë koncepte relative tepër të diskutueshme dhe të tilla që në realitet lënë vend për abuzime, mendoj se ndikimi i përgjithshëm i tyre në historinë njerëzore ka qenë mjaft pozitiv, duke përbërë dhe një ndër bazat e Të Drejtës Natyrore.
[443] Të tilla ishin dhe Kartat/Statutet e qyteteve, që në thelb përbënin një grup të drejtash të cilat feudali pronar i tokës, që mund të ishte dhe një vend pushtues si në rastin e Venedikut në bregdetin shqiptar, ia njihte banorëve të qyteteve të ngritura në tokat e tij.
[444] E nënshkruar më 12 Qershor 1215, ajo *shërbeu si pikë referimi për shumë karta apo dokumente të* mëvonshme në lidhje me njohjen dhe sigurimin e disa të drejtave shtresave të shtypura, nga ana e sunduesve. Ndër të tjera, ajo sanksiononte parime të tilla si: krijimin e organeve që do të kontrollonin veprimtarinë e Mbretit, të drejtën e mosbindjes ndaj veprimeve arbitrare të tij (përfshirë të drejtën e kryengritjes), të drejtën e përfaqësimit, etj.
[445] Anastasi A. "*Historia e Institucioneve*", Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë 2006, ISBN 99927-0-297-4, Fq. 249, par. 2.
[446] Kërkesat e fshatarëve gjermanë ndaj Ligës Svabiane, të konsideruara si një ndër dokumentet e parë të të Drejtave në Evropë.
[447] Të tilla si: "Leviathani" i Hobbes, "Dy Traktate Qeverisjeje" i John Locke, "Ligjëratë mbi Pabarazinë" dhe "Mbi Kontratën Sociale" e Ruso (Rousseau), etj.
[448] Miratuar nga Parlamenti anglez më 7 Qershor 1628 ai parashikon një mori të drejtash si mjet të individëve ndaj veprimeve arbitrare të pushtetit mbretëror. Gjithashtu, ai konsolidoi pozitën mbizotëruese të Parlamentit në lidhje me Kurorën.
[449] Miratuar nga Parlamenti i Gjatë anglez në vitin 1641**,** ai vendosi të drejtën e Gjykatës për t'i dhënë *Habeas Corpus* çdo personi të ndaluar apo arrestuar nga organet shtetërore me qëllim kontrollimin e ligjshmërisë së ndalimit ose arrestimit të tij. Gjithashtu, me të njëjtin emër është dhe një akt i Parlamentit anglez i vitit 1679 i cili ripohoi të drejtën e *Habeas Corpus* dhe të drejta të tjera.
[450] I miratuar nga Parlamenti anglez më 16.12.1689, ai ripohoi përfundimisht të drejtat e Parlamentit, kryesisht lidhur me Kurorën.
[451] I miratuar nga parlamenti Skocez në Prill 1683 ai mund të vlerësohet si versioni skocez i Bill of Rights.

Liria dhe ndjekja e Lumturisë[452]; dhe ai Francez, si rrjedhojë e të cilit u shpall më 20 – 26 Gusht 1789, "Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit" e cila sanksionoi për herë të parë në Evropën Kontinentale një mori të drejtash dhe lirish ndaj shtetasve, të përfshira në një sistem të vetëm ligjor[453]. Të një rëndësie të veçantë janë dhe 10 Amendamentet e para të Kushtetutës së SHBA[454], pasi ato sanksionuan, për herë të parë në Kushtetutën e një vendi, njohjen e të drejtave civile dhe politike për qytetarët e tyre.

Rreth Shek. të XVIII-të dhe XIX-të togfjalëshit 'Të Drejtat' iu shtua termi 'të Njeriut' duke plotësuar dhe formuar përfundimisht termin që ne njohim sot: 'Të Drejtat e Njeriut'.

E) Gjatë **Shek. të XIX,** interesimi kryesor në fushën e të Drejtave të Njeriut ishte lufta kundër skllavërisë[455] (shpallja e saj e paligjshme) dhe E drejta Humanitare[456].

F) Në **shek. 20** ndryshimet më të mëdha ndodhën në fushën e të Drejtës së Punës[457], të të Drejtave të Gruas[458], çlirimit të popujve të kolonizuar dhe në njohjen e të drejtave civile të minoriteteve të ndryshme.

Por, do të ishte Lufta e Dytë Botërore[459] dhe humbjet njerëzore dhe materiale rrjedhojë e saj, ajo që të do të bindte opinionin ndërkombëtar për nevojën e instrumenteve shtrëngues ndërkombëtarë. Si rrjedhojë, u krijua OKB, si një sistem i cili ka si objekt kryesor ruajtjen dhe sigurimin e paqes në botë. Megjithatë, Neni 55 dhe Neni 56 i Kartës së OKB i referohej "*zhvillimit dhe inkurajimit të respektimit të të Drejtave dhe lirive themelore pa dallim…*", por pushtetet e njohura organizatës në këtë fushë ishin të pakta. Do të ishte Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, ajo e cila do të njihte universalisht të drejtat politiko – civile dhe ato ekonomiko-sociale[460]. Në kuadër të OKB-së u miratuan në vitin 1966 dy pakte shumë të rëndësishme: "Pakti i të Drejtave Civile dhe Politike" dhe "Pakti i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore", të cilët pasi hynë në fuqi në vitin 1976 krijuan obligime angazhuese ndaj shteteve palë në to. Në kuadër të OKB-së

---

[452] "*We hold these truths to be self-evident, that all men are created equal, that they are endowed by their Creator with certain unalienable Rights, that among these are Life, Liberty and the pursuit of Happiness.*" – Deklarata e Pavarësisë së Shteteve Amerikane të bashkuara, 4 Korrik 1776, pjesë nga Preambula.

[453] Duhet thënë se Deklarata e parë e të Drejtave në historinë moderne është ajo e shtetit amerikan të Virxhinias e quajtur: Deklarata e të Drejtave të Virxhinias, e 12 Qershorit 1776.

[454] I emërtuar Bill of Rights, miratuar më 21 Gusht 1789.

[455] Në Evropë u realizua më herët, kurse në SHBA vetëm pas Luftës Civile, 1861 – 1865. Amendamentet 13, 14 dhe 15 (1865 – 1870) i siguruan të drejta të barabarta njerëzve me ngjyrë në SHBA.

[456] Përmes nënshkrimit të Konventave të Gjenevës më 1864 dhe themelimit të Kryqit të Kuq në vitin 1919.

[457] Duke vënë theksin në të drejtën për të formuar sindikata.

[458] Veçanërisht të drejtës për të votuar.

[459] Megjithëse, fillimisht ekzistonin disa mjete në kuadër të Lidhjes së Kombeve si sistemi i Mandateve dhe ai i Minoriteteve.

[460] "Megjithëse, në fillimet e saj ajo kishte karakter thjesht deklarativ pasi u miratua në formën e një Rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, me kalimin e kohës ajo është kthyer në një instrument shumë të rëndësishëm angazhues të së Drejtës Ndërkombëtare, duke bërë që respektimi i të drejtave të parashikuara prej saj të kthehet në një lloji zakoni ndërkombëtar. Për këto arsye – shprehet Prof. Dr. A. Puto në librin e tij "*E Drejta Ndërkombëtare Publike*", fq. 217, parag. 3 – dhe për rolin referues që ajo zhvilloi dhe zhvillon akoma për instrumente të tjerë rajonalë në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, rëndësisë politike dhe statusit moral, disa autorë janë shprehur se '*…ajo mund të vihet në një radhë me dokumente të tillë historikë si Magna Carta, Deklarata Franceze e të Drejtave të Njeriut dhe Deklarata Amerikane e Pavarësisë…*'"

janë miratuar dhe një mori instrumentesh të tjera në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, sikurse përshkruhet në vijim të këtij punimi.

Nënshkrimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), është padyshim momenti më i rëndësishëm në historinë evropiane të pasluftës në lidhje me mbrojtjen dhe sigurimin e të Drejtave të Njeriut, pasi për herë të parë qytetarët e vendeve nënshkruese kishin një instrument mbikombëtar i cili do t'i ndihmonte ata në mënyrë efikase për të siguruar dhe garantuar të drejtat e tyre. Dispozitat e saj kanë karakter detyrues, gjë e cila u pasqyrua dhe në krijim e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, një mekanizëm shumë efikas ky për sigurimin dhe respektimin e parimeve të shpallura nga KEDNJ.

G) Për sa i përket zhvillimeve në **shek. 21-të**, disa studiues mendojnë se Të Drejtat e Njeriut janë zgjeruar përtej qëllimeve të tyre fillestare anti – totalitariste, për të përfshirë në to dhe çështje humanitare dhe të zhvillimit social – ekonomik të vendeve të Botës së Tretë[461]. Karta e të Drejtave Themelore të BE dhe Lufta Kundër Terrorizmit janë ndër zhvillimet kryesore në planin ndërkombëtar lidhur me të Drejtat e Njeriut.

Trendi aktual

Me trend aktual të zhvillimit të të Drejtave të Njeriut nënkuptohen të gjithë ato të drejta për të cilat, si rrjedhojë e zhvillimit dhe ndryshimeve të sotme në shoqëri në fushat sociale, ekonomike, kulturore, teknologjike, etj., ekziston një debat i gjerë për përfshirjen ose jo të tyre në legjislacionet përkatëse shtetërore. Si të tilla mund të përmendim:

1- **Të Drejtat Mjedisore[462]:** Të pavarura, ose që mund të derivohen prej të drejtave të tjera, ato kanë pësuar një zhvillim tepër të ndjeshëm kohët e fundit si rrjedhojë dhe e ndryshimeve klimatike.

2- **Të Drejtat e Brezave të Ardhshëm:** Në kuptimin e "përgjegjësisë së brezave aktualë për të siguruar që nevojat dhe interesat e brezave aktualë dhe të ardhshëm të ruhen plotësisht"[463]. Ajo shpreh nevojën dhe angazhimin e shoqërisë njerëzorë për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe burimet natyrore në favor të brezave të ardhshëm.

3- **Lesbike, Gey, Biseksual, Transgjinor (LGBT):** Janë të drejta të lidhura me orientimin seksual, gjinor dhe shprehjen e tyre. Ndër problematikat kryesore janë: dekriminalizimi i marrëdhënieve seksuale të vullnetshme mes të rriturve të të njëjtit seks, në

[461] Scott McLemme, "*The Last Utopia*", *Inside Higher Education*, Dec. 8, 2010, http://www.insidehighered.com.
[462] Janë parashikuar dhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE.
[463] Neni 1 i "Deklaratës Mbi Përgjegjësitë e Brezave Aktualë ndaj brezave të Mëvonshëm", OKB, 1997.

vendet ku kjo gjë është e ndaluar; e drejta e LGBT-ve për të adoptuar fëmijë; e drejta e tyre për t'u martuar; ligjet anti – diskriminim, etj.[464]

4- **Uji:** E konceptuar si e drejta për akses ndaj burimeve ujore[465].

5. **Ndëshkimi:** E drejta dhe mbrojtja nga një ndëshkim çnjerëzor e degradues, duke kundërshtuar ndëshkime të tilla si: dënimi me vdekje, tortura, fshikullimi, etj.

6 . **Aborti:** E drejta për abort bie ndesh me të drejtën për jetë të fetusit dhe për këtë arsye shumë shtete të botës e kanë kufizuar ose ndaluar kategorikisht atë.

7. **E Drejta e Riprodhimit:** Përfaqëson njohjen e së drejtës themelore të çdo çifti dhe individëve për të përcaktuar vetë, me vullnet të lirë, numrin, vendin dhe kohën e lindjes së fëmijëve të tyre dhe pasjen e informacionit dhe mjeteve të nevojshme për këtë gjë dhe të drejtën për të gëzuar standardet më të larta të shëndetit seksual dhe riprodhues. Ajo gjithashtu, përfshin të drejtën e të gjithë njerëzve për veprime riprodhimi të lira nga diskriminimi, shtrëngimi apo dhuna[466]. Është njohur për herë të parë në Konferencën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, të vitit 1968.

8. **Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikacionit:** Sipas një sondazhi të BBC World Service, 4 nga 5 persona në botë e shohin atë si të drejtë themelore[467].

9. **E Drejta për të mbajtur armë:** Aktualisht po zhvillohet një debat i gjerë ndërmjet përkrahësve dhe kundërshtarëve të kësaj të drejte, kryesisht në SHBA.

Gjithsesi, me trend aktual mund të kuptojmë dhe ndryshimet e përgjithshme të qëndrimit të aktorit kryesor, shtetit, ndaj të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Megjithëse, në këtë pikë qëndrimet e shteteve janë të ndryshme[468], duhet thënë se në kuadër të Luftës Kundër Terrorizmit, përgjithësisht, pati një qëndrim negativ ndaj të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Burimet e brendshme në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut

Me burime të brendshme në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut kuptohet tërësia e akteve normative me fuqi detyruese, të nxjerra nga organi kompetent me pushtet legjislativ, të cilat mbrojnë dhe sigurojnë të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut brenda territorit të një shteti. Të tilla janë:

---

[464] Megjithë aksionet e ndryshme, nuk ka arritje konkrete në nivel ndërkombëtar lidhur me këtë çështje.

[465] Komiteti mbi të drejtat Ekonomike dhe Sociale e pranoi si të drejtë njerëzore në Nëntor 2002, ndërsa OKB deklaroi 'ujin e pijshëm, të pastër dhe të sigurt dhe higjienën publike' si pjesë të të Drejtave të Njeriut, më 28.07.2010.

[466] "*Gender and reproductive rights*", Organizata Botërore e Shëndetësisë, e vlefshme në: http://who.int/reproductive-health/gender/index.html.

[467] "*Four in Five Regard Internet Access as a Fundamental Right: Global Poll*", BBC News, E Vlefshme në: http://news.bbc.co.uk/1/shared/bsp/hi/pdfs/08_03_10_BBC_internet_poll.pdf.

[468] Duke reflektuar kulturën mbizotëruese, nivelin e zhvillimit dhe/ose faktorë të tjerë.

1. **Kushtetuta:** Pothuaj të gjitha Kushtetutat e vendeve demokratike të botës parashikojnë parime në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut. Megjithë karakterin e përgjithshëm dhe diskret të tyre, ata përbëjnë norma themelore, me fuqi detyruese ndaj të gjithë subjekteve që i nënshtrohen pushtetit të atij shteti dhe sidomos organeve të vetë shtetit. Si rrjedhojë e rolit themeltar në sistemin e burimeve juridike të një vendi, norma të tilla luajnë rol parësor në sigurimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, pasi kushtëzojnë vetë përmbajtjen e normave të tjera detyruese në atë vend.

2. **Traktatet Ndërkombëtare:** Normalisht janë pjesë e së Drejtës Ndërkombëtare, por një pjesë e tyre 'thirren' nga legjislacioni i brendshëm i një vendi duke përbërë kështu pjesë integrale të tij, shpesh me fuqi detyrues të një niveli superior. Gjithashtu dhe traktatet e ndryshme, pas ratifikimit nga Parlamentet përkatëse, bëhen pjesë e së drejtës së brendshme të tyre.

3. **Ligjet:** Përbëjnë një mjet për mbrojtjen dhe sigurimin e të Drejtave të Njeriut pasi ato miratohen në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës së një vendi, duke theksuar, përpunuar dhe interpretuar më hollësisht kuptimin e parimeve të deklaruara në të.

4. **Aktet nënligjore:** Janë të gjithë ato akte, të nxjerra nga organet kompetente, në përputhje dhe në zbatim të ligjeve të një vendi. Duke qenë se ata kanë një karakter teknik dhe praktik, ndikimi që sjellin në fushën e të Drejtave të Njeriut është shumë i ndjeshëm. Për këtë arsye ligjshmëria dhe pse jo ndjeshmëria ndaj të Drejtave është shumë e rëndësishme në këtë nivel.

5. **Vendimet e gjykatave:** Për sa i përket kësaj çështjeje ekzistojnë dy praktika të ndryshme: Në vendet e sistemit *Common Law*[469], vendimet gjyqësore të gjykatave më të larta formojnë për juridiksionet më të ulëta, precedent detyrues në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Për sa i përket familjes *Civil Law*[470], megjithëse *de jure* vendimet e tyre nuk kanë fuqi detyruese ndaj vendimeve të mëvonshme të gjykatave më të ulëta në lidhje me çështje të ngjashme, mund të themi se *de facto* gjykatat në përgjithësi në çështje të ngjashme priren të ndjekin një vijë të përafërt arsyetimi dhe si rrjedhojë dhe vendimi.

6. **Gjykata Kushtetuese**[471]**:** Për vetë rolin e saj si gardiane e Kushtetutës në vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore, apo dhe si rrjedhojë e rolit të saj si instancë e fundit kombëtare ndaj të cilës mund të ankimohen vendime të gjykatave të tjera, mund të themi se Gjykata kushtetuese është një instrument shumë i rëndësishëm në Mbrojtje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

[469] MB, SHBA, Kanada, Australi, Zelandë e Re, Indi, Nigeri, Pakistan, Irlandë, etj.
[470] Evropa kontinentale, Rusi, Kinë, Brazil, Meksikë, Egjipt, Turqi, etj.
[471] 'Gjykatë Kushtetuese' në Shqipëri, Itali, etj.; 'Gjykatë Supreme' në SHBA, Kanada, etj.; 'Këshill Kushtetues' në Francë, etj.

Burimet ndërkombëtare në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut

Me burime ndërkombëtare në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut kuptojmë tërësinë e akteve ndërkombëtare[472], të nënshkruara nga një grup shtetesh dhe që parashikojnë për to angazhime detyruese të veçanta, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të tyre. Të tilla janë[473]:

1. **Traktatet: J**anë burim kryesor i së Drejtës Ndërkombëtare[474] dhe si rrjedhojë dhe e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në nivel ndërkombëtar. Aktualisht ata kanë pësuar një përhapje tepër gjerë. Ndër më kryesorët mund të përmendim[475]:

- Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (hyrë në fuqi më 1951);
- Konventa për Statusin e Refugjatëve (hyrë në fuqi në vitin 1955);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit racial (1969);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Femrave (1981);
- Konventa e OKB Kundër Torturës (hyrë në fuqi në vitin 1987);
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (hyrë në fuqi në vitin 1990);
- Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë punëtorëve Emigrantë dhe Pjesëtarëve të Familjeve të tyre (hyrë në fuqi në vitin 2003);
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (hyrë në fuqi në vitin 2008);
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Personave nga Zhdukja e Detyruar (2010).

2. **E Drejta Ndërkombëtare Zakonore:** Përbëhet nga veprime të përsëritura në kohë dhe të pranuara gjerësisht dhe përgjithësisht prej shteteve të civilizuara, të cilat krijojnë norma detyruese sjelljeje në situata të njëjta për të gjitha shtetet. Si rrjedhojë, kemi dhe zakone të krijuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave të ndryshme të qytetarëve, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga vende të ndryshme[476] në nivel ndërkombëtar.

---

[472] Objekt studimi i së Drejtës Ndërkombëtare.
[473] Renditja është marrë nga: Jordan Daci, "*Të Drejtat e Njeriut*", Shtëpia Botuese Erik, Tiranë 2008, Kapitulli II.
[474] Neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.
[475] Për më tepër shiko: http://treaties.un.org/Pages/Treaties.aspx?id=4&subid=A&lang=en.
[476] Shiko Nikaragua *k.* SHBA: 1989 I.C.J Reports 14 (vendim i 27 Qershorit 1986).

3. **Burime Dytësore:** Ndikojnë jo drejtpërdrejt në formësimin e rregullave të ndryshme në fushën objekt studimi. Për këtë mund t'i referohemi dhe Nenit 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas të cilit përbëjnë burime dytësore:

a. Vendimet gjyqësore;

b. Jurisprudenca më e kualifikuar botërore;

c. Vendimet e organeve të ndryshme *quasi* dhe jo gjyqësore;

d. Rekomandimet e organeve të ndryshme;

e. Interpretimi i traktateve nga organet e parashikuara në to, ose nga GJND;

f. Raportet e hartuara nga raportuesit special, në kuadër të mekanizmave të OKB-së;

g. *Opinio juris* të shteteve, lidhur me qëndrime të tyre.

5- **Parimet e Përgjithshme të së Drejtës:** Janë një mori parimesh demokratike, të tilla si: parimi i mirëbesimit, parimi i gjësë së gjykuar, parimi i respektimit të të dërguarve, të cilët sigurojnë një bashkëjetesë dhe bashkëpunim paqësor, normal dhe të sigurt mes shteteve të ndryshme duke siguruar relativisht dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve të prekur.

Aktorët e Ndryshëm në Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut:

Me aktorë në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut kuptohen ato institucione, organizata dhe/ose organizma të cilët kanë si objektiv të tyre, ndër të tjera dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Si të tillë mund të përmendim:

1- Shteti: Shteti me të gjitha organet e tij përbërëse është aktori më i rëndësishëm në procesin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të tij. Njëkohësisht, ai është dhe aktori më i predispozuar për t'i shkelur ato. Për shkak të kësaj pozite thellësisht të dyzuar të tij, respektimi i parimeve dhe normave demokratike nga ana e organeve shtetërore është një detyrë kritike në procesin e Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

2- Institucionet dhe Organizmat Ndërkombëtare: Për shumë institucione ndërkombëtare, Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut është objektiv primar i aktivitetit të tyre[477], ndërsa për disa të tjerë ai është thjesht një objektiv plotësues[478]. Sidoqoftë, ndërhyrja e tyre në veprimtarinë e shteteve të ndryshme, përbën shpesh një faktor vendimtar në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të tyre nga veprimet arbitrare të organizmave shtetërorë, por jo vetëm.

[477] Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, OSBE dhe ODHIR, Komitetet e ndryshme, pjesë e sistemit të OKB si: PNDCP, KKT, KDF, Komisioni Ndëramerikan etj.
[478] OKB, NATO, BE, etj.

3- Organizatat Joqeveritare: Ekzistojnë një mori OJQ-sh, me karakter kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, të angazhuara në mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut. Funksioni i tyre si alternativë dhe oponencë ndaj organeve shtetërore, bën që roli i tyre të jetë tepër i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Veprimtaria e OJQ-ve shtrihet në shumë fusha dhe aksionet e përbashkëta të tyre kanë një ndikim të konsiderueshëm. Ato trajtohen më hollësisht më poshtë.

Sistemet ndërkombëtare dhe rajonale në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut

Me termin "sistem në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut" kuptohet: tërësia e instrumenteve dhe organeve ndërkombëtare të inkorporuara në formën e një organizate ndërkombëtare dhe që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, ose pjesë të saj, mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Ndër to kemi:

1) OKB. Për shkak të pjesëmarrjes së gjerë të shteteve të ndryshme në të (193 nga 196 shtete), i vetmi sistem ndërkombëtar universal që i përmbush dhe përkufizimin më lart është OKB**.** Këtë funksion ai e kryen nëpërmjet një sërë organesh, si më poshtë vijon:

- Këshilli Ekonomik Social[479]*;
- Këshilli për të Drejtat e Njeriut[480];
- Komiteti Kundër Torturës dhe Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës*;
- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial*;
- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave*;
- Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve*;
- Komiteti për të Drejtat e Punëtorëve Emigrantë dhe Familjeve të tyre*;
- Komiteti për të Drejta Sociale, Ekonomike, Kulturore*;
- Komiteti për të Drejtat e Njerëzve me të Meta*;
- Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë[481]*;
- Byroja Ndërkombëtare e Punës (ILO)[482]*.

Për sa i përket sistemeve rajonale që sigurojnë mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, si të tilla mund të përmendim:

---

[479] Me funksion kryesor bashkëpunimin ndërkombëtar mes shteteve në fushën ekonomike e sociale. Në kuadër të tij funksionojnë një mori organizmash të specializuara që ndihmojnë në punën e tij.
[480] Krijuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme Nr. 60/251, datë 15.03.2006, ai ka si qëllim kryesor mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut duke shqyrtuar ankesat e paraqitura përpara Komitetit Këshillues të Këshillit të të Drejtave të Njeriut lidhur me dhunime masive të të Drejtave të Njeriut. Këshilli kryen dhe hetime të ngjarjeve dhe procesi është tërësisht konfidencial.
[481] E cila duke siguruar garantimin e zbatimit të së Drejtës Ndërkombëtare siguron, megjithëse në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
[482] Organ shumë i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave të të punësuarve, në marrëdhëniet e punës.
* Organe që burojnë nga Traktatet.

2) <u>Këshilli i Evropës</u>; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut[483] dhe **Karta Sociale Evropiane:** Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut ishte një ndër qëllimet themelore, të shprehura që në themelimin e organizatës së Këshillit të Evropës. Mjeti më i rëndësishëm është padyshim KEDNJ dhe **Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut**[484]. KEDNJ-në e kanë nënshkruar 47 vende dhe neneve të tij në shumë prej tyre i është dhënë fuqi e barabartë me Kushtetutat përkatëse, duke përbërë kufirin maksimal të lejueshëm të kufizimit të të Drejtave të Njeriut[485]. KEDNJ ka parashikuar dhe krijimin e GJEDNJ, si instrumenti i fundit në mbrojtjen e të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, për shtetasit e vendeve nënshkruese. Karakteristikë themelore e saj, është e drejta e shtetasve të shteteve nënshkruese, për t'i drejtuar ankesa në lidhje me vendimet e gjykatave të brendshme të cilat shkelin të drejtat dhe liritë themelore të shpallura në KEDNJ. Vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet përgjegjëse. Ndërsa, përsa i përket Kartës Sociale Evropiane, megjithëse ekziston një sistem mbikëqyrës, ajo nuk ka arritur rezultatet e KEDNJ dhe arsyet për këtë janë të shumta.

3) Bashkimi Evropian: Megjithëse qëllimi i tij fillestar ishte i ndryshëm, BE[486], veçanërisht duke filluar nga Akti Unik Evropian e më tej, ka rritur ndjeshmërinë e tij ndaj çështjeve të të Drejtave të Njeriut. Në këtë kuadër mund të përmenden parashikimet e ndryshme si në Preambulën dhe përmbajtjen e Traktatit mbi BE[487]. Ndërkohë, megjithëse akti më i rëndësishëm i miratuar nga BE rreth kësaj fushe, **Karta e të Drejtave Themelore të BE** ka fuqi deklarative, Gjykata e Luksemburgut mund ta zbatojë atë në vendimet e saj[488].

Për t'u përmendur është dhe praktika e **Gjykatës Evropiane të Drejtësisë**, e cila në momente të caktuar ka vërejtur se: "*të Drejtat e Njeriut, si themele të shoqërive të shteteve pjesëmarrëse në Bashkim, janë pjesë integrale e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe për këtë arsye zbatimi i tyre është objekt shqyrtimi nga Gjykata*" [489]. Megjithatë, numri i rasteve të shqyrtuara nga GjED lidhur me fushën e të Drejtave të Njeriut është tepër i kufizuar.

4) Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian (OSBE): Në Deklaratën e Helsinkit, të vitit 1975 u shpallën dhe 10 parime si objektiva të veprimtarisë së organizatës, ndër të cilat dhe respektimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. **KSBE** (Emërtimi fillestar i organizatës) u institucionalizua përfundimisht duke e kthyer në OSBE, më 1 Janar 1995. Në kuadër të OSBE vepron dhe **Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut** (**ODHIR**) me detyrë kryesore: 'vëzhgimin e zhvillimit të institucioneve demokratike në zonën e OSBE jashtë çdo

[483] Më poshtë referuar shkurtimisht dhe si KEDNJ.
[484] Më poshtë referuar shkurtimisht dhe si GJEDNJ.
[485] Shiko Nenin 17 §2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
[486] Në fillim KEE, më pas KE dhe tani BE.
[487] P.sh. Neni 11, Neni 35 kanë lidhje të drejtpërdrejtë me fushën e të Drejtave të Njeriut.
[488] Karta s'mund të përdoret nga qytetarët si shkak ligjor për t'i drejtuar ankesë GjED, pa plotësuar kërkesat e tjera për pranim.
[489] Çështjet: J. Nold, Kohlen dhe Bastoffgro Bhandlung *k.* Komisioni i KEE dhe Erich Stauder *k.* Qyteti i Ulmit.

ndërhyrjeje, me objektiv kryesor mbajtjen dhe zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë dhe transparent, në përputhje me standardet e mirënjohura evropiane'.

5) Organizata e Shteteve Amerikane (OAS): ka dy dokumente kryesore, **Kartën e OAS** dhe **Deklaratën Amerikane të të Drejtave dhe Detyrave të Njeriut,** të dyja të miratuara në vitin 1948. Në vitin 1978 hyri në fuqi **Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut**, e cila ka krijuar Komisionin Ndëramerikan të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatën Amerikane të të Drejtave të Njeriut[490]. Ndryshimi kryesor mes këtyre instrumenteve dhe GJEDNJ është se, në rastin a parë shtetet duhet të japin pëlqimin për zhvillimin e procesit gjyqësor.

6) Organizata e Unitetit Afrikan (OUA): Kjo organizatë ka adoptuar **Kartën Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave të Popujve**. Kjo kartë ndryshon nga karta evropiane dhe ajo amerikane pasi këtu përveç të drejtave individuale njihen dhe mbrohen dhe ato kolektive, kombëtare, si më kryesore e të cilave vlerësohet e drejta e popujve për vetëvendosje dhe sovranitet mbi burimet kombëtare. OUA nuk ka krijuar një gjykatë për të siguruar respektimin e parimeve të shpallura nga Karta, por ndërkohë, vepron **Komisioni Afrikan i të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave të Popujve,** me funksion kryesor shqyrtimin e ankesave individuale a shtetërore për shkeljet e kryera dhe interpretimin e neneve të Kartës.

7) Organizatat Joqeveritare (OJQ): Ekzistojnë një mori organizatash të ndryshme joqeveritare me ndikim global ose rajonal, të cilat kanë si objektiv mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Veprimtaria, karakteristikat dhe ndikimi që ato kanë bëjnë që roli i këtyre organizatave të jetë tepër i rëndësishëm për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Veprimtaria e tyre investiguese, raportuese, bashkëpunimi me aktorët e ndryshëm shtetërore dhe organizmat ndërkombëtarë, potenciali i tyre ekonomik dhe mbështetja e gjerë nga qytetarët, bëjnë të mundur që shkrimet dhe/ose përfundimet e tyre të kenë një ndikim tepër pozitiv në drejtim të kritikës dhe si rrjedhojë dhe përmirësimit të praktikave të shteteve të ndryshme dhe ushtrimit të presionit e detyrimit të tyre për të ndaluar praktikat të cilat shkelin hapur të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Si të tilla mund të përmendim: Human Rights Watch, Amnesty International, Transparency International, Human Rights Action Center, Human Rights Withuot Frontiers, etj.

Gjithashtu, ekziston dhe një numër i madh institucionesh, organizmash dhe organizatash të tjera rajonale të cilat si pjesë të veprimtarisë së tyre kanë dhe mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, mirëpo duke qenë se ndikimi i tyre është i një shkalle më e ulët se ato të përshkruara më lart, nuk janë listuar në këtë punim.

Përfundime

[490] Me detyrë kryesore mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në Konventë nga shtetet palë.

Mbrojtja dhe garantimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është një element thelbësor për garantimin e legjitimitetit dhe suksesin e veprimtarisë së qeverive të shteteve demokratike të së drejtës. Gjithashtu, respektimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ndihmon dhe në sigurimin dhe garantimin e një barazie relative në mundësitë formale në dispozicion të klasës sunduese në një shoqëri dhe pjesës tjetër të saj. Përpjekjet e pashterura të shoqërisë njerëzore ndër shekuj pasqyrojnë pikërisht këtë: mbrojtja dhe garantimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është një mjet tepër efikas për të siguruar barazinë politike – civile në një shoqëri ku pabarazia ekonomike sjell një pabarazi në mundësi, mjete dhe të drejta për shtresa të gjera të popullsisë.

Gjithashtu, të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut janë dhe një mjet tepër efikas për ruajtjen dhe garantimin e paqes dhe sigurisë në botë. Lufta e Dytë Botërore, apo luftërat në ish – Jugosllavi janë një shembull i qartë për këtë. Destabilizimi, konfliktet dhe precedentët e rrezikshëm që shkelja e skajshme e të Drejtave të Njeriut sjell, janë një katalizator i efektshëm për prishjen e paqes dhe destabilizimin e një rajoni të caktuar, apo edhe në shkallë globale.

Kuptimi i drejtë i këtij fenomeni ka bërë që Sistemi Ndërkombëtar të zhvillohet në një drejtim dhe nivel të tillë saqë aktualisht ekzistojnë një numër i konsiderueshëm mjetesh ndërkombëtare të cilat realizojnë mbrojtjen dhe sigurimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, proces i cili ka ndodhur relativisht më vonë sesa pranimi dhe zbatimi i vetë koncepteve të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Shpesh këto mjete janë manifestuar dhe në planin ushtarak si p.sh.: ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe në Libi në vitin 2012, e OKB në Ruanda në vitet 1993 – 1996, në Timorin Lindor në vitin 2006, apo në Haiti në vitin 2010[491].

Megjithatë, duhet thënë se respektimi dhe mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në pjesë të ndryshme të globit është në nivele të ulëta. Ngjarjet e ndodhura në kuadër të 'Pranverës Arabe' dhe në Mianmar (Birmani) tregojnë për një përhapje dhe përkrahje të gjerë të teorive demokratike në mbështetje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Por, raporte dhe statistika të fundit të hartuara nga OJQ të ndryshme kanë ngritur shqetësimin se gjendja e përgjithshme e të drejtave në botë po përkeqësohet dhe 'demokracia është në tërheqje', duke qenë se është më i madh numri i shteteve në të cilat treguesit e demokracisë janë në përkeqësim, sesa ai i shteteve ku ato janë në përmirësim[492]. Për këto arsye dhe të tjera, zhvillimi dhe afirmimi i vazhdueshëm teorik dhe praktik i koncepteve dhe instituteve të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe institucioneve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe sigurimin e tyre, është një nevojë reale dhe e vazhdueshme, e

[491] Megjithëse këto shembuj dhe interpretimi ligjor i tyre është i diskutueshëm.
[492] Raporti Vjetor i publikuar nga Freedom House në vitin 2013 mbi gjendjen e lirisw globale. I vlefshëm në http://www.freedomhouse.org.

domosdoshme si për respektimin e nderit dhe dinjitetit njerëzor, por dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë.

Bibliografia

Libra

Anastasi A. "*Historia e Institucioneve*", Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë 2006, ISBN 99927-0-297-4.

Daci J. "*Të Drejtat e Njeriut*", Shtëpia Botuese Erik, ISBN 99943-47-93-3, Tiranë 2008.

Puto A., "*E Drejta Ndërkombëtare Publike*", Botimet Dudaj, ISBN 978-99943-0-160-7, Tiranë 2012.

Alex P. Schmid, "*Research on gross Human Rights Violations*", P.I.O.O.M, P. Leiden 1989, ISBN 9071042286.

Curtis F. J. Doebbler, "*International Human Rights Law: Cases and Materials*", CDP, SHBA 2003, ISBN 0974357006.

Raporte.

Scott McLemme, "*The Last Utopia*", *Inside Higher Education*, e vlefshme në http://www.insidehighered.com.

Gender and reproductive rights", Organizata Botërore e Shëndetësisë, e vlefshme në: http://who.int/reproductive-health/gender/index.html.

"*Four in Five Regard Internet Access as a Fundamental Right: Global Poll*", BBC News, e vlefshme në: http://news.bbc.co.uk/1/shared/bsp/hi/pdfs/08_03_10_BBC_internet_poll.pdf.

Legjislacion.

Deklarata e Pavarësisë së Shteteve Amerikane të bashkuara.

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

OKB, Traktatet: http://treaties.un.org/Pages/Treaties.aspx?id=4&subid=A&lang=en.

Praktikë Gjyqësore.

Nikaragua kundër SHBA: 1989, I.C.J Reports 14, vendim i 27 Qeshorit 1986.

J. Nold, Kohlen dhe Bastoffgro Bhandlung *k*. Komisioni i KEE, çështja Nr. 4/73 dhe Erich Stauder vs. Qyteti i Ulmit, çështja Nr. 29/79.

Zbatimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Procesin Penal Shqiptar

Arbesa Kurti[1], Elida Elezi[2]

[1]Departamenti Penal, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

[2]Departamenti Penal, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakti

Njeriu gëzon një tërësi të drejtash, që i janë garantuar nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kur individit i shkelen të drejtat dhe liritë, ai ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur përpara gjykatave kombëtare, të cilat duhet të jenë të paanshme, të pavarura dhe të respektojnë procesin e rregullt ligjor. Një tjetër garanci që i është njohur individit, të cilit i janë shkelur të drejtat është kërkimi i rivendosjes në vend të të drejtave në Gjykatën Evropiane të të Drejatve të Njeriut. Individët mund t'i drejtohen GJEDNJ-së, si në rastet e shkeljeve të të drejtave civile ashtu edhe për të drejtat e shkelura në fushën penale, me kushtin që të jenë ezauruar mjetet e brendshme ligjore.

Aplikueshmëria e vendimeve të GJEDNJ është parashikuar në nenin 46 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por një rregullim më specifik që parashikon detyrueshmërinë e zbatimit të vendimit të GJEDNJ nga shteti kundër të cilit është dhënë ky vendim është sanksionuar në Protokollin e 11 të saj. GJEDNJ kur konstaton shkelje të të drejtave të njeriut, përveç parashikimit të shumave të dëmshpërblimeve që duhet të paguhen nga shteti , e vë këtë të fundit përpara detyrimit për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur ose ndryshimin e sistemit ligjor në përputhje me respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Vendimet e GJEDNJ parashikohen si rrethanë, për të cilën mund të bëhet rishikimi i vendimeve civile të formës së prerë në Gjykatën e Lartë, ndërsa në Kodin e Procedurës Penale, vendimi i GJEDNJ, i cili ka konstatuar shkelje të të drejtave në procedimin penal, nuk përbën shkak për të kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë në Gjykatën e Lartë . Problemi që ka lindur në zbatueshmërin e këtyre vendimeve është mosparashikimi i kësaj rrethane, si shkak për të rishikuar vendimin gjyqësor dhe përplasja me parimin res judicata (gjësë së gjykuar).

Në këtë punim do të ndalemi në një analizë të detyrueshmërisë së Vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe aplikueshmëria e tij në sistemit aktual të rishikimit të

vendimeve të parashikuar nga Kodi i Procedurë Penale. Do të analizohen edhe vendime të praktikës gjyqësore Shqiptare të cilat janë përballur me këtë vakum ligjor.

Fjalët kyçe*:* *Aplikueshmeria, neni 46 i KEDNJ, rishikimi problemet normative dhe praktike*.

Hyrje

Rëspektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut është një nga element thelbësor për një shoqëri demokratike. Në rastet kur një person ka kryer një vepër penale të parashikuar në ligj, atij i garantohen një tërësi të drejtash proceduriale, të cilat i gëzon nga momenti kur ndaj tij kanë filluar hetimet deri në momentin e përfundimit të vuajttjes së dënimit. Shkelja e të drejtave proceduriale e bën një proces jo të rregullt.

E drejta për një proces të rregullt ligjor njihet si nga e drejta e brëndshme, ashtu edhe nga aktet ndërkombëtare. Në momentin kur një shtet ratifikon një konventë apo një akt ndërkombëtar, ai duhet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga ato (pacta sun servanda)[493]. Krahas zbatimit të detyrimeve, shtetet duhet të ndërmarrin masa për të harmonizuar legjislacionin e brëndshëm me aktet ndrkombëtare të ratifikuara.

Në këtë punim synohet të analizohet kuadri ligjor që mundëson rishikimin e vendimeve që kanë marrë formë të prerë, në rastet kur nga një gjykatë ndërkombëtare (GJEDNJ) është konstatuar që vendimi është marrë në bazë të një procesi të parregullt ligjor.

Ky punim do të ndahet: *së pari* në analizimin e raportit midis Kushtetutës, të drejtës së brëndshme dhe akteve ndërkombëtare, *së dyti* në detyrueshmërinë e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ndryshimet që ka pësuar neni 46 i Konventës, *së fundmi* do të analizojmë zbatimin e këtyre vendimeve në procesin penal Shqiptar.

II. Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendimeve të GJEDNJ

Traktati ndërkombëtar është një marrëveshje e lidhur midis dy ose më shumë shteteve, marrëveshje me anën e së cilës palët vendosin, të ndryshojnë ose pezullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në shkallë ndërkombëtare[494]. Shqipëria ka aderuar, ka nënshkruar dhe ratifikuar një tërësi aktesh ndërkombëtare.

Një nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishëm është Konventa Evropiane e të Drejtave të njeriut (KEDNJ). Në këtë Konventë parashikohen dhe garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Krahas parashikimit të të drejtave, Konventa ka ngritur Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila do të gjykojë rastet kur janë shkelur të drejtat e parashikuar nga konventa.

[493] Shih Konventën e Vjenës "*Mbi të drejtën e Traktateve*, dt.23.05.1969
[494] Shih Puto.A, "*E drejta ndërkombëtare publike*", Tiranë, 2010, fq 352

Shqipëria e ka ratifikuar KEDNJ më 2 tetor të vitit 1996. Nga moment i ratifikimit për shtetin tonë rrjedh detyrimi për të respektuar të drejtat e parashikuara në këtë konventë dhe të zbatojë vendimet e GJEDNJ të marra kundër tij.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është parashikuar se :

"Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të[495]*"*.

Nga kjo dispozitë konstatojmë se në Kushtetutë është mishëruar parimi *pacta sun servanda,* që do të thotë që Shteti Shqiptar nuk mund ti shmanget detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara prej tij.

E drejta ndërkombëtare ka epërsi ndaj të drejtës së brëndshme, por jo ndaj Kushtetutës. Në teorinë bashkëkohore mbrohet mendimi se, pavarësisht nga vendi që zë sot e drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ajo konsiderohet "shpesh si një e drejtë minimum". Kjo do të thotë se të drejtat e shpallura me solimnitet në aktet ndërkombëtare, të cilat ratifikohen nga shtete të ndryshme, nuk e pengojnë të drejtën e brëndshme Kushtetuese të këtyre vendeve që të shkojë më tej në çështjen e afirmimit të mbrojtjes dhe garantimit të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore[496].

Por vetë Kushtetuta bën një klasifikim dhe rënditje të akteve në bazë të fuqisë juridike të tyre. *Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë*[497]*:*

a) Kushtetuta,

b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara,...

Në këtë nen parashikohet hierarkia e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Siç vihet re edhe nga dispozita e mësipërme marrëveshjet ndërkombëtare vijnë menjëherë mbas Kushtetutës. Në ratstet kur një akt ligjor i brëndshëm është në kundërshtim ose në mospërputhje me një marrëveshje ndërkombëtare, atëherë do të zbatohet marrëveshja ndërkombëtare. Epërsia e marrveshjeve ndërkombëtare parashikohet edhe në nenin 122/2 të Kushtetutës:

"Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të".

KEDNJ ka epërsi ndaj ligjeve të brendshme. Çdo akt ligjor duhet të jetë në përputhje me konventën. KEDNJ ka një status të veçantë, ndryshe nga aktet e tjera ndërkombëtare, të cilat gjithmonë qëndrojnë nën Kushtetutë dhe nuk duhet të bien në kundërshtim me të. Në rastet e kufizimit të të drejtave, KEDNJ ka të njëjtin status me Kushtetutën.

Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet rastet e kufizimit të të drejtave:

[495] Shih nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e vitit 1998
[496] Shih Anastasi.A, *E drejta Kushtetuese*, Tiranë 2004, fq.78
[497] Shih nenin 116/1 të Kushtetutës

Kufizimet e të drejtve nuk mund të cënojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut[498].

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar këtë dispozitë duke u shprehur se[499]*:*

> *…Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përcakton disa nga të drejtat themelore të njeriut, por ajo nuk ndalon që shtetet palë të parashikojnë edhe më shumë të drejta e liri për individët , ndërsa Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj ka pranuar përmbajtjen e Konventës Evropiane si minimumin e këtyre kufizimeve, pa penguar që legjislacioni vendas t'u japë më shumë të drejta e liri si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit.*

Në rastet kur një ligj, apo akt nënligjor kufizon një të drejtë dhe bie në kundërshtim me Konventën, gjykata e brëndshme që shqyrton këtë çështje ka të drejtë të zbatojë dhe ti referohet drejtëpërdrejtë Konventës.

Siç u përmend më lart, në Konventë krahas parashikimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, parashikohet organizimi dhe funkionimi i GJEDNJ, mënyra e zhvillimit të procesit në këtë gjykatë. Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e kanë perosnat fizik/juridik shtetas të vendeve palë në Konventë. Palë kundërshtare në GJEDNJ janë shtetet, të cilët kanë shkelur të drejtat e shtetasve të vet. Vendimet që merren nga GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar nga shtetet, kundër të cilëve është marrë ky vendim. Në nenin 46 të KEDNJ parashikohet dipozita e detyrueshmërisë së vendimeve të GJEDNJ:

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikqyr ekzekutimin e tij.

3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikqyrja e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i

---

[498] Shih nenin 1

[499] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.24/2007

tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.

4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi y'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Pale dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në të, mund t'i referojë Gjykatës problemin nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.

5. Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.

Nga dispozita e mësipërme vëmë re se vendimet e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar. Përpara ndryshimeve të Konventës, juridiksioni i Gjykatës ishte fakultativ, duke e lënë në dorë të shteteve nëse do ta pranonin ose jo juridiksionin e gjykatës [500].Ky nen është ndryshuar me Protokollin 11, i cili hoqi klauzolën fakultative juridiksionale, duke e bërë juridiksionin e Gjykatës të detyrueshëm. Gjithashtu në KEDNJ është parashikuar mekanizmi që do të monitorojë zbatimin e vendimeve nga shtetet, i cili është Komiteti i Ministrave. Problemi që është ngritur është mënyra e ekzekutimit të vendimeve. Disa shtete parashikojnë që këto vendime të zbatohen direkt në të drejtën e brëndshme, ndërsa disa të tjerë kanë adoptuar dispozita që u lejojnë atyre të rishikojnë vendimet e brëndshme që kanë rezultuar në mospërputhje me Konventën[501].

Midis Konventës dhe të drejtës të brëndshme ka një lidhje të ngushtë, e cila shprehet në drejtim të zbatimit të normave, të ezaurimit të mjeteve të brëndshme, të mënyrave të zbatimit të vendimeve të GJEDNJ në të drejtën e brëndshme[502].

Vendimet e GJEDNJ janë të detyrueshme, por jo të ekzekutueshme. Kjo do të thotë se shtetet zotohen se do të respektojnë vendimin (duke dëmshpërblyer personin që i janë shkelur të drejtat, por vendimi nuk ndryshon dhe as shfuqizon aktet e brëndshme të shtetit "fajtor"[503]. Në bazë të nenit 46 të sipërcituar, Gjykatës i lind e drejta të japë urdhra konkret për zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve, duke i detyruar shtetet jo vetëm në dëmshpërblimin e personit, por edhe në marrjen e masave ligjore për të ndalur cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit[504].

III. Detyrueshmëria e zbatimit të Vendimeve të GJEDNJ-së në një proces penal

[500] Shih Pradel.J, Corstens.G, Vermeulen.G, *E drejta Penale Evropiane,* Tiranë 2009, fq 229
[501] Shih Puto.A, *E drejta ndërkombëtare Publike*, Tiranë, 2010, fq 232
[502] Po aty
[503] Shih Pradel.J, Corstens.G, Vermeulen.G, *E drejta Penale Evropiane,* Tiranë 2009, fq 254
[504] Shih çështjen Bronioëski kundër Polonisë

Në Konventë nuk është parashikuar mënyra e zbatimit apo ekzekutimit të vendimeve të cilat kanë konstatuar shkelje të të drejtave të indiviëve gjatë një procesi penal. Siçc u përmend më lart shtetet kanë aplikuar mënyra të ndryshme për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së. në një vendim të GJEDNJ-së, krahas konstatimit të shkeljes dhe detyrimit të shtetit për të dëmshpërblyer individin (ekzekutimi i i dëmshpërblimit nuk ka hasur problem ligjore), Gjykata kërkon nga shtetet që të rikthejnë individin në gjëndjen e mëparshme *restitution in integrum* dhe të ndërmarrin masa që këto shkelje mos të ndodhin më.

Problemi që kanë hasur shtetet është rishikimi i vendimeve penale të cilat kanë marrë formë të prerë, kur nga ana e GJEDNJ-së janë konstatuar shkelje të procesit të rregullt ligjor ose të drejtave të individit.

Pavarësisht se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut(Gjykata) shpesh thekson në vendimet e saj që nuk është një gjykatë që gjykon në shkallë të tretë apo të katërt,vetëm pak mund të mos bien dakord me mendimin se gjykata është"ndërgjegjja kushtetuese" e Këshillit të Europës në fushën e të drejtave të njeriut. Në tre çështje kundër Bosnjë-Hercegovinës[505], Hungarisë[506] dhe Lituanisë[507] gjykata është shprehur se shtetet përkatëse duhet të bëjnë ndryshime në nenet Kushtetuese që bien ndesh me Konventën. Në këtë mënyrë është e lehtë për të kuptuar se pse Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës i ka njohur Konventës një rol qëndror si "një instrument kushtetues" i rendit publik të Europës, nga e cila varet dhe stabiliteti demokratik i kontinentit[508].Tre shembujt e mësipërm bëjnë të qartë se KEDNJ mund të jetë shtyllë e fuqishme në sjelljen e ndryshimit të thellë politik dhe social.

Siç thekson dhe Gjykata, një vendim i cili konstaton se ka pasur shkelje të Konventës imponon tek shteti përkatës detyrimin ligjor jo vetëm të paguaj dëmin, por edhe ndërmarrjen e masave ligjore për parandalimin e shkeljeve. Një çështje nuk konsiderohet e përfunduar me marrjen e vendimit nga gjykata por vetëm kur Komiteti i Ministrave shprehet se shteti përkatës ka ndërmarrë të gjitha masat e duhura dhe harton një raport përfundimtar. Si masat e posaçme ashtu dhe ato përgjithshme mund të sjellin ndryshime strukturore: nëse për shembull gjykata vlerëson se një procedim penal ka shkelur procesin e rregullt ligjor, Gjykata mund të urdhërojë rihapjen e proçesit dhe mbajtjen e një gjyqi tjetër. Kjo mund të bëhet e mundur vetëm nëse legjislacioni përkatës është ndryshuar dhe harmonizuar,duke lejuar rihapjen e proçeseve për çështje të ngjashme në të ardhmen.

---

[505] Shih Vendimin e GJEDNJ, *Sejdik dhe Finci kundër Bosnjë –Hercegovinës*, 22 Dhjetor 2009
[506] Shih Vendimin e GJEDNJ, "*Alajos Kis v Hungarisë*", 20 Maj 2010.
[507] Shih Vendimin e GJEDNJ, "*Paksas v Lituanisë*" i 6 Janarit 2011.
[508] Shiko paragr.2 të Deklaratës se Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, www.wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=743337&Site=COE

Pjesa më e madhe e vendimeve të Gjykatës kanë natyrë deklarative. Zbatimi i efektivitetit të këtyre masave mbikëqyret nga një trup politik si Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës që përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme ose deputetët e tyre. Sanksioni që mund të merret ndaj shtetit që refuzon të përmbushin detyrimet e tyre është largimi nga anëtarësia ose përjashtimi nga Këshilli i Europës, një sanksion që është përdorur në një masë të vogël.

3.1 Ndryshimet në aplikueshmërinë e nenit 46 të KEDNJ

Gjatë mbikqyrjes së ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ, Komiteti i Ministrave konstatonte vështirësi në ekzekutimin e tyre. Nga ana tjetër në GJEDNJ, po shtoheshin raste të shkeljes të të drejtave të njeriut dhe shkeljet vinin nga i njëjti burim. Në vitin 2003 Komiteti i Ministrave i bën thirrje Gjykatës që të identifikonte në gjykimet e saj, në të cilat konstatonte shkelje të neneve të Konventës, se cili ishte problemi i vazhdueshëm dhe cili ishte burimi i këtij problem (në veçanti kur kishte aplikime të shumta për të njëjtin fakt). Gjykata krahas konstatimit të shkeljes dhe caktimit të dëmshpërblimit duhet të përcaktonte edhe detyra konkrete për shtetin "fajtor", duke i lehtësuar punën Komitetit të Ministrave në asistimin e shteteve për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve.[509]

Duke marrë parasysh numrin e madh të çështjeve të ardhura në këtë gjykatë dhe kërkesën e Komitetit të Ministrave, gjykata për herë të parë në historinë e saj, në çështjen Broniovski kundër Polonisë[510], shprehimisht tha që shkelja që u konstatua kishte në origjinën e saj një problem të gjerë që rezulton nga një keqfunksionim i legjislacionit Polak dhe praktikës administrative[511].Gjykata i kërkoi Qeverisë Polake jo vetëm te kompensonte aplikantin, por dhe të ndërmerrte masa të ngjashme për të parandaluar shkeljen lidhur me 167 aplikantët e tjerë. Gjithashtu gjykata i dha gjashtë muaj kohë qeverisë Polake të hartonte dhe implementonte të gjitha masat e nevojshme të posaçme dhe të përgjithshme, duke pezulluar në të njëjtën kohe shqyrtimin e çështjeve të ngjashme që ishin ngritur pas dhënies të këtij vendimi.[512]

Çështja Broniovski është mbajtur si mekanizmi i parë ndërkombëtar ligjor, që i dha mundësinë Gjykatës që në mënyrë të shpejtë të rregullonte një sërë cështjesh që kishin mbetur në pritje dhe në të njëjtën kohë u mundësonte qeverive përkatëse orientime lidhur me masat që duhet

[509]Shih Rezolutën (2004)3 e Komitetit të Ministrave
[510]Shih Vendimin e GJEDNJ, *Broniovski v Polonise,* dt. 28 Shtator 2005
[511] Po aty ,paragrafi 185
[512] Po aty

të ndërmerrnin për të ekzekutuar vendimin, si dhe të parandalonte aplikantët potencial për t'iu drejtuar Gjykatës për të njëjtat shkelje.

Kjo çështje mund të cilësohet gjithashtu novatore edhe për një arsye tjetër. Ajo shënoi rritjen e "mbikqyrjes" të Gjykatës ndaj Komitetit të Ministrave, i cili deri në atë moment ishte i vetmi organ që bënte vlerësimin e efektivitetit të masave individuale dhe të përgjithshme të adoptuara nga shtetet përkatëse.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm do të zinte vend në vitin 2006 kur Procedurat e Rregullave të Komitetit u amenduan dhe për herë të parë iu lejua aplikantëve dhe përfaqësuesve të tyre me mundësinë e aksesit në informacionet e Komitetit lidhur me pagesën e kompensimit dhe adoptimin e masave të posaçme dhe të përgjithshme, së bashku me komentet lidhur me efektivitetin e tyre.

Hapa të mëtejshme u bënë me ratifikimin e Protokollit 14 të Konventës. Dy të tretat e shumicës së Komitetit të Ministrave duhet ti bëjnë kërkesë Gjykatës për vendosjen e një rregulli interpretues duke vendosur një dykuptimesi si dhe vetë dispozitat e saj .Akoma më tej dy të tretat e shumicës mund të nisin procedurat e shkeljes përpara Dhomës së Madhe kundër një shteti që refuzon ti bindet një vendimi përfundimtar marrë kundër tij. Deri në hyrjen në fuqi të Protokollit 14 , mundësia e vetme për Komitetin ishte marrja e masave të pezullimit ose të dëbimit të shteteve anëtare nga Këshilli i Europës.

3.2 Çështjet pilot të GJEDNJ

Gjykata filloi konkretizimin e qëllimeve të saj jurisprundenciale me anë të gjykimeve pilot. Ajo ka zhvilluar tre lloj gjykimesh pilot lidhur me zbatimin e nenit 46 të KEDNJ:

- Gjykimi pilot *par excellence* (i iniciuar kryesisht), është një gjykim, i cili e ka bazën në çështjen "Broniovski". Ky lloj gjykimi është sanksionuar në rregullat e Gjykatës, rregulli 61 i cili parashikon që: "*Gjykata mund të iniciojë procedurën e një gjykimi-pilot dhe të adoptojë një gjykim të tillë kur faktet e një aplikimi të zbuluara në shtetin kontraktues evidentojnë ekzistencën e një problemi strukturor ose mosfunksionime të tjera të ngjashme të cilat mund të ngrihen dhe në aplikime të tjera të ngjashme*". Gjykata mund ta nisë procedurën qoftë kryesisht pra me iniciativën e saj ose me kërkesën e njërës apo të dyja palëve. Në gjykimin e saj Gjykata duhet të identifikojë si problemet strukturore si dhe të vendosë dispozita detyruese të gjykimit.Një tipar plotësues i një gjykimi pilot është që nën Rregullin 4 të Rregullave të Komitetit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve, implementimi i vendimit dhe rishikimi do të ketë prioritet.

- Gjykimet *pseudo-pilot*[513], në këto gjykime gjykata efektivisht vepron sikur të kishte adoptuar një procedurë të gjykimit pilot, thekson natyrën dhe përmbajtjen e masave të përgjithshme që duhet te implementohen në mënyrë që të konkretizojë problemet strukturore të identifikuara. Gjykata nuk e konverton këtë këshillë në një urdhër duke e përfshirë në një parashikim fakultativ të gjykimit. Në këtë mënyrë shteti nuk është i detyruar të adoptojë masat pavarësisht se Komiteti i Ministrave mund të miratojë udhëzime nga vendimet dhe ti kërkojë shteteve të adoptojë masat e përshkruara nga gjykata.Nuk është gjithashtu e zakonshme që në këto cështje Gjykata të përfshijë një masë të posaçme në dispozitat facultative të vendimit.
- Gjykimet *mbështetëse ose gjykime këshilluese,* në këto gjykime gjykata nuk e identifikon ekzistencen e një problemi strukturor por në varësi të natyrës të shkeljes tërheq vëmendjen e shtetit përkatës dhe e inkurajon atë të marrë masat e nevojshme në mënyrë që të parandalojë dhunimet e ngjashme, sërish vendimi i gjykatës nën artikullin 46 nuk është e përfshirë në pjesën detyruese të gjykimit. Një cështje e këtij lloji është Dybeku v Shqipërisë.[514]Cështja lidhet me ndalimin në një burg të zakonshëm dhe mungesa e dispozitave të përshtatshme të një asistence mjekësore ndaj aplikantit, i cili po vuante nga një skizofreni kronike.Pasi gjeti një dhunim të artikullit 3 të Konventës, gjykata theksoi në pjesen deklarative të vendimit që mori dijeni për angazhimin e qeverisë në përmirësimin e kushteve të burgut por inkurajoi ato që të adoptonin të gjitha masat relevante si një problem i natyres urgjente. Në cështjen Surmeli v Gjermanisë[515] gjykata adoptoi një gjykim vlerësues, duke përgëzuar qeverinë Gjermane për iniciativat legjislative.Qeveria Gjermane gjithsesi deshtoi në zbatimin e masave finale dhe si rezultat katër vite më vonë, gjykata në cështjen Rumpf v Gjermanisë[516] procedoi në zhvillimin e një gjykimi pilot.

IV. Zbatimi i Vendimeve të GJEDNJ në një process penal në Republikën e Shqipërisë

Çdo individ ka të drejtën të ankimojë një vendim gjyqësor, për të cilin pretendon se është marrë në bazë të një procesi jo të rregullt ligjor, ose ka shkelur të drejtat e parashikuara në Kushtetutë, KEDNJ, apo në ligjet e brëndshme[517]. Individi të drejtën e ankimimit ndaj një vendimi mund t'ia drejtojë instancave kombëtare, në rastin e Shqipërisë instancat janë, Gjykata e rrethit gjyqsor, Gjykata e Apelit. Gjykata e Lartë dhe në rastin kur individi pretendon se është shkelur procesi i rregullt ligjor, i drejtohet dhe Gjykatës Kushtetues. Pas ezaurimit të mejeteve të brëndshme

[513]Shih Vendimin Driza kundër Shqipërisë, 13 Nëntor 2007
[514] Shih Vendimin e GJEDNJ, *Dybeku kundër Shqipërisë*, dt .18 Dhjetor 2007
[515] Shih Vendimin e GJEDNJ, *Surmeli kundër Gjermanisë*, dt. 8 Qershorit 2006
[516] Shih Vendimin e GJEDNJ, *Rumpf kundër Gjermanisë*, dt. 2 Dhjetorit 2010
[517] Shi Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr.9/ 2003

individi, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas dhënies së vendimit nga gjykata e brëndshme ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Instituti i rishikimit të vendimeve penale të formës së prerë u rivendos në Kodin e Ri të Procedurës Penale, si mjet i rëndësishëm për korrigjimin e vendimeve të gabuara lidhur me faktin. E drejta e Gjykatës së Lartë për rishikimin e vendimeve të formës së prerë duhet marrë në kuptimin e gjerë, si në riekzaminimin e vendimeve të formës së prerë, ashtu edhe për shkak të gabimit në fakt[518].

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, parashikohen rastet kur mund të rishikohet një vendim penal që ka marrë formë të prerë[519]. Rastet kur mund të kërkohet rishikimi i një vendimi janë:

a) Kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) Kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;

c) Kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;

d) Kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Në nenin e mësipërm konstatohet, se në rastet e rishikimit nuk është parashikuar rasti kur një gjykatë ndërkombëtare, si psh.GJEDNJ-së merr një vendim i cili konstaton se vendimi i brëndshëm i shtetit është marrë në bazë të shkeljes të të drejtave të njeriut ose në bazë të një procesi jo të rregullt ligjor[520].

Kur një vendim penal i formës së prerë atakohet në GJEDNJ, Gjykata në parim nuk ndërhyn në vlerësimin e provave, duke parashikuar se vlersimi i provave bëhet në bazë të rregullave të së drejtës të brëndshme. Gjykata ndërhyn dhe vlerson provat në rastet kur vendimet e gjykatave të brëndshme duken arbitrare ose haptazi të paarsyeshme dhe me kusht që procesi i rregullt gjyqësor të ketë qenë i parregullt[521].

Në disa vendime të GJEDNJ-së të marra kundër shtetit Shqiptar, Gjykata është shprehur se:

"Kur konstatohet se një aplikant është dënuar pa iu siguruar ndonjë prej garancive të procesit gjyqësor të drejtë, mënyra më e përshtatshme e dëmshpërblimit do të ishte, në parim një

[518] Shih Islami.H, Hoxha.A, Panda.I, *"Procedura Penale"*, Tiranë 2010, fq. 581
[519] Shih nenin 450 të Kodit të Republikës së Shqipërisë
[520] Shih Vendimin e GJEDNJ, *Berhami kundër Shqipërisë*, dt.27 maj 2010
[521] Po aty

rigjykim ose rihapje e procesit gjyqësor në kohën e duhur dhe në pajtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së"[522].

Pavarsisht se GJEDNJ ka konstatuar se vendimet e marra nga gjykatat e brëndshme të shtetit Shqiptar kanë shkelur procesin e rregullt gjyqësor, problem është hasur në ekzekutimin e këtij vendimi. Duke u bazuar në nenin 450 të KPP, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka refuzuar rishikimin e vendimit të formës së prerë, pasi është konstatuar shkelje nga ana e GJEDNJ-së.

Ky qëndrim i Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë do të ndryshojë, pasi GJEDNJ në një vendim të dhënë kundër Shtetit Shqiptar parashikon se:

> "*Gjykata thekson se në kuadrin e preambulës së Konventës, shteti i së drejtës është pjesë e trashigimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese, një ndër aspektet themelore të të cilit është parimi i sigurisë lijore, që kërkon ndërmjet të tjerash se kur Gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje*"[523].

Për arsye të problemeve ligjore që u konstatuan në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese i ka "deleguar" kompetencën për zgjidhjen e vakumit ligjor Gjykatës së Lartë duke u shprehur se[524]:

> "*Vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, palë të KEDNJ-së, duke përmbushur në këtë menyrë zotimet që burojnë nga neni 46/1 i saj. Gjykata konstaton gjithashtu se krahas domosdoshmërisë së plotësimit nga Kuvendi të boshllokut ligjor në legjislacionin penal procedural, Gjykata e Lartë duhet të bëjë përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur, për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuesit, qoftë duke përdorur edhe analogjinë ne Kodin e Procedurës Civile*".

Në një tjetër vendim të dhënë kundër Shtetit Shqiptar[525], GJEDNJ thekson rëndësinë që shtetet duhet të marrin masa ligjore të cilat të bëjnë të mundur gjykimin *de nova*, rihapjen e procesit gjyqësor, në rastet kur kjo gjykatë konstaton shkelje të procesit të rregullt. Në këtë vendim Gjykata shprehet se sistemi ligjor i Shtetit Shqiptar nuk ofron mundësitë për rishqyrtimin e çështjeve. Mënyra më e drejtë që aplikanti të dëmshpërblehet është rihapja e procesit gjyqësor, duke i hequr pengesat ligjore të brëndshme të cilat nuk mundësojnë rigjykimin.

[522] Po aty, paragrafi 91
[523] Shih Vendimin e GJEDNJ, Xheraj kundër Shqipërisë, dt.1.12.2008
[524] Shih Vendimi e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 01.06.2011
[525] Shih Vendimi e GJEDNJ, Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, dt. 20 prill 2010

Duke u bazuar në Vendimet e GJEDNJ-së, si dhe në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të sipërpërmendur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se[526]:

> *"Pavarsisht se nuk gjejmë referim ligjor të shprehur në mënyrë formale, të drejtëpërdrejtë, lehtësisht të lexueshëm nga cilido, vështrimi dhe trajtimi i këtyre çështjeve nga ana e drejtësisë nuk mund të jetë i ngrirë dhe i folizuar në të shkuarën. Përkundrazi është dhe duhet të jetë largpamës, bashkëkohor me qëllim të vetëm dhënien e drejtësisë dhe respektimin maksimal të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim Gjykata e Lartë ka pasur parasysh hiearkinë e normave juridike dhe vendimeve të GJEDNJ, që zënë një vend të rëndësishëm sipëror, duke e konsideruar në këtë drejtim kulmin e piramidës".*

Pavarsisht vakumit ligjor që ekziston në sistemin procedural penal, jurispudenca është munduar të japë një zgjidhje të drejtë, me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura dhe respektimit të vendimeve të GJEDNJ. Një tjetër problem që është konstatuar është që pavarsisht se procesi gjyqësor rihapet për tu gjykuar, përgjithësisht në gjykatën e apelit[527], problem është gjetja e provave, p.sh dëshmitarët nuk mbajnë mend apo nuk gjenden për shkak të kohës shumë të gjatë që ka kaluar etj.

V. Konkluzione dhe Rekomandime

Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë të detyrueshme për tu zbatuar. Shteti Shqiptar e ka ratifikuar KEDNJ dhe ka marrë përsipër detyrimet që rrjedhin jo vetëm nga Konventa, por edhe nga vendimet e Gjykatës. Shteti Shqiptar ka detyrimin që të dëmshpërblejë personin që i janë shkelur të drejtat, si dhe të organizojë sistemin e brëndshëm ligjor dhe gjyqësor në mënyrë që të respektohen kërkesat e Konventës. Në vendimet e marra kundër Shteti Shqiptar, është theksuar që duhet të ndërmerren ndryshime ligjore, për të mundësuar rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, me anë të rihapjes së procesit gjyqësor. Pavarsisht vendimeve dhe parashikimeve të tyre, në Kodin e Procedurës Penale nuk është ndërmarrë një ndryshim për të parashikuar mundësinë e rihapjes së procesit gjyqësor, kur nga GJEDNJ është konstatuar që vendimi i formës së prerë i dhënë nga gjykatat e brëndshme është marrë në shkelje të të drejtave të personit ose në bazë të një procesi jo të rregullt ligjor. Ky vakum është tentuar të mbushet nga vendimet dhe interpretimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Pavarsisht se

[526] Shih Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr.74, dt.07.03.2012
[527] Po aty

jurispudenca i ka dhënë drejtim zabtimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane, duke u bazuar në nenin 46 të Konventës dhe dispozitave të Kushtetutës që rregullojnë pozitën e akteve ndërkombëtare, janë konstauar probleme në perceptimin e vendimit të GJEDNJ dhe në rigjykimin e çështjes.

Duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Jurispudencën dhe Vendimet e GJEDNJ- së të dhëna kundër Shqipërisë, për të shmangur edhe interpretimet e vazhdueshme të Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë dhe për ti dhënë rrugë zbatimit të vendimeve të GJEDNJ-së që kanë konstatuar shkelje të të drejtave nga një vendim penal, mendojmë që duhet të bëhen ndryshime në Kodin e Procedurës Penale. Ndryshimi duhet të bëhet në nenin 450 të KPP, duke shtuar si rast për rishikimin e vendimeve të formës së prerë, vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Bibliografia

Puto. A,*"E drejta ndërkombëtare publike"*, Tiranë, 2010

Pradel.J, Corstens.G, Vermeulen.G, *E drejta Penale Evropiane,* Tiranë 2009

Islam.H, Hoxha.A, Panda, " *Procedura Penale*", Tiranë 2010

Anastasi.A, "E drejta kushtetuese", Tiranë 2004

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Konventën e Vjenës "Mbi të drejtën e Traktateve, dt.23.05.1969

Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Deklaratës se Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, www.wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=743337&Site=COE

Rezolutën (2004)3 e Komitetit të Ministrave

Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.24/2007

Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr.9/ 2003

Vendimi e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 01.06.2011

Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr.74, dt.07.03.2012

Vendimin e GJEDNJ, Berhami kundër Shqipërisë, dt.27 maj 2010

Vendimin e GJEDNJ, Xheraj kundër Shqipërisë, dt.1.12.2008

Vendimi e GJEDNJ, Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, dt. 20 prill 2010

Vendimin e GJEDNJ, Sejdik dhe Finci kundër Bosnjë –Hercegovinës, 22 Dhjetor 2009

Vendimin e GJEDNJ, "Alajos Kis v Hungarisë", 20 Maj 2010.

Vendimin e GJEDNJ, "Paksas v Lituanisë" i 6 Janarit 2011.

Vendimin e GJEDNJ, Broniovski v Polonise, dt. 28 Shtator 2005

Vendimin Driza kundër Shqipërisë, 13 Nëntor 2007

Vendimin e GJEDNJ, Dybeku kundër Shqipërisë, dt .18 Dhjetor 2007

Vendimin e GJEDNJ, Surmeli kundër Gjermanisë, dt. 8 Qershorit 2006

Vendimin e GJEDNJ, Rumpf kundër Gjermanisë, dt. 2 Dhjetorit 2010

Roli i individit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare; mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

Gjergji Ceka[1],Geraldo Taraj[2]

[1]Faculty of Law, University of Tirana, Tirane, Albania

[2]Department of Law, Bedër University, Albania

Abstract:

Në këtë studim kemi vendosur të trajtojme qasjet e sotme ne lidhje me rolin e individit në të drejtën ndërkombetare, një historik te shkurtër te evoluimit te kësaj marrëdhënieje e parë në planin e shkaqeve shoqërore, ideologjike që sollën ndryshimin e pozitës së individëve si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Dimension tjetër i kësaj çështjeje, duke shërbyer në të njëjtën kohë si faktor parësor, është edhe mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Rrugët drejt këtij ndërkombëtarizimi të të drejtave të njeriut, ndihma drejt globalizmit, kontributet e liberalizmit në riformëzimin e fuqizimin e rolit te individit në shoqëri Bashkëpunimi i kombeve ka krijuar edhe instrumente të përhershme ndërshtetërore, ku kryesori syresh është Organizata e Kombeve të Bashkuara, i krijuar me iniciativë të anëtarëve të koalicionit fitues të Luftës së Dytë Botërore Ndryshe nga paraardhësja, Lidhja e Kombeve, OKB-ja ka qenë faktor kryesor dhe vendimtar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale sidomos në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të Njeriut; vetë akti themelues i saj, karta e OKB, shpallte solemnisht si perkushtim të kombeve të bashkuara "...të forcojmë sërish besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e peronalitetit njerëzor, në barazinë mes burrit dhe gruas si dhe midis kombeve, të mëdhenj dhe të vegjël qofshin këto". Në vitin 1948, Asamblea e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nënshkroi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, një akt që ndonëse juridikisht nuk ka forcë detyruese, nuk ka dyshim që shënon fillimin e një etape të madhërishme në historinë botërore dhe të së drejtës ndërkombëtare. Nën hapat e kësaj deklarate, institucione të tjera ndërkombëtare do të fillojnë me vrull aksionin për mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nëpërmjet instrumenteve kontinentale si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Karta Amerikane e të Drejtave të Njeriut, etj. E drejta ndërkombëtare, ka vendosur hegjemonine e të drejtave të njeriut dhe nga ana tjetër vetë mbrojtja e të drejtave të njeriut ka sjelle "hegjemonine" e së drejtës ndërkombëtare në marrëdheniet e sotme shoqërore.

Keywords: *Individi, E Drejta Ndërkombëtare, Liberalizmi, Globalizmi, Organizata Ndërkombetare*

Hyrje

E drejta ndërkombëtare në kuptimin tradicional është përcaktuar si degë e së drejtës që ka rregulluar marrëdhëniet midis shteteve sovrane. Të drejtat dhe detyrimet e tyre në fusha të tilla si tregtia, lundrimi, vendosja e përfaqësive diplomatike, shpallja e fillimit ose përfundimi i luftës, etj., ishin fillimisht objekt i rregullimit të marrëveshjeve politike të përfunduara mes autoriteteve kompente të shteteve kontraktuese. Kryesisht këto marrëvëshje, që ishin burim kryesor i së drejtë ndërkombëtare, nuk preknin marrëdhëniet e shteteve palë me shtetasit e vet, çka konsiderohej domen eksluziv i cdo shteti dhe element i sovranitetit të tij. Asnjë akt juridik ndërkombëtar, deri në Kartën e Kombeve të Bashkuara nuk ka treguar interes mbi mënyrën se si një shtet sovran i trajton shtetasit e tij. Pra, duke qenë se e drejta ndërkombëtare kishte si burim kryesor traktatet e konkluduara mes shteteve, dhe këto traktate nuk ishin gjë tjetër vecse, si të thuash, një shfaqje formale dhe normative e marrëdhënieve politike mes tyre, është e qartë se e drejta ndërkombëtare në këtë kohë nuk ishte gjë tjetër vecse një aksesor i politikës së jashme të sovranëve . Sa për rolin e qenieve njerëzore në të drejtën ndërkombëtare, kuptohet se të drejtat dhe detyrat që marrëveshjet ndërkombëtare i akordonin shteteve, indirekt binin edhe mbi shtetasit e shteteve palë sepse shteti si formë e vecantë e organizimit shoqëror nuk ka qenë dhe nuk është një tërësi e shkëputur nga popullsia objekt i sovranitetit të tij. PSh., detyrimet që burojnë nga marrëveshja e paqes pas një lufte të humbur, detyrimet që rrjedhin nga përgjegjësi të tjera të shtetit në nivel ndërkombëtar, etj., paguhen nga shtetasit nëpërmjet taksave dhe tatimeve, që janë një formë klasike e ushtrimit të sovranitetit të shtetit ndaj popullsisë. Edhe përfitimet që i akordohen shtetit nga e drejta ndërkombëtare, po ashtu gëzohen indirekt nga popullsia ose së paku një pjesë e saj. Shumë autorë e kanë përdorur këtë fakt për të deduktuar se cdo rend juridik qoftë edhe e drejta ndërkombëtare, nuk ka subjekt tjetër vecse individët[528].

Një dëshirë për ta parë të drejtën ndërkombëtare të përfshijë individët si subjekte të saj, është gjetur tek H.KELSEN, PRINCIPLES OF INTERNATIONAL LAW (1966)[529]. Kelsen e shihte gjithë të drejtën të aplikuar vetëm tek individët dhe përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit si " asgjë tjetër vec përgjegjësisë kolektive të individëve që i përkasin komunitetit të përfaqësuar si një person juridik". Por ai e shihte rendin juridik të shkëputur nga faktorët politikë si shkalla e zbatimit të parimit të sovranitetit popullor, ndaj duke i futur këto faktorë "në lojë" ky realitet "i kulluar" i tij, turbullohet. Kjo teori e mbështetur nga Kelsen na vlen gjithsesi për të nxjerrë një përfundim tepër të

[528] Individuals as Subjects of International Law, M.W. Janis, Cournell International Law Journal, Vol 17:61, fq.64
[529] Hans Kelsen, Principles of International Law, 180-290, (1969).

rëndesishëm; sa më i madh të jetë roli i njerëzve në qeverisjen e një vendi, sa më drejtësisht të shpërndahen në popull përfitimet dhe detyrimet që ka një shtet sipas të drejtës ndërkombëtare, aq më tepër rritet roli i individit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Sipas prof Arben Puto, ky këndvështrim i rolit të njeriut në të drejtën ndërkombëtare më tëpër afron me të qenit objekt sesa subjekt i saj[530]. Ky mendim pasqyrohet kryesisht në doktrinat e juristëve të rrymës pozitiviste të cilët dallimin mes të drejtës së brendshme dhe të së drejtës ndërkombëtare e bazojnë tek subjektet. Jeremy Bentham, në 1789 krijoi termin "E Drejtë Ndërkombëtare" në "PREZANTIME MBI PRINCIPET E MORALIT DHE LEGJISLACIONIT[531] dhe e përkufizoi këtë term si " e drejta që merret me transaksionet e ndryshme mes sovranëve". Duke kategorizuar të drejtën në bazë të personave sjelljet e të cilëve janë objekt i kësaj të drejte, Bentham konkludoi se vetëm shtetet janë subjekt i së drejtës ndërkombëtare[532]. Bentham pra, e dinte se duke ndryshuar "të drejtën e kombeve" në "të drejtë ndërkombëtare" po krijonte një emër të ri, por nuk dinte se ish krijuar në këtë mënyrë, një koncept i ri. Edhe një pozitivist i moderuar si H.L.A. Hart mendonte se "e gjithë esenca e së drejtës ndërkombëtare, ishte se ajo u drejtohej shteteve[533]".

Një shembull i hershëm i realitetit të individit si subjekt i së drejtës drejtës ndërkombëtare na vjen që nga praktika e gjykatave në ShBA që në shekullin XVIII.

Në *Respublika v. De Longchamps* një gjykatë vendore Amerikane dënonte të pandehurin për vrasjen e Konsullit të Përgjithshëm të Francës në Sh.B.A. Cështja u mbështet në "parimet e përgjithshme të së drejtës së kombeve534". Sipas kësaj gjykate "cilido që cënon personin e një ministri publik, cënon jo vetëm Sovranin të cilin ai përfaqëson, por gjithashtu dëmton sigurinë e përgjithme dhe mirëqenien e kombeve; ai është fajtor për krime kundër të gjithë botës535".

Edhe në periudhën e baticës më të fortë të pozitivizmit, në kohën kur në evropë sundonte doktrina e sovranitetit të monarkut si pasojë e kundërreaksionit feudal që kish sjellë restaurimin e monarkive dhe nuk mund të flitej për sovranitet popullor dhe pozitë të popullit si subjekt në rendin ndërkombëtar, kur traktatet i lidhnin mbretërit, luftërat i nisnin dhe i përfundonin mbretërit, diplomatët konsideroheshin përfaqësues personalë të monarkëve, me fjalë të tjera kur i gjithë sovraniteti dhe të qenit subjekt i së drejtës ndërkombëtare i atribuohej atyre, the United States Supreme Court nuk e pati të vështirë të konsideronte individët subjekt të së drejtës ndërkombëtare.

Tek, The Paquete habana536, marina e Sh.B.A. pati ndaluar dy peshkarexha Kubaneze ditët

---

[530] Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tirane 2010, fq 210
[531531] Jeremy Bentham, An Introduction to the Principles of Morals and Legislation 6, (J.Burns and H.L.A.Hart eds. 1970)
[532] M.W.Janis, Individuals as Subjects of International Law, Cournell International Law Journal, Vol 17:61, fq.65
[533] Shih H.L.A Hart, The Concept of Law, 208 (1961), Cituar, *Idem*.
[534] 1U.S (1 Dall) 111 (1784) Cituar, Ibidem.
[535] *Idem*
[536] *175 U.S. 677 {1900}*, M.W.Janis, Individuals as Subjects of International Law, Cournell International Law Journal, Vol 17:61, fq.67.

e para të luftës Amerikano-Spanjolle. Një gjykatë e ulët federale vendosi që këto anije të konfiskoheshin si plackë lufte. Ekuipazhi dhe pronarët e anijes argumentuan para gjykatës së lartë federale se mjetet lundruese që peshkonin paqësisht, ishin të përjashtuara nga ndalimi forcërisht sipas të drejtës ndërkombëtare. Në këtë vendim historik gjykata e lartë tha: E drejta ndërkombëtare është pjesë e së drejtës sonë dhe duhet të sigurohet dhe administrohet nga gjykatat e juridiksionit përkatës, sa herë që e drejta e vënë në diskutim, determinohet prej saj. Më tej kjo gjykatë vazhdon: Sipas në praktike të hershme mes kombeve të qytetëruara, që daton shekuj më parë dhe gradualisht e shndërruar në një rregull të së drejtës ndërkombëtare, anijet peshkuese përgjatë bregut, që ndjekin destinacionin e tyre të zënies dhe transportit të peshkut të freskët, janë konsideruar të përjashtuara, me gjithë ekuipazhin dhe mallin, nga ndalimi dhe konfiskimi si plaçkë lufte[537].

Të dy rastet e mësipërme të gjykatave amerikane, i pari lidhur me dënimin penal të një qytetari në bazë të së drejtës ndërkombëtare, dhe i dyti që i njeh anëtarëve të ekuipazhit dhe pronarëve të dy anijeve të huaja peshkuese disa të privilegje të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, na bëjnë të dukshme afirmimin e rolit të individëve si subjekte të së drejtës ndërkombëtare në Sh.B.A. Vendimi i parë, më i hershmi, e njeh qenien njerëzore si subjekt pasiv ndërsa vendimi i dytë, si subjekt aktiv të së drejtës ndërkombëtare. Vihet re se e drejta ndërkombëtare jo vetëm i drejtohet njerëzve nëpërmjet normimit të disa marrëdhënieve mes tyre, duke i dhënë atyre zotësi juridike ndërkombëtare, por edhe i njeh të drejta të cilat mund ti mbrojnë në gjykatë, pra i njeh zotësinë për të vepruar nderkombëtarisht. Nga këto dy vendime nxjerrim përfundimin se në Amerikë, individët kanë gëzuar personalitet ndërkombëtar që në shekullin e tetëmbëdhjetë nëpërmjet plotësimit të të dyja kushteve, pasjes së zotësisë juridike ndërkombëtare dhe zotësisë për të vepruar ndërkombëtarisht. Një vendim gjyqësor që interpreton të drejtën ndërkombëtare duke i njohur një njeriu të thjeshtë privilegjin që i buron prej saj, kthehet në precedent dhe bëhet pjesë e së drejtës ndërkombëtare. Duke qenë iniciues në këtë proces gjyqësor që krijon një precedent, precedent i cili është një burim i së drejtës, këtë individ e shohim në këtë mënyrë si një faktor rregull-vënës në rendin juridik ndërkombëtar.

Kronologjikisht të njëjtën rradhë ndoqi edhe evoluimi i konceptit të pozitës së individit në rendin ndërkombëtar të Evropës dhe kontinenteve të tjera, vecse dhjetëra vjet më vonë. Në kontinentin tonë, fillet e njohjes së qenies njerëzore si aktorë në rendin ndërkombëtar i gjejmë tek e rruga e evoluimit të së drejtës ndërkombëtare penale. Bëhet fjalë për pozitë pasive pasi e drejta penale ndërkombëtare u drejtohet në mënyrë urdhëruese njerëzve, duke i detyruar ata të mos kryejnë disa vepra penale nderkombëtare, megjithëatë kjo gjë mjafton për ta quajtur në këtë mënyrë të pajisur me një nga kushtet e të pasurit personalitet ndërkombëtar, zotësinë juridike. Disa zakone

[537] Idem

ndërkombëtare, disa traktate, psh. Mbi ndalimin e skllavërisë dhe piraterisë" midis Britanisë së madhe dhe tribuve arabike[538] kanë qenë përpjekje sporadike për ndalimin e disa veprave me natyrë ndërkombëtare. Deri pas Luftës së Parë Botërore, e drejta ndërkombëtare ka qenë e cunguar nga pikëpamja e subjektit sepse nuk i nenshtroheshin personat që kishin kryer vepra te dënueshme bazuar në pozitën e tyre shtetërore. Ajo merr një zhvillim të plotë pas L. I. B., ku shkelja masive e rregullave të luftës dhe forca e reagimit publik çuan në domosdoshmërinë e ndëshkimit të një kryetari shteti, perandorit gjerman, Vilhelm i II[539]. Traktati i Paqes i përfunduar në Versajë parashikoi për herë të parë pergjegjesinë penale individuale të një kryetari shteti për shkelje të rregullave të luftës.

Statuti i Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nurenbergut për herë të parë, në mënyrë të shprehur bëri individët subjekte të së rrëgullave lidhur me krimet kumdër paqes, krimet e luftës dhe krimet e njerëzimit (neni 6). Kjo u shpreh edhe me veprimtarinë e kësaj gjykate ku u gjykuan dhe u dënuan me qindra Nazi-kriminelë. Nurembergu riafirmoi forcërisht se e drejta ndërkombetare mund dhe duhet të aplikohet mbi individët. Ky tribunal mbajti qëndrimin e tij historik se : " krimet kundër së drejtës ndërkombëtare janë kryer nga njerëz, jo nga entitete abstrakte dhe vetëm duke ndëshkuar njerëzit të cilët ndërmarrin këto krime mund të vihen në vend normat ndërkombëtare[540]". Gjyqi i Nurenbergut ishte një event që solli një ndryshime themelore në të drejtën ndërkombëtare por nuk ishte i vetëm. Nën shembullin e tij u ngritën gjyqe të tjera për dënimin e krimeve ndërkombëtare si Gjyqi i Tokios, Gjykata për krimet e Ish- Jugosllavisë, Gjykata e Ruandës dhe së fundmi Gjykata Ndërkombëtare Penale e krijuar me Statutin e Romës. Në nenin 25 të Statutit të Romës sanksionohet parimi përgjegjësisë penale individuale[541]; sipas parag.1, "gjykata ka juridiksion mbi personat fizikë". Ky parashikim ezauron edhe një herë në mënyrë të plotë pozitën e personave fizikë si subjekte pasivë të rendit juridik ndërkombëtar. Le të ndalim pak në një trajtesë të shkurtër të zhvillimit të elementeve të tjera të personalitetit ndërkombëtar të personave fizikë. Përvec pozitës pasive ndëkombëtare, që konsiston në afësinë e tyre për të pasur detyrime në bazë të rregullave ndrërkombëtare, personaliteti ndërkombëtar kërkon edhe poziten aktive, aftësinë për të pasur të drejta, si dhe mundësinë për t'i gëzuar efektivisht ato duke i realizuar institucionalisht (zotësia për të vepruar). Ky kusht thelbësor është arritur nëpërmjet "ndërkombëtarizimit të të drejtave të njeriut". Të drejtat e Njeriut janë fenomeni më kontribues në ngritjen e pozitës së individit përballë subjekteve të tjera ndërkombëtare sepse këto të drejta i përkasin individëve dhe kanë si palë të detyruar kryesisht shtetet dhe organizatat ndërkombëtare. Janë këto të drejta që i japin mundësinë

[538] Jola Xhafo,E Drejta Penale Nërkombëtare, Tiranë 2012, fq.16
[539] Idem
[540] Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tirane 2010, fq.256.
[541] Otto. Triffterer, Kai Ambos, Commentary on the Rome Statute of the International Criminal Court,(2008), fq.56.

individit të kërkojnë gëzimin efektiv të tyre në instanca ndërkombëtare, duke i pajisur në këtë mënyrë, të gjithë njërëzit me zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar.

Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të Njeriut, deri në Luftën e Dytë Botërore, ka pasur disa impulse sporadike si psh. veprimtaria e Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve[542], por lulëzimin e vet e fitoi mbas Luftës së Dytë Botërore, ku ndërgjegjësimi i kombeve pas masakrave të luftës, vuri si detyrë parësore të tyre, afirmimin dhe përhapjen universale të të drejtave të Njeriut. Nëpërmjet Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara të nënshkruar më 26 Qershor 1945 dhe hyrë në fuqi më 24 tetor 1945, shtetet nënshkruese marrin përsipër "...të forcojnë sërish besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e personalitetit njerëzor, në barazinë mes burrit dhe gruas si dhe mes gjithë kombeve..". Nenet 55 dhe 56 të Kartës u vinin si detyrë shteteve të nxitnin dhe zhvillonin të drejtat e Njeriut dhe liritë themelore pa dallim mbi bazë race, gjuhe, gjinie ose feje. Megjithë dispozitat e e përgjithshme dhe karakterin jo detyrues të garancive institucionale Karta e OKB ishte hapi i parë thelbësor që "ndërkombëtarizoi" të drejtat e Njeriut. Shtetet anëtare, duke aderuar në OKB, njihnin se të drejtat e Njeriut janë një angazhim ndërkombëtar dhe jo cështje e juridiksionit të tyre të brendshëm[543]. Pas tre vitesh, në dhjetor 1948, Asambea e Përgjithshme e OKB nxorri Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, që është instrumenti i parë tërësor dhe ndërkombëtar i të drejtave të njeriut . Kjo deklaratë transformon në mënyrë substanciale të drejtat e njeriut nga cështje e brendshme në pjesë të së drejtës ndërkombëtare. Këto dy akte (Karta e OKB dhe DUDrNj) hodhën bazat e rendit të ri juridik ndërkombëtar duke shndërruar në objektiv kryesor të së drejtës ndërkombëtare mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Cdo individ ka një rend të tërë juridik universal që i garanton atij paprekshmërinë trupore, lirinë e shprehjes, sigurinë nga arrestimet e padrejta, të drejtën për tu arsimuar etj.,duke pasur kështu zotësi të plotë juridike ndërkombëtare.

DUDNj dhe veprimtaria e OKB, në bazë të Kartës, nis kështu aksionin ndërkombëtar për thellimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Pas këtyre dy akteve monumentale, edhe e drejta ndërkombëtare merr një zhvillim spektakolar. Krijohen shumë organizata ndërkombëtare me karakter rajonal si Këshilli i Evropës, Organizata e Unitetit Afrikan, Organizata e Shteteve Amerikane, dhe një numër i madh aktesh juridiko-ndërkombetare si Konvena Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (1950), Deklarata Amerikane e të Drejtave dhe Detyrave të Njeriut, Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut(1969), Karta Afrikane e të Drejtave te Njeriut(1986). Këto instrumenta kanë thelluar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rang internacional duke sjelle venien e tij në qendër të rëndit juridiko-ndërkombëtar.

---

[542] Idem, fq.211.
[543] Ibidem, fq.213.

Akti që ka patur më shumë ndikim në këtë pikë ka qenë KEDrNj me aktivitetin e saj në thellimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në mbarë Evropën. Kjo konventë siguron se shtetet palë do të garantojnë brenda juridiksionit të tyre të gjitha të drejtat dhe liritë të përmbajtura në të. Konventa jo vetëm formulon të drejta ndërkombëtare për individët, por gjithashtu krijon një set institucionesh që sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave; Gjykatën Europiane të DNJ (NENI 19) dhe Komisionin Europian të DNJ. Juridiksioni i Gjykatës shtrihet për të gjitha çështjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve që i referohen asaj (neni 32). Përvec shtetëve venien në lëvizje të gjykatës për të realizuar të drejtat e tyre mund ta bëjnë edhe individët. Sipas nenit 34 të saj, Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Pa u ndalur gjatë në studimin e kësaj konvente, shohim se ajo i pajis individët jo vetëm me të drejta dhe liri themelore, por i jep mundësinë të kërkojnë rivendosjen e tyre në një institution ndërkombëtar duke i pajisur kështu më zotësi për të vepruar ndërkombëtarisht. Kësisoj, kjo tregon qartë plotësinë e të gjitha elementëve të personalitetit ndërkombëtar të individëve. Nuk duhet të harrojmë se vendimet e kësaj gjykate përbëjnë precedentë të detyrueshëm, statusi ligjor i të cilave është ai i normave ligjore mandatare[544]. Duke nisur një proces gjyqësor të tillë, individët mund të kontribuojnë në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtarë duke u bërë në mënyrë indirekte rregull-vënës në rendin ndërkombëtar.

Një model të ngjashëm në spektrin institucional të KEDrNj, kanë ndjekur edhe simotrat e saj në kontinentet e tjera. Në bazë të Konventës Amerikane të të Drejtave të Njeriut është krijuar Gjykata Ndëramerikane e DNj dhe Komisioni Ndëramerikan i DNj që shqyrtojnë kërkesat dhe peticionet individuale duke dhënë vendime detyruese për shtetet palë. Në kuadër të ndërkombëtarizimit të të drejtave të Njeriut janë nënshkruar edhe shumë traktate të tjera universale dhe rajonale si : Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa kundër Torturës, Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor, Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Karta Sociale Evropiane (1965), Pakti mbi të drejtat Civile dhe Politike (1966), Pakti i të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore (1966). Disa nga këto akte kanë mekanizma institucionalë për zbatimin e të drejtave të sanksionuara në to në bazë të kërkesave individuale.

Një shembull tjetër i personalitetit të plotë ndërkombëtar të individëve na vjen nga një organizatë rajonale më karakter thellësisht politik dhe ekonomik si Bashkimi Evropian. Një prej institucioneve kryesore të komunitetit, është edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë e krijuar me traktatin e Romës për Komunitetin Ekonomik Europian (1957, hyrë në fuqi në 1958) e cila vendos

[544] Monika Carss-Frisk, Liria e shprehjes,Një udhëzues për implementimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

për cështjet që i paraqiten duke zbatuar të drejtën komunitare[545]. Kjo gjykatë mund të investohet edhe në bazë të një kërkese të një personi fizik, kur veprimtaria e organeve të komunitetit ose të shteteve anëtare cënojnë të drejtat e tij në bazë të akteve primare të rendit komunitar[546]. Një institucion tjetër i Bashkimit Evropian është edhe Gjykata e Shkallës së Parë e vënë në funksionim në vitin 1989. Kjo gjykatë sipas nenit 225 të KEE është kompetente të gjykojë disa kategori cështjesh të propozuara nga personat fizikë dhe juridikë. Siç shihet edhe nga ky shembull, edhe në një organizatë ndërkombëtare partikulare me karakter thellësisht politik si Bashkimi Europian, roli i qytetarëve nëpër institucione ndëkombëtare tregon për realitetin e tyre si subjekte të së drejtës ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj analize mbi evoluimin dhe realitetin e sotëm të së drejtës ndërkombëtare, e parë nga dimensioni i pozitës së individit si subjekt i saj, dua të trajtoj shkurtimisht edhe përqasjen e kushtetutës sonë lidhur me këtë çështje. Neni 5 i saj thotë se "Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshmë për të", ndërsa neni 117 i rendit marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ndër burimet e së drejtës në RSh. Sipas nenit 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat shteti ynë është palë, bëhen pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe **zbatohen drejtpërdrejt,** përveçse kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji[547]. Shohim pra se kushtetuta jonë, ashtu si edhe shumë kushtetuta të tjera moderne, e konsideron të drejtën ndërkombëtare direkt të zbatueshme. Kjo do të thotë së çdo qytetar në Republikën tonë, është subjekt i së drejtës ndërkombëtare në të njejtën mënyrë siç është edhe subjëkt i së drejtës së brendshme. Ai mund të gëzojë të drejta në bazë të traktateve, të kërkojë gjyqësisht rivendosjen e tyre nëse i janë shkelur si dhe të nisë proçedura në mekanizmat juridiksionalë ndërkombëtarë.

3.1 Ndikimi i filozofise Liberale ne rolin e Individit perballe shoqerise, shtetit dhe rendit nderkombetar.

Një faktor kyç në rritjen e rolit të individit në jetën politiko-shoqërore të shoqërive perëndimore, ka qenë dhe mësymja e ideve liberale që kulmuan në shekullin e 18-të dhe 19-të. Në tërësinë e tyre, këto ide përbëjnë atë rrymë filozofike që ndryshe njihet si Liberalizëm, i cili në qendër të tij vendos lirinë individuale dhe e konsideron arritjen e saj si qëllimin më të rëndësishëm politik, gjithashtu synon zgjerimin e të drejtave të individit dhe krijimin e mundësive të barabarta atij. Filozofët e kësaj rryme, besonin se shoqëria duhet të ketë në bazë të organizimit të saj disa të

[545] Dr.Iva Zajmi, E Drejta Europiane, Botim i Dhjetë, Tiranë 2010,fq.129
[546] Idem, 138
[547] Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 si dhe Ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 (Kushtetuta)

drejta dhe liri themelore të njeriut, si e drejta e jetës, liria e mendimit dhe e shprehjes, apo liria e pronës. Gjithashtu, ata kishin bindjen se tradita në vetvete nuk është se mbart vlera të pazëvendësueshme, duke vënë theksin tek reformimi i shoqërisë, kur e mira e përgjithshme e saj e kërkon. Ata ishin kundër prezumimeve absolute të tilla si, të Drejtat Hyjnore të Mbretërve, trashëgimi i pushtetit apo feja e qëndrueshme, e padiskutueshme dhe e pandashme nga shteti. Kjo filozofi, përveçse tronditi nga themelet regjimin e hekurt e të centralizuar të Kishës Katolike, në të njëjtën kohë i dha dhe goditjen finale rendit feudal dhe absolutizmit në evropë. Kjo, për shkak edhe se idetë liberale i konvenonin synimeve të klasës së re borgjeze, e lindur me kohë në gjirin e feudalizmit, e cila përveç pushetit ekonomik që e zotëron tashmë, kërkon edhe pushtet politik. Gjithashtu për faktin se, një nga shtyllat bazë të Liberalizmit është Kapitalizmi dhe siç dihet marrëdhëniet borgjeze në prodhim janë realizim në praktikë i teorive kapitaliste, por edhe nëse nuk janë, ato kanë gjithnjë karakter kapitalist, janë sinonim i marrëdhënieve kapitaliste.

Në vazhdën e filozofisë liberale të kësaj kohe, u zhvillua dhe doktrina e së Drejtës Natyrore, e cila gjithashtu u përdor prej borgjezisë në funksion të synimeve të saj. Kjo doktrinë filozofiko-juridike, ashtu si liberalizmi, në qendër të saj vendos individin të pajisur me disa liri dhe të drejta themelore, të cilat mbi bazën e një ligjësie natyrore i përkasin atij që me ardhjen në jetë. Një nga filozofët më me peshë të Liberalizmit dhe themelues i së Drejtës Natyrore (në kuptimin e saj modern), Xhon Loku (John Locke), në një nga veprat e tij më të rëndësishmë " Dy Traktate mbi Qeverisjen"[548], do të vinte në pah dy ide themelore liberale: liri ekonomike, që do të thotë e drejta për të pasur pronë dhe për ta përdorur e gëzuar lirisht dhe liri intelektuale, ku përfshihet liria e ndërgjegjes. Kjo teori e tij e së Drejtës Natyrore, përbën në fakt thelbin e konceptimit modern të të drejtave të njeriut, edhe pse ai shihte të drejtën e pronës private si më të rëndësishme se pjesëmarrja në qeverisje apo vendimarrjen publike, duke mos e përfshirë demokracinë në tezat e tij, me frikën se dhënia pushtet popullit do të prishte shenjtërinë e pronës private. Megjithatë, është i padiskutueshëm fakti, se ideja e të drejtave natyrore luajti një rol kyç në sigurimin e një justifikimi ideologjik për revolucionin Amerikan apo Francez dhe në zhvillimin e mëtejshëm të Liberalizmit.

Rëndësia e veçantë e Liberalizmit, qëndron në atë se vlerat e promovuara fuqimisht prej tij do të përbënin themelet e rendit të ri shoqëror që pasoi feudalizmin. Në gjithë këtë ndërmarrje ndikim të padiskutueshëm pati dhe filozofia e zhvilluar prej Zhan-Zhak Rusoit (Jean-Jacques_Rousseau), i cili influencoi drejtepërdrejtë në revolucionin Francez dhe përmes veprave të tij hodhi bazat e një mënyre të re të konceptimit të politikës, së drejtës, shtetit dhe organizimit shoqëror në përgjithësi. Në veprën e tij "Kontrata Sociale"[549], në të cilën mbështet idenë se njerëzit

[548] John Locke, "Two Treatises on Government", 1689
[549] Jean-Jacques Rousseau, "*Du contrat social ou Principes du droit politique",1762*

Rekomandimi për Përfaqësuesit e Punëtorëve, 1971 (Nr. 143), sjell si shembuj një listë masash me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje të efektshme ndaj akteve që synohen si paragjykuese, që përfshijnë: përkufizime të detajuara e preçize të arsyeve që justifikojnë ndërprerjen e punësimit; konsultim apo marrjen e një mendimi këshillues nga një trupë e pavarur apo e përbashkët; një praktikë të veçantë proçedurale; riparim të efektshëm të ndërprerjes së padrejtë të punësimit përfshi, nëse kjo nuk bie ndesh me parimet bazë të legjislacionit të vendit në fjalë, rikthim në punë me marrjen e pagave të papaguara dhe rivendosjen e të drejtave të plota; vendosjen mbi punëdhënësin të detyrimit për të faktuar; njohjen e një përparësie për përfaqësuesit e punëtorëve për t'u mbajtur në punë në rast shkurtimesh. Sipas Rekomandimit, mbrojtja e përcaktuar në Konventë duhet të aplikohet edhe par punëtorët kandidatë për t'u zgjedhur a caktuar përfaqësues të punëtorëve.

Konventa Nr. 135 parashtron gjithashtu se përfaqësuesve të punëtorëve duhet t'u sigurohen lehtësirat e nevojshme në mënyrë që t'u mundësojë atyre kryerjen e funksioneve si duhet e me efiçencë. Por sigurimi i këtyre lehtësirave nuk duhet të pengojë funksionimin efikas të ndërmarrjes në fjalë.

Rekomandimi Nr. 143 paraqet një numër lehtësirash për përfaqësuesit e punëtorëve, përfshirë: dhënien e lejes nga puna pa humbur pagesën dhe përfitimet e tjera; leje për të hyrë në

vendet e punës dhe zyrat e drejtuesve të kompanisë apo përfaqësuesve të tyre; autorizim për mbledhjen e kuotave të sindikatës; autorizim të dërgojnë kërkesat e sindikatës; shpërndarjen e dokumenteve të sindikatës punëtorëve; lehtësira materiale dhe informacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tyre. Rekomandimi siguron edhe garanci për punëdhënësit që këto lehtësira të mos pengojnë punën normale të ndërmarrjes

Të drejta sindikaliste në administrimin publik

Konventa e Marrëdhënieve të Punës (Shërbimet Publike), 1978 (Nr. 151) u adoptua duke marrë parasysh faktin se Konventa Nr. 98 nuk mbulon kategori të caktuara të shërbyesve publikë, dhe sepse Konventa për Përfaqësuesit e Punëtorëve, 1971 (Nr. 135) aplikohet vetëm për përfaqësuesit e punëtorëve në ndërmarrje.

Konventa Nr. 151 iu aplikon gjithë personave të punësuar nga autoritetet publike (deri në masën që për ta të mos aplikohen kushte më të favorshme në konventa të tjera ndërkombëtare të punës). Megjithatë, ngelet për t'u përcaktuar nga legjislacioni i çdo vendi se në çmasë garancitë e ofruara nga kjo Konventë do të aplikohen për: (1) punonjës të nivelit të lartë, funksionet e të cilëve konsiderohen si politikë-bërës dhe drejtuese; (2) punonjës detyrat e të cilëve janë të një natyre tepër konfidenciale; dhe (3) forcat e armatosura dhe policia.

Përmbledhje e parimeve nga Komisioni i Ekspertëve

Të drejta dhe liri civile të sindikatave

- Garancitë e paraqitura në Konventat ndërkombëtare të punës, në veçanti ato që lidhen me të drejtën e organizimit, mund të jenë të efektshme vetëm nëse të drejtat civile dhe politike që shprehen në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe të tjerë instrumente ndërkombëtare njihen dhe mbrohen me vërtetësi.
- E drejta e punëmarrësve dhe punëdhënësve, pa asnjë lloj përjashtimi, të themelojnë apo hyjnë në organizata që vetë i zgjedhin
- Ushtrimi i lirshëm i kësaj të drejte sindikaliste përfshin: mungesën e çfarëdo dallimi (për shkak race, kombësie, gjinie, gjendje civile, moshe, përkatësie apo veprimtarie politike) në legjislacion e në praktikë, ndër ata që kanë të drejtën e organizimit; mungesën e nevojës për autorizim paraprak për të themeluar organizata; dhe lirinë e zgjedhjes për anëtarësi në këto organizata.

- Garancitë e Konventës Nr 87 duhet të aplikohen për gjithë punëmarrësit e punëdhënësit pa asnjë lloj përjashtimi, veç forcave të armatosura dhe policisë. Akte që ndalojnë të drejtën për organizim për kategori të caktuara punëtorësh si shërbyesit publikë, staf drejtues, shërbyes shtëpiakë, apo punonjës të bujqësisë bien ndesh me aktet e shprehura të Konventës.

E drejta për themelimin e organizatave pa autorizim paraprak

Formalitetet e kërkuara, si ato që nevojiten për fushatë njohjeje, nuk duhet të jenë aq komplekse e të zgjatura sa t'u japin autoriteteve në praktikë fuqi të justifikuar për refuzimin e ngritjes së organizatave. Duhet të parashikohet krijimi i mundësisë së apelimit gjyqësor kundër çfarëdo vendimi administrativ të këtij lloji tek një organ i pavarur e i pa-anshëm.

E drejta e punëmarrësve dhe punëdhënësve të themelojnë apo hyjnë në organizata të zgjedhjes së tyre të lirë nënkupton në veçanti marrjen në liri të këtyre vendimeve: zgjedhje e strukturës dhe përbërjes së organizatave; themelimin e një a më shumë organizatave brenda së njëjtës ndërmarrje, lloj apo degë aktiviteti; dhe ngritjen e federatave e konfederatave. Kjo rrjedh nga parimi që, ndonëse konventa nuk ka për qëllim që ta bëjë pluralizmin sindikalist të detyrueshëm, pluralizmi duhet të jetë në çdo rast i mundshëm, edhe pse lëvizja sindikaliste dikur pati adoptuar unitetin. Prandaj nuk duhen imponuar direkt me ligj sisteme uniteti apo monopoli sindikalist.

Kufizimet e skajshme lidhur me numrin minimal të anëtarëve bien gjithashtu ndesh me Nenin 2 të Konventës Nr. 87.

Funksionimi i lirë i organizatave. E drejta për t'i hartuar vetë statutet dhe rregulloret

Në mënyrë që kjo e drejtë të garantohet plotësisht, duhet që pikësëpari të përmbushen dy kushte bazë: së pari, legjislacioni shtetëror duhet të përmbajë vetëm kërkesa formale lidhur me organizatat sindikaliste; së dyti, statutet dhe rregulloret nuk duhet t'i nënshtrohen aprovimit paraprak nga ana e autoriteteve publike.

Ekzistenca e një të drejte për t'ju drejtuar gjykatës lidhur me aprovimin e statuteve nuk përbën në vetvete një garanci të mjaftueshme. Gjykatat duhet të kenë fuqinë të rishqyrtojnë substancën e çështjes, si dhe bazat mbi të cilat është marrë një vendim administrativ.

E drejta për të zgjedhur përfaqësues në liri të plotë

Autonomia e organizatave mund të garantohet efektivisht vetëm nëse anëtarët mund t'i zgjedhin përfaqësuesit e vet në liri të plotë. Për këtë, autoritetet shtetërore duhet të shmangin

çfarëdo ndërhyrje që mund ta kufizonte ushtrimin e kësaj të drejte, qoftë përsa i përket mbajtjes së zgjedhjeve të sindikatës, kushtet e kandidimit, apo rizgjedhjen a shkarkimin e përfaqësuesve.

Rregullimi i proçedurave dhe mënyrave për zgjedhjen e zyrtarëve sindikalistë duhet të bëhet në radhë të parë nga vetë sindikatat. Ideja në themel të Nenit 3 të Konventës Nr. 87 është që punëmarrësit dhe punëdhënësit mund të vendosin vetë lidhur me rregullat që duhet të drejtojnë administrimin e organizatave të veta dhe zgjedhjet e mbajtura brenda tyre.

Ndërhyrja e autoriteteve në ushtrimin e kësaj të drejte nuk duhet të shkojë matanë garantimit të akteve që nxitin parimet demokratike brenda sindikatave apo sigurimit të funksionimit të duhur të proçesit të zgjedhjeve, lidhur me të drejtat e anëtarëve, në mënyrë që të mënjanohen çfarëdo lloj mosmarrëveshjesh me përfundimin e tyre.

E drejta e sindikatave për të organizuar administrimin e tyre

E drejta e punëmarrësve dhe punëdhënësve për të organizuar administrimin e tyre pa ndërhyrjen e autoriteteve publike përfshin veçanërisht autonominë dhe pavarësinë financiare dhe mbrojtjen e aseteve e pasurisë së këtyre organizatave.

Probleme të pajtueshmërisë me konventën Nr. 87 lindin kur ligji përcakton kontributin minimal të anëtarëve, specifikon proporcionin e fondeve të sindikatës që i duhen paguar federatës, ose kërkon që operacione të caktuara financiare, si pranimi i fondeve nga jashtë shtetit, të aprovohen nga autoritetet publike.

Probleme të pajtueshmërisë lindin gjithashtu kur autoriteti administrativ ka kompetencën të kontrollojë llogaritë dhe dokumentacion të një organizate tjetër, të ndërmarrë një hetim dhe të kërkojë informacion në çfarëdo kohe, apo është i vetmi organ i autorizuar për të ushtruar kontroll, ose nëse një kontroll i tillë ushtrohet nga e vetmja organizatë qendrore e përcaktuar shprehimisht me ligj.

Liria për të organizuar administrimin e tyre nuk kufizohet në operacionet e mirëfillta financiare por gjithashtu nënkupton që sindikatat janë të lira të tjetërsojnë pa pengesë gjithë asetet e tyre të luajtshme e të paluajtshme dhe që ato duhet të gëzojnë mosdhunimin e mjediseve, korrespondencës dhe komunikacionit të tyre.

E drejta e organizatave për të organizuar aktivitetet në liri të plotë dhe për të formuluar programet e tyre.

Kjo e drejtë përfshin në veçanti të drejtën për të mbajtur mbledhje të sindikatës, të drejtën e zyrtarëve sindikalistë të kenë akses në ambiente pune dhe të komunikojnë me stafin drejtues,

aktivitete të caktuara politike të organizatave, të drejtën e grevës dhe, në përgjithësi, çfarëdo aktiviteti përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve.

E drejta për grevë paqësore duhet njohur në përgjithësi për sindikatat, federatat dhe konfederatat në sektorin privat e atë publik; kjo e drejtë mund të mohohet apo të pësojë kufizime të rëndësishme vetëm për kategoritë e punonjësve apo vetëm në situatat që vijojnë: pjesëtarë të forcave të armatosura apo të policisë; shërbyes publikë që ushtrojnë autoritet në emër të shtetit; punonjës të shërbimeve të rëndësishme në kuptimin rigoroz të termit (shërbime ndërprerja e të cilave do të rrezikonte jetën, sigurinë vetjake apo shëndetin për gjithë popullsinë a një pjesë të saj); dhe në rastin e një krize të rëndë kombëtare.

Kushtet ligjore që duhen përmbushur për ta bërë një grevë të ligjshme duhet të jenë të arsyeshme dhe asnjëherë të tilla që të shkaktojnë kufizime thelbësore për mjetet e veprimit në dispozicion të organizatave sindikaliste.

Udhëheqësve e punëtorëve sindikalistë duhet t'u sigurohet mbrojtja e duhur ndaj masave që mund të merren kundër tyre (pushim nga puna a sanksione të tjera) për organizim apo pjesëmarrje në greva të ligjshme e paqësore.

Mbrojtja ndaj akteve diskriminuese kundër-sindikaliste

Mbrojtja që u ofrohet punëtorëve dhe zyrtarëve sindikalistë ndaj akteve diskriminuese kundër-sindikaliste përbën një aspekt thelbësor të lirisë së organizimit, pasi akte të tilla mund të rezultojnë në praktikë në mohimin e garancive që parashtrohen në Konventën Nr. 87.

Neni 1 i Konventës Nr. 98 u garanton punëtorëve mbrojtjen e duhur ndaj akteve të diskriminimit anti-sindikalist, në marrjen në punë dhe gjatë punësimit, përfshirë kohën e ndërprerjes, dhe mbulon gjithë aktet paragjykuese lidhur me anëtarësinë në sindikatë apo pjesëmarrjen në aktivitete të ligjshme sindikaliste.

Mbrojtja që siguron Konventa ka rëndësi të veçantë në rastin e përfaqësuesve apo zyrtarëve sindikalistë, pasi këta duhet të kenë garancinë se nuk do të paragjykohen për shkak të postit sindikalist që mbajnë.

Ekzistenca e akteve të përgjithshme ligjore që ndalojnë aktet diskriminuese kundër-sindikaliste është e pamjaftueshme po qe se këto akte nuk kombinohen me proçedura të efektshme, të shpejta, të pakushtueshme dhe të paanshme që sigurojnë aplikimin e tyre në praktikë, shoqëruar me sanksionet e përshtatshme parandaluese.

Mbrojtja ndaj akteve diskriminuese kundër-sindikaliste mund të marrë forma të ndryshme në përshtatje me legjislacionin dhe praktikën e çdo vendi, me kusht që të mos lejojë apo të kompensojë në mënyrë të efektshme diskriminimin anti-sindikalist.

Zbatimi i standardeve dhe parimeve në praktikë

Analiza e përmbajtjes së vërejtjeve të Komisionit të Ekspertëve për 2001 dhe 2002 lidhur me zbatimin e Konventës Nr. 87 tregon se janë bërë komente për 88 nga 134 vendet që e kanë ratifikuar Konventën. Megjithatë, për shumicën e këtyre vendeve problemet e vëna re nuk dëmtonin seriozisht parimet e lirisë së organizimit. Çështjet e adresuara përfshijnë kufizime në të drejtën e organizimit për kategori të caktuara punonjësish (shërbimet publike, marinë, punonjës në zonat e përpunimit të eksporteve, etj.) (40 vende). Në një numër të konsiderueshëm vendesh, legjislacioni përmban kufizime mbi kategoritë e personave që mund të zënë poste sindikaliste (dallim në mes vendasve dhe të huajve) (15 vende), kufizime mbi zgjedhjen e lirë të drejtuesve sindikalistë (12 vende), kërkesa për një numër tejet të lartë punëmarrësish a punëdhënësish për të themeluar një sindikatë apo shoqatë punëdhënësish (11 vende), refuzim kërkese për regjistrim organizate apo kërkesë për autorizim paraprak (12 vende). Së fundi, ka një numër më të vogël komentesh lidhur me imponimin nëpërmjet legjislacionit të monopolit sindikalist (8 vende), mohim të drejtës për të themeluar federata dhe konfederata, apo kufizime në funksionet e këtyre (7 vende), shkrirjen e organizatave prej autoriteteve administrative (4 vende), dhe ndalimin e më se një sindikate brenda të njëjtës ndërmarrje apo sektori (5 vende). Komentet u adresohen gjithashtu kufizimeve në aspekte të ndryshme të drejtës për grevë (mohimi i kësaj të drejte për shërbyesit publikë që nuk ushtrojnë autoritet në emër të shtetit, imponimi i arbitrazhit të detyruar, ndalimi i grevave në shërbime që nuk janë të rëndësisë së veçantë në kuptimin rigoroz të fjalës, mohimi i të drejtës për grevë për federatat e konfederatat, dhe imponimi nga ana e qeverisë i shërbimeve minimale pa u konsultuar me palët.

Në lidhje me zbatimin e pikave të Konventës Nr. 98 për respektimin e mbrojtjes kundër akteve të diskriminimit dhe ndërhyrjes anti-sindikaliste, vërejtjet e Komisionit të Ekspertëve për 2001 dhe 2002 përfshijnë komente kritike për 34 nga 148 vendet që e kanë ratifikuar Konventën. Problemet e ngritura lidhen veçanërisht me legjislacionin ku mungojnë aktet që ndalojnë diskriminimin anti-sindikalist (20 vende) apo aktet ndërhyrëse (12 vende), apo që ofron mbrojtje të pamjaftueshme, në veçanti në përsa i përket mungesës së proçedurave (5 vende) apo të sanksioneve të duhura parandaluese (12 vende). Në një shkallë më të ulët, problemet e ngritura lidhen me ngadalësinë e proçedurave të kompensimit dhe përjashtimin e kategorive të caktuara të punonjësve nga garancitë që ofron Konventa (5 vende).

Rekomandime, përfundime.

Në kudrin e angazhimeve të ndërrmara për Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE Shqipëri të rekomandimeve të dhëna nga organizmat ndërkombëtar të cilat kanë vlerësuar dispozitat e legjislacionit të punës dhe njekohësisht kanë diktuar nevojën e përmirësimit nëpërmjet ndryshimit të disa dispozitave të Kodit aktual të Punës.

Kjo nismë ligjore vjen si një kërkesë jo vetëm e partnerëve sociale por edhe e punëdhënësve dhe e punëmarrësve,të cilët gjatë zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës kanë gjetur vështirësi. Kjo nismë ligjore konsiston në këto drejtime :

a)Afatet e njoftimit për proçedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës (neni 143 i Kodit të Punës). Lidhur me këto afate ka vlerësime nga Komiteti i Eksperteve i të Drejtave Sociale të Këshillit të Europës,të cilat në disa raste të tjera kërkohet zgjatja apo shkurtimi i tyre. Kuptohet që përcaktimi i afateve të përshkallëzuara në përputhje me vjetërsinë në punë të punëmarrësit pranë punëdhënësit do të bëhet pas një konsultimi të gjerë me “aquis communitare” të BE dhe me partnerët sociale.

b)Greva e solidaritetit dhe kufizimet që janë vendosur lidhur me të në nenin 197/7 të Kodit të Punës.Sipas përcaktimeve në fuqi të Kodit të Punës greva e solidaritetit është e ligjshme nëse ajo mbështet një grevë të ligjshme kundër punëdhënësit në ndihmë të të cilit punëdhënësi i grevistëve solidare jep mbështetje aktive për të ndaluar ose përfunduar grevën. Për këtë çështje është dhënë një rekomandim i cili synon të ndryshojë përcaktimin e mësipërm për ligjshmërinë e grevës së solidaritetit. Sipas këtij rekomandimi punëmarrësit duhet të kenë të drejtë të bëjnë grevë solidariteti në çdo rast kur greva që mbështesin është e ligjshme.

c)Duke ju referuar dispozitave të Kodit të Punës në lidhje me organizmat e dialogut social trepalësh, mbështetur në direktivat e BE, dialogu social duhet të jetë shtrirë edhe në nivel rajonal duke parashikuar Këshilla Konsultative Trepalësh në këtë nivel.

d)Në Kodin aktual të Punës janë përcaktuar rregulla edhe për veprimtarinë e organizatave sindikale të nëpunësve civile duke i krijuar mundësinë edhe kësaj kategorie punëmarresish që të negociojë për marrëdheniet juridike të punës. Ky ndryshim në Kodin e Punës duhet të shoqërohet detyrimisht edhe me ndryshimin e Ligjit: “Për Statusin e Nëpunësit Civil” për tu krijuar mundësinë edhe organizatave sindikatale të nëpunësve civilë të ushtrojnë të drejtën e grevës.

e)Gjithashtu mund të rishikohen edhe dispozitat të cilat japin përcaktimin për kontratat individuale të punës me kohëzgjatje të përcaktuar dhe të pacaktuar(neni 140/2 i Kodit të Punës). Mund të ketë një riformulim të nenit 140 të KP duke parashikuar mundësinë e lidhjes së kontratave të punës me kohëzgjatje të përcaktuar edhe në rastet kur detyra e punëmarresit nuk është e përkohshme.

f)Rritja e fleksibilitetit në drejtim të kohëzgjatjes normale të punës dhe kohezgjatjes së pushimit javor të punës por edhe ne marrëveshjen e palëve.

Për të pasur një numër sa më të madh të punësuarish shteti shqiptar nëpërmjet strukturave përkatëse duhet në vazhdimësi të hartojë politika punësimi, për të ulur sa më shumë numrin e të papunëve.

Për realizimin e këtij objektivi duhet:

- Të krijohet dhe forcohet institucionalisht sistemi i shërbimeve të punësimit.
- Të krijohet një sistem unik dhe modern i shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të metodave të punës dhe kapaciteteve manaxheriale.
- Të rritet performanca e shërbimeve të punësimit dhe sidomos ndërmjetësimit për punësim duke përshtatur sa më mirë kërkesat dhe ofertat për punë.
- Të aplikohen sa më shumë politika aktive të tregut të punës,sidomos zhvillimi i atyre politikave që kanë në fokus grupe të veçanta me probleme si p.sh gratë e trafikuara, romët,jetimët etj.
- Të krijohen dhe zhvillohen marrëdhënie të fuqishme partneriteti me aktorë të tjerë që operojnë në tregun e punës. Kjo mund të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit apo forcimit të këtij bashkëpunimi me partnere social në fushën e punësimit siç janë subjektet e ndryshme private apo shtetërore, institucione studimore, donatore të ndryshëm etj.
- Të bëhen monitorime të vazhdueshme për të pare ecurinë dhe efektivitetin e programeve aktive të tregut të punës.
- Plotësimi i kuadrit ligjor dhe hartimi i programeve të reja të punës. Ndryshimet e fundit që ka pësuar ligji “Mbi Nxitjen e Punësimit” si dhe ligji “Për të Huajt”ka bërë të mundur lindjen e nevojës për hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtyre ndryshimeve.
- Nxitja e punësimit nëpërmjet aplikimit efektiv të programeve aktuale dhe hartimi i programeve të reja.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies në punë duke përmirësuar sistemin e mbrojtjes dhe shëndetit në punë.Në këtë aspekt duhet të hartohet një strategji kombëtare që të këtë si objekt mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- Përmirësimi i sistemit ligjor të dialogut social, e cila mund të arrihet nëpërmjet përqasjes se mëtejshme të sistemit ligjor duke pasqyruar kërkesat e konventave ndërkombëtare, zgjerimi i organizimit sindikal në sektorin privat.

- Në lidhje me formimin profesional,hartimi i kuadrit ligjor me ligje,udhëzime,rregullore,vendime në mbështetje të gjitha ndryshimeve të bëra kohët e fundit në këtë aspekt.

Bibliografia

Analiza e tregut të punës së të rinjve në Shqipëri - Studim i ILO

Banka Botërore, Shqipëria: Vlerësimi i tregut të punës, Washington D.C. 2006

E drejta e punes (Prof.Dr. Kudret Çela)

E drejta kushtetuese (Luan Omari,Aurela Anastasi, viti 2009)

Faqja zyrtare e internetit e ILO www.ilo.org

Filloreta Kodra Diana Metohu ,Përmbledhje mbi të drejtën e punës (1991)

Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë (2009)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Personel / Human resource management Terry L.Leap dhe Michael D.Crino (1997)

Raporti i komisionit ndërkombëtar mbi zbatimin e standarteve të punës (2000-2005) Autorët: Një grup anëtarësh të ILO si: M. Humblet .

Raporti i vlerësimit të varfërisë, Banka Botërore, 2004

Republika e Shqipërisë, Strategjia për Përfshirjen Sociale 2006 dhe 2007-2013

Shqipëria: Një Vlerësim i Tregut të Punës, Studim i Bankës Botërore 2006

Standartet ndërkombëtare të punës.

Strategjia sektoriale e punësimit dhe formimit profesional (M.P.Ç.S.SH.B)

Studime të tregut të punës të marra nga M.P.Ç.S.SH.B

Tripartizmi përballë krizës (Tripartism against crisis), (1997) Daniel Vaughan-Whitehead

Sistemi i drejtësisë për të miturit në Shqipëri, standartet ndërkombëtare dhe Drejtësia miqësore

Artili Mandro

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Absrakt

Të analizosh sistemin e drejtësisë penale për të mitur është një detyrë komplekse dhe e vështirë. Kjo, pasi nënkupton të analizosh apo të reflektosh mbi ligjin, strukturat e ngarkuara me këtë detyrë, institucionet përgjegjëse, nivelin e kompetencave të tyre, burimet njerëzore dhe aftësitë e tyre, politikat që ndjek shteti, dhe sigurisht mënyrën e interpretimit dhe zbatimi të ligjit. Bërja e një analize objektive të administrimit të sistemit të drejtësisë për të mitur kërkon të analizohen shumë konponentë (jo vetem ligjor por edhe social) të cilët nuk kanë të bëjnë vetëm me mënyrën se si lexohet apo perceptohet baza ligjore, por edhe me studimin e raporteve të brendshme edhe nderkombëtare në lidhje me strukturat përgjegjëse, marrja parasysh e sugjerimeve nga partner ndërkombëtarë të rëndësishëm për integrimin e vendit në modelet europiane, elasticiteti dhe efiçenca e strukturave etj.

Kriminaliteti i tw miturve është një temë mjaft dinamike dhe shohim me vend të theksojmë se analiza e sistemit të drejtësisë për të miturit përbën një rëndësi të madhe pasi nuk është pjësë vetëm e një kuadri ligjor, por lidhet drejtpërdrejtë me gjithë shoqërinë. Kështu duke qenë një fenomen kaq kompleks nuk mund që sytë të drejtohen veç nga legjislatori si i vetmi "shpëtimtar" për këtë dukuri, përkundrazi kriminaliteti ndër të mitur kërkon angazhim dhe punë të palodhur nga psikologë, sociologë, punonjës social, specialistë të aspekteve të veçanta të tij, por jo vetëm, duke qenë një fenomen social familja, shoqëria, institucionet arsimore dhe edukuese kanë një rol jo pak të rëndësishëm.

Në të vërtetë pas viteve 90' i gjithë "Shteti i së Drejtës" në Shqipëri pësoi një reformim thelbësor në këtë fushë sidomos me miratimit të Kushtetutës në 1998[575], ratifikimin e "Konventës për të Drejtat e Njeriut"[576], "Konventës Evropiane për të Drejtat Fëmijëve"[577], dhe më pas reforma në sistemin e drejtësisë nuk pati vetëm përmasa sasiore por edhe cilësore. E megjithëse hapat drejt

[575] "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" miratuar me referendum më 28.11.1998, ligj nr 8417 dt 21.10.1998, I ndryshuar.
[576] "Konventa mbi të Drejtat e Fëmjës", New York 20.11.1989 ratifikuar me ligjin me dt 27.02.1992
[577] "Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore" ratifikuar me ligjin nr 8137, 2.02.1996

një standardi të duhur po hidhen, e në fakt reformimi i sistemit të drejtësisë nuk ka reshtur ndonjëherë, nuk mund të thuhet që më e mira është arritur, mendojmë se ka ende rrugë për tu bërë.

Krimi ndër të mitur mbart dhe reflekton shumë probleme për të ardhmen e një vendi. Sa të mitur arrestohen në vit? Sa të mitur dënohen me burgim? A keqtrajtohen të mitur nga sistemi i drejtësisë penale? A ka recedivistë ndër të miturit? A mund të themi se sistemi që jemi duke aplikuar po frenon dhe rehabiliton këta kriminelë të rinj? Secila nga këto pyetje shoqërohen nga një PSE e madhe. Përgjigjet ndaj këtyre çështjeve na tregojnë edhe nivelin në të cilin standartet ndodhen dhe se sa shumë punë ka ende për tu bërë.

1. Cilat janë standartet ligjore në fushën e drejtësisë për të miturit?

Duke qenë koshientë se çdo ndryshim në shoqëri vjen si pasojë e dorës së legjislatorit, këtë punim dëshirojmë ta fillojmë duke pasqyruar instrumentat ligjorë në fushën e drejtësisë për të mitur. Ato ndahen në kombëtare (Kushtetuta, Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, ligjet në lidhje më kriminalitetin ndër të mitur dhe kodet) dhe ndërkombëtare (instrumentet e OKB-së, instrumentet e Këshillit të Evropës, Instrumentet e Bashkimit Evropian)

Ne nivel Kombëtar.

Nisur nga parimi i hierarkisë së normave që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të përcaktuar prej vet Kushtetutës[578] "Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e RSh janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

d) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

1. Kushtetuta është ligji suprem në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas saj**:** "... dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,..., janë baza e këtij shteti, i cila ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë"[579]. Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Me rëndësi për tu theksuar këtu janë edhe përdorimi i shprehjeve si "të gjithë", "askush", "kushdo", "kujtdo", "secili" të cilat shprehin trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminues për cdo qënie njerëzore për të cilën dispozita shprehet, qoftë i mitur apo madhor. Neni 3 lidhet drejtpërdrejt me "Katalogun e Lirive dhe të Drejtave Themelore të

[578] Neni 116/1 I Kushtetutës

[579] Neni 3 I Kushtetutës, duke u bazuar edhe në preambulë mbrojtja e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor përmendët si një zotim i popullit, pra ky parim përshkon gjithë Kushtetutën dhe theksohet fortë.

Njeriut"[580], dhe duke patur parasysh tematikën tonë çmojmë të përmendim *se "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik"*. "Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre" (neni 15/2); "jeta e personit mbrohet me ligj" (neni 21); "askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues" (neni 25); "askujt nuk mund t'i hiqet liria ... Liria e personit nuk mund të kufizohet ..." (neni 27); 'martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit" (neni 53/2); "1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti[581]" . "Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, ..." (neni 54). Po në Kushtetutë gjenden edhe garancitë më thelbësorë për të drejtën penale, përmendim këtu:

Prezumimin e pafajsisë: *"Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë." (neni 30)*

E drejta për një process të rregullt ligjor: *"Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohet pa një process të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik. Brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj." (neni 42)*

E drejta për integritet moral e fizik: *Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues (neni 25).*

Të drejtat dhe garancitë procedurale penale "kushtetuese" *të personit të cilit i është hequr ose kufizuar liria si dhe gjatë procesit penal të tilla si: njoftimi mbi shkaqet e marrjes së masës dhe ngritjes së akuzës dhe të drejtave ligjore të garantuara; gjykimi brenda një afati të arsyeshëm i të paraburgosurit; dërgimi për gjykim brenda 48 orëve të personit të cilit i është hequr liria sepse ka pasur dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen e një vepre penale; parimi i gjësë së gjykuar; e drejta e bërjes së pyetjeve dëshmitarëve*[582]

Cilat janë Kodet dhe Ligjet në lidhje me drejtësinë për të mitur ne RSH?

Mund të themi që nga shteti ynë është bërë një punë e konsiderueshme me qëllim përqasjen e legjislacionit tonë të brendshëm me instrumentat ndërkombëtarë në lidhje me drejtësinë për të miturit. Miratimi i Kodit Penal dhe Procedural në vitin 1995, ka shënuar një reformim të dukshëm

[580] Pjesa e dytë e Kushtetutës e ndarë në katër krerë, nenet 15-63.
[581] Neni 54/1 këtu kemi të bëjmë me një "diskriminim pozitiv", Kushtetuta e ka veçuar këtë kategori si më e brishtë.
[582] nenet 28, 31, 32, 33, 34 te Kushtetutës.

të sistemit të drejtësisë penale. Përmendim këtu edhe rolin aktiv që ka patur Komisioni Europian me asistencën e tij, në përqasjen e këtyre kodeve me konventat ndërkombëtare të ratifikuara, rekomandimet dhe udhëzimet, me qëllim për të pasqyruar përvojën më të mirë europiane në Kodin Penal dhe në atë Procedural. Në të dy këta kode gjejmë një pasqyrim të plotë të të gjitha aspekteve që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin. Pas miratimit të Kushtetutës në 1998, janë miratuar disa ligje të rëndësishme, të cilat kanë kompletuar kornizën ligjore të sistemit të drejtësisë për të mitur, si Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"[583], Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale"[584], Ligji "Për policinë gjyqësore"[585], Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë"[586], ligjet për policinë e shtetit, për policinë e burgjeve, për organizimin dhe funksionimin e e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë etj. Gjithashtu mund të përmendim disa akte nënligjore me rëndësi në këtë fushë si përshembull "Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve"[587], Vendimin e Qeverisë për kalimin e sistemit të paraburgimit nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë e me radhë. Kujdesi për të miturit ka zënë një vend të rëndësishëm në politikat shtetërore të qeverisë shqiptare. Mund të përmendim Strategjinë për Fëmijët dhe Plani i Veprimit për periudhën 2001-2005 dhe 2005-2010[588], Strategjinë Kombëtare për Rininë 2007-2013[589], Strategjia Kombëtare dhe Plani i Punës për luftën kundër Trafikut të Fëmijëve dhe mbrojtjes së Fëmijëve viktima të Trafikut. Përmirsime të dukshme ka pësuar edhe sistemi i drejtësisë për të mitur, përveç infrastrukturës ligjore, mund të përmendim krijimin e Seksioneve të Gjykatave për të Mitur në gjashtë rrethe gjyqësore, ku janë vendosur edhe Gjykatat e Apelit, ndërtimin e një institucioni modern për të miturit në Kavajë sipas parametrave të sigurisë dhe riintegrimit të të miturve[590], ndërtimin e pesë institucioneve të reja për ekzekutimin e vendimeve penale sipas standarteve ndërkombëtare, krijimin e seksioneve për të mitur në prokuroritë e rretheve gjyqësore, të policisë së shtetit dhe trainimi i vazhueshëm i këtyre punonjësve. Gjithashtu një arritje e madhe është edhe ngritja e Shërbimit të Provës, i cili ka

[583]Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"Nr.8328, datë 16.4.1998 për më tepër shih Kreu II neni 5 "Respektimi I të Drejtave të Njeriut" si dhe pjesa II kreu I nenin 17 "Vendet e dënimit për gratë dhe të miturit"

[584] Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale"Nr 8331 dt 21.4.1998

[585]Ligji "Për policinë gjyqësore Nr. 8677 dt 2.11.2000

[586] Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" nr.8678 dt.14.05.2001

[587] Vendim Nr.303, datë 25.3.2009, për më shum shih nenin 21: "…Ndalohet mbajtja e të burgosurve të mitur në një dhome me të rriturit…. Të burgosurit e mitur vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke iu krijuar mundësi për një trajtim të veçantë.

588 Miratuar me VKM nr. 368, date 31.05.2005, objektivat e saj kryesore kanë qenë: I Mbijetesa e fëmijëve, II Mbrojtja e fëmijëve, III Zhvillimi i fëmijëve, IV Pjesmarrja e fëmijëve

[589] Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 782, datë 16 nëntor 2006

[590] Ky institute u hap në tetor 2009 me investimin e BE dhe shërben si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle; http://www.dpbsh.gov.al

mundësuar zbatimin e dënimeve alternative duke shmangur dënimet me burg dhe arrestimin në burg[591].

Konstatojmë se në Kodin Penal të RSH dispozitat që trajtojnë të miturin janë: Neni 50 KP, vepra penale e kryer kundër të miturit përbën rrethanë rënduese, Neni 79 KP vrasja me dashje e të miturit, Neni 83 KP kanosja serioze për gjakmarrje ndaj një të mituri, Neni 100 KP marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur, Neni 101 KP, marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës14-18 vjeç, Neni 108, vepra të turpshme, Neni 109/2 KP, rrëmbimi ose mbajtja peng e të mituritNeni 117, pornografia, Neni 124 KP braktisja e fëmijës së mitur Neni 125 KP, mosdhënia e mjeteve për jetesë, Neni 127 KP marrja e padrejtë e fëmijës, Neni 128 KP trafikimi i fëmijëve, Neni 129 KP shtytja e të miturve në krim;

I mituri del edhe si autor i veprave penale. Lidhur me këtë një vend të veçantë zënë dispozitat që kanë të bëjnë me rregulla në lidhje me:

- Moshën për përgjegjësi penale[592];
- Diferencime në caktimin e dënimit të të miturve të akuzuar për vepra penale;
- Masat edukuese për të miturit;
- Dënimet alternative.

Ndërsa për sa i përket Kodit të Procedurës Penale bazuar në Kushtetutën e RSH "Konventën për të Drejtat e Njeriut", "Konventën për të Drejtat e Fëmijëve" dhe akte të tjera të OKB, njeh këto garanci për personat e mitur: prezumimin e pafajësisë (neni 4 KPP); të drejtën për një proces të rregullt ligjor (në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës); gjykimin të miturve prej seksioneve përkatëse të të miturve; të drejtën për tu njohur me akuzat; të drejtën për të heshtur; të drejtën e mbrojtjes, të ndihmës juridike dhe psikologjike; të drejtën për të pyetur a ballafaquar me dëshmitarë ; Rregulla lidhur me verifikimin e moshës sipas nenit 41 dhe 290b KPP ; Ndihmën juridike dhe psikologjike ndaj të miturit në procesin penal (neni 35 KPP) ; Lidhja midis personalitetit të të miturit dhe masat penale (42 KPP); Mbajtjen e të miturit nën masën e sigurimit dhe afatet e hetimit e të gjykimit të çështjes; Trajtimin e të miturit në rastet kur thirret si i pandehur, dëshmitar dhe të dëmtuar (viktimë).[593]

Në nivel Ndërkombëtar:

[591] Shih Drejtësia për të mitur Fehmi Isufaj Revista shqiptare për studime ligjore volume 1 2011 fq 66

[592] Neni 12 I Kodit Penal të RSH ligj nr 7895 dt. 21.1.1995 I ndryshuar, përcakton përgjegjsinë lidhur me moshën për krime, e cila është 14 dhe përgjegjsinë për kundravajtjet që është mosha 16 vjeç.

[593] Për më shumë shih: "Një analizë e administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në RSH", CRCA Mandro A.

Sigurisht që Kushtetuta jonë e ka mirpërcaktuar vendin që do të zërë e drejta ndërkombëtare në të[594]. Aq më tepër që për tematikën e kriminalitetit për të miturin burimet ndërkombëtare luajnë një rol me peshë të madhe. Dhe në fakt "marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara" nga Kuvendi ynë vijnë fill pas ligjit më thelbësor, pra Kushtetutës. Kjo do të thotë se në rast konflikti me legjislacionin e brendshëm (psh kode ligje apo edhe v.k.m.) marrëveshja ndërkombëtare merr epërsi. E thënë ndryshe, përpara se vendi ynë të ratifikojë një marrëveshje të tillë përbën sfidë përshtatja e legjislacionit dhe krijimi I strukturave të domosdoshme për zbatimin e këtyre konventave.

Më poshtë do të rendisim disa nga instrumentat ndërkombëtare që kanë një peshë kryesore në drejtësinë për të miturit.

Aktet dhe Instrumentat e Kombeve të Bashkuara:

- Konventa e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989) ratifikuar më 27 Shkurt 1992 dhe Protokolli shtesë i saj, datë 18 janar 2002 lidhur me shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve
- Deklarata Universale per të Drejtat e Njeriut[595]
- Deklarata mbi të Drejtat e Fëmijës;
- Rregullat Standard minimum të Kombeve të bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit[596];
- Rregullat e Kombeve të bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria[597];
- Udhëzimet e Kombeve të bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve[598];
- Rregullat Standard Minimum të Kombeve të bashkuara lidhur me Masat e Mos-arrestimit[599];
- Konventa e ONP 138 (ILO) mbi përcaktimin e moshës minimale për punë;[600]
- Konventa e ONP nr. 29 për Punën e Detyruar (1930)
- Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike[601]

---

[594] RSH zbaton te drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të…(neni 5)
[595] Më 10 dhjetor 1948 Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli këtë deklaratë, duke ftuar shtetet të shpallin dhe të përpiqen ta përhapin atë sidomos në shkolla dhe institucione edukative të të gjitha vendeve dhe shteteve pa marrë parasysh statusin e tyre politik.
[596] Rregullat e Pekinit 1985.
[597] Rregullat e Havanës 1990.
[598] Rregullat e Riadit 1990.
[599] Rregullat e Tokios 1990.
[600] Konveta është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 8086 dt. 13.03.1996.
[601] Miratuar me 1966 dhe hyrë në fuqi me 1976.

- Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues dhe protokolli shtese i saj[602]

Të përmbledhura tërësia e instrumentave të mësipërme synojnë:

i. Garantimi që çdo veprim ndaj të miturit të jetë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe me veprën penale të kryer.

ii. Sigurojnë një trajtim të vazhdueshëm të të miturit në komunitet.

iii. Sigurojnë që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumë të jetë e mundur.

iv. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, është e rëndësishme që ata të veçohen nga të rriturit, duhet që të miturit ti ofrohet mundësia e kontaktit me familjen dhe të afërmit e tij; duhet të merren masat për riintegrimin e të miturit në komunitet kur ata të kthehen, tu sigurohet përkrahja dhe asistenca e duhur.

v. Domosdoshmëria e një stafi të kualifikuar në të gjitha strukturat përbërëse në lidhje me drejtësinë ndaj të miturve.

Aktet dhe instrumentat e Këshillit të Europës:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut KEDNJ dhe Protokollet nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7; Karta Sociale Evropiane (e rishikuar)[603];
- Konventa Evropiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve
- Konventa Evropiane "Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese"[604]
- Konventa Evropiane mbi të Drejtat Sociale.
- "Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuarose të liruar me kusht" ligji nr.8724/26.12.2000.
- Rezoluta (78) 62 "Mbi delikuencën e të miturve dhe ndryshimet sociale"
- Rekomandimi (85) 7 "Mbi pjesëmarrjen e publikut në politikën penale"
- Rekomandimi (87) 21 "Për asistencën ndaj viktimave të krimit dhe parandalimin e viktimizimit"
- Rekomandimi nr. (91) 11 "Në shfrytëzimin seksual, pornografinë prostitucionin dhe trafikimin e të rinjve dhe të fëmijëve"

[602] Ratifikuar nga vendi ynë më 30.03.1993 me ligjin nr. 7727

[603] Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3). KEDNJ ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme, dhe gjyqësori duhet të mbështetet në dispozitat e Konventës Evropiane dhe jurisprudencën e gjykatës së Strasburgut.

[604] Nënshkruar me 02.10.1996, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi 1.01.1997. Ligji nr.8135/31.7.1996.

- Rekomandimi i Këshillit të Evropës "Për ndërhyrjen e hershme psiko-sociale në parandalimin e kriminalitetit" Qershor 2000
- Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi trafikimin e fëmijëve dhe për fëmijët ushtarë etj.

Aktet dhe instrumentat e Bashkimit Europian:

Megjithëse instrumentat dhe direktivat e BE janë të lidhura veçanërisht me vendet pjestare në Komunitet, kjo nuk do të thotë që ato janë larg fokusit dhe objektivave të vendeve jo-Komunitare (siç është psh. vendi ynë). Në fakt hyrja në BE nuk është thjesht një dëshirë, ajo duhet shoqëruar nga një permbushje dhe përkushtimi ndaj përqasjes së legjslacionit të brendshëm me atë të BE dhe zbatimin e MSA (Marrëveshja Stabilizim Asocim). Plani Kombëtar që synon përqasjen e legjislacionit me atë të BE dhe zbatimit të MSA parashikon një sërë masash legjislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, duke ftuar legjislatorin për të pasqyruar këtë ndryshim.

Këtu vlen të përmendim:

- Rekomandimet e Komisionit Evropian të tilla si ato mbi:Turizmin seksual;
- Pornografinë fëminore; Masat kundër turizmit seksual;
- Trafikimin e qenievenjerëzore dhe shfrytëzimin seksual te fëmijëve;
- Ndihmën ndaj fëmijëve te zhdukur ose te shfrytëzuar seksualisht;
- Vendim kuadër i Komisionit Evropian lidhur me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë fëminore.

Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshilli i Evropës për drejtësinë miqësore ndaj të miturve[605].

Udhëzimi i Komitetit të Ministrave nxirret duke pasur parasysh garancitë që njeh Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në përputhje me rastet që ka shqyrtuar praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në mjaft raste të shqyruara nga gjykatat e vendeve anëtare është evidentuar nga Komisioni, si një problem në tërësi, mos dhënia apo pamundësia e dhënies së aksesit dhe pjesmarrjes së të miturve në sistemin gjyqësor. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës i ka cilësuar këto praktika si të rrezikshme, të afta për të sjellë shkelje apo kufizime të të drejtave të afirmuara në KEDNJ dhe në KDF, më konkretisht të drejtën për një mbrojtje ligjore, të drejtën për tu përfaqsuar në gjykimit, të drejtën për tu informuar dhe të drejtën për tu dëgjuar. E drejta e çdo personi për akses dhe për një gjykim të drejtë, me të gjithë komponentët shoqëruese të saj, është e

[605] Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice *17 November 2010.*

domosdoshme për një shoqëri demokratike e cila i trajton të gjithë shtetasit e saj, duke përfshirë edhe fëmijët, në mënyrë të barabartë.

Gjatë hartimit të këtij Udhëzimi janë vënë re vështirësitë dhe pengesat egzistuese për të miturit në kuadër të sistemit gjyqësor si psh. të drejtën egzistuese të pjesshme apo të kushtëzuar ligjore për akses në drejtësi, pavarësisht diversitetit dhe kompleksitetit të procedurave egzistuese. Është vënë re gjithashtu se mospërfshirja apo mënjanimi i të miturve ndaj çështjeve të zhvilluara ndaj tyre apo në rastet e një procesi ku ai mund të ketë një interes, çon në një viktimizim dhe diskriminim të tij nga ana e sistemit gjyqësor. Ky Udhëzim i Komisionit Ministror të Këshillit të Europës fton shtetet anëtare për të hetuar problemet egzistuese dhe për të identifikuar fushat në të cilat drejtësia miqësore për të mitur mund të aplikohet. Këto të fundit duhet të zbatojnë këtë Udhëzim:

- Duke marrë parasysh zhvillimin mendor, atë fizik dhe social në të cilat i mituri ndodhet, për çfarëdo lloj arsye që e solli atë në kontakt me organet kompetente
- Duke marrë parasysh të drejtën për informim, të përfaqësimit, të pjesëmarrjes dhe të mbrojtjes, duke mbajtur në konsideratë nivelin e pjekurisë së fëmijës dhe të kuptuarit dhe rrethanave të rastit.
- Duke mos cënuar të drejtat e palëve të tjera të përfshirë në proces.

Parimet themelore në fushën e drejtësisë miqësore ndaj të miturve dhe jurisprudenca përkatëse e GJEDNJ.

Pjesmarrja e të miturve[606].

Parimi i pjesmarrjes apo i aksesit që duhet të ketë i mituri në një procedim ndaj tij apo ku ai mund të ketë një interes që i përket, është gur themelor mbi të cilin duhet ndërtuar një proces i drejtë dhe i paanshëm. E drejta e të gjithë fëmijëve që të jenë të informuar në lidhje me të drejtat e tyre, e dhënë nëpërmjet mënyrave të përshtatshme për qasje në drejtësi, për tu konsultuar dhe dëgjuar në procedurat ku ata përfshihen, duhen marrë seriozisht në konsideratë. Parimi i pjesëmarrjes do të thotë se fëmijët kanë të drejtë të thonë mendimet e tyre dhe të japin qëndrimet e tyre në të gjitha çështjet në të cilat preken interesat e tyre[607]. Por me këtë nuk do të kuptohet që çdo gjë të cilën i mituri shpreh gjatë procesit të merret përherë parasysh apo të respektohet. Udhëzimi parashikon që mendimet e tyre të merren "*në konsideratë*", që do të thotë: "duke patur parasysh respektimin e duhur ndaj moshës dhe pjekurisë së tyre në krahasim me rrethanat e çështjes që i nënshtrohen ligjit kombëtar procedurjal".

Referimi që i bëhet termit "*i aftë të formojë pikëpamjet e tij/saj*[608]" nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve nuk duhet të shihet si një kufizim, përkundrazi duhet parë si një detyrë e autoriteteve për të vlerësuar plotësisht zhvillimin mendor të fëmijës, në vend që shumë lehtë të supozohet se fëmija nuk është në gjendje të formojë një opinion. Shtetet duhet të supozojnë se i mituri e gëzon në fakt këtë kapacitet. Kuptohet që kjo nuk është në dorë të fëmijës për tu provuar, por me këtë detyrë duhen angazhuar struktura të posaçme të specializuara.

Shtetet shkurajohen në përdorimin e një moshe standart limit[609]. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi "Drejtësinë në Cështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë Krimesh" gjithashtu theksojnë se "*mosha nuk duhet të jetë një pengesë për të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë plotësisht në procesin e drejtësisë* "[610]. Në çështjet familjare fëmijët duhen përfshirë në debatin gjyqësor përpara marrjes së vendimit i cili afekton interesat e tyre në të tashmen apo të ardhmen. Të gjitha masat për të siguruar këtë pjesmarrje në procedurën gjyqësore janë përgjegjësi e gjyqtarit të çështjes, i cili duhet të verifikojë dhe të kujdeset se përfshirja e të miturit ka qenë efikase. Mos pjesmarrja e të miturit në procesin gjyqësor legjitimohet vetëm në rastet kur vet ai e ka refuzuar atë si edhe në rastet në të cilat ai, me pjekurinë që gëzon, është i ndërgjegjshëm se

---

[606] Për më shum shih rekomandimin e Komitetit të Ministrave nr. 98 mbi pjesmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe sociale, 18 shtator 1998, paragrafi 4: në të citohet "pjesmarrja është një factor kyç për sigurimin e kohezionit social dhe për të jetuar në një shoqëri demokratike multikulturale me parimin e tolerancës". Shih po aty paragrafin 5: " pjesmarrja e të miturve është vendimtare në përmirsimin e kushteve të jetesës së tyre…mbi të gjitha kjo është edhe një model I përgjithshëm demokratik për të gjitha fushat e jetës familjare dhe shoqërore".

[607] "Konventa e Të Drejtave të Fëmijëve" e OKB neni 12 i saj.

[608] KDF neni 12/2

[609] Udhëzues I Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Drejtësinë miqësore për të miturit fq 3, Fjalor termash(definitions): me fëmijëçI mitur do të kuptohet çdo individ nën 18 vjeç;shih edhe KDF neni 1; sipas GJEDNJ I njihen këto të drejta çdo personi nën 18 vjeç, përveç atyre rasteve në të cilat edhe pse personi mund të jetë nën 18 vjeç nuk konsiderohet fëmijë psh në rastet e "emancipatio" egzistuese në disa shtete komunitare.

[610] Udhëzues i Kombeve të Bashkuara mbi çështje që përfshijnë fëmijët viktima dhe dëshmitarë të kriminalitetit (ECOSOC Res 2005/20, 22 July2005), paragrafi18.

përfshirja e tij nuk është e mundur. Gjithashtu rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat jo-fitimprurëse, avokati i popullit si dhe çdo institucion tjetër i specializuar, të cilat duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar se i mituri është përfshirë efektshëm në çështjet në fjalë, dhe përkundrazi nuk është përballur me një *fait accoumpli* (fakt të kryer).

Në çështjen *S.C kundër Mbretërisë së Bashkuar*[611], rast në të cilin i mituri gëzonte "*një nivel të ulët perceptueshmërie"*, Gjykata ka nxjerrë në pah kuptimin që merr "pjesmarrja efikase". Sipas saj ky term prezumon që i pandehuri gëzon një perceptim të përgjithshëm të natyrës së procesit, i tillë që të kuptojë rëndësinë e situatës në të cilën ndodhet dhe se ç'kuptim ka një sanksion që mund ti jepet si masë ndëshkuese. Do të thotë se ai ose ajo nëse e nevojshme me ndihmën e një përkthyesi, avokati, punonjësi social ose një të afërmi të tij, duhet të jetë në gjendje të perceptojë debatin që zhvillohet në sallën e gjyqit. I mituri i pranishëm në proces duhet të jetë në gjendje të ndjeki dinamikat e debatit gjyqësor, fjalët e dëshmitarëve dhe nëse është i përfaqsuar nga një avokat, ti shpjegojë atij versionin personal të rrethanave dhe fakteve, ti tregojë nëse me dëshmitë e dhëna nuk është dakort, si dhe ti evidentojë mbrojtësit fakte të cilat duhen përdorur në mbrojtje të tij. Gjykata gjithashtu ka theksuar që është thelbësore për të miturin të gjykohet nga një gjykatë e posaçme, e cila është e ndërgjegjshme për vështirësitë që ai ka në ndjekjen e procedurave gjyqësore[612].

Në mënyrë të ngjashme në rastin *Sahin kundër Gjermanisë,* Gjykata është shprehur se "do të ishte e tepërt të thuhej se gjykatat kombëtare të shteteve janë të detyruar të dëgjojnë një të mitur mbi preferencën për të zgjedhur një prind, i cili mbi të gjitha nuk e ka kujdestarinë mbi fëmijën, por kjo çështje varet nga rrethanat e rastit, duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e fëmijës në fjalë"[613].

Së fundmi në një rast tjetër kujdestarie, *Hokkannen kundër Finlanës*, Gjykata vë re se e mitura 12 vjeçare " ka pjekuri të mjaftueshme që mendimi i saj të merret në konsideratë nga gjykata dhe aksesi nuk duhet mohuar kundër dëshirës së saj"[614].

Interesi më i lartë.

Interesi më i lartë i të miturit duhët të jetë konsiderata mbizotëruese në të gjitha rastet ku ata përfshihen dhe vlerësimi i gjendjes duhet bërë me saktësi. Udhëzimi mbi "Drejtësinë Miqësore për të Miturit" synon nxitjen e metodave multidisiplinare për vlersimin e interesave më të mira të fëmijës duke patur parasysh kompleksitetin e kësaj detyre. Ky vlerësim bëhet edhe më kompleks sidomos kur këto interesa balancohen me interesat e palëve të tjera të përfshira, të tilla si të mitur të

[611] Gjykata Europiane e te Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), 15 qershor 2004, *S.C. v. UK*, No. 60958/00, paragraph 29
[612] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, *ibid.*, paragraph 35.
[613] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (dhoma e madhe), 8 qershor 2003, *Sahin v. Germany*, No. 30943/96, paragraph 73.
[614] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut , 23 Shtator 1994, *Hokkanen v. Finland*, No. 19823/92, paragraph 61.

tjerë, prindër, viktima etj, duke kërkuar një profesionalizëm dhe një vlerësim rast pas rasti. Interesi më i lartë duhet parë gjithmon në kombinim me të drejtat e të miturve të tjerë, si psh e *drejta për tu dëgjuar, e drejta për tu mbrojtur nga dhuna, e drejta për te mos u shkëputur nga prindërit* etj[615].

Është për tu habitur se sa i pamjaftueshëm është përdorimi i parimit "interesi më i lartë", në drejtësinë për të mitur kundrejt çështjeve të së drejtës familjare. Këshilli i Europës dhe shumë shtete anëtare ka vënë re një tendencë shqetësuese ndaj trajtimit së të miturve kriminelë në kushte të ngjashme si i të rriturve që kanë probleme me drejtësinë[616]. Eshtë e domosdoshme të theksojmë se të gjitha të drejtat e të miturve duhen respektuar, duke përfshirë edhe të drejtat e atyre të miturve që shkelin ligjin. Trajtimi i padallueshëm i të miturve nga të rriturit jo vetëm që është diskriminues, por është një qasje e ndëshkueshme dhe jo konform principeve thelbësore të përfshira në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara[617]. Përkundrazi ndërhyrje të një natyre socio-edukative janë shumë më të efektshme[618].

Në çështje të ndryshme të natyrës familjare, GJEDNJ është shprehur se gjykatat e vendeve anëtare duhet të vlerësojnë çështjen delikate por të vështirë të interesit më të lartë të fëmijës, mbi bazën e një raporti psikologjik të motivuar sipas të cilës i mituri sipas mundësisë, moshës dhe pjekurisë së tij duhet të dëgjohet nga psikologu i gjykatës[619].

Më lidhje me interesin më të lartë të fëmijës Gjykata është shprehur edhe në rastin Sahin *kundër Gjermanisë*. Gjykata duke u mbështetur në nenin 8 të KDF agumenton se " autoritetet kombëtare duhet të gjejnë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit më të lartë të fëmijës dhe të prindërve, i cili mund edhe të prevalojë ndaj interesit së këtyre të fundit, në varësi të çështjes në fjalë, mund edhe ta zëvendësojë atë. Në veçanti një prind nuk mund të kërkojë sipas nenit 8 të merren masa të tilla, të cilat mund të dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës."[620]

Në një rast birësimi *Pini dhe të tjerë kundër Rumanisë*, Gjykata refuzoi që i mituri në fjalë të birësohej nga një familje e huaj me argumentin se: " në raste të tilla... interesi më i lartë i fëmijës prevalon ndaj atij të prindit".[621]

Dinjiteti.

---

[615] Për më shumë shih UNHCR Guidelines on Determining the Best Interests of the Child, 2008 web (http:ëëë.unhcr.org/refëorldçdocid/48480c342.html).
[616] Për më shumë shih T. Hammarberg web (http://www.coe.intçtçcommissioner/Viwwpoints/090202_en.asp).

[617] KDF neni 40
[618] Komente të përgjithshme nr.10 mbi të drejtat e fëmijëve në kriminalitetin e të miturve (CRCçCçGCç10, 25 April 2007).
[619] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), 13 Qershor 2000, *Elsholz v Germany*, No. 25735ç94, paragraph 53, 8 July 2003, *Sommerfeld v Germany*, No. 31871ç96, paragraphs 67-72. Shih edhe mendimin pjesërisht kundërshtues të Gjyqtarëve Ress i bashkuar me atë të Gjyqtarit Pastor Ridurejo dhe Tumer në Sommerfeld v Gjermanisë paragrafi 2.

[620] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), 8 Qershor 2003, *Sahin v. Germany*, No. 30943ç96, paragraph 66.
[621] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 22 qërshor 2004, *Pini and Others v. Romania*, Nos. 78028ç01 and 78030ç01, paragraph 155.

Respektimi i dinjitetit njerëzor është në bazën e shumë instrumentave egzistuese[622]. Edhe shumë dispozita të Udhëzimeve të OKB, si për shembull mbi drejtësinë që përfshijnë "Të Miturit Viktima dhe të Miturit Dëshmitarë të Krimeve", janë të rëndësishme në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë deklarata sipas së cilës " çdo fëmijë është një qënie unike dhe e paçmueshme njerëzore dhe si e tillë gëzon dinjitetin e tij individual, ka nevojat e tij të veçanta, dhe interesi i jetës private të tij duhet të respektohet dhe mbrohet."[623]

Mbrojtja nga diskriminimi.

Ndalimi i diskriminimit është një parim tashmë i mirnjohur dhe i konsoliduar në të "Drejtat e Njeriut në Fushën Ndërkombëtare". Neni 2 i "Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve" është parë si një udhërëfyes mbi konceptet bazë për diskriminimin[624].

Interes të veçantë paraqet përdorimi i termit "racë", Komisioni i Europës kundër Racizmir dhe Diskriminimit i Këshillit të Europës (*ECRI*), në Rekomandimin nr.7 "Mbi legjislacionin Kombëtar Kundër Rracizmit dhe Diskriminimit" përcakton se: "Duke qenë se të gjitha qëniet njerëzore i përkasin të njëjtit grupimi (lloji), ECRI hedh poshtë të gjitha teoritë mbi egzistencën e "racave" të ndryshme. Megjithatë, në rekomandimin e saj ECRI bën një përdorim të këtij termi për të garantuar se personat, grupi i të cilëve perceptohet se i përket "një race tjetër" nuk përjashtohen nga mbrojtja nga diskriminimi në këtë Rekomandim"[625]. Për disa kategori të fëmijëve të rezikuara mund të jetë në nevojë një mbrojtje e veçantë në këtë aspekt. Rekomandimi rendit edhe disa nga këto kategori, por lista nuk është shteruese, ashtu si edhe fushat në të cilat diskriminimi mund të shfaqet.

Një tjetër faktor i rëndësishëm diskriminimin e të miturve është edhe mosha dhe pamundësia për të vepruar. Shumë të mitur megjithë pamundësinë për të ndjekur dhe kërkuar të drejtat e tyre janë bartës të drejtash. Në raste të tilla duhen parashikuar sisteme alternative përfaqësimi me qëllim për të shmangur diskriminimin.

Parimi i sundimit të ligjit.

---

[622] Shih psh edhe Preambulën e "Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike" si dhe nenin 40 paragrafi 1 i "Konventës e të Drejtave të Fëmijëve" e OKB.

[623]Udhzim i kombeve të bashkuara në çështje që përfshijnë të mitur viktima dhe dëshmitarë të krimit (ECOSOC Res 2005ç20, 22 July 2005), III, 8, a and I, 6.

[624] Në nenin 2 thuhet: "Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije....pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia,prejardhja familjare....çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

[625] ECRI General Policy Recomandation No. 7 on National Legislacion to Combat Racism and Racial Discrimination Adopted on 13 December 2002, Defininitions I fq 5.

Sundimi i ligjit përcakton parimin themelor sipas të cilit, gjithkush është përgjegjës përpara ligjit dhe disponon të gjitha të drejtat e aplikueshme. Ky parim aplikohet duke patur parasysh moshën, në mënyrë që shtetet pjesmarrëse të njohin dhe të garantojnë të drejtat themelore për të gjithë, duke përfshirë këtu edhe fëmijët. Aplikimi i parimit të sundimit të ligjit kërkon ndër të tjera, inter alia, garantimin e prezumimit të pafajsisë dhe të drejtën e një procesi të drejt, duke përfshirë një asistencë ligjore dhe një akses të efektshëm ndërmjet një avokati apo institucioni të posaçëm për mbrojtjen e të miturve. Parimi nullum criminem sine lege dhe nulla poena sine lege, janë të vlefshme për të miturit njësoj si për personat madhor, duke përbërë kështu një gur themeli për gjithë sistemin penal të drejtësisë[626]. Megjithatë kur bëhet fjalë për sjellje antisociale, edhe pse jo kriminale, në sjelljen e të miturve, disa shtete kanë shfaqur tendencën në disa raste edhe për heqjen e lirisë ndaj tyre. Me pretekstin e mbrojtjes së shoqërisë nga sjellje anti sociale, të miturit përfshihen në programe edukuese dhe restauruese, të cilat nuk do të aplikoheshin ndaj një personi madhor. Këshilli i Europës ka vënë re që standarte thelbësore siç janë barra e provës kur i përket shtetit dhe e drejta për një proces të drejtë dhe të paanshëm, jo gjithmonë janë të garantuara dhe të zbatuara në mënyrë të njëjtë si ndaj të miturve ashtu edhe ndaj të rriturve. Vihet re gjithashtu një tendencë për të dënuar të miturit për të ashtuquajturat "Status Offenses", që janë veprime jo të përkufizuara si krime dhe për shkeljen e të cilave një person i rritur nuk do të dënohej[627]. Është e rëndësishme që shtetet të kenë në asetin e tyre të mjeteve për një sundim efektiv të ligjit edhe mekanizma ankimorë të përshtatshëm, që të veprojnë mbi të gjitha duke qenë të vetëdijshëm për moshën dhe pjekurinë e të miturit.

[626] "Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut" neni 7, "Konventa e të Drejtave të Fëmijëve" e OKB, neni 40, paragrafi2,a.
[627] Shih CRIN "Raport mbi Status Offence" http:ççëëë.crin.orgçdocsçStatus_Offenses_doc_2_final.pdf

Bibliografi

"Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" miratuar me referendum më 28.11.1998, ligj nr 8417 dt 21.10.1998, I ndryshuar

Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"Nr.8328, datë 16.4.1998

Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" nr.8678 dt.14.05.2001

Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve Vendim I këshillit të ministrave Nr.303, datë 25.3.2009

Strategjinë Kombëtare për Rininë 2007-2013 Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 782, datë 16 nëntor 2006

Një analizë e administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në RSH", CRCA Mandro A.

Drejtësia për të mitur Fehmi Isufaj Revista shqiptare për studime ligjore volume 1 2011

"Deklarata Universale per të Drejtat e Njeriut" 10 dhjetor 1948

"Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore" ratifikuar me ligjin nr 8137, 2.02.1996

Konventa e ONP 138 (ILO) "Mbi përcaktimin e moshës minimale për punë" ratifikuar me ligjin nr. 8086 dt. 13.03.1996

Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues Ratifikuar nga vendi ynë më 30.03.1993 me ligjin nr. 7727

Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshilli i Evropës për drejtësinë miqësore ndaj të miturve 17 dhjetor 2010]

Rekomandimin e Komitetit të Ministrave nr. 98 mbi pjesmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe sociale, 18 shtator 1998

Udhëzues i Kombeve të Bashkuara mbi çështje që përfshijnë fëmijët viktima dhe dëshmitarë të kriminalitetit (ECOSOC Res 2005ç20, 22 July2005

UNHCR Guidelines on Determining the Best Interests of the Child

Komente të përgjithshme nr.10 mbi të drejtat e fëmijëve në kriminalitetin e të miturve (CRC/C/GC/10, 25 April 2007

ECRI General Policy Recomandation No. 7 on National Legislacion to Combat Racism and Racial Discrimination Adopted on 13 December 2002

Jurisprudencae GJEDNJ

CRIN "Raport mbi Status Offence"2010

Gjykata Europiane e te Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), 15 qershor 2004, S.C. v. UK No. 60958ç00,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (dhoma e madhe), 8 qershor 2003, Sahin v. Germany, No. 30943ç96

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 23 Shtator 1994, Hokkanen v. Finland, No. 19823ç92

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), 13 Qershor 2000, Elsholz v Germany

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut 23.qerhor.2003Sommerfeld v Germany, No. 31871/96,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 22 qershor 2004, Pini and Others v. Romania, No. 78028/01

Prof. Omari. L, Prof. Dr. Aurela. A, E Drejta Kushtetuese, fq.158, ABC Tiranë 2010

http://drejtesiashqiptare.com/?p=1054

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese nr. 17. 2010, http://ëëë.gjk.gov.al/

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 16. 2008, http://ëëë.gjk.gov.al/

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 30

Prof. Omari. L, Prof. Dr. Aurela. A, E Drejta Kushtetuese, fq.159, ABC Tiranë 2010

Kodi I Procedurës Penale I Republikës së Shqipërisë, Neni 3, ligji,nr, 7905, datë, 21.3.1995 Alb Juris, Tiranë 2008

Kukshtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42.

Zaganjori. Xh, Anastasi. A, Cani. E. Shteti I së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, fq.105. Adelprint, Tiranë 2011.

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese Nr. 17.2005, http://ëëë.gjk.gov.al/

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 142

Për këtë pjesë ndër të tjera, jam referuar kryesisht tek http://drejtesiashqiptare.com ”E Drejta Per Nje Process Te Rregullt Ligjor Sipas Konventes Evropiane”.

1 Konventa Europiane Për të Drejtat e Njeriut 1948. Neni 6

Cështja Klass kundër Gjërmanisë, date 6.09.1978, Seria A, Nr.28,f, 25-26

“Konventa mbi të drejtat e Fëmjës”, New York 20.11.1989 ratifikuar me ligjin me dt 27.02.1992

Ligji nr.7692, datë 31.03.1993 Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Cështja Van de Hurk kundër Hollandës Nr 61, datë 19.04.1994

Kodit Penal të RSH ligj nr 7895 dt. 21.1.1995 I ndryshuar.

Kodi i Procedures Penale i RSH ligj nr 7905 dt 21.3.1995 i ndryshuar.

Ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”Nr 8331 dt 21.4.1998

Ligji Nr.8485, datë 12.5.1999 , Kodi I Proçedurave Administrative, Neni 50

Ligji Nr.8485, datë 12.5.1999 , Kodi I Proçedurave Administrative, Neni 49.

Ligji “Për policinë gjyqësore Nr. 8677 dt 2.11.2000

Strategjinë për Fëmijët dhe Plani i Veprimit për periudhën 2001-2005 me VendimKëshillitMinistrave nr. 368, date 31.05.2005

1http://ëëë.ius.info/EUII/EUCHR/dokumenti/2001/06/CASE_OF_KREUZ_v._POLAND_19_06_2001.html

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese Nr. 9.2001, http://ëëë.gjk.gov.al/

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 39, datë 23.12.2003, http://ëëë.gjk.gov.al/

Cështja Qufaj kundër Shqipërisë : 54268/2000 , datë 18.11.2004

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 10. 2006, http://ëëë.gjk.gov.al/

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese nr. 10. 2006, http://ëëë.gjk.gov.al/

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e 1948. Neni 8.9.10.11

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese nr. 11.2009, http://ëëë.gjk.gov.al/.

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese nr. 21,13.04.2012, http://ëëë.gjk.gov.al/

Përgjegjësia Penale për Veprat Penale Ndërkombëtare sipas Kodit Penal të Kosovës

Albulena Hajdari[1], Milot Krasniqi[2]

[1]Fakulteti i Drejtwsisw, Kolegji Universitar "Iliria" Prishtina, Kosovo

[2]Agjencia kundër Korrupsioni, Prishtina, Kosovo

Abstrakt

Veprat penale të karakterit ndërkombëtar manifestojnë shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore për shkak se pasojat e tyre shtrihen përtej shtetit në të cilin ato kryhen. Për këtë arsye me qëllim të pengimit dhe luftimit të tyre të suksesshëm krahas të drejtës ndërkombëtare, shtetet i inkriminojnë ato si vepra penale me rregullativë interne. Edhe Republika e Kosovës në Kodin Penal të saj ka paraparë disa vepra penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare.

Qëllimi i punimit është që të elaboroj përgjegjësinë penale për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare sipas Kodit Penal të Kosovë. Rrjedhimisht, sipas parimeve të së drejtës penale ndërkombëtare përgjegjësia penale është element konstituiv i veprës penale dhe parim themelor i të drejtës penale ndërkombëtare.

Punimi i prezantuar do të jetë me rëndësi të posaçme për faktin se përgjegjësia penale për veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare është trajtuar kryesisht nga prizmi i të drejtës penale ndërkombëtare por edhe sipas zgjidhjeve të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Në fakt, edhe zhvillimet kryesore të së drejtës penale ndërkombëtare lidhen me përgjegjësinë penale dhe sanksionet penale.

Punimi përshkohet me konstatime, analiza dhe rekomandime të pavarura, të cilat de lege ferrenda mund t`i shërbejnë politikës kriminale në parandalimin dhe luftimin efikas të veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare. Për hulumtimin e këtyre veprave penale kemi përdorur metodën historike, metodën juridike-dogmatike, metodën sociologjike dhe atë krahasimore.

Nga hulumtimi i këtij lloji të kriminalitetit mund të arrihet në përfundim se këto vepra penale përfaqësojnë lloj të rëndë të kriminalitetit që shkakton pasoja të mëdha shoqërore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato hasen në të gjitha shoqëritë bashkëkohore, përfshirë edhe Kosovën.

Fjalët kyçe: *Kryerësit, përgjegjësia penale, sanksionet penale, veprat penale ndërkombëtare.*

Hyrje

Përgjegjësia penale krahas veprës penale dhe kryerësit të veprës penale, paraqet njërin nga tri institucionet kryesore të së drejtës penale materiale. Rrjedhimisht, në çdo rast kur kryhet vepër penale shtrohet si kërkesë e domosdoshme që të konstatohet përgjegjësia penale e kryerësit në mënyrë që të zhvillohet procedura penale dhe atij t`i caktohet sanksioni penal. Kur themi se një person është penalisht i përgjegjshëm, atëherë në çdo rast kuptojmë se ai ka kryer vepër penale. Nga kjo mund të arrijmë në përfundim se përgjegjësia penale dhe vepra penale janë dy kategori të lidhura dhe të varura reciprokisht. Përgjegjësia penale si koncept ka evoluar dhe ka pësuar ndryshime të mëdha. Mosha e përgjegjësisë penale varion nga vendi në vend por në shkencën e të drejtës penale mbizotëron mendimi dhe pajtimi i gjerë se mosha e përgjegjësisë penale të jetë mosha katërmbëdhjetëvjeçare. Ngjashëm me zgjidhjet e pranuara në vendet tjera edhe Kosova në Kodin Penal, përkatësisht në nenin 17 (paragrafi 3) ka paraparë se përgjegjësia penale fillon nga mosha katërmbëdhjetëvjeçare.

Në nenin 17 të Kodit Penal është paraparë se kryerësi është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën e ka kryer me dashje ose nga pakujdesia. Në të drejtën penale çdo person i cili ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale supozohet të jetë penalisht i përgjegjshëm, nëse nuk dyshohet në aftësinë e tij mendore që e bëjnë të papërgjegjshëm. Kjo është një zgjidhje parimore sepse çështja e konstatimit të përgjegjësisë penale të kryerësit të veprës penale shtrohet vetëm në rastet kur dyshohet se ekzistojnë kushtet ligjore që atë e bëjnë të papërgjegjshëm penalisht. Kodi Penal ka paraparë bazat e përgjithshme dhe të veçanta të përjashtimit të përgjegjësisë penale. Rrjedhimisht, sipas zgjidhjeve të dhëna në Kodin Penal të Kosovës një person konsiderohet penalisht i papërgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka pasur aftësi për të kuptuar rëndësinë e veprës penale dhe nuk ka mundur t`i kontrollojë sjelljet e tij. Deri te kjo situatë mund të vjen për shkak të sëmundjes mendore, çrregullimit mendor ose të ngecjes në zhvillimin mendor.

Sipas zgjidhjeve të dhëna në Kodin Penal të Kosovës bazat e përgjithshme të përjashtimit të kundërligjshmërisë, përkatësisht kur kryerësi nuk konsiderohet i përgjegjshëm penalisht janë *Vepra e rëndësisë së vogël, (neni 11), Mbrojtja e nevojshme, (neni 12), Nevoja ekstreme, (neni 13), Dhuna dhe kanosja, (neni 14), Veprat e kryera nën shtrëngim, (neni 15) dhe Urdhrat nga lart, (neni 16).* Në nenin 78 të Kodit Penal është paraparë edhe baza e posaçme e lirimit nga dënimi për veprat penale të kryera nga pakujdesia. Rrjedhimisht, në këto raste kryerësi është penalisht i përgjegjshëm por për shkak të rrethanave specifike që e kanë goditur atë, gjykata e liron nga dënimi. Gjykata do të veprojë në këtë mënyrë kur *pasojat e veprës penale e godasin rëndë kryerësin sa që dënimi është*

i panevojshëm për realizmin e qëllimit të tij dhe kur *pas kryerjes së veprës kryerësi bën përpjekje të evitoj pasojat e veprës ose në masë të konsiderueshme e kompenson dëmin e shkaktuar*.

Disa çështje të përgjithshme të përgjegjësisë penale

Përgjegjësia penale përbën njërin nga institucionet qendrore të së drejtës penale materiale. Rrjedhimisht, përgjegjësia penale, kryerësi i veprës penale dhe sanksioni penal janë tri institucionet kryesore mbi të cilat ndërtohet fusha e të drejtës penale materiale. Në të drejtën penale bashkëkohore, veçanërisht sa i përket çështjes së përgjegjësisë penale vlen parimi i ligjshmërisë *nulla poena sine culpa* që do të thotë se askush nuk mund të merret në përgjegjësi penale pa faj. Përgjegjësia penale është kusht që një person të merret në përgjegjësi penale dhe t`i caktohet sanksioni penal për veprën e kryer. Parimisht, përgjegjësia penale është individuale e cila mundëson që çdo person të përgjigjet vetëm për veprimet e tij. Nga ky rregull ka përjashtim sepse në rastin kur vartësi kryen vepër penale qoftë ai person ushtarak, polic ose paraushtarak, për veprimet e tij përgjigjet edhe eprori sipas parimit të hierarkisë.

Në të drejtën penale konsiderohet se çdo person që kryen vepër penale është i përgjegjshëm penalisht, me kusht që të jetë mendërisht i shëndoshë. Që një person të jetë i përgjegjshëm penalisht është e domosdoshme që në kohën e kryerjes së veprës penale të ketë qenë i aftë të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij dhe të ketë qenë i aftë që t`i kontrollojë sjelljet, përkatësisht veprimet e tij. Në procedurën penale administrohen provat se a ka qenë një person i përgjegjshëm penalisht apo jo vetëm në rastet kur lind dyshimi i bazuar se kryerësi i veprës penale ka qenë apo jo i përgjegjshëm.[628]

Përgjegjësia penale është institucion i të drejtës penale materiale i cili ka evoluuar gjatë historisë e madje edhe sot ka mendime të ndara në shkencën, legjislacionin penal dhe në praktikën juridike. Në këtë aspekt shtetet janë të ndara sa i përket çështjes së përcaktimit të moshës së përgjegjësisë penale. Në disa vende kufiri i përgjegjësisë penale fillon nga mosha 10, 12 e në disa të tjera nga ajo 14 vjeçare. Sipas nenit 17 (paragrafi 3) të Kodit Penal, është përcaktuar se personi është penalisht i përgjegjshëm që nga mosha katërmbëdhjetëvjeçare.

Përgjegjësia penale është çështje faktike e cila duhet të konstatohet në çdo rast konkret. Rrjedhimisht, veprat penale mund të kryhen në forma të ndryshme të fajësisë të cilat ndikojnë drejtpërdrejt edhe në shkallën e përgjegjësisë penale dhe në matjen e dënimit. Po ashtu, te disa vepra penale ekziston edhe qëllimi i caktuar i kryerësit i cili veprës i jep karakter të cilësuar (të rëndë, të kualifikuar). Vepër penale tipike në të cilën shprehet qëllimi i caktuar i kryerësit është

[628] Krahaso: Salihu I, *E drejta penale, pjesa e përgjithshme,* Prishtinë, 2008, faqe 279.

krimi i gjenocidit i cili kryhet me qëllim të eliminimit ose zhdukjes së tërësishme ose të pjesërishme të grupit nacional, etnik, racor ose fetar. Te veprat penale të kryera me dashje njohja e qëllimit dhe motivit të kryerësit ka rëndësi vendimtare për zbulimin e saj.[629] Qëllimi është element i natyrës subjektive i lidhur direkt me personalitetin e kryerësit andaj çdoherë kur ekziston ai duhet të provohet në procedurë penale.

Nocioni i përgjegjësisë penale

Ekzistimi i përgjegjësisë penale është kusht i domosdoshëm *(conditio sine qua non)* për zhvillimin e procedurës penale dhe caktimin e sanksionit penal ndaj kryerësit të veprës penale. Përgjegjësia penale është çështje juridike dhe faktike e cila ka zgjuar interesim të gjerë ndër autorët e shkencës juridike. Përgjegjësia penale nënkupton plotësimin e kushteve që kërkohen sipas ligjit në mënyrë që një person të përgjigjet për veprën penale të kryer dhe mundësinë e caktimit të sanksionit penal.

Përgjegjësia penale së bashku me veprën penale dhe kryerësin e saj janë institucionet kryesore të së drejtës penale materiale. Përgjegjësia penale në të drejtën penale bashkëkohore ka rëndësi të madhe sepse nga ajo varet nëse do të ndiqet penalisht personi që ka kryer vepër penale si dhe caktimi i masave, përkatësisht caktimi i sanksionit penal. Rrjedhimisht, në nivelin e përgjegjësisë penale të kryerësit luan rol të madh dashje dhe pakujdesia. Siç është e ditur veprat penale mund të kryhen me dashje dhe nga pakujdesia.[630] Personi konsiderohet penalisht i përgjegjshëm kur në kohën e kryerjes së veprës është i përgjegjshëm (ka aso veti a cilësi psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t`i kontrollojë sjelljet e veta) dhe i fajshëm (kur ndaj veprës së kryer ka qëndrim apo raport i cili i bën të mundshme që t`i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten).[631]

Përgjegjësia penale përbëhet nga **elementi intelektual** përkatësisht aftësia intelektuale (mendore) që nënkupton aftësinë e kryerësit për të kuptuar rëndësinë e veprës, kur ai ka parafytyrim të qartë (vetëdije) se është duke kryer një vepër të rrezikshme dhe të kundërligjshme, pra kur kryerësi i kupton pasojat që mund t`i shkaktojë me veprimet e tij. **Elementi volitiv (i dëshirës)** është aftësia e kryerësit që t`i kontrollojë sjelljet e tij. Kryerësi duhet të ketë aftësi që vullnetarisht të vendosë për të kryer një vepër dhe aftësi që t`i kontrolloj sjelljet e tij.[632] Në çdo rast kur kryerësi i veprës penale nuk i posedon këto dy aftësi është i papërgjegjshëm penalisht dhe ndaj tij mund të

[629] Sahiti E. *Psikologjia gjyqësore*, Prishtinë, 2007, faqe 40.
[630] Shih nenin 8 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.
[631] Salihu I. *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, faqe 277.
[632] Krahaso: Po aty, faqe 279.

ndërmerren vetëm masa të karakterit jopenal. Kjo është zgjidhje parimore e cila është pranuar gjerësisht në shkencën penale dhe në legjislacionet penale sepse nuk mund të merret në përgjegjësi penale personi që për shkak të defekteve mentale nuk mund të kuptojë rëndësinë e veprës dhe as nuk ka aftësi që t`i kontrollojë sjelljet e tij.

Si u tha më lart, personi konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës mbi 14 vjeç. Veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare si edhe shumica e veprave penale kryhen me dashje. Dashja është forma më e rëndë e kryerjes së veprave penale e cila ngërthen në vete vetëdijen e personit se po kryen një veprim i cili përveç që është i dëmshëm është edhe i inkriminuar si vepër penale.

Elementet e përgjegjësisë penale

Sikurse çdo institucion tjetër i së drejtës edhe përgjegjësia penale i ka elementet e saj të cilat e ndërtojnë atë. Rrjedhimisht, përgjegjësia penale përbehet nga dy elemente, përkatësisht nga:

1. *Nga vetitë e caktuara psikike të kryerësit (nga përgjegjësia) dhe*
2. *Nga qëndrimi apo marrëdhënia e kryerësit ndaj veprës që e ka kryer (nga fajësia).*[633]

Nga kjo e dhënë mund të konstatojmë se përgjegjësia penale në të drejtën penale sajohet nga elementi i përgjegjësisë dhe fajësisë. Rrjedhimisht, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm kur posedon veti (cilësi) psikike që e bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës penale dhe t`i kontrollojë sjelljet e tij. Ndërsa personi konsiderohet i fajshëm kur ndaj veprës së kryer ka pasur asi qëndrimi apo raporti që e bëjnë të mundshme t`i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten.[634] Pra në çdo rast që kryesi të merret në përgjegjësi penale për veprën e kryer penale duhet që të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Përgjegjësia penale dhe fajësia si elemente konstituive të veprës penale janë kategori të ndërlidhura reciprokisht. Kësisoj nëse një person nuk është i përgjegjshëm, kur nuk është i aftë të kuptojë rëndësinë e veprës dhe as t`i kontrollojë sjelljet e tij, atëherë nuk mund të konsiderohet i fajshëm. Përgjegjësia penale është bazë në të cilën mbështetet fajësia. Mungesa e njërit nga elementet e përmendura, qoftë e përgjegjësisë ose e fajësisë e bën të pamundshme dënimin e kryerësit të veprës penale.

Rrjedhimisht, në nenin 17 të Kodit Penal është përcaktuar nocioni i përgjegjësisë penale. Ai përcakton se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia. Në këtë rast Kodi Penal nuk e përdor

[633] Shih: Salihu I, *E drejta penale, pjesa e përgjithshme,* faqe 275.
[634] Po aty, faqe 275.

termin fajësi por vetëm i përmend dy format e fajësisë, përkatësisht dashjen dhe pakujdesinë të cilat paraqesin dy shkallët e përgjegjësisë penale.

Përgjegjësia penale në të drejtën penale bashkëkohore është e shkallëzuar. Në fakt, në të drejtën penale njihen tri shkallë të përgjegjësisë penale;

1. Papërgjegjësia penale;
2. Përgjegjësia penale e zvogëluar dhe
3. Përgjegjësia penale e plotë.

Secila nga këto lloje të përgjegjësisë penale i ka bazat e saj të veçanta dhe se ajo duhet të vërtetohet në çdo rast konkret nga gjykata kompetente. Është me rëndësi që të vërtetohet përgjegjësia penale dhe fajësia e kryesit në kohën e kryerjes së veprës penale. Natyrisht, në shkallën e përgjegjësisë penale luan rol të madh edhe dashja dhe pakujdesia si forma të fajit.

Përgjegjësia penale në të drejtën penale ndërkombëtare me vështrim në statutin e gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare

Përgjegjësia penale për veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare ka kuptim më të gjerë dhe është më gjithëpërfshirëse se përgjegjësia penale që parashihet me ligje penale nacionale. Edhe në të drejtën penal ndërkombëtare është pranuar përgjegjësia penale sipas parimit latin *nullum crimen sine culpa* që do të thotë se nuk ka vepër penale (krim) nëse nuk është kryer me fajin e personit.

Sikurse parimi i ligjshmërisë edhe përgjegjësia penale është parim themelor i të drejtës penale ndërkombëtare. Parimi i ligjshmërisë është garanci e drejtësisë dhe sigurisë juridike të qytetarëve sipas të cilit një person mund të merret në përgjegjësi penale dhe të dënohet për vepra penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare vetëm nëse janë përmbushur elementet e fajësisë, përkatësisht përgjegjësia penale qoftë në formën e dashjes ose pakujdesisë si dhe vetëdijes për kundërligjshmërinë.[635] Përgjegjësia penale për kryerje të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare është e gjerë dhe specifike. Për këto vepra penale përgjigjen kryerësit, urdhërdhënësit dhe ndihmësit. Po ashtu, sipas nenit 27 të Statutit të Romës, çdo person që kryen vepra penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare është penalisht përgjegjës, pa marrë parasysh pozitën dhe statusin që mund të ketë ai, sipas parimit të irelevancës së pozitës zyrtare.

Përgjegjësia penale individuale

[635] Shih dhe krahaso: Salihu I, *E drejta penale ndërkombëtare*, Prishtinë, 2011, faqe 397.

Sipas parimeve të së drejtës penale bashkëkohore përgjegjësia penale është individuale. Sipas nenit 25 të Statutit të Romës, parimisht secili individ përgjigjet penalisht vetëm për veprimet e tij dhe jo të dikujt tjetër. Nga ky rregull ka një përjashtim kur kemi të bëjmë me kryerje të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Sipas nenit 28 të Statutit të Romës është penalisht përgjegjës eprori (komandanti) për veprimet e vartësit të tij nëse vepra penale është kryer me dijeninë e eprorit kur ky nuk ka ndërmarrë masa për të parandaluar ose ndëshkuar vartësin. Në rastet tjera, edhe në të drejtën penale ndërkombëtare është pranuar parimi i përgjegjësisë individuale penale sipas të cilit çdo person përgjigjet për veprimet e tij. Në rastet kur ka disa kryerës të veprës penale (bashkëkryerës) përgjegjësia penale shkallëzohet dhe secili kryerës përgjigjet në kufijtë e nivelit të kontributit që ka dhënë në kryerjen e veprës penale. Përveç kryerësit të drejtpërdrejtë përgjigjet penalisht edhe shtytësi, ndihmësi si dhe personi që përkrahë kryerjen e veprave penale. Kjo zgjidhje mundëson që në masë të gjerë të ndiqen dhe të ndëshkohen kryerësit e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare.

Përgjegjësia e komanadantëve dhe e përgjegjësve të tjerë

Personat në hierarki ose në pozita të caktuara shtetërore ose ushtarake kanë rol të madh në kryerjen e shumë krimeve, veçanërisht gjatë kohës së luftës ose okupimit. E drejta penale ndërkombëtare ka paraparë dispozita të veçanta me të cilat i inkriminon veprat penale të kryera nga komandantët (eprorët) si dhe ka paraparë dënimet që mund të ju caktohen atyre. Rrjedhimisht, në nenin 28 të Statutit të Romës është rregulluar çështja e përgjegjësisë së komandantëve dhe udhëheqësve tjerë. Sipas zgjidhjes së dhënë në këtë nen komandanti është penalisht përgjegjës për veprat penale të kryera nga forcat nën komandën e tij. Komandant përkatësisht epror sipas këtij neni mund të jetë çdo person i cili ka autoritet të jap urdhra dhe të cilin të tjerët e njohin si të tillë.

Edhe Kodi Penal e ka paraparë përgjegjësinë penale të komandantëve. Rrjedhimisht, në nenin 161 është paraparë vepra penale *Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësve tjerë*, sipas të cilit personi që vepron si komandant ushtarak përgjigjet penalisht për veprat në nenet 148-156 të Kodit Penal të kryera nga forcat nën komandën dhe kontrollin e tij të vërtetë ose nën autoritetin (pushtetin) e tij si rezultat i dështimit të tij për të ushtuar kontrollin e duhur mbi forcat e tilla, kur ai:

1. E ka ditur ose është dashur ta dijë se forcat nën komandën e tij kanë kryer ose po përgatiten që të kryejnë krime të tilla;

2. Nuk i ka ndërmarrë masat e nevojshme në suaza të kompetencave të tij për të parandaluar kryerjen e krimeve apo për t`i dorëzuar kryerësit në organet kompetente për hetim dhe ndjekje.[636]

Nga zgjidhjet e dhëna në këtë inkriminim rezulton se kjo vepër kryhet me mosveprim. Në rastin e parë kemi të bëjmë me mosndërmarrjen e veprimeve nga komandanti për të parandaluar kryerjen e krimeve kurse në rastin e dytë me mosndërmarrjen e masave me qëllim të hetimit dhe ndjekjes penale të vartësve të tij për krimet e kryera. Sipas nenit 161 (paragrafi 2) të Kodit Penal komandanti është përgjegjës penalisht për veprat penale të kryera nga vartësit e tij të paraparë në nenet 148-159 të këtij Kodi si pasojë e mosushtrimit të kontrollit ndaj vartësve të tij nëse:

1. Eprori e ka ditur ose me vetëdije nuk e ka përfillur informatën e cila ka treguar qartë se vartësit e tij po kryenin ose ishin përgatitur të kryenin vepra penale të tilla;
2. Krimet kanë të bëjnë me veprimet brenda përgjegjësisë dhe kontrollit të eprorit dhe
3. Eprori nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar ose për të ndalur kryerjen e tyre apo për të dorëzuar çështjen te organet kompetente për hetim dhe ndjekje.

Që të gjitha këto forma të këtyre veprave penale kryhen me mosveprim, me dashje direkte e në raste të caktuara edhe me dashje eventuale.

Përgjegjësia penale për veprat penale ndërkombëtare sipas kodit penal dhe disa karakteristika të veprave penale

Kodi Penal i Kosovës përfaqëson modelin e kodeve penale i cili në masë të madhe i ka inkorporuar veprat penale të cilat i parasheh Statuti i Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës). Përmes kësaj zgjidhje, Kosova është zotuar se në shtetin e saj nuk do të lë hapësirë për përsëritjen e krimeve të luftës dhe gjenocidit sikurse që ndodhi në luftën e fundit më 1998-1999 dhe të njëjtat kurdo që ndodhin do t`i ndëshkojë. Në këtë aspekt, Kosova ka dhënë kontribut modest për kultivimin dhe ruajtjen e paqes dhe vlerave mbarënjerëzore.[637]

Për veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare përgjigjet penalisht çdo person që ka kryer vepra të tilla me kusht që të jetë i përgjegjshëm penalisht.

[636] Krahaso: Po aty, faqe 375.
[637] Shih dhe krahaso: Hajdari A. *Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe Kodi Penal i Kosovës*, Portali Telegrafi, http://www.telegrafi.com/lajme/gjykata-penale-nderkombetare-dhe-kodi-penal-i-kosoves-26-5113.html, datë 10.06. 2012.

Rrjedhimisht, për këto vepra penale përgjigjen penalisht kryerësit e drejtpërdrejtë, ndihmësit, urdhërdhënësit, komandantët, ata që kanë ofruar përkrahje dhe që kanë nxitur kryerjen e këtyre krimeve. Veprat kryhen vetëm me dashje. Inkriminimet e veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare janë voluminoze, me shumë nene dhe paragrafë. Shumë dispozita janë të karakterit blanket sepse udhëzojnë në aplikimin e akteve relevante ndërkombëtare. Si karakteristika të përbashkëta të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare janë:

1. Janë të drejtuara kundër marrëdhënieve të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
2. Vepra penale blankete sepse udhëzojnë (referojnë) në aplikimin e akteve të ndryshme të shteteve dhe anasjelltas;
3. Për shkak të natyrës së tyre zakonisht kryhen në formë të krimit të organizuar, (nga ushtarakët, rezervistët, mercenarët, grupet kriminale, qeveritarët, pushtetarët e tjerë);
4. Kryhen me dashje si formë më e rëndë e fajësisë;
5. Përgjegjësia penale është specifike dhe e veçantë sepse për këto vepra përgjigjen një rreth i gjerë personash;
6. Për këto vepra nuk aplikohet parashkrimi i ndjekjes penale dhe vuajtjes së dënimit;
7. Kryerësve nuk u njihet e drejta e azilit;
8. Për këto vepra penale caktohen dënimet më të rënda;

Në përgjithësi për nga karakteri veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare mund të ndahen në:

1. Krime të gjenocidit;
2. Krime kundër njerëzimit;
3. Krime të luftës;
4. Krime kundër paqes.

Llojet e veprave penale ndërkombëtare sipas kodit penal

Veprat penale si akte të dëmshme dhe të rrezikshme shoqërore janë të parapara me ligj sipas parimit të ligjshmërisë *nullum crimen sine lege*. Sikurse vendet tjera edhe Republika e Kosovës i ka

paraparë në mënyrë taksative veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare. Rrjedhimisht, në kuadër të Kapitullit *Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare* bëjnë pjesë:

1. Krimi i gjenocidit, (neni 148);
2. Krimet kundër njerëzimit, (neni 149);
3. Krimet e luftës për shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës, (neni 150), Krimet e luftës për shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, (neni 151), Krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventave të Gjenevës, (neni 152), Krimet e luftës për shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, (neni 153);
4. Sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme, (neni 154);
5. Rekrutimi ose regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në konfliktin e armatosur, (neni 155);
6. Përdorimi i mjeteve ose metodave të ndaluara të luftimit, (neni 156);
7. Shtyrja e paarsyeshme e riatdhesimit të robërve ose e civilëve, (neni 157);
8. Përvetësimi i kundërligjshëm i sendeve nga të vrarët ose të plagosurit në fushëbetejë, (neni 158);
9. Rrezikimi i negociatorëve, (neni 159);
10. Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës, (neni 160);
11. Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësve të tjerë, (neni 161);
12. Shtytja në luftë agresive ose konflikt të armatosur, (neni 162);
13. Keqpërdorimi i emblemave ndërkombëtare, (neni 163);
14. Rrëmbimi i fluturakes, (neni 164);
15. Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil, (neni 165);
16. Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar, (neni 166);
17. Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental, (neni 167);
18. Piratëria, (neni 168);
19. Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar, (neni 169);
20. Kontrabandimi me emigrantë, (neni 170);
21. Trafikimi me njerëz, (neni 171);
22. Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz, (neni 172);

23. Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare, (neni 173);
24. Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, (neni 174);
25. Marrja e pengjeve, (neni 175);
26. Përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve nukleare, (neni 176);
27. Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear, (neni 177).

Përgjegjësia penale për kryerje të krimit të gjenocidit

Gjenocidi është krimi më i rëndë në kuadër të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Krimi i gjenocidit është paraqitur qëmoti edhe pse si krim është inkriminuar relativisht vonë. Rrjedhimisht, gjenocidi konsiston në ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të eliminimit ose zhdukjes së tërësishme ose të pjësërishme të grupit nacional, etnik, racor ose fetar.

Gjenocidi është vepër penale komplekse, figura e të cilit ndërtohet nga disa veprime të posaçme. Gjenocidi kryhet nga kushdo (delicta communia) i cili me qëllim të asgjësimit të tërësishëm ose të pjesërishëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar kryen një ose disa nga veprimet e mëposhtme:

1. Vrasja e anëtarit të grupit;
2. Shkaktimi i lëndimeve të rënda fizike ose psikike anëtarit të grupit;
3. Vënia e qëllimshme e grupit në kushte të jetës që shpijnë në shfarosje të plotë ose të pjesërishme fizike;
4. Vënia e masave me të cilat pengohet shtimi i grupit;
5. Transferimi me dhunë i fëmijëve dhe të miturve në grupin tjetër.[638]

Përgjegjësia penale për këtë vepër penale sajohet ndaj shumë subjekteve sepse rrethi i personave të cilët mund ta kryejnë atë është i gjerë, përkatësisht zona kriminale e veprës është e gjerë. Në fakt, për këtë vepër penale do të përgjigjet penalisht personi i cili e kryen, ndihmësi, shtytësi përkatësisht personi urdhërdhënës, pa marrë parasysh statusin që mund të ketë ai. Vepra penale kryhet me dashje si formë e rëndë e fajit dhe me qëllim të posaçëm për asgjësimin e plotë

[638] Rreth krimit të gjenocidit shih: Nenin 2 të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, New York, 1948, nenin 6 të Statutit të Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare, Romë, 1998, nenin 148 të Kodit Penal të Kosovë, Salihu I. *E drejta penale, pjesa e posaçme,* Prishtinë, 2009, faqe 49 dhe Schabas W. *Gjenocidi në të drejtën ndërkombëtare,* Prishtinë, 2000, faqe 17-24.

ose të pjesërishëm të grupit të caktuar nacional, etnik, racor apo fetar. Sipas zgjidhjeve të dhëna rezulton fakti se përgjegjësia penale për këtë vepër penale ndërtohet nga dy elemente të posaçme, përkatësisht nga dashja dhe qëllimi i kryerësit. Si karakteristika tjera të krimit të gjenocidit janë:

1. Gjenocidi parimisht kryhet me veprim;
2. Në të shumtën e rasteve kryhet gjatë luftës, okupimit e më rrallë gjatë kohës së paqes;
3. Për shkak të rrezikshmërisë ndjekja penale dhe ekzekutimi i dënimit nuk parashkruhet;
4. Kryerësve nuk u njihet e drejta e azilit;
5. Për këtë vepër vlen parimi i juridiksionit universal.

Sipas nenit 168 të Kodit Penal të Kosovës për kryerësit e krimit të gjenocidit është paraparë caktimi i dënimit me burgim prej 15-25 vjet ose me burgim të përjetshëm kur vepra rezulton me pasoja më të rënda. Ky dënim është i arsyeshëm dhe ka për qëllim që t`i parandalojë dhe luftojë në masë të madhe këto krime të rënda.

Përgjegjësia penale për kryerje të krimeve kundër njerëzimit

Krimet kundër njerëzimit përfshijnë një numër të madh të veprave penale. Sipas zgjidhjeve të dhëna në aktet relevante ndërkombëtare si krime kundër njerëzimit konsiderohen ato vepra penale të cilat ndërmerren si pjesë e sulmit të gjerë dhe sistematik që janë të drejtuara kundër popullsisë civile, në kohë të luftës, okupimit ose në kohë të paqes. Krimet kundër njerëzimit konsistojnë në kryerjen e ndonjërës nga veprat në vijim:

1. Vrasja;
2. Shfarosja;
3. Skllavërimi;
4. Deportimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë;
5. Burgosja ose privimi nga liria në mënyrë të kundërligjshme;
6. Tortura;
7. Dhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni, shtatzënia, sterilizimi i detyruar ose dhuna e ngjashme seksuale;
8. Persekutimi i një grupi të identifikuar me një bashkësi për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore apo fetare;
9. Zhdukja e detyruar e personave;

10. Krimet e aparteidit;

11. Veprat tjera çnjerëzore që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha, lëndime serioze të shëndetit fizik ose mendor.

Përgjegjësia penale për këto vepra është e gjerë dhe specifike, sepse përgjigjen penalisht kryerësit e drejtpërdrejtë si dhe urdhërdhënësit, përkatësisht eprorët si dhe personat të cilat kanë ndihmuar, përkrahur ose nxitur kryerjen e këtyre veprave. Rrjedhimisht, këto vepra penale kryhen zakonisht me dashje direkte e në raste më të rralla edhe me dashje eventuale. Për t`u sajuar përgjegjësia penale për ndonjërën nga këto vepra penale në kuadër të krimeve kundër njerëzimit duhet të plotësohen tri kushte në mënyrë kumulative:

1. Sulmi të jetë ndërmarrë në kuadër të sulmit të gjerë ose masiv;
2. Sulmi duhet të jetë ndërmarrë në mënyrë sistematike dhe
3. Sulmi kundër popullsisë civile të jetë kryer me pajtimin apo përkrahjen e shtetit ose të politikës së caktuar.[639]

Sipas nenit 149 të Kodit Penal për krime kundër njerëzimit kryerësve mund t`ju caktohet dënimi prej të paktën 15 vjetëve ose me burgim të përjetshëm. Masa e tillë e dënimit vlerësohet të jetë e ashpër por e arsyeshme kur kihet parasysh se krimet kundër njerëzimit në të kaluarën e hidhur të njerëzimit kanë shkaktuar dëme të mëdha, viktima në njerëz, humbje besimi ndër popuj, dyshime në drejtësinë ndërkombëtare e të tjera.

Përgjegjësia penale për kryerje të krimeve të luftës

Krimet e lutës përbëhen nga shumë lloje të veprave penale. Në kuadër të krimeve të luftës konsiderohen këto vepra penale: vraja, tortura ose trajtimi çnjerëzor, shkaktimi i mundimeve të mëdha, dhunimi dhe ngacmimi seksual, detyrimi i robërve të luftës që të shërbejnë në forcat e armikut, gjykimi arbitrar, deportimi i kundërligjshëm, marrja e pengjeve.[640] Pra për nga lloji dhe natyra krimet e luftës janë vepra penale të përbëra dhe komplekse. Me qëllim të humanizimit të luftës bashkësia ndërkombëtare ka nxjerrë akte të shumta, si konventa, protokolle, deklarata e tjera.

Krimet e lutës shquhen me disa karakteristika të posaçme. Rrjedhimisht, krimet e luftës mund të kryhen nga çdo person (delicta communia) dhe mund të kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit. Përgjegjësia penale për kryerje të krimeve të luftës është e

[639] Salihu I. *E drejta penale, pjesa e posaçme,* faqe 54.
[640] Shih nenin 8 të Statutit të Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare dhe nenin 150 të Kodit Penal të Kosovës. Më gjerësisht rreth krimeve të luftës në Kosovë: Shih: Hajdari A. *Krimet e luftës kundër popullsisë civile në Kosovë gjatë periudhës shkurt 1998-qershor 1999,* Prishtinë, 2002, faqe 165-207.

relativisht e zgjeruar dhe specifike. Përveç kryerësit të drejtpërdrejtë për krime të luftës përgjigjet penalisht edhe personi që ka planifikuar, urdhëruar dhe ndihmuar në kryerjen e tyre.[641]

Lidhur me përgjegjësinë penale për kryerje të krimeve të luftës e drejta penale ndërkombëtare ka paraparë zgjidhjen parimore sipas të cilës për këto vepra përgjigjet çdo person, pa marrë parasysh statusin që mund të ketë. Me qëllim që të parandalohen dhe luftohen me sukses krimet e luftës si dhe të ndëshkohet çdo kryes është paraparë *instituti i irelevancës së pozitës zyrtare*. Sipas këtij parimi pozita zyrtare e kryerësit ose imuniteti që mund të ketë ai, qoftë ai kryetar i shtetit, kryeministër ose zyrtar tjetër i lartë i shtetit nuk e liron nga përgjegjësia penale, madje nuk mund t`i merret as si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Po ashtu, kryerësve të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare nuk u njihet e drejta e azilit.

Krimet e luftës kryhen vetëm me dashje e cila ngërthen në vete edhe qëllimin e caktuar të kryerësit, zakonisht dëmtimi i pjesëtarëve të popullsisë së caktuar. Po ashtu, me qëllim që të ndëshkohen të gjithë kryerësit e krimeve të luftës është paraparë rregulli parimor sipas të cilit krimet e luftës, krimi i gjenocidit, agresioni dhe krimet kundër njerëzimit nuk parashkruhen.[642] Pra, për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare nuk zbatohet parashkrimi ligjor i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit. Kjo zgjidhje mundëson që kryerësit e krimeve të luftës në çdo kohë të ndiqen dhe të dënohen. Sipas neneve 150-160 të Kodit Penal për veprat penale të krimeve të luftës dënimet variojnë, varësisht peshës dhe llojit të veprës penale konkrete. Rrjedhimisht, për këto vepra penale kryerësve mund t`ju caktohet dënimi prej të paktën 5, 10, 15 vjetësh ose me burgim të përjetshëm.

Përgjegjësia penale për llojet tjera të veprave penale ndërkombëtare

Veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare janë të shumta dhe të llojllojshme. Me aktet relevante ndërkombëtare është tentuar që në masë të madhe të parashihen shumica e veprave penale si dhe sanksioneve penale që mund të ju caktohen kryerësve. Edhe përgjegjësia penale për këto vepra penale është e zgjeruar dhe specifike.

Siç e kemi cekur edhe më lartë, përveç gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës si krime tradicionale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, ekzistojnë edhe disa vepra penale për të cilat sajohet përgjegjësia penale. Për shkak se janë shumë në numër, do t`i elaborojmë shkurtimisht vetëm disa prej veprave penale, në kontekst të përgjegjësisë penale.

[641] Krahaso: Salihu I. *E drejta penale, pjesa e posaçme*, faqe 67.
[642] Mosparashkrimi i veprave të luftës është paraparë shprehimisht me nenin 111 të Kodit Penal të Kosovës.

Sipas nenit 155 të Kodit Penal është përgjegjës penalisht çdokush i cili regjistron fëmijë ndërmjet moshës 15-18 vjeçare në forcat e armatosura. Ky inkriminim është paraparë me qëllim që të mbrohen fëmijët nga abuzimi eventual. Sipas nenit 157 është përgjegjës penalisht kushdo i cili në kundërshtim me parimet e të drejtës ndërkombëtare shtynë riatdhesimin e robërve të luftës ose civilëve pas përfundimit të luftës. Kjo është vepër penale tipike e kryer nga zyrtarë të shtetit të Serbisë pas përfundimit të luftës në Kosovë sepse pa arsye është vonuar riatdhesimi i peronave të liruar nga dënimi, i robërve dhe civilëve shqiptarë. Vepra penale kryhet me mosveprim. Në nenet 164-166 të Kodit Penal janë paraparë si vepra penale edhe rrezikimi i fluturakeve, aviacionit civil dhe cenimi i sigurisë së lundrimit detar. Këto inkriminime kanë për qëllim që të mbrojnë rregullat e trafikut ajror dhe detar nga atakimet kriminale. Këto vepra penale kryhen me dashje direkte dhe zakonisht nga grupet terroriste dhe për qëllime të caktuara politike dhe ideologjike.

Në nenet 170-172 janë paraparë veprat penale të kontrabandimit me emigrantë, trafikimi me njerëz dhe veprat e ndërlidhura me to. Me inkriminimin e këtyre veprave penale është synuar që maksimalisht të parandalohen dhe luftohen këto vepra penale që manifestojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe pasoja shumëdimensionale. Në fakt, këto inkriminime kanë për qëllim që të mbrojnë kategoritë e veçanta të njerëzve nga keqpërdorimi i mundshëm nëpërmjet atakimit që ju bëhen me këto vepra penale nga njerëz dhe grupe të ndryshme kriminale. Këtu mendohet në rend të parë në femrat dhe fëmijët të cilët më së shpeshti janë objekt i këtyre veprave penale. Në nenet 174-177 të Kodit Penal janë paraparë veprat penale të rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara, marrja e pengjeve si dhe përvetësimi dhe përdorimi i paligjshëm i materialeve nukleare. E drejta ndërkombëtare ka bërë përpjekje që të garantoj sigurinë e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe objekteve të tyre. Po ashtu, është synuar që të pengohet përvetësimi dhe përdorimi i materialeve nukleare nga njerëz të paautorizuar, që të parandalohet dhe luftohet përdorimi i tyre kur dihet se çfarë rreziku paraqesin ato për rendin dhe paqen ndërkombëtare, veçanërisht nëse bien në duart e grupeve terroriste.

PËRFUNDIME

Pas hulumtimit të përgjegjësisë penale për kryerjen e veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës kemi arritur në këto përfundime të rëndësishme:

Në Kodin Penal të Kosovës në një kapitull të veçantë me gjithsej 30 nene, janë paraparë shumica e veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Për shkak të natyrës së rëndë të këtyre veprave penale dhe rrezikshmërisë që paraqesin ato, zona e inkriminimit për këto vepra është e zgjeruar dhe specifike. Veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare kryhen

me dashje si forma më e rëndë e fajit dhe me qëllime të caktuara politike, nga urrejtja e të tjera. Ato kryhen në formën themelore (të rëndomtë) dhe në formë të rëndë (të kualifikuar, të cilësuar).

Përgjegjësia penale është element konstituiv i veprës penale i cili mundëson që ndaj kryerësit të veprës penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare të zhvillohet procedura penale dhe t`i caktohet sanksioni penal, përkatësisht dënimi i caktuar. Rrjedhimisht, personi për t`u ndjekur penalisht dhe për t`u dënuar për një vepër penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare rregullohen me akte juridike relevante ndërkombëtare, si Konventa, Rezoluta, Statute si dhe me rregullativë interne të shteteve me ligje penale të cilat në shumicën e rasteve referojnë në këto akte, pra janë vepra penale blankete. Me qëllim të parandalimit dhe ndëshkimit të kryerësve të veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare vlen parimi i juridiksionit universal. Këto vepra penale nuk parashkruhen (vjetrohen) gjë që ofron mundësi që kryerësit në çdo kohë të ndiqen penalisht dhe të dënohen. Po ashtu, kryerësve të veprave penale nuk u njihet e drejta e azilit.

Në të drejtën penale ndërkombëtare është paraparë edhe rregulli parimor sipas të cilit për kryerje të veprave penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht për gjenocid, krime kundër njerëzimit, krime të luftës dhe aparteid, përgjigjen penalisht edhe personat zyrtarë, qoftë në pozita politike ose ushtarake. Sipas kësaj zgjidhje nuk ka rëndësi pozita e kryerësit të veprës penale (irelevanca e pozitës zyrtare).

Edhe politika ndëshkimore për veprat penale të mbrojtur me të drejtën ndërkombëtare është më e ashpër. Për veprat penale kundër vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare është paraparë caktimi i dënimeve më të rënda. Rrjedhimisht, për këto vepra penale janë paraparë dënimet më të rënda, kryesisht dënimi me burgim afatgjatë dhe me burgim të përjetshëm.

Bibliografia

Tekste universitare, libra dhe artikuj shkencorë:

HAJDARI, Azem *Krimet e luftës kundër popullsisë civile në Kosovë gjatë periudhës kohore shkurt 1998 – qershor 1999*, Prishtinë, 2002;

Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe Kodi Penal i Kosovës, Portali Telegrafi, http://www.telegrafi.com/lajme/gjykata-penale-nderkombetare-dhe-kodi-penal-i-kosoves-26-5113.html, datë10.06.2012.

SAHITI, Ejup *Psikologjia gjyqësore*, Prishtinë, 2007.

SALIHU, Ismet *E drejta penale ndërkombëtare*, Prishtinë, 2011.

SALIHU, Ismet *E drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 2008.

SALIHU, Ismet *E drejta penale, pjesa e posaçme*, Prishtinë, 2009.

SCHABAS, William *Gjenocidi në të drejtën ndërkombëtare*, Prishtinë, 2000.

GRUDA, Zejnullah *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*, Prishtinë, 2005.

Akte normative:

Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, (Convention on Prevention and Punishment of the Crime of Genocide), Resolution no. 260 (III) A, General Assembly of United Nations, New York, December 9, 1948.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.

Kodi nr. 04/L082 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 13.07.2012.

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare nr. 37, datë 28.12.2012.

Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Gazeta Zyrtare nr. 17, datë16.09.2011.

Efektet e Globalizimit në Profesionin e Avokatisë

Arsiola Dyrmishi[1], Erald Shushari[2]

[1]Doktorante, Universiteti Europian i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

[2] Departamenti i të Drejtës Administrative, Fakulteti Juridik, Universiteti Europian i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Globalizimi përfaqëson një dukuri komplekse që përfshin të gjitha sferat e jetës të njerëzve dhe të shteteve në të gjithë botën. Për më tepër,globalizmi nuk është një proces i së ardhmes,por një proces që ka filluar prej shumë kohësh tashmë. Sot dimensionet të cilat përbëjnë globalizmin janë: dimensioni politik, ekonomik, ideologjik dhe kulturor, dimensione këto që kanë ndikim edhe në ndërtimin e sistemit juridik dhe në institutin e avokatisë. Ky studim trajton nëpërmjet qasjes teorike dhe analizës kritike një element esencial të Shtetit të së Drejtës dhe sistemit gjyqësor,avokatinë si një profesion të pavarur. E rëndësishme është të niset nga një premisë,nëse globalizmi afekton avokatinë. Kësaj pyetje realiteti i ri i krijuar i ka dhëne përgjigje pozitive tashmë. Globalizmi në profesionin e avokatisë shihet në dy aspekte,si një realitet fizik i veprimtarisë së studiove ligjore në hapësirën e tyre të veprimit dhe si një realitet juridik duke përfaqësuar tërësinë e ligjeve të cilat rregullojnë apo lejojnë një veprimtari të tillë. Të nisur nga premisa e afektimit,avokatia shqiptare në mënyrë të pashmangshme do të përballet me të si mundësi ,por edhe si sfidë. Globalizmi e vendos profesionin e avokatisë përballë shumë sfidave,që nuk janë vetëm strukturore,por kanë të bëjnë më së shumti edhe me njohjen e sistemeve dhe normave ligjore të shteteve të huaja.

Ky studim përfaqëson përpjekjen për ta konsideruar avokatinë shqiptare në një dimension global,për t'i dhënë përgjigje pyetjeve Pjesa e parë e studimit do të trajtojë kriteret për ushtrimin e këtij profesioni,të konsideruara ato në krahasim me praktikat më të mira europiane dhe botërore.Mandej duke nisur nga këto kritere sa të njëjta dhe të ndryshme do të analizohet nëse është gati avokatia shqiptare të veprojë në një botë "pa kufi"?Cilat janë sfidat në kuadrin e globalizmit ?Cila është qasja e ligjit shqiptar për avokatinë në lidhje me avokatët e huaj që kërkojnë të ushtrojnë këtë profesion në Shqipëri?

Qëllimi i këtij studimi është që nëpërmjet evidentimit të sfidave të produktojë rekomandime konkrete për ta shndërruar profesionin e avokatisë në Shqipëri në një profesion që i përgjigjet

trendeve aktuale të globalizmit dhe ndërkombëtarizimit,duke njohur dhe vlerësuar korrekt faktorët pengues në këtë drejtim. Studimi do të shkojë në koherencë me pyetjen nëse globalizmi mund të mbërrihet vetëm nëpërmjet masave ligjore(duke specifikuar ato dhe efektet respektive) apo kërkon masa komplekse si vet procesi që përfaqëson.

Fjalë kyçe: *Avokatia ,globalizimi, ligj, sisteme juridike,studio ligjore.*

1. Hyrje

Studimi i efekteve te globalizimit mbi profesionin e avokatisë përbën një temë pak të trajtuar në debatet akademike shqiptare për shkak të zhvillimeve të avokatisë sot,e cila shfaq probleme në përcaktimin e rolit të saj,si një faktor i rëndësishëm i Shtetit të së Drejtës,Sistemit të Drejtësisë apo rolit garant në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Duke njohur dhe vlerësuar me objektivitet këto zhvillime por të vetëdijshëm se procesi i globalizimit në mënyrë të pashmangshme do të afektojë profesionin e avokatisë edhe në Shqipëri ky studim është rivlerësim dhe qëndrim kritik i literaturës ekzistuese mbi globalizimin dhe avokatinë në një qasje ndërkombëtare për të nxjerrë në këtë mënyrë rekomandimet dhe konkluzionet përkatëse mbi pikëpyetjet e natyrshme që shoqërojnë këtë proces i cili midis qasjeve pozitive dhe negative ka provuar se vlen te trajtohet nën termat e një procesi te pashmangshëm...Është e rëndësishme që fillimisht të qartësojmë nocionin e globalizimit,por pikërisht këtu hasim me problemin e parë,globalizimi nuk ka një koncept gjerësisht të pranuar në qarqet shkencore. Elmar Altvater ka tentuar ta përcaktojë globalizimin si :" Globalizimi është një proces i kapërcimit të kufijve të lindur historikisht... "Anthony Giddens e përcakton si "...intensifikimi i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese, sikurse edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg dhe anasjelltas" Dirk Messner dhe Franz Nuscheler: "Globalizimi është kthesa më e madhe ekonomike dhe shoqërore që prej revolucionit industrial"

Globalizimi,i perceptuar si proces mbi nacional mbart një qasje pozitive po aq sa edhe diskutime sensitive. Ndërsa duket se këto diskutime po tejkalohen për efekt të avantazheve që ky proces sjell çështja shtrohet në një tjetër nivel:globalizimi në profesionin e avokatisë. Avokati është një profesionist i autorizuar për të praktikuar ligjin,duke kryer padi,dhënë këshilla ligjore apo përfaqësuar persona para gjykatës apo në çështje ligjore[643].Në terma ndërkombëtar ky profesion njihet me termin anglez "*lawyer* apo *attorney*" i cili përmbledh termin ''avokat'' ndërkohë që praktika ndërkombëtare i përgjigjet këtij profesioni sipas specializimeve duke përmbledhur këtu mbrojtësin publik[644],avokatin e caktuar nga gjykata për të investiguar dhe raportuar një çështje para gjykatës[645],avokatin(karakteristikë për Anglinë) i cili jep këshilla ligjore dhe përgatit

643 http://www.thefreedictionary.com/lawyer

644 **public defender** n. an elected or appointed public official (usually of a county), who is an attorney regularly assigned by the courts to defend people accused of crimes who cannot afford a private attorney. In larger counties the public defender has a large case load, numerous deputy public defenders and office staff. In each Federal Judicial District there is also a federal public defender, and some states have a state public defender to supervise the provision of attorneys to convicted indigents for appeals. http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Public+Defender Shikuar më 24.03.2013

645 referee - an attorney appointed by a court to investigate and report on a case http://www.thefreedictionary.com/referee

dokumentet[646],apo avokat i specializuar për të mbrojtur klientët para një gjykate[647] si dhe *barrister* si një avokat britanik apo kanadez i cili merr pjesë në gjykatat më të larta në emër të ligjit apo të ndjekjes penale. Këto terma,të cilët nuk janë shterues demonstrojnë përmasat në të cilat zhvillohet profesioni i avokatisë sot në dimensionin ndërkombëtar. Fillesat e profesionit të Avokatisë lidhen me Greqinë e Lashtë në të cilën grekët kërkonin dikë (i cili zotëronte aftësi komunikimi) për të përfaqësuar çështjen e tij në pamundësi për të përfaqësuar veten. Këta persona nuk paguheshin dhe kjo përbënte një pengesë për ta trajtuar si profesion apo një veprimtari ekspertësh megjithëse ne praktikë ky rregull jo gjithmonë u zbatua. Por megjithëse fillesat ndeshen në Greqinë e Lashtë,avokatët në kuptimin e ngushtë lidhen me zhvillimet në Romë. Ligji i miratuar në Romë në vitin 204 para Lindjes së Krishtit ndalonte pagesën e avokatëve,por ky ligj nuk u zbatua gjerësisht. Ligji u shfuqizua nga Perandori Claudius i cili ligjëroi avokatinë si profesion dhe i lejoi avokatët romakë të ushtronin këtë profesion lirisht me tarifë. Praktikantët e ligjit(avokatët por edhe gjyqtarët) fillimisht nuk kishin një edukim specifik por shumë vonë në Romë u arrit krijimi i një klase specialistësh me vokacion ligjor të njohur si *iuris consulti*,ç'ka bëri që më vonë ligjet romake të ishin precize,të detajuara dhe teknike. Karakteristikat e profesionit të avokatisë siguristh sot kanë ndjekur rrjedhën evolutive të shoqërisë dhe të çështjeve që lidhen me administrimin e drejtësisë. Profesioni i avokatisë duhet shikuar nën tendencat bashkëkohore të cilat tentojnë të shkojnë drejt unifikimit të së drejtës nën vlerat universale të njohura dhe të mbrojtura ndërkombëtarisht. Pse është i rëndësishëm profesioni i avokatit?Në një botë natyrshëm konfliktuale avokati përfaqëson profesionistin e autorizuar për të zbatuar ligjin,agjentin e rendit dhe të qetësisë dhe sipas një paradigme bashkëkohore në kuptimin aktual nuk mund të ketë shoqëri pa avokatë si garant të lirive dhe të drejtave të njeriut atëherë kur zbatimi i ligjit i mbetet si detyrë gjykatës Ndërsa trajtuam fillimisht termat përshkrues të profesionit të avokatit ata të gjithë konkludojnë diku:avokati është zbatues apo studiues i ligjit. Studimi i efekteve të globalizimit në raport me profesionin e avokatisë kërkon definicionin e termit "globalizim".Vetë termi globalizmi është evolucion i termit ndërkombëtar,e më pas trans-nacional. Globalizimi duhet nënkuptuar si integrimi i shteteve dhe njerëzve,i ardhur si pasojë e reduktimit të kostove të transportit,komunikimit dhe shmangies së barrierave të lëvizjes së mallrave,shërbimeve,kapitaleve dhe dijes. Pas këtij parashkrimi deskriptiv mbi avokatinë dhe globalizimin si koncept teorik është e rëndësishme të trajtojmë shkaqet e globalizimit të avokatisë.

---

646 solicitor - The chief law officer of a city, town, or government department,Chiefly British An attorney who advises clients on legal matters, represents clients in certain lower courts, and prepares cases for barristers to present in the higher courts. *Canadian* A barrister and solicitor. http://www.thefreedictionary.com/solicitor Shikuar më 24.03.2013

647 trial attorney, trial lawyer - a lawyer who specializes in defending clients before a court of law http://www.thefreedictionary.com/trial+attorney

2.Shkaqet e globalizimit të profesionit të avokatisë.

Arsyet pse avokatia ka një tendence të kthehet në një profesion gjithmonë e më global janë të ndryshme. Ato janë të lidhura me aspekte ekonomike, të harmonizimit të legjislacioni, zhvillimet teknologjike etj. Përmendim disa arsye:

I. *Nevoja për tu rritur të studiove ligjore*[648]**.**

Studiot ligjore,në realitetin ndërkombëtar po bëhen gjithmonë edhe më të mëdha,duke kërkuar të zgjerojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet klientëve të rinj përtej kufijve të vendit të origjinës e madje edhe përtej kontinentit .Studiot ligjore me më shumë se një avokat përbëjnë:

-Bashkim aftësish

-Bashkim kompetencash

-Bashkim eksperiencash

-Bashkim të njohurive mbi legjislacione të ndryshme (kur avokatët i përkasin vendeve të ndryshme të origjinës apo janë arsimuar në vende te ndryshme)

-Bashkim te klientëve ekzistues

-Bashkim të kapitalit financiar

II. *Lindja e shoqërive tregtare multi-nacionale*

Në shekullin e XXI është rritur shumë numri i kompanive ndërkombëtare .Duke qenë se këto kompani veprojnë në shumë shtete ,lind nevoja që ato të marrim përsipër detyrime ose të kryejnë veprime juridike në vende të ndryshme duke pasur nevojë për asistencë ligjore. Pikërisht ushtrimi i veprimtarisë përtej kufijve historikë nacionalë sjell nevojën e përfaqësimit të këtyre shoqërive.Për shoqëritë është më e besueshme,përveçse më konventiente që edhe në këto veprime të përfaqësohen nga avokatët e tyre të zakonshëm. Në praktikën ndërkombëtare edhe në kuadër të shërbimeve ligjore është braktisur ideja e avokatëve të rastësishëm,duke kaluar në idenë e një avokati familje

III. *Harmonizimi dhe lehtësitë ligjore.*

Ligjet që rregullojnë profesionin e avokatisë në vende të ndryshme po ndryshojnë duke lehtësuar mundësinë që avokati i një shteti të huaj të ushtroj këtë profesion edhe në një shtet tjetër. Nga ana tjetër shtetet Evropiane po harmonizojnë gjithmonë edhe më shumë legjislacionin e tyre

[648] Breckon,R 2012, *Globalisation of legal services*, <www.manches.com/.../Globalisation%20of%20legal%20services.pdf >,shikuar :22/03/2013.

duke mundësuar kështu lëvizjen e lirë të avokatëve nga një shtet në një tjetër[649]. Lehtësitë ligjore lidhen me instrumentat kryesisht ndërkombëtar të lëvizjes së lirë (të profesionistëve) por edhe me njohjen e diplomave,aspekte që do të trajtohen në pjesën e dytë të këtij studimi.

IV. Zhvillimi i teknologjisë[650].

Zhvillimi i teknologjisë përbën një nga shkaqet e globalizimit të shërbimeve ligjore. Zhvillimi i teknologjisë ka ndikuar në dy mënyra : e para,shumë studio ligjore ofrojnë shërbime asistence ligjore ose përpilime dokumentesh "online" .Aksesi elektronik i jep mundësinë shumë klientëve të marrin shërbimet ligjore që kanë nevoje nga studio ligjore të huaja.E dyta, duke qenë se interneti është përhapur gjerësisht ,shumë studio ligjore në të gjithë botën kanë ndërtuar web-faqja Kjo mundëson informimin e klientëve për shërbimet ligjore të studiove të vendeve të tjera,duke diktuar kështu edhe kërkesat e klientëve ndaj avokatëve kombëtarë.

V. Rritja e juridiksioneve gjyqësore ndërkombëtare[651].

Me marrëveshje shumëpalëshe shtetet jo vetëm po miratojnë akte ndërkombëtare që synojnë një mbrojtje më të gjerë të drejtave të njeriut,por po parashikohet edhe krijimi i instancave gjyqësore për mbrojtjen e tyre .Një rast është Gjykata Evropiane të Drejtave të Njeriut. Avokatet,si një subjekt esencial i proceseve gjyqësore edhe në Drejtësinë Evropiane apo Ndërkombëtare duhet të ofrojnë shërbimet ligjore edhe në këto instanca.

VI. Unifikimi i praktikave gjyqësore[652].

Krijimi i gjykatave me juridiksion ndërkombëtar ka bërë të mundur unifikimin e praktikave ligjore dhe avokatët e kanë më të lehtë të përfaqësojnë klientët e tyre në një shtet tjetër. Një rol shumë të rëndësishëm në unifikimin e praktikave ligjore ka luajtur edhe internetit. Tani një gjyqtar nga Shqipëria e ka më të lehtë të gjej vendimin e nje gjykatë të një shteti tjetër për një çështje të ngjashme dhe të zbatojë me analogji arsyetimin e saj.

[649] Directorate General of Human Rights and Rule of Law ,2012 *Eastern Partnership Enhancing Judicial Reform in the Eastern Partnership Countries* **,** Strasbourg.
[650] Breckon,R 2012, *Globalisation of legal services*, <www.manches.com/.../Globalisation%20of%20legal%20services.pdf >,shikuar :22/03/2013.
[651]Lum,R 2006,*The Globalization of the Legal Profession*, <http://www.lawcrossing.com/article/4186/The-Globalization-of-the-Legal-Profession/# > ,shikuar : 23/03/2013,
[652]

VII. Arsimimi ligjor në vende të ndryshme dhe njohja e diplomave.

Po ndodh gjithmonë edhe më shpesh kur një student ndjek studimet Universitare në një shtet dhe vazhdon studimet Master ose Doktorale në një shtet tjetër. Kjo i mundëson njohjen me sisteme të ndryshme ligjore duke i dhëne mundësi të ofroje shërbime në te dyja shtetet duke qenë se i njeh mirë sistemin dhe praktikat e tyre gjyqësore . Meqenëse arsimimi ligjor në vende të ndryshme dhe njohja e diplomave përben një nga shkaqet kryesore të globalizimit të profesionit të avokatisë ,por dhe për vete rëndësinë që paraqesin do ti trajtojmë në mënyre të zgjeruar në vijim këto dy pika .

VIII. -Arsimi Ligjor dhe Globalizimi

Shkollat ligjore u krijuan në Mesjetë në shekullin e 12-të dhe janë më të vjetrat pas atyre të mjekësisë. Edukimi ligjor është shoqëruar me pikëpyetje edhe për natyrën e tij duke diskutuar faktin nëse është diplomë e kualifikimit teknik apo intelektual?Pyetja ende qëndron e hapur,ndërsa shumë çështje të tjera shqetësojnë edukimin ligjor,aq më tepër tashmë të afektuar nga globalizimi. Në plan të parë duhet qartësuar se mund të ushtrohet profesioni i avokatit në bazë të kritereve kualifikuese të shteteve për këtë profesion. Ekzistojnë dy praktika:

- E para,sipas te cilës mund të ushtrohet ky profesion pasi ke marrë diplome universitare në Drejtësi
- E dyta,përpos diplomës universitare kërkohet një përgatitje teorike e cila testohet nga autoriteti kompetent (Dhoma e Avokatisë A.D) dhe nje fazë përgatitje praktike,e supervizuar nga nje avokat i licensuar(Shqipëri).Pjesa teorike dhe praktike mund të jenë të ndara(Francë) ose edhe së bashku(Holanda).

Vetëm një numër i kufizuar shtetesh në botë lejojnë ushtrimin e profesionit të avokatit vetëm me diplomën universitare apo me certifikatë profesionale.Në Australi[653] vetëm gjysma e të diplomuarve në Drejtësi arrijnë të ushtrojnë profesionin e avokatit privat. Arsimi ligjor zgjidh pikëpyetjen mbi vlerësimin e kurrikulave të arsimit të lartë në profilin juridik,si mund të realizojnë ato kërkesat për avokatë globalë edhe si mund të arsimojnë universitetet shqiptare profesionist për një treg global?Arsimimi i mjaftueshëm për t'u pranuar dhe integruar në një treg global shërbimesh ligjore përbën parakusht për realizimin e proceseve globalizuese.
Shumë universitete ndërkombëtare sot po angazhohen ta realizojnë këtë nëpërmjet:

[653] Ka 1 student të Drejtësisë për 700 banorë

- Ndryshimit të kurrikulave të Arsimit të Lartë në Drejtësi
- Përshtatjes së kurrikulave arsimore duke tentuar në dhënien e të njëjtës vlerë kurseve që lidhen me të drejtën ndërkombëtare,apo të drejtën e krahasuar në raport me të drejtën e brendshme
- Ofrimi i diplomave në partneritet me universitetet e huaja
- Mobilitet i studentëve apo pedagogëve në mjedise shkencore ndërkombëtare
- Përfshirja në kurrikulat akademike e pjesëmarrjes së detyrueshme në konferenca shkencore ndërkombëtare,simpoziume,seminare apo workshop-e.

Edukimi ligjor sot tentohet të ngrihet në krijimin e një gjenerate juristësh global[654],duke kërkuar reformimin e kurrikulës,përfshirjen e të drejtës dhe pedagogjisë ndërkombëtare si një pjesë substanciale e kurseve të së drejtës. Në këtë kontekst Universiteti Juridik i New York është proklamuar si "shkolla e parë globale e së drejtës"

Çështja e dytë e cila lidhet njëkohësisht me arsimimin ligjor por edhe me shkaqet e globalizimit është njohja e diplomave. Pikëpyetja nëse ka vlerë një diplomë e cila njihet vetëm në një shtet ndërkohë që lëvizja e lirë është e garantuar konfirmon rëndësinë e ketij procesi.Njohja e diplomave përbën parakusht për globalizimin por edhe për të drejtën e arsimimit,si një të drejtë themelore të Njeriut.

Njohja e Diplomave

"Unifikimi i kurrikulave" dhe i sistemit arsimor është i rëndësishëm në dy aspekte:

- Krijon kritere kualifikuese të ngjashme pavarësisht diferencave në shtete të ndryshme.
- Është kriter për njohjen e diplomave.

Njohja e diplomave nuk është një proces automatik por për zbatimin e saj ekzistojnë një sërë instrumentash. Megjithatë për të shkuar deri këtu,është e rëndësishme të arrihet unifikimi i proceseve arsimore. Në nivel evropian Deklarata e Bolonjës është një tregues i ndryshimeve në arsim me qëllim njohjen reciproke të diplomave.Procesi i reformimit të arsimit universitar në Evropë është iniciuar në të ashtuquajturën "Sorbonne Joint Declaration" ku ministrat e Arsimit të Francës,Gjermanisë,Anglisë dhe Italisë shpallën qëllimin e tyre për të krijuar një sistem uniform arsimi me qëllim krijimin e një Hapësire Evropiane të Arsimit të Lartë. Bashkimi Evropian është

[654] Mini-workshop Materials, AALS Mini-workshop on Teaching the First Gen-eration of Global Lawyers, 1993 AALS Annual Meeting (on file with the Fordham Interna-tional Law Journal)

përballur me problemin e njohjes dhe lirisë së lëvizjes së profesionistëve që prej vitit 1977.Më tej ,në Konferencën Ndërministrore në Pragë(2001) u inkurajua njohja akademike dhe profesionale e diplomave,kurseve,apo titujve me qëllim ushtrimin efektiv të kualifikimeve,titujve apo aftësive në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.Njohja e diplomave kurseve apo titujve është njohje akademike si dhe profesionale.

- Njohja akademike e diplomave apo titujve lejon vazhdimin apo fillimin e cikleve universitare apo post universitare në shtete të ndryshme nga ai i origjinës.
- Njohja profesionale e diplomave diferencon profesionet e rregullura nga profesionet e lira.Si nocion njohja profesionale e diplomave nënkupton lejimin e ushtrimit të profesionit në një vend të ndryshëm nga shteti ku diplomohesh.Në raport me profesionet e lira,profesionet e rregulluara gëzojnë njohje automatike[655].

Duhet vënë theksi te fakti se njohja e përbashkët e kualifikimeve profesionale është një nga drejtimet për të lejuar profesionistët për t'iu përgjigjur globalizimit të shërbimeve[656], qofshin këto edhe ligjore. Në çdo rast njohja e përbashkët e diplomave duhet parë në këto aspekte:

- Njohja e përbashkët e diplomave nuk nënkupton "dhënien e një pune".Kjo është një çështje midis punëmarrësit dhe punëdhënësit.
- Njohja e përbashkët e diplomave shërben edhe për anëtarësimet në organizatat profesionale dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre.
- Njohja e përbashkët e diplomave merr rëndësi në rastet kur profesionisti dëshiron të praktikojë profesionin e tij.
- Mbi të gjitha njohja e përbashkët e diplomave është thelbësore në rastet kur për ushtrimin e profesionit kërkohet një licensë.

Në këtë aspekt,duhet theksuar se njohja e diplomave është parakusht që avokatët shqiptarë të jenë pjesë e studiove ligjore ndërkombëtare duke e ushtruar këtë profesion në shtete të ndryshme nga vendi i origjinës. Kjo sigurisht kërkon:

- Ndryshimin e kurrikulave të arsimit të lartë në drejtësi duke përfshirë në to kurse të së drejtës ndërkombëtare apo të drejtës së krahasuar.
- Licensimi dhe akreditimi i institucioneve arsimore që plotësojne kushtet.

[655] There is also a second group of so-called "automatic recognition". These directives provide for the automatic recognition of diplomas, certificates and other qualifications related to the aforementioned professions, delivered by Member States in so far as they fulfil the minimum training conditions laid doën by Community legislation.
[656] http://www.fig.net/pub/jakarta/papers/ps_05/ps_05_2_plimmer.pdf. Shikuar më 15/03/2013

- Ushtrimi i kompetencave të organeve kompetente në institucionet arsimore private duke i kontrolluar,licensuar dhe akredituar ata institucione që plotësojnë kushtet.
- Implementimi korrekt i Deklaratës së Bolonjës në institucionet e arsimit të lartë,si një proces që në Shqipëri ka nisur në vitin 2007[657].

Ndoshta në një këndvështrim tjetër,më tradicional lëvizja e lirë e avokatëve përbën një qasje të kritikueshme apo ndoshta *non sens* pasi avokatët apo juristët diplomohen në njohuri të cilat relacionohen në pjesën më të madhe në njohuri që lidhen me legjislacionin kombëtar,apo duke u nisur edhe nga paranteza tjetër se një avokat i huaj mund të mos realizojë mbrojtjen në nivelet qe e realizon një avokat "kombëtar".Kjo është një çështje e diskutueshme dhe argumentat nuk mund të jenë kurrsesi ezauruese por le t'ja lëmë këtë vlerësim klientëve të përzgjedhin avokatët e tyre. Vetëm pasi të jetë garantuar lëvizja e lirë e avokatëve mund të diskutohet për të drejtën e themelimit[658] dhe të ofrimit të shërbimeve[659] në një treg unik.

Kufijtë e globalizimit nuk janë kufijtë evropianë por për veçoritë e Shqipërisë është e rëndësishme të prezantojmë parashikimet ligjore si dhe paradigmat mbi lëvizjen e lirë të avokatëve në nivel evropian. Janë tri fazat nëpër të cilat ka kaluar për t'u konfirmuar lëvizja e lirë e avokatëve:

- Faza e I-rë (vitet 1957-1977) e cila filloi në 25 Mars 1957 kur Traktati i Themelimit të Komunitetit Europian sanksionoi në nenet 43 dhe 59 të drejtën e themelimit dhe sigurimit të sherbimeve[660].
- Faza e II-te i referohet Direktives per Njohjen e Diplomave[661]
- Faza e III-të i referohet Direktivës së Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës të 16 Shkurtit 1998 për lehtësimin e praktikes në profesionin e avokatit.

Ndërsa diskutohet për bazën ligjore e cila mundëson lëvizjen e lirë të avokatëve,minimalisht në Hapësirën e Bashkimit Evropian natyrshëm dalin dy probleme:

- Direktivat nuk janë të aplikueshme për avokatët e diplomuar dhe licensuar ne territorin e Republikës së Shqipërisë si një vend i cili nuk i perket ende Bashkimit Europian.Avokatët shqiptarë nuk kanë shtetësinë europiane.
- Ende ka probleme përsa i përket njohjes së diplomave shqiptare në shtetet e tjera.

[657] Deklarata e Bolonjës është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë ne Komunikatën e Londrës(16-18 maj 2007) firmosur nga ministri i atëhershëm i Arsimit dhe Shkencës Z. Genc Pollo.
[658] Sanksionuar ne nenin 43-48 te Traktatit te Komunitetit Europian
[659] Sanksionuar ne nenin 49-55 te Traktatit te Komunitetit Europian
[660] According to the Article 50 of the EC Treaty the term "services"covers: a) activities of an industrial character; b) activities of a commercial character; c) activities of crafts-men; d) activities of the professions.
[661] The Council Directive 89/48/EEC

Këto probleme të integrimit të avokatëve shqiptarë në tregun evropian apo ndërkombëtar të studiove ligjore kanë sjellë edhe vëmendjen e munguar për të trajtuar efektet e globalizmit ne raport me avokatinë shqiptare. Por,mund të thuhet me siguri që shumë shpejtë,ndoshta edhe e papërgatitur avokatia shqiptare do të përballet me shoqërinë globale.Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian,si nje objektiv i kahershëm do të mundësojë profesionistë të huaj të jenë pjesë e ofruesve të shërbimeve ligjore në Shqipëri. Nëse në këtë aspekt,parashikimet të orientojnë drejtë një qasje pozitive për faktin e standardeve të avokatisë që do të përcjellin por edhe tërheqjes së natyrshme të shqiptarëve ndaj profesionistëve të huaj,shpesh edhe duke i mbivlerësuar,a do munden avokatët shqiptarë të ruajnë pozitat e tyre të dominancës në territorin shqiptar nëse ai pasurohet me eksperienca dhe standarde "jo shqiptare"?A do munden këta avokatë,të diplomuar dhe licencuar këtu,me eksperiencë në hapësirën shqiptare të administrimit të drejtësisë të përballen suksesshëm në një treg ndërkombëtar me status të mirëpërcaktuar,kompetent dhe me standarde te tjera?Pikëpyetjet tashmë shtrohen në nivelin teorik si për t'i paraprirë asaj që shumë shpejtë do diktojë rregullimin për një fakt shoqëror ekzistues. Studiot ligjore (të ashtuquajturat *law firm)* përbëjnë një praktikë të konsoliduar tashmë në arenën ndërkombëtare. Janë krijuar nën kuadrin e zbatimit të direktivave mbi shërbimet ligjore,krijimit të njohjes së përbashkët te diplomave,e cila i lejon avokatët të praktikojnë profesionin në shtete të tjera. Zhvillimet e fundit në SHBA,në zbatim të Rekomandimit të Shoqatës Amerikane të Juristëve(ABA) për praktikat multi-juridiksionale të avokatëve të huaj,lejojnë avokatët e diplomuar në një shtet tjetër apo të licensuar të ushtrojnë profesionin pa qenë e nevojshme marrja e certifikimit amerikan. Për më tepër ABA ka insistuar në zbatimin e një Rregulli Model mbi praktikimin e përkohshëm të profesionit të avokatisë e cila lejon angazhimin e përkohshëm të avokatëve me terma te ngjashëm të funksionimit si për avokatët e "brendshëm" . Në nivel evropian,dokumenti i cili legjitimon krijimin e bashkimeve të studiove ligjore është Rekomandimi 2000(21) i Komitetit te Ministrave për Shtetet Anëtare mbi lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatisë[662]. Në përputhje me Rekomandimin avokatët duhet të lejohen dhe inkurajohen në bashkime profesionale lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Studiot e mëdha ligjore kanë kontribuar në forcimin e lëvizjes globaliste dekadat e fundit duke krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore për globalizimin ekonomik. Në këtë mënyrë ato po bëhen institucione globale të cilat kanë nevojë për rregullim. Rregullimi ose më saktë,vetrregullimi është një nga parimet e profesioneve te pavarura. Pikëpyetjet në këtë rast shtrihen mbi kodet deontologjike të dyzuara,pra kodi deontologjik që i përket vendeve të origjinës si dhe vendi ku

[662] Recommendation No.R(2000)21 of the Committee of Ministers to member States on the freedom of the exercise of the profession of lawyers.Adopted by the Committee of Ministerson 25 October 2000 at the 727th meeting of the Minister's Deputies

ushtrohet veprimtaria .Studiot ligjore shqiptare nuk janë të angazhuara në veprimtari ligjore ndërkombëtare. Ligji Shqiptar Nr.9109, datë 17.7.2003,i ndryshuar ”Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë “ sanksionon “Avokati ushtron profesionin e tij individualisht ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë, pasi është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit dhe është regjistruar në organet tatimore.”Avokatët mund të organizohen në zyra avokatie, të cilat regjistrohen në organet tatimore.”[663] Ajo ç’ka vihet re është se ligji shqiptar i referohet me termin “zyrë avokatie” dhe në Shqipëri pak avokatë janë të organizuar në zyra avokatie me disa avokatë.Për më tepër shumë zyra avokatie funksionojnë si bashkime apo “biznese familjare” jo të bazura mbi ndarje të qartë të profileve të çështjeve (penale,civile,administrative) por mbi lidhjet familjare apo fisnore të avokatëve.

Evidentohen dy aspekte:

- Avokatët shqiptarë nuk janë të organizuar në zyra avokatie të përbashkëta të cilat nënkuptojnë më shumë potencial njerëzor dhe financiar çka përkthehet në mundësi më të mëdha për t’u integruar në një treg që i kërkon të dy elementët
- Profilizim dhe specializim jo fortë i qartë i avokatëve në lidhje me çështjet në të cilat shfaqen më tepër kompetentë.Zyrat e avokatisë,edhe pse kanë në përbërje të tyre vetëm 1(një) avokat ofrohen për të gjitha çështjet ligjore,pavarësisht nga profili i tyre.Kohët e fundit është duke u njohur një tendencë e lehtë drejtë specializimit të avokatëve.

Nëse trajtojmë globalizimin në raport me profesionin e avokatisë është e domosdoshme të jemi të qartë mbi avantazhet dhe disavantazhet,kjo përcakton qasjen mbi këtë proces.

3. Avantazhet dhe disavantazhet globalizimit të profesionit të avokatisë .

Globalizimi ka avantazhe dhe disavantazhe. Në përgjithësi globalizmi i profesionit të avokatisë është parë si një trend shumë pozitiv dhe që nxitë konkurrencën midis firmave ligjore në të gjithë botën. Disa nga avantazhet kryesore të globalizmit të avokatisë janë :

i. Globalizimi i profesionit të avokatisë rrit konkurrencën.

Rritja e konkurrencës midis firmave ligjore përmirëson shërbimet ligjore ndaj klientëve duke ofruar shërbime me profesionale dhe me kosto gjithmonë më të përshtatshme.

[663] Ligj nr.9109 datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë “Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9795, datë 23.7.2007 http://qpz.gov.al/botime/permbledhese/Permbledhje%20legjislacioni%20per%20Sistemin%20e%20Drejtesise.pdf

ii. **Globalizimi i profesionit të avokatisë i jep mundësi më të mëdha avokateve të ecin në karrierën e tyre[664].**

Globalizimi i profesionit të avokatisë i jep mundësi më të mëdha avokateve të aftë dhe të talentuar të ecin në karrierën e tyre. Kjo vjen sepse globalizmi zgjeron tregun dhe u jep mundësi të gjejnë klient edhe në shtetet e tjera.

iii. **Globalizimi i profesionit të avokatisë forcon marrëdhëniet me klientët[665].**

Në shumë vende çdo qytetar ka avokatin e tij ose studion e tij ligjore .Midis tyre krijohet një marrëdhënie besimi. Kur këta klient investojnë ose kryejnë veprime juridike të rëndësishme në një shtet tjetër ata mund të përfaqësohen përsëri nga avokati i tyre dhe për të cilin kanë krijuar besim .

iv. **Globalizimi i profesionit të avokatisë pasuron të drejtën dhe praktikën gjyqësore[666].**

Kur një avokat nga një shtet përfaqëson një klient në një vend tjetër ai ka tendencën të përdore praktikën gjyqësore dhe qëndrimet doktrinare e vendit e tij mbi një çështje konkrete duke ndikuar kështu indirekt edhe në zhvillimin e së drejtës dhe doktrinës ne një shtet të caktuar. Pra edhe praktika gjyqësore dhe doktrina kanë marrë dimensionin e tyre global.

v. **Globalizimi i profesionit të avokatisë ule korrupsionin dhe ndikon në krijimit e një sistemi gjyqësor të paanshëm.**

Në vende në trazicion si vendi ynë sistemi gjyqësore mbetet shumë korruptuar dhe avokatët vendas kane lidhje nepotike të forta me gjyqtaret .Ardhja e avokateve nga shtete e tjera duket sikur e shkëput pak këto lidhje dhe ndikon në dhënien e drejtësisë.

Disavantazhet e globalizimit të profesionit të avokatisë

Globalizimit të profesionit të avokatisë nuk ka vetëm avantazhe ,ai ka edhe disavantazhe .Këto disa avantazhe janë :

1) **Globalizimi i profesionit të avokatisë mund të ul cilësinë e shërbimeve ligjore.**

Duhet të biem dakord që sado që avokatët e një shteti të jenë të mirëshkolluar apo të mirëinformuar me praktikën gjyqësore të një shteti tjetër,ata kurrë nuk do të kenë shkallën e njohjes së praktikes gjyqësore të avokateve vendas. Avokat vendas merren me praktikën gjyqësore

[664] Julian,F 2009, *Globalization, Courts, and Legal Profession in India*, < http://select75.org/07.html>. Shikuar :20/03/2013.
[665] Breckon,R 2012, *Globalisation of legal services*, <www.manches.com/.../Globalisation%20of%20legal%20services.pdf > ,shikuar :22/03/2013.
[666] Dezalay,Y& Garth,B (2012),*Lawyers and the Rule of Law in an Era of Globalization*, Routledge,Paris

çdo dite të punës së tyre dhe kështu sigurisht qe janë më të informuar. Nga ana tjetër avokatet që veprojnë ne një shtet tjetër mund të mos jenë azhonuar me të gjitha ndryshimet që i janë bërë legjislacionit kombëtar.

2) **Globalizimi i profesionit të avokatisë mund të dëmtoje rënde studiot ligjore të shteteve me tradite modeste në ketë fushe.**

Shume shtete të dala nga sistemet diktorale nuk kanë shumë tradite në profesionit e avokatisë. Të gjithë avokat janë të rinj në profesion dhe studiot ligjore po bëjnë vetëm pak vite që operojnë në treg. Kështu,këta avokat ose studio e kanë shumë të vështire të konkurrojnë me studiot e mëdha të shteteve të tjera në një treg global.

3) **Globalizimi i profesionit te avokatisë mund të çoje në shërbime ligjore më të shtrenjta.**

Në qofte se një avokat përfaqëson një klient te tij në një shtet tjetër,ai mund të kërkoj një pagese me të madhe sesa një avokat vendas. Kjo sepse kostot e shërbimit të tij janë më të mëdha.Mund të përmendim këtu kostot e transportit ,e akomodimit ne një shtet tjetër,të përkthimit etj.

4.Sfidat e avokatisë shqiptare si pasojë e globalizmit

Globalizimi paraqitet si mundësi ,por edhe si sfidë. Globalizimi e vendos profesioni e avokatisë përballe shumë sfidave dhe vështirësish Praktike. Vështirësitë janë jo vetëm strukturore,por kanë të bëjnë më së shumti edhe me njohjen e sistemeve dhe normave ligjore të shteteve te huaja. Mendohet se vështirësitë e avokateve shqiptar për konkurruar në një treg global lidhen kryesisht me këto pika:

1) Avokatët shqiptar janë pak t familjarizuar me sistemet e tjera të drejtësisë

Në kurrikulat e Fakulteteve të Drejtësisë në vend lëndët me objekt të drejtën e krahasuar janë të pakta në numër dhe zakonisht janë lende që shihen si lëndë dytësore. Në përgjithësi ato janë lëndë me zgjedhje dhe jo të detyrueshme.

2) Avokatet janë pak te informuar me jurisprudence e krahasuar.

Për fat të keq konstatojmë se avokatet në vendin tonë në përgjithësi nuk tregtojnë ndonjë interes të madhe për tu njohur me jurisprudencën e vendeve të tjera. Vitet e fundit ka pasur një rritje të këtij interesi sidomos për jurisprudencën kushtetuese e krahasuar të vendeve si Gjermani,Italia etj,por përsëri njohja me ketë jurisprudence mbetet në nivele modeste. Përveç interesit të munguar,ka edhe probleme të tjera që lidhen pamundësitë për tu njohur me ketë

jurisprudence për shkak se ato nuk janë te përkthyera ne shqip, pamundësitë për ti gjetur online vendimet etj.

3) Shume avokat nuk flasin në nivel të avancuar gjuhë të huaja.

Njohja me praktikën gjyqësore të një shteti,kërkon minimalisht njohuri shumë të mira te disa gjuhëve të huaja pasi praktika gjyqësore është në gjuhën amtare ose në gjuhen Angleze. Prandaj minimalisht është e nevojshme të flasësh shumë mirë Anglishten ligjore,e cila ne kurrikulat e arsimit të larte në një numër shumë të vogël universitetesh publike apo private është praktikuar. Kurrikulat e Drejtësisë orvaten mes përfshirjes se gjuhës angleze,por jo profesionale,çka jep njohuri të komunikimit të përgjithshëm,por jo profesional.

4) Shumica e avokatëve punojnë vetëm dhe të paorganizuar në studio ligjore.

Kohët e fundit avokatët në vendin tonë kanë tendencën të organizohen në studio ligjore ,por ende shumica prej tyre punojnë vetëm. Kështu ata do ta kenë shumë të vështire të konkurrojnë me studio ligjore të mëdha dhe me tradite të vendeve të tjera. Në shumë vende të tjera avokatet janë shumë herë më të organizuar,profilizuar dhe shpesh kanë edhe eksperienca e të punuarit në një shtete tjetër.

5) Studiot ligjore në Shqipëri nuk janë të njohura ndërkombëtarisht.

Studiot ligjore në vendin tonë janë studio të reja dhe nuk njihen në vende të tjera. Kjo e vështirëson se tepërmi gjetjen e klientëve nga vendet e tjera. Nga tjetër shumica prej tyre janë pak të pranishme “online” dhe kështu vështire të kontaktohen nga klientët.

5.rekomandime

Disa rekomandime që kanë si qellim rritjen e aftësisë konkurruese të avokatëve shqiptarë :

1. Duhet të ndryshohen kurrikulat e Fakulteve të Drejtësisë në vend.

Kurrikulat që ofrojnë sot Fakultet e Drejtësisë në vend nuk mund ti përgjigjen siç duhet efekteve të globalizimit. Rekomandojmë që avokatët të jenë të aftë të konkurrojnë në një treg global është e nevojshme të bëhen ndryshme në tre drejtime :e para, duhet të shtohen lëndët me profil të drejtën krahasuese në Fakultet e Drejtësisë .Përsa më sipër,numri i këtyre lëndëve mbetet i kufizuar për te realizuar funksionin .Është e rëndësishme që këto lënde të shtohen në numër dhe ti jepet rëndësia që i takon. Ato nuk duhet të trajtohen thjesht si lënde dytësore ose lënde me zgjedhje. E dyta,duhet që Anglishtja ligjore të jetë një lënde e detyrueshme gjatë gjithë viteve të studimit. E treta,duhet të shtohen programet Master me profil të drejtën e krahasuar.

2. Duhet të nxiten studimet që kanë si objekt jurisprudencën e krahasuar.

Avokatet shqiptar përgjithësisht nuk janë te familjarizuar me jurisprudencën e vendeve të tjera. Kjo më shumë se mungesa e interesit personal për ketë jurisprudence lidhet me faktorë të tjerë si pamundësia për t'u njohur me ketë jurisprudence për shkak të mungesës së përkthimeve në shqip,si dhe pamundësia për ti gjetur online vendimet etj. Në ketë aspekt, duhen gjetur mekanizma për përkthimin dhe shpërndarjen e praktikave gjyqësore të gjykatave të rëndësishme si : Gjykatës Evropiane të Drejtave te Njeriut,Gjykatës së Drejtësisë së Luksemburgut ,Gjykatës Kushtetuese Gjermane etj .

3. Duhet të nxitet organizimi i avokateve në studio ligjore.

Kohet e fundit avokatet në vendin tonë kanë tendencën të organizohen ne studio ligjore ,por ende shumica prej tyre punojnë vetëm. Avokatet që punojnë vetëm e kanë shumë të vështire të veprojnë në treg global.

4. **Duhet të nxitet ofrimi i shërbimeve ligjore online.**

Në shumë vende,studiot ligjore ofrojnë një serë shërbimesh "online". Ofrimi i shërbimeve online nga avokatet shqiptar ndihmon në njohjen e tyre ndërkombëtare .Kushdo që është i interesuar për studio ligjore shqiptare apo që synon të përfshihet në jetën në Shqipëri ka akses mbi shërbimet ligjore që ofron,për të bërë më pas një zgjedhje te informuar. Studiot ligjore në Shqipëri janë studio të reja dhe nuk njihen në vende të tjera. Kjo kufizon mundësitë për gjetjen e klientëve te huaj.

Duhet të nxitet shkëmbimi i eksperiencave midis avokatëve nga vende të ndryshme

Dhoma kombëtare e avokatisë duhet të nxisë shkëmbimin e eksperiencave midis avokateve nga vende të ndryshme. Kjo mund të realizohet me marrëveshje dy paleshe midis dhomave të Avokateve.

5. **Është e nevojshme që të ngrihet sa me shpejt shkolla e formimit vazhdues të avokatëve .**

Kjo shkolle nuk ekziston tani në vendin tonë,por pritet të krijohet së shpejti. Ndryshimet e fundit në ligji nr. 9109, dt.17.07.2003 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" parashikohet si një nga detyrimet parësore të Dhomës Kombëtare të Avokatisë të trajnojë jo vetëm për avokatët e rinj, pra asistentët, por edhe për avokatët aktivë, pra për avokatët që ushtrojnë profesionin në praktikë. Trajnimi profesional vazhdues ligjor për të dyja kategoritë do të jetë një proces sa i detyrueshëm, aq edhe i shtrirë në të gjithë vendin, me qëllimin që kandidatët për t'u bërë avokat (por edhe avokatët në praktikë) të fitojnë dhe të pasurojnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë e tyre profesionale ligjore, teorike dhe praktike. Është shumë e rëndësishme që në këto trajtime që do të realizohen të përfshihet sa më shumë njohja me praktiken e gjyqësore e vendeve të tjera dhe të gjykatave ndërkombëtare. Avokatët duhet të jenë të azhurnuar me zhvillimet ligjore dhe praktikën gjyqësore e vendeve të tjera nëpërmjet procesit të edukimit të vazhdueshëm.

6. Konkluzione

Në termat e një procesi të pashmangshëm globalizimi do të afektojë patjetër edhe avokatinë shqiptare. Afektimi do të jetë në dy nivele:

-Rritja e konkurrencës në ofrimin e shërbimeve ligjore ndërkohë që "tregu ligjor" shqiptar do të ketë pjesë të tijën edhe studio ligjore të huaja (Ndërkombëtare) për profesionistë ligjor të cilët do të zgjedhin si destinacion profesional Shqipërinë.

-Mundësinë e avokatëve shqiptarë për t'u integruar në tregun global dhe për ta ushtruar këtë profesion në shtete të tjera të cilat kanë standarde të tjera të zhvillimit të avokatisë.

Shërbimet ligjore tashmë,por më së shumti pas Integrimit në BE do të përbëjnë një treg të hapur i cili do të konkurrojë mes profesionistësh për të qenë të përzgjedhur prej klientëve. Aktualisht avokatia shqiptare,minimalisht apo aspak mund të jetë në gjendje t'i përgjigjet këtyre sfidave por është detyrë marrja e masave me qëllim që t'i paraprijë këtyre zhvillimeve. Nën këto kushte institucionet përgjegjëse duhet të marrim masa konkrete dhe ti paraprijmë këtij procesi. Duhen marrë masa që avokatët shqiptarë të jenë në gjendje të konkurrojnë në një hapësirë Evropiane dhe më gjerë sesa kaq në të ardhmen e afërt. Nga ana tjetër avokatët shqiptar duhet të jenë të ndërgjegjshëm për efektet e globalizimit dhe duhet të përgatisin veten për të qenë konkurrues në një hapësire globale. Për të qenë konkurrues në hapësirën globale,avokatët duhet të jenë të azhornuar jo vetëm me praktikën gjyqësore në Shqipëri por edhe praktikën ndërkombëtare. Tregu shqiptar i avokatisë sot ndoshta është përballë konkurrencës duke nisur nga numri i lartë i të licencuarve për të ushtruar profesionin e avokatit privat por globalizimi do ta çojë konkurrencën në një nivel tjetër:konkurrencë mbi kritere aftësie,rezultatet e të cilës do të maten nëpërmjet përzgjedhjeve të klientëve. Globalizimi i profesionit të avokatisë nuk është një proces i parëndësishëm,të kujtojmë që afekton ndoshta gjithë sistemin e drejtësisë duke reformuar kështu një subjekt esencial të proceseve gjyqësore. Institucionet përgjegjëse,duhet të marrin masat përkatëse por edhe avokatët duhet të jenë të vetëdijshëm në angazhimin personal pasi mbi të gjitha afektohen ata dhe profesioni i tyre. Gradualisht studiot ligjore shqiptare duhet të tejkalojnë synimin për një treg klientësh "të njohurish" duke paravendosur synimin për status ndërkombëtar të studios ligjore ku ata bëjnë pjesë. Globalizimi mes të tjerash i jep mundësinë avokatëve për të hyrë në tregun botëror të avokatisë,të bashkohen me firmat ligjore shumëkombëshe ,të praktikojnë profesionin e tyre në juridiksione të shumëfishta. Globalizimi kërkon angazhim profesional në nivelin e një sfide por mbi të gjitha duhet konsideruar mundësi për t'u konfirmuar si profesionist në

një treg merite si dhe mundësi për të rikonfirmuar rolin e avokatit në Shqipëri,si ndikues në Shtetin e së Drejtës,Sistemin e Drejtësisë dhe mbrojtjen e të Drejtave te Njeriut.

Bibliografia:

Burime parësore :

Ligj nr.9109 datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" Ndryshuar me ligjin nr.9795, datë 23.7.2007,me ligjin nr.10047, datë 24.12.2008 ,me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 12.3.2010 366

*The independence of the legal profession in a globalised economy – an Australian perspective***.**Speech given by Tim Bugg, President, Law Council of Australia at the Commonwealth Law Conference, Nairobi.11 September 2007

Report on the recognition of diplomas and study programs,the national plan for diploma recognition. This report has been structured as requested by the model approved in Vienna by "Bologna Follow Up Group" on 07.04.2006.

*Report of the Committee on Current Issues in Private Practice and the Future of the Profession.*June 2011

*Recommendation No.R(2000)21 of the Committee of Ministers to member States on the freedom of the exercise of the profession of lawyers.*Adopted by the Committee of Ministerson 25 October 2000 at the 727th meeting of the Minister's Deputies

*Report provided to the Alfred P. Sloan Foundation by the Harvard Law School Center on Lawyers and the Professional Services Industry.*Overview of the professionals services industry and the legal profession

Burime dytësore :

Dezalay,Y& Garth,B (2012),*Lawyers and the Rule of Law in an Era of Globalization,* Routledge,Paris

.Directorate General of Human Rights and Rule of Law ,2012 *Eastern Partnership Enhancing Judicial Reform in the Eastern Partnership Countries* **,** Strasbourg.

Višinskis,V&Žalėnienė,I& Tvaronavičienė,A (2008),*Legal environment within the EU:Free movement of lawyers and legal services,*Verslas: teorija ir praktika, 2009, 10(1): 30–37issn 1648-0627 print/ issn 1822-4202 online

Flood,J.(2011)*The re-landscaping of the legal profession: Large law firms and professional regulation,*Current Sociology 59(4) 507–529

Hutchinson, T. (2006) *Educating the Transnational Lawyer: Globalisation and the Effects on Legal Research Skills Training* . In Proceedings Australasian Law Teachers Association - ALTA, pages pp. 1-24, Melbourne Victoria Australia.

Aronson,E,B. *Elite Law Firm Mergers and Reputational Competition: Is Bigger Really Better? An International Comparison.* Vanderbilt journal of transnational law [Vol. 40:763

Stephanie Chieh-Ying Chong.(2009)*The Anthropomorphization of Law: Fictional Judges and Lawyers in Contemporary North American and European Settings.* A thesis submitted in conformity with the requirements for the degree of Doctor of Philosophy Centre for Comparative Literature University of Toronto

Yves Dezalay and Bryant G. Garth, *Corporate Law Firms, NGOs, and Issues of Legitimacy for a Global Legal Order*, 80 Fordham L. Rev.2309 (2012).Available at:http://ir.lawnet.fordham.edu/flr/vol80/iss6/

Faulconbridge,R& Beaverstock,J & Muzio,D& Taylor ,P.*Global Law Firms: globalization and organizational spaces of cross-border legal work.* Published in Northwestern Journal of International Law and Business28 (3) 455-488.

Claessens,S. (2008)*Free Movement of Lawyers in the European Union.* Wolf Legal Publishers ISBN 978-90-5850-397-8

Avocats sans frontières (asf) *Justice in a Globalised Economy: A Challenge for Lawyers Corporate Responsibility and Accountability in European Courts* March2011

Owasanoye,B.*Globalised curriculum for global lawyers.*February 2004

Papa, M& Wilkins,D.*Globalization,Lawyers and India:Toward a theoritical synthesis of globalization studies and the sociology of the legal profession.*International Journal of the Legal Profession

Boon,A& Flood.*Globalization of Professional Ethics?The significance of lawyer's international Codes of Conduct.*Legal Ethics,Volume 2,No 1

Marais Du B(2012) *Training Lawyers for a globalized world in economic crisis.*Journal of Legal Education ,Volume 6,No 3,February 2012

Chesterman,S (2008) *The globalisation of legal education* .Singapore Journal of Legal Studies[2008] 58-67

Matias,Sh. *Globalization, International Law, and The StateDeputy* Presented as Keynote Speech On October 17, 2008 at the Georgetown University Law Center's event on Globalization

Terry,L.(2008) *The Legal World Is Flat: Globalization and Its Effect on Lawyers Practicing in Non-Global Law Firms*

Daly,M.*The Ethical Implications of the Globalizationof the Legal Profession: A Challenge to theTeaching of Professional Responsibility in theTwenty-First Century.* Fordham International Law JournalVolume 21, Issue 4 1997 Article 4

Terry,L&Mark,S&Gordon,T.*Trends and Challenges in Lawyer Regulation: The Impact of Globalization and Technology.*Fordham Law Review,Volume 8,Issue 6 ,Article 13

Faqe interneti :

Breckon,R 2012, Globalisation of legal ervices,<www.manches.com/.../Globalisation%20of%20legal%20services.pdf

Lum,R 2006,*The Globalization of the Legal Profession.*<http://www.lawcrossing.com/article/4186/The-Globalization-of-the-Legal-Profession/# > .

Julian,F 2009, *Globalization, Courts, and Legal Profession in India*, < http://select75.org/07.html>.

Këndvështrimi historik dhe juridik i minoritetit grek në Shqipëri në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare

Estela Hoxha[1], Etleva Goxhaj[2]
[1]Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
[2]Fakulteti i Histori-Filozofisë, Universiteti i Tiranës

Historikisht ka pasur një debat në lidhje se çfarë kuptohet me termin "minoritet". Në rrethet shkencore botërore është shprehur hërë pas here mendimi se kjo mungesë ka kushtëzuar në një masë të konsiderushme edhe sjelljet e shteteve ndaj tyre. Studimet për të përcaktuar termin"minoritet" kanë hasur në shumë pengesa, një pjesë e të cialve rrjedh nga shumëllojshmëria e identiteteve të individeve që përbëjnë komunitet minoritare, dhe nga faktorët që ndikojnë mbi secilin prej tyre. Për kompleksitetin e tyre këto çështje mund dhe duhet të studiohen në disa drejtime, por në këtë kumtesë do të trajtojmë vëtëm çështjet që kanë të bëjnë më karakterin historik dhe atë juridik. Si çështje me karakter historik, minoritetet janë një bashkësi individesh që u nënshtrohen ndryshimeve gjatë periudhave të ndryshme kohore. Si të tillë, kjo bashkësi krijon historinë e saj, e cila lidhet me historinë e shtetit në të cilin jeton, ashtu dhe me historinë e shtetit amë. Si çështje me karakter juridik, minoritet përbëhen nga individë, të cilët si të tillë, por edhe si qytetarë të një shteti, kanë të drejtat e tyre.[667]

Në territorin e Shqipërisë jetojnë disa minoritete të cilat kategorizohen në; minoritete etnike dhe kulturore. Është njohur si minoritetet etnik vetëm minoriteti grek. Pjesa dërrmuese e saj jeton në jug të vendit, në 40 fshatra të rrethit Gjirokastër, 35 fshatra të Sarandës, 16 fshatra të Delvinës dhe 3 fshatra të Përmetit. Pakica kombëtare greke është pakica e parë e njohur nga shteti shqiptar dhe mund të thuhet se çështja e pakicave kombëtare në Shqipëri ka qenë identifikuar për një kohë të gjatë me pakicën greke.

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore, bashkë me shkatrimin përfundimtar të perandorive shumëkombëshe, shënoi përfundimin e procesit të krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan. Çështja e mbrojtjes së minoriteteve në shtetet e vogla ballkanike zuri një vend të rëndësishëm në diskutimin e të Mëdhenjve.[668] Rendi i Ri Botëror i krijuar pas kësaj situate synonte të krijonte një sistem të ri vlerash dhe parimesh, midis të cilave edhe parimin e vetëvendosjes të iniciuar nga presidenti amerikan Uidrou Uillson. Parimi i vetëvendosjes kishte parasysh sigurimin e një paqeje

[667] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integrimit 139-1949*, Tiranë: Kristalina-Kh, 2012, f. 32.

[668] Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: Shtëpia Botuse e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999, f.218

të qëndrushme në një botë ku drejtësia të garantohej për të gjithë kombet, të mëdhenj apo të vegjël qofshin ata.[669]

Në Ballkan dështoi politika e përcaktimit të kufijve të shteteve ballkanike në bazë të parimit të kombësisë dhe të vetvendosjes. Arsyet duhen kërkuar sa te interest gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha, të cilat favorizonin njërin apo tjetrin shtet të ri, në bazë të preferencave të tyre, aq dhe te mungesa e kritereve të qarta dhe të pakundërshtushme mes dallimit të kombeve dhe të minoriteteve. [670]

Numri i lartë i minoriteteve që u krijua brenda Ballkanit u bëri të qartë shumë prej liderve ndërkombëtarë se paqja e ardhshme e rajonit, si dhe konsolidimi i brendshëm i shteteve ballkanike, varej nga marrëdhëniet që do të krijonin ato me minoritetet e tyre.[671] Lidhja e Kombeve, ishte i pari organizëm ndërkombëtar, që krijoi një sistem për mbrojtjen e minoriteteve. Ajo detyroi shtetet e krijuara rishtazi, si dhe shtetet të cilat kishin zgjeruar territorin, që të angazhoheshin juridikisht duke nënshkruar dokumente të veçanta për mbrojtjen e minoriteteve.[672]

Shqetësimi i shtetit Shqiptar në lidhje me minoritetet fillon që me shpalljen e pavarësisë. Edhe pse në fillesat e tij, shteti Shqiptar i cili ishte një shtet i dobët si ekonomikisht edhe politikisht, u përpoq që të shmangte mosmarrëveshjet dhe konfliket e brendshme etnike. Politikanët e kohës u përpoqën t'u garantonin minoriteteve të drejta të pranuara ndërkombtarisht, me shpresën se vetëm kështu do të pengonin shtetet e tyre amë të destabilizonin vendin. Kështu, pas shpalljes së Shqipërisë si "principatë autonome e pavarur, e trashëgushme dhe neutrale, nën garancinë e Fuqive të Mëdha" nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (29 korrik 1913) dhe vendosjes së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit[673]u hartua dhe u miratua Statusi Organik i Shqipërisë.[674] Minoritet nuk përmëndeshin në mënyrë specifike në të. Statusi njihte si gjuhë zyrtare gjuhën shqipe, por lejonte përdorimin dhe të gjuhëve të tjera që fliteshin në vend[675] , duke i dhënë kështu *de fakto* të drejtën edhe minoritetit grek, i cili ishte i vetmi që kishte kaluar në përbërje të territorit shqiptar, të përdorte lirshëm gjuhën e tij për arsimim, në administratë dhe në jetën e përditshme.

Pas ardhjes së princ Vidit, qeveria e kryesuar nga Turhan pashë Përmeti e cila kishte si qëllim dhe detyrë kryesore të shtrinte juridiksionin e saj në të gjitha territoret që i ishin njohur shtetit shqiptar nga Konferenca e Londrës, ju desh të përballonte përveç vështirësive të shumta edhe ndërhyrjen e fqinjës së saj jugore , Greqisë. Qeveria greke organizoi në krahinat jugore të

[669] Henry Kissinger, *Diplomacia*, f. 221
[670] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f. 29.
[671] *Po aty*.
[672] Dhimitër Berati, *Qëllimi dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë, Mosonjtorja 1931, f.15
[673] Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f.61
[674] *Historia e Popullit Shqiptar III* , Akademia e Shkencave e Shqipërisë , Tiranë : Toena, 2007, f. 59
[675] Arben Puto, *vep. e cit*, f.128

vendit të ashtuquajturën "Lëvizje të autonomisë vorio-epirote", e cila përfundoi me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit më 17 maj 1914.[676] Sipas këtij protokolli, dy prefekturat jugore të Shqipërisë do të gëzonin një administratë gjysmëautonome. Nënpunësit e lartë do të ishin vendë s, xhandarmëria do të ishte lokale, komunitet fetare njiheshin si persona juridikë, ortodoksët lejoheshin t'i dërgonin fëmijët në shkollat greke dhe gjuha shqipe do të mësohej në tri klasat e para fillore. Në administratë do të përdorej edhe shqipja, edhe greqishtja.[677]

Lufta e Parë Botërore zbehu edhe ato suksese të brishta që kishte arritur shteti shqiptar. Pas mbarimit të luftës më 25 dhjetor 1918, një Asamble e Përgjithshme Kombëtare e mbledhur në Durrës krijoi një qeveri të përkohshe.[678] Në programin e saj qeverisës, ajo kishte disa synime kryesore ku midis të tjerave ishte sigurimi i të drejtave të minoriteteve, në mënyrë të pajtueshme me të drejtat e sovranitetit të shtetit shqiptar. Kjo do të thoshte që shteti shqiptar , pa cënuar pavarësinë, integritetin dhe sovranitetin e tij, do të merrte të gjitha masat t'u garantonte minoriteteve të drejtat e tyre. [679]Qeveria e Durrsit nuk u njoh nga asnjë prej Fuqive të Mëdha, kështu që për çështjen e statusit të Shqipërisë do të vendosete Konferenca e Paqes në Paris.[680]

Në Konferencën e Paqes kufijë e Shqipërise u vunë sërish në diskutim. Në këto kushte kur shteti shqiptar rrezikonte të humbiste gjithcka, dukej krejtësisht absurde të flitej për çështjen e mioiriteteve në Shqipëri. Por në rrjedhjen e ngjarjeve, delegacionit zyrtar shqiptar do t'i duhej të përballej me situata në të cilat duhej të merrte angazhime ndaj minoriteteve. Kështu në përballjen greko-shqiptare, minoriteti u shndërrua në kryefjalën e ditës. Kryeminsitri grek Elefteros Venizello kërkoi të zhvilloheshin bisedime me Italinë[681], në mënyrë që të gjendej një marrëveshje për pretendimet greke në Shqipërinë e Jugut, apo siç i referohej ai "Epirin e Veriut".[682] Sipas kryeministrit grek, pretendimet greke bazoheshin në kritere etnike. Ai i mëshoi faktit se të krishterët në shqipëri persekutoheshin nga muhamedanët. Në memorandumin e delegacionit shqipatar hidheshin poshtë të gjitha pretendimet e pabaza të kryeministrit grek duke theksuar se statistikat e përmëndura nga grekët për të mbështetur kërkesat e tyre në shqipëri kanë bazë të gabuar. Delegacioni shqiptar nuk harroi të përmendte kujdesin e shtetit shqiptar për minoritetet. Delegacioni garantoi Konferencën se Shqipëria do të bënte detyrë të vetën që të jetojë në bashkim të plotë me një shpirt tolerance sa më të gjerë, duke ju dhënë minoriteteve të huaja të gjitha të drejtat që ju njihen në vëndet më të përparuara në qytetërim.[683]

---

[676] *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 62
[677] Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë; KRISTALINA-KH, 2007, f. 67
[678] *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 127-128.
[679] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f.53
[680] *Historia e Popullit Shqiptar III*, f.129-130
[681] *Po aty*, f. 131
[682] Margaret Macmillan, *Paris 1919. Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë : Plejad, 2006, f. 412
[683] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f. 56

Për të shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga qeveria greke si dhe pretendimet e shtetit shqiptar u ngrit një komision i cili u quajt Komisioni për Çështjet Greke dhe Shqiptare. Peshën kryesore për palën shqiptare para Komisionit e mbajti Dr. Mihal Turtulli. Ai foli si i krishterë, si korçar dhe si shqiptar duke hedhur poshtë pretendimet e palës greke se ndërgjegjia e banorëve të krishterë të Korçës ishte greke. Ai ishte shembulli i gjallë që e kundërshtonte këtë. Ai ishte i krishterë, i shkolluar në shkollat greke, por ndihej shqiptar, ashtu si dhe të gjithë bashkëqytetarët e tij të krishterë.[684] Anëtari tjetër i delegacionit Mehmet Konica kundërshtoi vlefshmërinë juridike të Protokollit të Korfuzit, të cilët përfaqësuesit grekë e kishin përmendur shpesh gjatë seancave. Ai theksoi se Protokolli i Korfuzit nuk mund të ishte dokumenti ku do të bazohej mbrojtja e minoriteteve në Shqipëri.[685] Baza juridike e regjimit të minoriteteve do të lidhej me Lidhjen e Kombeve. Konferenca e Paqes i mbylli punimet pa dhënë vendime për statusin dhe kufijtë e shtetit shqiptar. U vendos se të gjitha çështjet e lëna pezull do të diskutoheshin dhe vendoseshin në marrëveshje dypalëshe apo në një nga organizmat që u krijuan nga Konferenca e Paqes: Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadorëve.

Vullnetin e shqiptarëve për një shtet tërrësisht Sovran e shprehu Kongresi i Lushnjës. Qeveria shqiptare e dalë nga ky kongres i kushtoi vëmëndjen e duhur situatës së krijuar.[686] Në nëntor 1920, kjo qeveri paraqiti kërkesën për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Kjo do t'i jepte shtetit shqiptar njohje kolektive dhe do ta ndihmonte në zgjidhjen përfundimatre të statusit të saj ndërkombëtar.[687] Ndërsa në Konferencën e Paqes minoritetet ishin shprehje periferike, në Lidhjen e Kombeve Shqipërisë iu desh të përballej më fuqishëm me këtë çështje. Asambleja e Lidhjes së Kombeve u kishte kërkuar disa shteteve midis të cilave edhe Shqipërisë, të cilat pretendonin të bëheshin anëtare të saj, të merrnin masat e domosdoshme që në frymën e traktateve të Lidhjes së Kombeve mbi minoritetet, të rregullonin legjislacionin e brendshëm.[688]Qeveria shqiptare u tregua e gatshme ta paranonte këtë kusht. Nënshkrimi i deklaratës për mbrojtjen e minoriteteve nuk ishte kusht për parnimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por Shqipëria i në nshkroi pa asnjë kundërshtim . Më 2 tetor 1920, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare pranë Lidhjes së Kombeve Fan Noli nënshkroi Deklaratën për Mbrojten e Minoriteteve.[689] Ai deklaroi se qeveria e tij do të merrte parasysh çdo rekomandim që mund t'i bëhej për minoritet nga Lidhja e Kombeve. Deklarata përmban 8 artikuj ku të gjitha i kushtohen minoriteteve. Kjo deklaratë parashikonte që

[684] Arben Puto, *Shqipëria Politike*, f.237
[685] *Po aty*, f.238
[686] *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 145-146
[687] Arben Puto, *Shqipëria Politike*, f.287
[688] Ledia Dushku, "*Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922)*, Studime Historike, 3-4, Tiranë: 2006, f.76
[689] Arkivi i Ministrisë të Punëve të Jashtme (më tej AMPJ), viti 1920, dosja 74, f.31. League of Nation. Protection of minorities in certain states Seeking admission to the League of Nation, 15 December 1920.

qeveria shqiptare t'u njihte minoriteteve që jetonin në Shqipëri të drejta të barabarta me ligj dhe me fakt me të gjithë shtetasit e tjerë. Ajo gjithashtu përmbante dispozita për garantimin e së drejtës së minoriteteve për të përdorur dhe mësuar gjuhën e tyre amtare, lirinë e besimit dhe të ndërgjegjies, si dhe mbajtjen e shoqatave të tyre të bamirësisë.[690]

Duke qenë se çështjet në lidhje me pakicat rregulloheshin me këtë Deklaratë, e cila si akt ndërkombëtar kishte përparësi ndaj atyre kombëtare, nuk u përfshinë në të norma specifike për minoritetet, gjë që do të thoshte që çështjet që do të lidheshin me statusin e minoriteteve rregulloheshin në bazë të parimeve të Deklaratës.[691]

Në një kohë kur shtetet fqinje ushtrinin trysni mbi qeverinë shqiptare për të sigurauar të drejtat maksimale për minoritetet e tyre në Shqipëri, popullsisë shqipate në Jugosllavi dhe Greqi nuk iu ishin garantuar as të drejtat minimale të jetës dhe të pronës.[692] Në këto kushte minoritetet u bënë shpesh herë objekte diskutimi dhe fërkimesh në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me qeveritë fqinje. Gjatë vitit 1922, qeveria shqiptare ndërmori një studim për të parë gjendjen e minoriteteve dhe shkallën e së drejtës së tyre. Rezultatet e e ktij studimi ishin se në shqipëri jetonin minoritetet greke, malazeze dhe vllahe, të cilat në përputhje me dispozitat e deklaratës së 2 tetorit 1922, kishin shkolla në gjuhën e tyre amtare si dhe institucione të pavaruara. Antarëve të minoritetit i'u ishin dhënë mundësi të barabarta për punësim në institucionet shtetërore, madje dhe e drejta e përfaqësimit në paralamntin shqiptar.[693]

Minoritet vazhduan të ishin një çështje problematike dhe gjatë periudhës kur shteti shqiptar drejtohej nga Ahmet Zogu qoftë si president apo si mbret. Ahmet Zogu si president që në janar 1925, rikonfirmoi deklaratën zyrtare që kishte bërë në vitin 1921 para Lidhjes së Kombeve se njihte minoritetin grek në Shqipëri duke u angazhuar që sipas noramave juridike ndërkombëtare të respektonte në bazë të reciprocitetit, të drejtat e tij. Minoriteti grek vazhdoi të kishte të drejtë të zgjidhte deputetët e tij në parlamentin shqiptar, të hapte shkolla në gjuhën greke, mësuesit e të cilave paguheshin nga qeveria shqipare, të ushtronte lirisht fenë e tij etj.[694]

Lufta e Dytë Botërore solli ndryshime në statusin e minoriteteve. Sistemi i mbrojtjes juridike i krijuar nga Lidhja e Kombeve *de fakto* pushoi së ekzistuari bashkë me këtë organizatë.[695] Fillimi i Luftës së Dytë Botërore prishi *stausquo*-në politike të vëndosur nga Traktai i Versajës i vitit 1919. Shtetet Ballkanike të cilat kishin mbetur të pakënaqura nga përcaktimi i kufijve në përfundim të Luftës së Parë Botërore e konsideruan fillimin e luftës së re si mundësi për të ndrequr

[690] AMPJ, Viti 1921, dosja 87, f. 178
[691] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f. 63
[692] *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 499
[693] Dhimitër Berati, *Qëllimi dhe organizimi..*, f.26
[694] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f. 68
[695] Sonila Boci, *Minoritetet në Shqipëri*, f.73

"padrejtësitë" territoriale dhe etnike. Kjo i dha Luftës së Dytë Botërore në Ballkan një karakter të shumfishtë të përcaktuar si katër konflikte brenda një lufte.[696]

Minoritetet me ose pa dashje e gjetën veten e tyre të përfshirë në secilën prej këtyre konflikteve. Mbi të gjitha ato u gjendën mes dilemës se cilit prej llojeve të identitetit duhej t'i jepnin rëndësi: identitetit të tyre kombëtar apo identitetit të tyre qytetar. Si pjesë e shkëputur nga trungu i vet kombëtar, minoritetet kombëtare ruanin në ndërgjegje ndjesinë se besnikëria e tyre duhej t'i përkushtohej kombit amë. Nga ana tejtër, kushtetuta e vendit ku jetonin dhe shumë akte ndërkombëtare i detyronin minoritetet të ishin qytetarë luajalë ndaj shtetit nën juridiksionin e të cilit ata ishin përfshirë.[697]

Periudhën gjatë Luftës së Dytë Botërore po e anashkalojmë për faktin se qeveritë e asaj kohe ishin kolaburacioniste dhe si pajojë antarët e këtyre qeverive nuk bënin dot politika direkte në lidhje me minoritet, kështu që në një farë mënyre përgjegjësia është e ndarë së bashku me pushtuesit, por nga ana tjetër qëndrimi që mbajti minoriteti gjatë luftës ishte i dyzuar. Duke u nisur nga këto fakte po bëjmë një kalim të kësaj periudhe, sepse mendojmë që është periudhë që do diskutim më vete.

Ende pa mbaruar lufta, në bisedimet për përgatitjen e projektit të Kartës së OKB-së, mbizotroi pikëpamja se sistemi i mbrojtjes së minoriteteve, i krijuar nga Lidhja e Kombeve, kishte shumë pika të dobta dhe duhej të ndryshohej në mënyrë radikale. Debati u përqëndrua në çështjen nëse duhej komuniteti ndërkombëtar të angazhohej për mbrojtjen kolektive të të drejtave të minoriteteve apo theksi duhej të vihej te garantimi i lirive themelore të individit. Fitoi opsioni i dytë. Në Konferencën e Potsdamit 1945 u fol vetëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe për vendosjen funksionale në botën e pasluftës. Ky ishte një vision i ri ndaj statusit të minoriteteve , që i bënte ata qytetarë të barabartë në shtetin ku jetonin, me të njëjta të drejta, por edhe me të njëjtat detyrime.

Minoriteti grek ka qenë vazhdimisht në fokus të qeverisë komuniste e cila erdhi në pushtet fill pas lufte. Në kushtetutën e saj qeveria komuniste e kohës sanksionoi akte të shumta ligjore në favor të këtij komuniteti. Kështu shteti shqiptar hapi rrugën dhe krijoi kushte për integrimin e minoriteteve në jeten politike, ekonomike dhe kulturore të vëndit duke i pranuar ata si shtetas me të drejta të barabarta. Ruajtja e identitetit kombëtar për të gjitha minoritet që jetonin në Shqipëri u sanksionua dhe në Statusin e RPSH-së të vitit 1946. Sipas këtij statusi pakicat nacionale në Republikën Popullore të Shqipërisë kanë të gjitha të drejtat, mbrojtjen e zhvillimin kulturor të tyre dhe përdorjen e lirë të gjuhës së tyre.[698] Gjithashtu shteti shqiptar u angazhua për sigurimin e

[696] *Po aty*, f.74
[697] *Po aty*
[698] Asambleja Kushtetuse. *Statusi i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë:Bashkimi, 1946, neni 32, f.12.

elemntëve bazë për ruajtjen e identitetit kombëtar. Me gjithë mangësitë dhe të metat që mund të vrehen në këtë proces , shteti shqiptar krijoi mundësi për shkollimin në gjuhën amtare dhe ruajtjen e kulturës tradicionale të minoritetit. Po ashtu, shteti shqiptar ndërmori politika që eleminonin ndasitë etnike në vend. Ajo që është lehtësisht e konstatushme në politikat e shtetit shqiptar ndaj minoritetit është ndërthurja e politikave integruse me ato për ruajtjen e identitetit etnik kombëtar të minoritetit. Këto politika u zhvilluan njëkohësisht dhe shpesh u alternuan me njëra-tjerën.

Udhëheqja e lartë e asaj kohe e dinte mirë që minoriteti grek, do të ishte "thembra e Akilit" në lidhje me fqinjin e saj jugor, kështu që qeveria komuniste u impenjua tërësisht në këtë çështje. Arsimimi i minoritarëve në gjuhën amtare, si dhe përdorimi i saj si në mjdiset publike ashtu dhe ato private, u konsideruan si shtylla të forta të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit kombëtar të minoritetit. Një nga masat e para që mori qeveria shqiptare ishte hapja e shkollave në zonat minoritare.[699] Gjithashtu qeveria shqiptare lejoi përdorimin e gjuhës greke si në mjediset publike, ashtu dhe në administratën shtetërore lokale.

Me ndryshimet demokratike në Shqipëri pas viteve 90', trajtimi i pakicave kombëtare mori një dimesion të ri i cili shprehet qartë në antarësimin e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare si OKB, Këshilli i Evropës etj, në ratifikimin apo aderimin në pothuajse të të gjitha konventave ndërkombëtare për të drejtata e njeriut dhe në mënyrë të vëcantë në ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër për Mbrotjen e Minoriteteve Kombëtare e cila është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 29.06.1995. Ajo është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin 8496, datë 3.06.1999 dhe, pas dorëzimit të instrumentave të ratifikimit më 28.09.1999, ka hyrë në fuqi më 01.01.2000.

Respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare qeveria shqiptare e konsideron si një detyrim që buron nga orientimi themelor i Republikës së Shqipërisë për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat dhe liritë themelore të individit. Këto të drejta dhe liri janë sankionuar nga Kushtetuta dhe te legjislacioni në fuqi, si dhe te konventa në përputhje me standaret ndërkombëtare. Qeveria shqiptare konsideron respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombetare dhe si një element thelbësor që i shërben krijimit të urave të miqësisë midis popujve dhe vendeve fqinjë, si dhe integrimit të saj të plotë në Evropë.

Përfundim

Gjatë gjithë periudhës së krijimit të shtetit shqipatar që me shpalljen e pavarësisë dhe në vazhdim, mund të themi me bindje se të gjitha qeveritë i kanë kushtuar kujdes dhe vëmendje të

[699]AMPJ, Viti 1946, dosja.6, fl. 60, Statistika të shkollave minoritare.

vecantë trajtimit të minoriteteve në vend, por veçanërisht atij gek. Të gjitha aktet ligjore që kanë hartuar qeveritë kanë pasur zbatim praktik.

Qveria komuniste e cila qëndroi më gjatë në pushtet megjithë mangësitë që vrhen i siguroi disa lëshime minoritetit grek. Me Vendimin nr. 7 të Byrosë Politike të PPSH-së, i janarit 1950, e vendosi minoritetin grek në RP të Shqipërisë nën një *diskriminim pozitiv* të shtetit, veçanërisht në fushën ekonomike, gjë që i siguroi minoritetit grek, por edhe minoriteteve të tjera, në raport me popullsinë shqiptare, një standart relativisht më të lartë jetese.

Sot me nënshkrimet e akteve ndërkombëtare që kanë bërë qeveritë demokratike dhe me ratifikimet e tyre, minoritetet gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Bibiografia

Arkivi i Ministrisë i Punëve të Jashtme *Literatura*

Asambleja Kushtetuse. *Statusi i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë:Bashkimi, 1946,

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Historia e Popullit Shqiptar* III Toena. Tiranë, 2007

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Insituti i Historisë. Ledia Dushku, "*Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922),* Studime Historike, 3-4, Tiranë: 2006

Berati, Dh. Qëllmet dhe Organizimi i Lidhjes së Kombeve (Botuar prej Sekretaria e Lidhjes së Kombeve)." Mbrothësia". Tiranë, 1931

Boci, S. Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integrimit 139-1949, Tiranë: Kristalina-Kh, 2012

Duka , V. *Historia e Shqipërisë 1912-200*. Shblu. Tiranë, 2007

Macmillan, Margaret. Paris 1919. Gjashtë muaj që ndryshuan botën, Tiranë : Plejad, 2006,Kissinger, H. *Diplomacia.* Shblu. Tiranë, 1999

Puto, A. *Shqipëria Politike* 1912-1939. Toena. Tiranë, 2009

Të drejtat e fëmijëve në të drejtën ndërkombëtare

Ma. Klevis Mustafaj[1], Msc. Arjola Mita[2]

[1]Department of Law, Bedër University, Albania

[2]Faculty of Law, University of Tirana, Tirane, Albania

Abstrakt

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në vitin 1989, duke u bërë kështu, mjeti dhe qëllimi kryesor i mbarë botës, për të siguruar mirëqenien e fëmijëve. Kjo konventë është ratifikuar nga 191 shtete të botës, ndërmjet tyre edhe vendi ynë, fakt që tregon se ajo është një nga dokumentet ligjorë dhe politikë më të pranuar nga shumë qeveri, si dhe duke dëshmuar që çështja e respektimit të të drejtave të fëmijëve, sot përbën një nga objektivat parësorë dhe thelbësorë për to.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për të cilat, sot, në kohët moderne flitet shumë, në fakt burojnë fillimisht nga të drejtat e fëmijëve, pasi një shoqëri bashkëkohore e cila respekton të drejtat njerëzore të fëmijëve, ka respektuar të drejtat e njeriut.

Qëllimi i këtij punimi është rëndësia që përcjellin dispozitat e parashikuara në "Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve" dhe në "Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut" duke i mbrojtur të drejtat e fëmijëve në mënyrën më efikase të mundur.

Për te realizuar ketë punim akademik janë referuar një sere botimesh te ndryshme artikujsh, Konventa Evropianë për te Drejtat e Njeriut, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve si dhe Karta e OKB së bashku me dy protokollet e saj shtesë.

Fjale kyçe: *Konventa,i mitur,të drejtat e njeriut,karta e OKB.*

‘‘Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij’’.

1. Hyrje

Diskutimi për të drejtat e fëmijëve nganjëherë është një temë e çuditshme. Në të parë, të gjithë do të pajtoheshin mbi të drejtën për banim, për të jetuar me familje dhe shokë, për mundësi të zhvillimit të personalitetit dhe talentit, që të jetë i respektuar dhe të trajtohet seriozisht. Prapëseprapë, edhe pse të drejtat e fëmijëve duken mjaft të rregulluara, ka shumë probleme në zbatimin e tyre. Dikur, pyetjet e ngritur për përgjegjësinë e realizimit të këtyre pikësynimeve, të formuluara si të drejtat e detyrueshme të fëmijëve, janë mbyllur. Garantimi i të drejtave të njeriut për fëmijët nuk krijon një grup shoqëror të“privilegjuar”. Përkundrazi, është një parakusht për ngritjen e statusit të tyre në shoqëri në një shkallë që të mund të mbrojnë interesin e tyre në hapa të njëjtë me të rriturit.

2. Historiku i të drejtave të fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve është një cështje e cila ka qënë e trajtuar gjerësisht ndër vite si një ndër aspektet kryesore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut konkretisht ajo e personave që nuk kanë mbushur moshën 18 vjec.. Koncepti i të drejtave të fëmijëve ka evoluar nga njëra anë nga lëvizja e gjerë për të drejtat e njeriut,por po ashtu ka rrjedhur nga zhvillimet e tjera në fushën sociale, arsimore dhe psikologjike në 300 vitet e fundit. Këtu përfshihen edhe ndikimi i përkrahjes institucionale shtetërore për arsim të obliguar në shkolla, efektet negative të industrializimit në fëmijë (për shembull shpërdorimi i fëmijëve në fabrika apo miniera) dhe pasojat e luftës. Një kuptim i ri mbi zhvillimin e fëmijës ka evoluar nga koncepti i ri i mësimit dhe modelet e ngritjes së fëmijës në “lëvizje liberale fëmijnore” në vitet ‘70.

Ata ndihmuan që ta zhvendosnin cenueshmërinë e fëmijës dhe nevojat e mbrojtjes në një diskutim të ri mbi autonominë e fëmijës, kompetencën, vetëvendosjen dhe pjesëmarrjen e fëmijës, duke i refuzuar botëkuptimet atërore të fëmijëve si objekte të kontrollit prindor/madhor. Përfundimisht, të gjitha këto zhvillime së bashku kanë pasur një ndikim të madh në proceset politike, të cilat filluan brendapërbrenda Kombeve të Bashkuara: skicimi i një trupi të ri ligjor detyrues për të drejtat njerëzore të fëmijës– Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Viti i miratimit të saj - 20 Nëntori 1989 – është përvjetori i *Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës.*

Më poshtë po rendisim shkurtimisht disa nga konventat dhe traktatet që janë ndërrmar në drejtim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

- 1924 Lidhja e Kombeve miraton deklaratën e Gjenevës mbi të drejtat e fëmijës. Deklarata përcakton të drejtat e femijeve lidhur me mjetet që mundësojn zhvillimin e tyre moral,shpirteror dhe material.
- 1948 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miraton Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.Konkretisht neni 25 i kesaj Deklarate i referohet fëmijërisë si "mosha që ka të drejtë për kujdes dhe mbështetje të vecantë." [700]
- 1959 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve ta Bashkuara miraton Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës[701]. Kjo deklarat sanksionon te drejtën për arsim,kujdes shëndetsor,të drejten e emrit dhe kombësisë,si dhe lirin për të mos u shfrytëzuar.
- 1966 Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike si dhe Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.[702] Këto Konventa bëjnë thirrje për nxitjen e së drejtës për arsim si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi.
- 1973 Organizata Ndërkombëtare e Punës miraton Konventën Nr.138,në të cilën përcaktohet mosha minimale e punës e cila duhet te jetë 18 vjec për tu pranuar në punë që paraqesin rrezik për moralin, jetën dhe shëndetin e individit.[703]
- 1979 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpall vitin 1979 si Vitin Ndërkombëtar të Fëmijës duke vënë në lëvizje Grupin e punës për të hartuar një konvent të detyrueshme ligjore për të drejtat e femijës.
- 1989 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miraton në mënyrë unanime Konventën për të drejtat e fëmijës. Kjo konvent hyri në fuqi një vit më vonë.
- 1990 Samiti Botëror për Fëmijët miraton Deklaratën Botërore për Mbijetesën, Mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve.
- 1999 Organizata Botërore e punës miraton Konventën Nr. 182 për ndalimin dhe masat e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve.
- 2000 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miraton dy Protokollet Opsionale të Konventës për të drejtat e Fëmijës, njëri për mos-përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura dhe tjetri për ndalimin e shitjes së fëmijëve,prostitucionin dhe pornografin e fëmijëve.
- 2002 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mban një Sesion Special për Fëmijët.

[700] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, .Neni 25.
[701] Deklarata për të Drejtat e Fëmijës.
[702] Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike.
[703] Organizata Ndërkombëtare e Punës,Konventa Nr.138

- 2007 Sesioni Special i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për fëmijët, pasohet nga një mbledhje që përfundon me një Deklaratë për Fëmijët, e cila miratohet nga më shumë se 140 qeveri. Deklarata konfirmon arritjet dhe sfidat për të ardhmen.

3. Kuptimi ligjor i termit "i mitur".

Shpesh herë, në jetën tonë të përditshme ne e dëgjojmë dhe e hasim termin "i mitur", në aspektin letrar, gjuhësor, ligjor, psikologjik, etj. Nisur nga përkufizimet e mësipërme, sipas kontekstit në të cilin përdoret termi, për efekt të këtij punimi, termin "i mitur" ne do ta shohim në aspektin kriminologjik dhe në penalogji. Në aspektin gramatikor i mitur konsiderohet personi që nuk ka arritur akoma moshën e pjekurisë, duke mos u bërë ende zot i vetes dhe i përgjegjshëm për veprimin e tij.

Koncepti në shkencat e mësipërme të së drejtës është i lidhur me dukurinë e kriminalitetit, që do të thotë se fillimisht ne duhet të ndalemi e të kuptojmë atë. Me kriminalitet kuptohet tërësia e krimeve të kryera në një periudhë dhe hapësirë te caktuar. Për të kaluar më pas në kriminalitetin e të miturve, i cili vlerësohet nga këto degë të së drejtës, si kriminalitet i kryer nga individë, që nuk kanë arritur moshën madhore.

Në disa prej vendeve, mosha për përgjegjësi penale, jo gjithmonë përputhet me moshën madhore, në kuptimin e të drejtave politike e civile (e drejta për të zgjedhur ose e njohur ndryshe si e drejta e votës, e drejta për të hyrë në një marrëdhënie të thjeshtë kontraktuale), çka bën që kuptimi i dukurisë së kriminalitetit të të miturve, të përafrohet më shumë me atë social-historik. Kjo do të thotë që përkufizimi i termit "kriminel i mitur", lidhet me trajtimin ligjor që i bëhet vetë të miturit, trajtim që ndryshon nga njëri shtet në tjetrin dhe është i ndërvarur nga shumë faktorë psikologjikë e ligjorë, të lidhur ngushtësisht me faktorët socialë.

Duke iu referuar nenit 1, të Konventës për të Drejtat e Fëmijve, i mitur do të konsiderohet *çdo fëmijë që nuk ka mbushur moshën 18 vjec*[704]. Ndërsa, referuar "Oxford – Dictionary of Law", i *mitur, cilësohet personi, ndërmjet moshës 10 dhe 17 vjeç, i cili ka kryer një krim dhe personi rreth moshës 14 deri në 17 vjec që kryen një krim, cilësohet si i ri*[705]. Po kështu, edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dokumentat e saj, kriminelin e mitur e përkufizon si : *".....cdo fëmijë ose adoleshent, të cilit i ngarkohet kryerja e një vepre penale ose është deklaruar fajtor për kryerjen e saj*[706]*...".*

---

[704] Konventës për të Drejtat e Fëmijve, nenit 1
[705] Oxford – Dictionary of Law.
[706] Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Ndërsa, duke ju referuar përkufizimit të Ragip Halilit, mund të themi, se *krimineli i mitur është ai individ, që nuk ka mbushur moshën madhore të parashikuar nga ligji penal dhe kryen një vepër të dënueshme nga ligji*[707].

Kriminaliteti i të miturve nuk është nje dukuri e re, e shfaqur në kohët moderne, por është një dukuri qe ka ekzistuar hershëm dhe ka patur vecoritë e tij ne periudha të ndryshme te zhvillimit historik. Duke bërë një vështrim historik lidhur me trajtimin ligjor të të miturit do ta hasim që në Kodifikimin e Justinianit, ku është vendosur një kufi ligjor, mes të miturit (impuberes), nga i rrituri (puberes), që është mosha katërmbëdhjetë vjec[708].

4. Konventa për mbrojtjen e fëmijëve

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.Ajo u firmos për një kohë të shkurtër nga 61 vende të botës,reagim ky i pashënuar më parë pas një marrëveshje të Kombeve të Bashkuara.

Konventa mbi të Drejat e Fëmijës nuk është në radhe të parë një katalog i të drejtave të fëmijëve,por më tepër një radhitje e përgjegjsive kundrejt fëmijëve,të cilat shtetet janë të gatshme ti njohin.Konventa prek tema me të cilat asnjëherë më parë nuk është marrë ndonjë dokument ndërkombëtar.

Duke u bazuar në respektin për dinjitet të të gjitha qenieve njerëzore,KDF e njeh cdo fëmijë si bartës të të drejtave të tij njerëzore,këto të drejta nuk rrjedhin apo ndërvaren nga të drejtat e njeriut apo ndonjë të rrituri tjetër. Kjo është mbështetja për konceptin e autorizimit të fëmijës,duke i mundësuar fëmijës si një subjekt i respektuar dhe qytetar i shoqërisë,qe të sfidojë dhe të ndërrojë kufizimet e përceptimeve diskriminuese dhe pritjet nga të rinjtë. Faktikisht,fëmijët mbeten të varur nga të rriturit(falë zhvillimit të tyre fizik dhe psikik,mungesa e të mirave materiale/të ardhurave dhe ndryshimeve në situatat ekonomike dhe sociale të prindërve) të cilat kanë ndikim të menjëhershëm në standardin e jetesës të fëmijës.

Korniza e KDF-së për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nuk është një dokument "statik", por një dokument në zhvillim. Ky proces po forcohet, për shembull: Nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës nëpërmjet interpretimit të KDF apo miratimit të standardeve të reja siç janë *Protokollet Fakultative (2000)* të KDF mbi përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura dhe shitja e fëmijëve, prostitucioni i fëmijëve dhe pornografia e fëmijëve (të dyja hynë në fuqi në vitin 2002)[709].

[707] R Halili, *Kriminalogjia* (Prishtinë 2008) pp.22.
[708] Vllado Kamboski, *E drejta penale Pjesa e Pergjithshme*, pp1085.
[709] Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Protokollet Fakultative (2000)

5. Definimi i "fëmijës" nga KDF-ja

Kush është konsideruar "fëmijë" në Konventën për të Drejtat e Fëmijës?KDF-ja e definon "fëmijën"në mënyrë të përgjithshme si cdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjecare[710](por nëse është arritur shumica në shtetin përkatës për ta ndryshuar këtë,Neni1).Këtej e tutje zgjedhim një qasje më të thjeshtë,duke i ndarë të rriturit nga adoleshentët.Nuk ka ndonjë përmëndje të kufizimeve të moshës në Konventë përvec nenit 38 .Komiteti për të Drejtat e Fëmijës – trup ndërkombëtar për mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës – vazhdimisht ka theksuar se qasja e KDF-së po ashtu urdheron shtetet që t'i rishikojnë ligjet e tyre nacionale për përkufizimet e moshës në përputhje dhe justifikim të vazhdueshëm.

Ndarë nga definimi i Nenit 1,ka disa kurthe për zbatimin e KDF-së,sepse grupi "nën moshën 18 vjec" përben një grup të shumëllojshëm,llojshmëri johomogjene sociale,e cila e bën të nevojshëm për të qenë i qartë për grupin e synuar apo masat.

6. Arritjet e Konventës dhe sfidat për të ardhmen

Konventa për të dejtat e fëmijëve ka njohur përparime të mëdha në mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijëve dhe ka kontribuar në konsolidimin dhe zgjerimin e përpjekjeve për mbrojtjen e tyre.Ajo ka ndihmuar dhe në krijimin e instrumenteve Ndërkombëtar si ILO,e cila vepron kundër punës së detyraur të fëmijëve**..** Kjo konventë detyron çdo shtet, i cili e ratifikon atë për *»marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për zbatimin sa më të shpejtë të ndalimit dhe luftimit të formave më të rënda të punës së fëmijëve«.* Fëmijë konsiderohen të gjithë personat nën moshën 18 vjeç. Ndër format më të rënda të punës së fëmijëve janë: *»Të gjitha format e skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, si shitja apo tregtia me fëmijë dhe e fëmijëve, puna e detyruar etj.*

Konventa ka hapur rrugën për konsolidimin e mbrojtjes së fëmijës duke u dhënë fëmijëve të drejtën për të qenë të mbrojtur nga llojet e ndryshme të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, diskriminimit dhe neglizhencës.

Konventa dhe Protokollet e saj Opsionale mbulojnë spektrin e plotë të të drejtave civile, politike, kulturore dhe ekonomike të fëmijëve, bazuar në disa parime kryesore ku mund të përmendim:parimin e mos-diskriminimit(neni 2), parimin mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës(neni3), e drejta për të jetuar, për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar(neni 6), si dhe respektimi i mendimit të fëmijëve në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tyre(neni12).

[710] Konventa për të Drejtat e Fëmijës,neni 1

Konventa ka pasur një ndikim të thellë dhe të shtrirë gjerësisht në institucionet publike. Kjo vihet re në faktin që objektivat, politikat, programet dhe fushatat avokuese për të drejtat e njeriut dhe progresin social, në plan kombëtar dhe ndërkombëtar, u referohen gjithnjë e më shpesh dhe vendosin gjithnjë e më shumë në fokus të drejtat e fëmijëve.Me ratifikimin e Konventës shumë qeveri filluan të nxisin të drejtat e fëmijëve dhe të fusin parimet themelore të konventës në të drejtën e tyre kombëtare.Kjo solli si rezultat ose heqjen e ligjeve që diskriminonin fëmijët ose miratimin e ligjeve të reja për nxitjen e të drejtave të fëmijëve.

Konventa ka ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, shkollave, familjeve dhe komuniteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Impakti i saj në media është i qartë dhe shfaqet në kodet e etikës për raportimin e çështjeve të fëmijëve, zgjerimin e hapësirës që zënë problematikat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe në tërheqjen e mendimit të fëmijëve për çështje që prekin dhe shqetësojnë ata.

7. Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri

Shqipëria u bë palë në Konventën e të Drejtave të Fëmijës (KDF) në 28 mars 1992 dhe në Protokollet e saj Opsionale "*Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura*" dhe "*Për shitjen e fëmijëve,prostitucionin e pornografinë me fëmijë*"[711], akte të cilat në përputhje me dispozitat kushtetuese janë bërë tashmë pjesë e sistemit ligjor **s**hqiptar.[712] Kushtetuta njeh fuqinë ligjore të marrëveshjeve/traktateve ndërkombëtare të ratifikuara **v**etëm pas publikimit në Fletoren Zyrtare[713], si dhe parimin e vetëzbatueshmërisë së tyre, përjashtuar ato raste kur dispozitat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e ligjit. Kushtetuta garanton përparësinë e KDF ndaj të drejtës së brendshme, për sa kohë që kjo e fundit bie në kundërshtim me dispozitat e saj.[714] Në këtë aspekt, ia vlen të nënvizojmë se prej vitit 1992 ende mbetet i papublikuar në Fletore Zyrtare teksti i KDF. Ndërkohë që tekstin e KDF-së në gjuhën shqipe e gjejmë të publikuar on-line në faqen zyrtare të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.[715]

Fëmijët gëzojnë, sipas dispozitave kushtetuese, mbrojtje të veçantë nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi,përdorimi për punë, mbrojtjen e shëndetit, moralit apo zhvillimin e tyre normal.[716]Por në

[711] Ligji Nr. 9893, datë 22.11.2007 dhe Ligji Nr. 9894, datë 22.11.2007 për aderimin në Protokollet Opsionale të KDF.
[712] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar në 2008, neni 116.
[713] Ibid, neni 122.
[714] Ibid, neni 122/1.
[715] <www.mpcs.gov.al> accessed on 19 February 2013
[716] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar në 2008, neni 54/1. "1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti".2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. 3. çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal".

këtë aspekt, Kushtetuta ende garanton të drejtat duke iu referuar individëve në përgjithësi, pa u ndalur specifikisht tek kategoria e të miturve.

8. Raporti UNICEF-it për Shqipërinë

Në Ditën botërore për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve, UNICEF publikoi shifra alarmante për sa i përket situatës në vendin tonë. Pas një anketimi të fëmijëve nga 2-14 vjeç është vënë re se 75% e fëmijëve shqiptarë kanë vuajtur të paktën një formë të dhunës fizike ose psikologjike. Të dhënat janë bërë të ditura në konferencën shkencore për dhunën ndaj fëmijëve në Shqipëri[717].Për përfaqësuesin e UNICEF-it në Shqipëri, Detlef Palm, "dhuna, përfshi atë fizike dhe psikologjike, është gjithmonë një eksperiencë shumë e dhimbshme dhe degraduese, aq më tepër kur viktima të saj janë fëmijët[718]". Ndërsa ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë, Ettore Sequi vlerësoi si shqetësues fenomenin e lypësve në rrugë, të cilët janë fëmijë që dhunohen nga prindërit e tyre dhe detyrohen të punojnë në vogëli

Konkluzione

Pas hulumtimeve dhe studimeve të bëra për punimin: "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në të Drejtën Ndërkombëtare", mund të nxirren disa përfundime:

-Kodet e vendit duhet të amendohen për të përcaktuar sanksione të qarta ndaj atyre që i lejojnë vetes abuzime fizike apo dhunë psikologjike ndaj fëmijëve tyre. Problemi kryesor qëndron te prindërit, te mungesa e zhvillimit të tyre, te superzemërimi i tyre i pamotivuar. Ndaj duhet një sistem në mbarë shoqërinë që të mbrojë fëmijët, të njoftojë dhunën ndaj tyre dhe të imponojë masa të rrepta në rastet e abuzimeve.Për të luftuar këtë fenomen është i rëndësishëm forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve në nivel qendror dhe vendor.

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijës, duhet të bëhet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë fëmijëve pa dallime race, feje, gjinie etj. Po ashtu fëmija martesor, fëmija jashtëmartesor, janë të barabartë në bazë të akteve juridike dhe si të tillë duhet që të trajtohen.

Si përfundim, mund të përmendim se përmirësime të rëndësishme janë bërë në Shqipëri dhe ne Botë. Megjithatë, mbeten ende sfida të rëndësishme në lidhje me drejtësinë për të miturit si dhe të politikave të hartuara në këtë drejtim.

[717] <http://www.mapo.al/2012/11/22/unicef-75-e-femijeve-ne-shqiperi-te-dhunuar/> accessed on 19 February 2013.
[718] <http://www.mapo.al/2012/11/22/unicef-75-e-femijeve-ne-shqiperi-te-dhunuar/> accessed on 19 February 2013.

Bibliografia

Deklarata për të Drejtat e Fëmijës

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Dekret nr 6218, datë 16.09.2009, *Për krijimin e seksioneve të vecanta për të mitur*

http://www.mapo.al/2012/11/22/unicef-75-e-femijeve-ne-shqiperi-te-dhunuar/ accessed on 19 February 2013

Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, shtator 2012, Ligji nr. 9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes i Shqipërisë neni 217,228,229.

Kodi Penal i Republikës së Shqiperisë.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar në vitin 2008.

Latifi *et al*.,"*Politika e Luftimit të Kriminalitetit*", Prishtinë 2012.

Organizata Ndërkombëtare e Punës,Konventa Nr.138

OSCE Prezence in Albania, *Manuali i Punonjësit të Shërbimit të Proves* (PEGI Tiranë)

Praktika Gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtat e fëmijës

Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, *Reformat në Drejtësinë për të Miturit dhe Roli I Institucioneve Kushtetuese* (Kont Urani No.10, Tiranë)

Rekomandime të miratuara nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës.

Xhafo J, *I Mituri dhe Procesi Penal* (Monografi, Botimet Geer Tiranë 2012)

Order and Justice in International Relations: Case Study: Kosovo in view of humanitarian intervention

Bardhok Bashota-PhD-Cand[1] & Arbër Reçi-PhD-Cand[2]

[1]Faculty of International Relations and Diplomacy, Iliria College, Prishtinë, Kosovë

[2]Faculty of International Business, Iliria College, Prishtinë, Kosovë

Abstract:

Kosovo case studies-especially in the context of the use of force and humanitarian intervention are the most obvious example where can manifest contradictory nature of the "solidarism" and "pluralist" concepts. At the same time, each of these concepts taken separately, represent a part of the explanation of the nature of developments in the case of Kosovo. For example, watching shocking acts of genocide that occurred in Rwanda, then very heavy violated human rights in the Balkans, have opened again (the issue of the right of humanitarian intervention to protect populations lives were endangered. As mentioned above, the debate about NATO's involvement in Kosovo has revealed that there is no universally agreed on the question whether they can overcome the right of sovereignty (Westphalia's concept, pluralist or realistic) by a principle of assuming higher moral protection of human rights (solidarism or liberalist concept).

Keywords: *humanitarian intervention, solidarism, pluralist, genocide, sovereignty.*

1. Introduction

Duke pasur në konsideratë faktin që doktrina e intervenimit humanitar konsiderohet si praktikë ekskluzive e politikës *liberale*, atëherë duhet të konstatohet se ku mbështeten këto konsiderata. Një konsideratë e tillë vije nga fakti që shtetet liberale demokratike kanë qenë ato që kanë avokuar përherë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe kanë ngritur rregulla dhe parime bazë me rol të rëndësishëm në pajtim me institucionet ndërkombëtare. Kjo rrjedhë nga një sërë supozimesh të shumta të cilat ndryshojnë nga *realizmi* për sa i përket numrit më të madh të akterëve në politikën botërore, ndikimin e institucioneve, dhe së fundi idetë liberale që kanë të bëjnë me autonominë individuale, tregtisë dhe racionalitetit univesal.

Rrjedhimisht, liberalizmi edhe rastin e Kosovës e trajton me termat që i qaset studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi. Por, lidhur me studimin e këtij rasti, këtu fokusohemi kryesisht në tri pika: 1) rritjen e normave të intervenimit humanitar dhe debatet "liberale" mbi strategjinë; 2) sigurinë kolektive dhe rëndësinë e veprimit shumëpalësh; dhe 3) rëndësinë e ligjit ndërkombëtar.

2. Rendi dhe drejtësia në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Duke shkruar për evoluimin e shoqërisë moderne të shteteve, mbrojtësi i Wight, Hadely Bull, vështroi se në "formë të doktrinës së ligjit natyror, idetë e drejtësisë njerëzore historikisht u kishin paraprirë zhvillimit të ideve të drejtësisë ndërë-shtetërore ose ndërkombëtare dhe kishte siguruar ndoshta themelet parimore intelektuale mbi të cilat ishin këto ide të fundit".[719] Në lidhje me këtë evoluim të shoqërisë modene të shteteve dhe këtyre relacioneve të drejtsisë, Kissinger sjellë shpjegime shumë të vlefshme përmes mënyrës së funksionimit të sistemit ndërkombëtarë Vestfalian dhe sfidave para të cilave ai gjendet sot. Ai thekson se:

> Sistemi ndërkombëtar i bazuar në Traktatin e Vestfalisë, kishte një përgjigje për problemin e dhunës midis shteteve- që është fjala për luftën- por nuk ofroi zgjidhje për dhunën *brenda* shteteve të shkaktuar nga luftërat civile, konfliktet etnike, dhe gjithë rrezen e atyre që sot quhen dhunime të të drejtave të njeriut. Traktati trajtoi problemet e paqes dhe la drejtësinë në dorë të institucioneve të brendshme. Aktivistët e sotëm të të drejtave të njeriut argumentojnë të kundërtën. Nga pikëpamja e tyre, paqja rrjedh automatikisht nga drejtësia, dhe shteteve kombe ose çdo shteti nuk mund t'i besohet për të dhënë drejtësi; ajo duhet të vendoset nën njëfarë autoriteti mbikombëtar me të drejtën për të përdorur forcën për ta bërë këtë vendim të funksionojë. Në

[719]S.Burchill, R.Devetak, A.Linklater, M.Paterson, Ch.Reus-Smit and J.True, *Theories of International Relations*, Second Edition, Palgrave, London, 2001, p.107.

përgjithësi, aktivistët e të drejtave të njeriut u besojnë më tepër juristëve sesa shtetarëve. Përkrahësit e parimeve vestfaliane u besojnë më tepër shtetarëve sesa juristëve. [720]

2.1 Rasti i Kosovës konform parimeve vestfaliane

Në lidhje me studimin e rastit të Kosovës, vërejmë qartë se Serbia edhe pse bënte shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut, ajo e justifikonte këtë veprim si "punë e brendshme e saja" duke u thirrur njëkohësisht në parimet vestfaliane të epërsisë së sovranitetit dhe mosndërhyrjes në "punët e brendshme". Por, kur bashkësia ndërkombëtare ndërhyri në emër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, atëherë parimet vestfaliane u gjenden në krizë sistematike. Ky veprim i bashkësisë ndërkombëtare nxiti debate të shumta në lidhje me çështjet nëse kjo bashkësi kishte të drejtë apo jo, pastaj nga buron kjo e drejtë etj[721]. Kjo është një çështje problematike që meriton studime të detajshme.

Disa vëzhgues e kanë mbështetur aksionin e NATO-s mbi bazën se shtetet kanë detyrim ndaj tërë njerëzimit dhe jo veteëm ndaj shteteve të tjera. Të tjerët kanë kritikuar NATO-n për atë që ata e konsideronin si cenimi Kartës së Kombeve të Bashkuara, për intensifikimin e lartë selseksionues për kontrollimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe për aktet e dhunës që i sollën vuajtje të shtuara një popullate vendore si ajo e Kosovës. Në këto reagime të ndryshme mund të degjohen jehona të një tensioni më të vjetër midis koncepteve *pluraliste* dhe *solidariste* të shoqërisë ndërkombëtare. Një mënyrë për të goditur balansin midis këtyr pikëpamjeve rivale është sygjeruar me argumentin se shtetet do të duhej të ishin të gatshme të intervenonin në rastet më të kqija të shkeljes së të drejtave të njeriut, por do të duhej të mbeteshin "kritik ndaj çdo nënvlerësimi të përgjithshëm të mos-intervenimit". Mbetet ende të shihet nëse shoqëria moderne e shteteve mund të arrijë një definicion të pajtimit kundër shkeljeve të patolerueshme të të drejtave të njeriut dhe të bashkohet në goditjen e balansit në mes pluralizmit dhe solidarizmit në këtë mënyrë.[722]

Megjithatë, përkundër pohimeve të Bull-it që pluralizmi në kohët moderne ka dominuar ndaj solidarizmit, prapë se prapë, ka dëshmi që tregojnë të kundërtën, dhe se njëra ndër këto dëshmi ka të

---

[720] H.Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*, Botimi i parë, Tiranë, 2003, f. 360-361.

[721] Një shpjegim mjaft preciz e ofron Bull. Në një ese të tij të hershëm, Bull bëri dallimin midis konceptit "solidarist" ose "Grocian" dhe atij "pluralist" të shoqërisë ndërkombëtare. Ai pohon se "supozimi qendror Grocian është ai i solidaritetit ose solidaritetit të mundshëm të shteteve, që përbëjnë shoqërinë ndërkombëtare, përkitazi me fuqizimin e ligjit". Solidarizmi është i dukshëm në bindjen Grociane se nuk ka dallim në mes të luftërave të drejta dhe të padrejta, dhe në supozimin "nga i cili rrjedhë e drejta për intervenim humanitar...se qeniet individuale njerëzore janë subjekte të së drejtës ndërkombëtare dhe anëtarë të shoqërisë ndërkombëtare në të drejtën e tyre. Pluralizmi, është shpjeguar nga avokati i së drejtës ndërkombëtare nga shekulli 18, Vattel, që e refuzoi këtë qasje, duke argumentuar se "shtetet nuk tregojnë solidaritet të këtij lloji, por janë në gjendje të pajtohen vetëm për qëllime minimale që janë më të vogla se fuqizimi i ligjit". Një argument përkatës është se shtetet e jo individët janë anëtarë themelor të shoqërisë ndërkombëtare. Duke e bërë këtë dallim, Bull pyeti nëse ka ndonjë dëshmi se shoqëritë pluraliste ndërkombëtare të epokës së pas-luftës së Dytë Botërore po bëheshin më solidare: S.Burchill, R.Devetak, A.Linklater, M.Paterson, Ch.Reus-Smit and J.True, *Theories of International Relations*, Second Edition, Palgrave, London, 2001, p.110.

[722] S.Burchill, R.Devetak, A.Linklater, M.Paterson, Ch.Reus-Smit and J.True, *Theories of International Relations*, Second Edition, Palgrave, London, 2001, p.118.

bëjë me rastin e Kosovës si ngjarje që tregoi për epërsinë e konceptit solidarist. Për më tej argumente në favor të konceptit solidarist vijnë edhe nga radhet e autorëve që konsiderohen si pluralist. Për shembull, Kissinger argumenton që:

> "Kosova ishte kulmimi i një numri ndërhyrjesh të kryera në emër të të drejtave të njeriut dhe vlerave njerëzore. Forcat amerikane u dislokuan në Somali, fillimisht për të ndihmuar shpërndarjen e ushqimit, pastaj për të vendosur një qeveri cilvile; në Haiti, me qëllim çlirimin e popullsisë nga një qeveri ushtarake që kishte ardhur në pushtet me grusht shteti; në Bosnje, për të detyruar fundin e një lufte të rrept civile dhe, në Kosovë, për të tarnsferuar autoritetin nga Serbia në shumicën e popullsisë që ishte etnikisht shqiptare."[723]

Me një fjalë, ishte ndërhyrja humanitare si në rastin e Kosovës, ajo që tregoi se bashkësia ndërkombëtare po hynte në një kapitull të ri dhe të pa parë deri më tani përsa i përket mënyrës se si ajo interesohet për të drejtat e njeriut si pjesë e shqetësimit të përbashkët. Madje, rasti i Kosovës u konsiderua se e promovoi doktrinën "intervencionizmit të ri", një term i proklamuar nga Kissinger.

Doktrina e re e ndërhyrjes humanitare qartëson pohimin pse bindjet humane përbëjnë një pjesë aq inegrale të traditës amerikane, ku jo vetëm thesari, por më në ekstrem, vetë jetët njerëzore lipset të rrezikohen për t'i vendikuar këto kudo në botë. Asnjë komb tjetër nuk ka parashtruar qëllime të tilla, të cilat rrezikojnë që Shtetet e Baashkuara dhe aleatët e saj të jenë në rolin e policit botëror...Afirmimi retorik i doktrinës së ndërhyrjes së përhershme u shpreh sidomos qartë në triumfin e operacionit të NATO-s në Kosovë, Kryeministri britanik Tony Blair e shpalli misionin e Kosovës si një fitore e forcave "progresive" (koncepti solidarist) në politikën e jashtme, duke zëvendësuar konceptet e vjetëruara tradicionale (pluralizmin). Sipas tij:

> "Kjo luftë...u zhvillua për një parim themelor të nevojshëm për përparimin e njerëzimit: që çdo qënie njerëzore, pavarësisht nga raca, feja apo lindja gëzon një të drejtë të patjetërsueshme për të jetuar të lirë nga përsekutimi".[724]

Një çështje që ende mund të konsiderohet se është lënë e hapur, megjithëse, është një veprim i "normës së drejtuar" të fuqive të NATO-së është në gjendje për forminim e plotë të kornizës institucionale dhe ligjore.

Kapitulli i Andrew Linklater (Andre Linklater), *"Shtetas i Mirë Ndërkombëtar dhe Kriza në Kosovë"*, tregon që ligji ndërkombëtar i bazuar në konceptin *"statist"* apo *"pluralist"* të të drejtave ligjore duhet të bazohet në konceptin *"solidarist"* të shoqërisë ndërkombëtare "që tregon se individët janë anëtarë bazë të asaj shoqërie, dhe shtetet janë të obliguara t'i mbrojnë interesat e tyre" Për t'i mbrojtur të drejtat e individëve nga abuzimi:

> "Shtetasit e mirë ndërkombëtar duhet të jenë të përgatitur t'a përdorin forcën. Si kujdestarë të kulturës

[723] H.Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*, Botimi i parë, Tiranë, 2003, f.387.
[724] H.Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*, Botimi i parë, Tiranë, 2003, f.385.

> të së drejtave njerzore globale ata duhet të veprojnë për t'u siguruar se kriminelët e luftës janë të ndjekur, dhe duhet të jenë të përgatitur për t'i rikonfiguruar sistemet politike që cenojnë parimet morale fondamentale. Krijimi i protektoratit ndërkombëtar, ndarja e shoqërive dhe mbështetja e krijimit të marrëveshjeve federale dhe konfederale janë tri mundësitë e vlefshme për shtetasin e mirë ndërkombëtar".[725]

Përgjithësisht mund të thuhet se aktualisht, ligji ndërkombëtar bazohet në parimet "pluraliste" duke i vendosur "shtetasit e mirë ndërkombëtar" në pozitën e pavolitshme ku ata i "respektojnë parimet ligjore ndërkombëtare ekzistuese", por gjithashtu ushtrojnë shtypje në to dhe e sfidojnë *status quo*-n. Linklater argumenton se Kosova mund të përbëjë një katalizator në krijimin e një korrnize të re ligjore:

> "Në mënyrë të dukshme, shumë që mbështetën akcionet e NATO-së – megjithëse me rezerva - e bënë këtë jo vetëm për shkak të besimit se ishte e mundshme një katastrofë humanitare ,por gjithashtu për shkak se besonin se Kosova mund të ishte një katalizator që paraqet një epokë të re "të zbatimit të ligjit kozmopolitan"...se a do të jep rritje Kosova në ligjshmërinë e re që e largon dilemën morale të shtetasit të mirë ndërkombëtar është ende e paqartë ...,por një nga përgjegjësitë fondamentale të shtetasit të mirë ndërkombëtar është që të përpiqet ta zgjidhë tensionin ndërmjet ligjshmërisë dhe progresivismit në një rend të ri ligjor" [726].

3. Rritja e normave të intervenimit humanitar dhe debatet "liberale" mbi strategjinë.

Është mëse e qartë se zhvillimi i normave lidhur me intervenimin humanitar mund ta mbështes liberalizmin dhe ta bëjë atë një sfidë serioze për shpjegimet realiste dominante të politikës botërore. Kjo është pika që u theksua më lartë, e që ka të bëjë me pretendimet e teorive për t'i arsyetuar qëndrimet e tyre në mënyrë vlerore. Për shembull, realistët i shikojnë pikëpamjet e tyre si shumë ideale, në të njejtën kohë kur liberalët i konsiderojnë qëndrimet e tyre si tejet reale.

Megjithatë, sado që liberalët e proklamojnë avancimin dhe maturin e normave dhe institucioneve ndërkombëtare në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, megjithatë rrethanat reale flasin për jo efikasitetin e tyre në zgjidhjen e shumë situatave sidomos me karakter problematik siç është rasti i Kosovës. Ka mjaft shembuj ku tregohet pafuqia e institucioneve dhe rregullave të tyre në zgjidhjen e disa kontesteve politike. Dhe si pasoj e kësaj, veprimet realiste kanë ardhur shpeshherë në shprehje dhe janë treguar si mjeti i vetëm vendimtar dhe efikase. Në këtë drejtim, ka shumë autorë që sjellin prova se veprimet realiste kanë qenë të vetmet mjete që kanë

---

[725] D.Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations*, Rewiew Essay, The Global Review of Ethnopolitics Vol. 1, no. 4, Brunel University, UK, June 2002, pp.110-118.
[726] Po aty, p. 110-118.

treguar efikasitet në zgjidhjen e problemeve, dhe që njëkohësisht kanë treguar për paefektshmërinë e institucioneve dhe normave apo parimeve ndërkombëtare në lidhje me zgjidhjen e këtyre problemeve. Edhe lidhur me rastin e Kosovës, Fischer për shembull, argumenton se bombardimet e NATO-s ishin mjeti i fundit dhe i domosdoshëm për ta zgjidhur krizën e Kosovës.Këtë konstatim ai e mbështetë nga përvojat e mëparshme në terren, ku sipas tij:

> "Nëse thoni: "Le të ndalen bombardimet, e më pas do të shikojmë, do të negociojmë". Kam shikuar se sa armëpushime kanë nënshkruar Millosheviçi dhe bashkëpunëtorët e tij. Tetëdhjetenjë (**81**) armëpushime që nga viti 1993, prej të cilave ka respektuar vetëm të fundit (atë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit). E gjithë kjo u ka kushtuar qindra mijëra njerëzve me jetë, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në rajonet e tjera. **73** rezoluta të OKB-së, të dashur miq dhe mikesha, **73!** Dhe do të përmendën dy prej tyre, më 16 prill 1993, Rezoluta **819** e OKB-së: Srebrenica bëhet zonë e mbrojtur. Dhe më 6 maj 1993, Rezoluta **824** e OKB-së: krijimi i gjashtë zonave të mbrojtura për refugjatët myslimanë në Srebrenicë, Zhepë, Gorazhd, Tuzëll, Sarajevë, Bihaq".[727]

Së këndejmi, liberalistët argumentojn se edhe pse kishte skepticizëm të arsyeshëm lidhur me aftësinë e normave dhe institucioneve ndërkombëtare për ta zgjidhur krizën e Kosovës me anë të mjeteve të diplomacisë së hapur, megjithatë ka vend për optimizëm në lidhje me mundësisë për përsosjen e mëtutjeshme të së drejtës humanitare. Gjithashtu liberalët argumentojnë se pa marrë parasyshë mënyrën se si u reagua ngaj menaxhimit të krizës së Kosovës, u vërejt se u krijua një koncept i ri i së drejtës ndërkombëtare në favor të avncimit të doktrinave dhe normave të së drejtës ndërkombëtare në përshithësi. Në lidhej me këtë, studiuesi Stoessinger me një ton optimist liberal argumenton se:

> "Përfundimisht, me fitoren kundër Millosheviçit gjatë luftës që ai bëri kundër shqiptarëve të Kosovës, NATO kishte krijuar një koncept të ri të së drejtës ndërkombëtare: jo vetëm që nuk do të tolerohej persekutimi i njerëzve nga një diktatorë, por atij do t'i kundërviheshin. Në këto përpjekje udhëhoqën Kombet e Bashkuara që u pasuan nga NATO-ja. Ky parim i ri i ndërhyrjes njerëzore ishte akoma larg të qenit universal, por ai ishte në fillim. Në agim të mijëvjeçarit të ri, ai ishte një pohim kumbues i Deklaratës Universale të të Drejtave të njeriut, të miratuar më shumë se një gjysmë shekulli më parë nga Kombet e Bashkuara nëpërmjet përpjekjeve të palodhshme të delegates së Shteteve të Bashkuara, Eleonora Ruzvelti (Eleanor Roosevelt)".[728]

4. Siguria kolektive dhe rëndësia e veprimit shumëpalësh.

Pa dyshim që liberalizmi e konsideron formën e sigurisë kolektive si mënyrën më të mirë të vetme për të reaguar ndaj situatave konfliktuoze të cilat e kërcënon paqen dhe stabilitetin

[727] J.Fischer, *Vitet kuq-gjelbër (Politika e jashtme gjermane-nga Kosova e deri më 11 shtator).*KOHA, Prishtinë, 2007, f. 221.
[728] J. G.Stoessinger, *Përse Kombet Shkojnë në Luftë,* Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2007, f.168-169.

ndërkombëtare. Mirëpo, ashtu si në shumë raste tjera, edhe në rastin e Kosovës, u vërejt qartë se sistemi i sigurisë kolektive i proklamuar sipas liberalizmit nuk funksionoi si duhet dhe për atë se kjo çshtje u bllokua në Këshillin e Sigurimit për shkak të raportit të forcave në mes anëtarëve të përhershëm. Por, prapë se prapë, edhe pse nuk u vepru në formën e sigurisë kolektive-në kuptimin që e proklamon liberalizmi-përgjigjja e bashkësisë ndëkombëtare ndaj krizës në Kosovë, që erdhi nga NATO-ja, në njëfarë mënyre, u realizua në formën e veprimit shumëpalësh dhe pak a shumë kolektiv. Kjo çështje ngritë nevojën që të tëriqet një paralele në mënyrë që të bëhet dallimi në mes të një sisteni të sigurisë kolektive në njërën anë, dhe një aleance në anën tjetër. Në këtë drejtim, Kissinger ofron një shpjegim shumë të qartë dhe se kjo ka shumë rëndësi për faktin se kur të shpjegohet rasti i Kosovës në këtë kontekst, kjo ndihmon që shpjegimet të jenë të qarta. Kissinger argumenton se:

> "Gjatë epokës së Klintonit, pohimet e Aleancës kishin një cilësi liturgjike që hap pas hapi e përafruan konceptin origjinal të Aleancës si kurrë më parë me doktrinën e sigurisë kolektive".[729]

4.1 Kriza në Kosovë: një sfidë e re për sigurinë kolektive

Shikuar sipas këtij kuptimi që Kissinger ofron për një aleancë dhe për arsyet që e involvojnë atë në luftë, ndëhyrja e NATO-s si në rasti i Kosovës përbënë një përjashtim sepse asnjë shtet anëtarë i NATO-s nuk ishte sulmuar direkt. Për këtë çështje mund të shtrohen pyetje të tilla si: përse u involvua NATO-ja në këtë konflikt përderisa nuk u prekën direkt interesat e saj?

Zakonisht, përgjigjet që vijnë nga liberalët lidhur me këtë pyetje, fokusohen kryesisht në argumentet se kjo ndodhi për shkak të rritjes së intersimit të bashkësisë ndërkombëtare për të evokuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe çështjeve tjera humanitare. Edhe pse liberalët e pranojnë faktin se mënyra e reagimit ndaj shkeljes së të drejtatës humanitare si në rastini Kosovës ishte paraqitur si një sfidë vendimtare për ta, prapë se prapë liberalët nuk e minimizojnë angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për të evokuar në të mirë të mbrojtjes së të drejtës humanitare në përgjithësi. Madje këta argumentojnë se ishte pikërisht rasti i Kosovës ai i cili bëri që të ndryshojnë shumë doktrina dhe parime ndërkombëtare. Rrjedhimisht liberalët argumentojnë se rasti Kosovës ai që e bëri NATO-n të zgjedh midis dy parimeve të intervenimit ushtarak

---

[729] Dallimi ndërmjet dy koncepteve nuk është një lojë e ligjshme fjalësh;ai shënon një ndryshim të rëndësishëm filozofik. Një aleancë krijohet kur një grup kombesh vendosë që të mbrojë një territor të caktuar ose një kauzë të caktuar; në të vërtet ai vë një kufi,shkelja e të cilit përbën një *akt që justifikon luftën.* Në dallim nga aleanca, një sitem i sigurisë kolektive nuk përcakton as territorin që do të mbrohet dhe as mjetet dhe makineritë për të realizuar atë; ai është, në thelb, një koncept juridik. NATO është një aleancë; Kombet e Bashkuara janë një sistem i sigurisë kolektive. Një aleancë merret me një kërcënim të qartë dhe të përcaktuar dhe shpesh i cakton forcat për ta përballuar atë. Një sistem i sigurisë kolektive është neutral nga pikëpamja juridike; duke mos e përcaktuar kërcënimin, ai është i detyruar që të pres derisa të shfaqet përpara veprimi e mund të merret në konsideratë. H.Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme,* Botimi i parë, Tiranë, 2003, f. 54.

ndërkombëtar, pra atij të l*egjitimitetit* human dhe parimit klasik të *legalitetit*. NATO zgjodhi të parin, madje edhe pa ndonjë vendim legal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Sipas liberalëve, realizmi e minimizon rëndësinë e institucioneve ndërkombëtare dhe rëndësinë në rritje të multilateralizmit, madje edhe në çështje të sigurisë. Kjo ishte vënë në pah detyrimisht gjatë intervenimit humanitar në Kosovë. Ishtë një sygjerim se çdo shtet liberal do të intervenonte apo do duhej të intervenonte në mënyrë të njëanshme për të ndaluar spastrimin etnik. Një koalicion më i mirë ndërkombëtar i vullnetit u bashkua dhe vendosi të veproj. Megjithëse, luftërat më të hershme të ish-Jugosllavisë (1990-1995) dhe intervenimi në Kosovë nxjerrën në pah institucionalizimin relativisht të dobët të Politikës së Përbashkët Evropiane të Jashtëme dhe të Sigurisë, institucionalistët liberal mund të theksojnë lëvizjet pasuese për të themeluar Forcën Evropiane të Reagimit të Shpejtë me mundësi të veproj pa mbështetjen e Shteteve të Bashkuara.[730] Kosova, kështu argumentojnë mbështetësit e Forcës Evropiane, demonstroi kontrastin shumë të madh që ekzistonte ndërmjet të dyja anëve të Atlantikut përsa i përket potencialeve ushtarake. Dhe sjellja e pakoordinuar e Aleancës, që më shumë anaonte nga dominimi (hegjemonia), kontribuoi në vendimin për të rifituar disa mjete për të përligjur në mënyrë të saktë interesat evropiane.[731]

Duke argumentuar në fakor të avancimit të arkitekturës së sigurisë kolektive, shumë teoricient (Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel, Stanley Hoffman), argumentojnë se aksioni ushtarak jashtë kornizës së Kombeve të Bashkuara nuk ishte opcion i pëlqyer i NATO-së. Drejtimi i saj për përdorimin e forcës ishte një koment kritik në rrethet institucionale për një aksion efektiv dhe në kohë nga Kombet e Bashkuara. Këta teoricien pohojn se kriza e Kosovës nxorri në pah rrjedhën qëndrore të arkitekturës së fundit të qeverisjes botërore, që është Këshilli i Sigurimit si autoritet legjitim dhe që organet regjionale mund të veprojnë vetëm me pëlqimin e Këshillit të Sigurimit. Por, pasiqë Rusia dhe Kina me fuqinë e vetos në KS, mund t'a kufizojnë apo pengojnë ndërhyrjen humanitare, spjegon se pse Washingtoni dhe Londra kanë favorizuar "koalicionet e vullnetit".

Shumë studiues dëshirojnë t'a ruajnë autoritetin ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara. Për shembull, Thakur dhe Schabel, bëjnë një pohim që: "adresimi i forcës nga NATO-ja ishte një përpjekje për t'a kthyer autoritetin e Kombeve të Bashkuara në Ballkan, që ishte shkatërruar nën kundërshtimin e pandërprerë nga Serbia". Megjithatë, duket se mënyra e vetme mbrojtjes së Kombeve të Bashkuara ishte që të menjanoj autoritetin e saj si një arbitër i fundit i përdorimit të forcës megjithëse e mbronë funkcionin e saj legjitimues. Në praktikë kjo ishte bërë, thekson Patrick

[730] Baylis and Smith, *The Globalization of World Politics*: 3e. Case Study: The 1999 Kosovo Crisis. IR Theory in Practice Case Study:The 1999 Kosovo Crisis. Section 2.Liberal IR Theory and the 1999 Kosovo Crisis.Oxford University Press, 2005, p. 2-3.
[731] H.Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*, Botimi i parë, Tiranë,2003,f.79.

Thornberry, konflikti përfundoi me rezolutën e Kombeve të Bashkuara, që duket se bëri të lajë çdo paligjshmëri të NATO-së sikurse vala në det".[732]

5. Rëndësia e Ligjit Ndërkombëtar.

Shpeshherë theksohet se ligji është produkt i politikës dhe pushtetit (James Michael). Për shembull, shoqëria ndërkombëtare e pas 1945 ishte e rekonstruktuar nën ndikimin e dy faktorëve qendror, të cilët në vitet 1990 më nuk ishin relevant – së pari, diskreditimi i sundimit kolonial dhe idetë e superioritetit të madh të pushtetit dhe së dyti, nevoja për të përmbajtur konfrontimin e Luftës së Ftohtë. Këta faktorë u reflektuan në institucionalizimin e barazisë ligjore dhe politike të shteteve sovrane dhe në kufizimin e përdorimit të forcës në rastet ku konsensusi do mund të arrihej në Këshillin e Sigurimit. Meqë u shemb balanca e fuqisë i Luftës së Ftohtë u krijua nevoja për një kornizë të re ligjore... Ky rindërtim ndërmjet ligjit ndërkombëtar dhe fuqisë politike ishte arritur pjesërisht përmes reagimeve në konfliktin e Kosovës. Kosova ka demonstruar përplasjen ndërmjet "normave të vjetra" të shoqërisë ndërkombëtare, të bazuara në balancin politik të vitit 1945 dhe të ruajtura në ligjin ndërkombëtar të Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe ndërmjet "normave të reja" të apeluara nga fuqitë e NATO-së, të cilat pohonin se kufizimi i përdorimit të forcës dhe mundësia e të drejtave të barabarta të sovranitetit ishin pengesë e rregullit efektiv ndërkombëtar. Çështja që është lënë e hapur, megjithëse është një veprim i "normës së drejtuar" të fuqive të NATO-së është në gjendje për formimin e plotë të kornizës institucionale dhe ligjore.[733]

5.1 Kosova në tendencat supranacionale të paqes

Lidhur me çështjen që u theksua më lart e që ka të bëjë me faktin se rasti i Kosovës ishte katalizator në transformimin e politikave të NATO-s, dhe të transformimit të doktrinave klasike të së drejtës ndërkombëtare, mund të ofrohen shpjegime në kuadër të të ashtuquajturave "Tendencat supranacionale të luftës".[734] Këto tendenca kanë të bëjë me praktikën e ndërhyrjes së një komuniteti të jashtëm (siç është p.sh. NATO) në "punët e brendshme" të një shteti të caktuar (siç është p.sh. Serbia) dhe duke e bërë thyerjen e sovranitetit të tij, e që vije në shprehje në disa rrethana specifike (siç janë p.sh. shkeljet e të drejtat e njeriut si në rastin e Kosovës"). Kështu pra, në mungesë të një autoriteti supranacional botëror, që pas LIIB-së mendohej se ishte OKB-ja, u krijua nevoja për rritjen e rolit të disa organizatave rajonale siç është NATO-ja. Intervenimi i NATO-s kundër

[732]D.Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations*, Rewiew Essay, The Global Review of Ethnopolitics Vol. 1, no. 4, Brunel University, UK, June 2002, pp.110-118.
[733] Po aty, p.110-118.
[734] B.Reka, *E Drejta e Unionit Evropian*, Instituti i Kosovës për Integrime Euro-Atlantike (KIEAI), Prishtinë, 2000, f.77.

Serbisë, megjithatë dha edhe provën praktike se me të gjitha të metat dhe kufizimet e kompromiseve politike midis pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, NATO, mundi që obligimet nga Kapitulli i VII i Kartës së OKB-së, t'i zbatojnë jo vetëm në rast të rrezikimit të paqes dhe sigurisë botërore a rajonale, nga konfliktet e armatosura midis shteteve por, edhe në rast të shkeljes masive dhe sistematike-të të drejtave të njeriut- deri në gjenocid, brenda një "shteti". Rasti i Kosovës imponoi nevojën e rishikimit të së drejtës tradicionale ndërkombëtare në drejtim të relativizmit të parimit të sovranitetit absolut klasik shtetëror, në të mirë të mbrojtjes së sovranitetit njerëzor.[735]

Siç dihet, ligji ndërkombëtare ka shumë për të thënë në lidhje me rastin e Kosovës por fokusi kryesisht bie në disa doktrina specifike të saj. Për shembull, *doktrina e luftës së drejtë* paraqet atë doktrin e cila mund të ofroj një kontribut të rëndësishëm në shpjegimin e disa çështjeve që doktrinat dhe teoritë e tjera i lënë të mjegullta. Në të vërtet duke pasur parasysh shpjegimet që u ofruan më lartë,sidomos në mënyrën se si u bë përdorimi i forcës dhe se si u realizuan veprimet luftarake të NATO-s kundër Serbisë, u vërejt se kishte pikëpamje mjaft radikale.

Për t'i nxjerrur në shesh këto pikëpamje radikale,dhe për t'i zbërthyer më tej, po e shtrojmë një pyetje: A ishte i drejtë dhe moral aksioni i NATO-s kundër Serbisë? Përgjigjet që vijnë për këtë pyetje argumentojnë se aksionet luftarake të NATO-s ishin të ligjshme dhe të moralshme, qëndrimet e tyre i justifikojnë përmes doktrinës së luftës së drejtë.

Kjo fushë e së drejtës është zhvilluar prej shkrimeve fetare (si ato të Augustinit dhe Akuinit) shekullore për luftërat e drejta. Sot, ligjshmëria e luftës përcaktohet nga Karta e OKB-së,e cila agresorin e nxjerr jashtë ligjit. Kundërpërgjigjja ndaj një agresioni është i vetmi rast kur lejohet përdorimi i forcës ushtarake në përputhje me doktrinën e luftës së drejtë. Ashtu si në rastin e Kosovës edhe në shembujt e shumtë të konflikteve dhe të luftës, kategoritë tradicionale të etikës së luftës së drejtë (të zhvilluar me burime të kombinuara të bindjes fetare dhe analizës psikologjike) ende janë mjeti më i përshtatshëm i analizës morale. Forca e etikës shtrihet në kompleksitetin e vetë, në metodën shumëdimensionale të analizimit të përdorimit të forcës. Po ky kompleksitet shpeshherë e bënë të vështirë të ketë njëzëshmëri të konkludimeve. Parimet e qëndrueshme duhet të

[735] Në fund të shekullit XX, Kosova – si rast, dha një mesazh të qartë hartuesve të së drejtës së re ndërkombëtare që të shkruhet një e drejtë e re ndërkombëtare në mileniumin e ri e cila nuk do të mbronte si deri më tash ekskluzivisht interesat e shteteve,integritetin territorial dhe ekzistencën e tij, por edhe integritetin biologjik të një kombi dhe ekzistencën fizike të qenies njerëzore. Fundja, intervenimi ushtarak kundër Serbisë, e bëri më real edhe supranacionalitetin, si fenomen jo vetëm teorik, por tani edhe real. Ky intervenim provoi se megjithatë, në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare në kalim nga shekulli XX në atë XXI, vetëm sa po ekziston një autoritet mbishtetëror, i cili po mundet të përdorë edhe forcën kundër një shteti, sa herë që ky i fundit nuk sillet brenda rregullave të përcaktuara, jo vetëm nga ai, por nga autoriteti supranacional.

japin zgjedhje specifike, madje edhe në pëlhurën e dendur të çështjeve morale që përbën enigmën e Kosovës.[736]

Kurse, sa u përket përkrahësve të doktrinës së luftës së drejtë, ata mbështetën në disa argumente specifike. Për shembull, Hugh Beach: fokusohet kryesisht në tri pika argumentuese që përbëhen nga: *Kauza e drejtë:* forca mund të përdoret vetëm ndaj të keqes publike, që nënkupton, agresionin apo dhunën masive të të drejtave themelore të të gjithë popujve. *Autoriteti i legjitim*: Vetëm autoritetet publike të konstituuara siç duhet mund ta përdorin forcën vdekjeprurëse apo të përfshihen në luftë. *Qëllim i drejtë*: Forca mund të përdoret vetëm në një çështje vërtetë të drejtë dhe vetëm për atë qëllim.[737]

Prandaj shikuar me logjikën e kauzës së drejtë, përdorimi i forcës nga ana e NATO-s ishte i drejtë dhe i justifikueshëm, sepse ishte bërë në emër të mbrojtjes së një vlere shumë të lartë siç është integriteti dhe dinjiteti njerëzorë nga shtypja sistematike që erdhi prej regjimit serb. Me një fjalë ishte mbrojtur një kauzë e drejtë.

Por, është një pjesë substanciale e mendimit dhe një praktikë e përkrahjes së këndvështrimit se ekzistojnë limite për atë liri të veprimit; kur bërësit e shtetit janë vetë fajtor për mizoritë dhe persekutimin e kombeve të tyre në atë mënyrë sa që t'i mohoj të drejtat e tyre themelore dhe ta shokoj ndërgjegjen e njerëzimit, intervenimi në të mirë të njerëzimit ligjërisht është i lejueshëm.[738]

Në këtë drejtim mund të jepen vlerësime mjaft relevante. *Së rari*, aksionet e NATO-së në asnjë kuptim nuk ishin arbitrare(në kuptimin e realizmit klasi) dhe të pamenduara, për faktin se ato ishin rezultat i një marrëveshje uninime ndërmjet nëntëmbdhjet shteteve demokratike.

Edhe këtu mund të shtrohet një pyetje se deri në çfarë mase intersi është përbërës i nenojshëm në qëllimin e drejtë?

Në rastin e Kosovës çështja humanitare ishte qartë motivi kryesorë, por që kredibiliteti i NATO-së (i prezantuara në disa drejtime edhe si hegjemonizmi Amerikan), poashtu ishte një tjetër çështje. Pastaj një faktor tjeter ishte se, nëse Millosheviçi do të ishte lejuar të vepronte lirshëm në Kosovë, atëherë kjo do të mund të qonte në destabilizimin e rajonit duke e provokuar një luftë të

[736] J. Bryan Hehir, *Kosovo: A War of Values and the Values of War.* First published in *America vol.* 180 (May 15, 1999): p.7-12. Hehir shtonse Kosova kërkon një etikë shumëdimensionale, sepse moraliteti nuk shtrihet në një vend në këtë konflikt, të cilin George Will e ka quajtur "luftë e vlerave". Sfida morale për politikë ngrihet nga ndërprerja e konkurrencës së kërkesave morale. Çështja e parë e etikës tradicionale përcaktohet vetëm si çështje: A janë vlerat në rrezik në një konflikt të veçantë të një karakteri të tillë që ndërgjegjja, marrja sistematike e jetës (dhe jetët e rrezikuara) mund të kërkohet që t'i ruajmë ato? Në një shkallë, tregimi i Kosovës jep një po bindëse në këtë pyetje: mbi një milion njerëz të larguar nga shtëpitë e tyre me metoda brutale të vrasjes, dhunimit, djegia dhe grabitja e fshatrave të tyre. Siç ka thënë Mark Danner në *The New York Review of Books* ("Endgame in Kosovo", 6 maj 1999), ky spastrim i Kosovarëve nuk ishte rezultat i turbullirës së luftës, por produkt i "racionalizmit të planifikuar". Në Kosovën e parafiguruar nga spastrimi etnik i Bosnjës, bota (edhe qytetarët edhe shtetet e tyre) e dinë saktësisht se çfarë po ndodhë, dhe ne e dimë kush është përgjegjës. Nëse rezultati i këtij racionaliteti të planifikuar nuk e formon luftën e drejtë, atëherë është e vështirë të dihet se çfarë domethënie ka kategoria.

[737] Hugh Beach, *Secessions, interventions and just war theory: the case of Kosovo*. Volume 1 - Number 1.February 2000.

[738] L. Oppenheim, *International Law*, Vol 1, Longman, 1948, p. 279.

mundshme më të madhe Ballkanike, nga e cila vetë shtetet e NATO-së do të ishin caku i fundit për probleme.

Bibliografia:

B.Reka. (2000), *E Drejta e Unionit Evropian*. Instituti i Kosovës për Integrime Euro-Atlantike (KIEAI), Prishtinë.

Baylis and Smith. (2005), *The Globalization of World Politics*: 3e. Case Study: The 1999 Kosovo Crisis. IR Theory in Practice Case Study:The 1999 Kosovo Crisis. Section 2.Liberal IR Theory and the 1999 Kosovo Crisis.Oxford University Press, London.

D.Chandler. (2002),'Kosovo and the Remaking of International Relations, Rewiew Essay', *The Global Review of Ethnopolitics*, Vol. 1, (no. 4), June 2002, pp.110-118.

H.Beach. (2000), 'Secessions, interventions and just war theory: the case of Kosovo',Vol. 1 (Number1)

H.Kissinger. (2003), *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*. Botimi i parë, Tiranë.

J. Bryan Hehir. (1999), 'Kosovo: A War of Values and the Values of War', *The New York Review of Books*, America vol. (180), pp7-12.

J.Fischer. (2007), *Vitet kuq-gjelbër(Politika e jashtme gjermane-nga Kosova e deri më 11 shtator)*.KOHA, Prishtinë.

L. Oppenheim. (1948), *International Law*, Vol 1, Longman.

S.Burchill, R.Devetak, A.Linklater, M.Paterson, Ch.Reus-Smit and J.True. (2001), *Theories of International Relations*, Second Edition, Palgrave, London.

E Drejta Ndërkombëtare Private

Shpresa Ibrahimi

Department of Law, Iliria University, Lecturer, Kosova

Abstract

Frost, Robert- na bën të motivohemi për të punuar me thënjën e tij- `` *Bota është më e plotë me njerzë që dëshirojnë të punojnë, dhe tjerë që dëshirojnë t`i lejojnë të bëjnë këtë.* E pse duhet të jemi njerëzë që punojmë?; për europianizimin e të drejtës ndërkombëtare private, mesiguri që rendi juridik botëror na lejon të punojmë, me rregullat dhe primatet e saja që e udhëheq politikën botërore. Një nga qështjet më kontestuese mbrenda Bashkimit Europian është europianizimi i të drejtës private. Qarkulliminë e njerëzve, shërbimeve, mallrave dhe kapitalit më së miri do i` a mundësonte nxerrja e një Kodi unik privat mbrenda BE-së, e që do shmangte konteste për të drejtën kompetente.

Deri sa në sferat e politikave publike, shtetet mbrenda BE-së dhe ato që synojn të antarësohen në këtë organizatë kanë hequr dorë- bile edhe nga një pjesë e sovranitetit, pse është aq jo e lehtë dhe jo e arritshme unifikimi i të drejtës private. Mesiguri që qështjet e të drejtës familjare e trashëgimore, pronësore e kontaktore, qështjet ku hyn e drejta e autonomisë së vullnetit, bën të mendojmë se qytetarët nuk janë edhe pro pozitës së qytetarit europian.

Sistemi juridik i Kosovës, në ndëritim e sipër është një hap përpara harmonizimit me rregullat e Bashkimit Europian nga sfera e të drejtës private. Do ishte e mirëseardhur që Kosova dhe Shqipëria të bashkpunonin për të krijuar një ``Kod Unik Civil``, e them këtë se `*Rruga e Kombit*` ka bërë që shqipëtaret nga të dyja anët e kufirit kanë liri lëvizje dhe krijojnë raporte nga sferat që hyjnë në të drejtën Private dhe kështu do shmangeshin konfiktet si për kompetencën territorjale dhe lëndore, rezultat i të cilës do ishte intesifikimim i marrdhënjëve juridike private.

Fjalët kyçe: *E drejta ndërkombëtare Private, Kodi Unik Europian, Rendi i ri botërorë, Sistemi Juridik i Kosovës.*

Në procesin e krijimit të drejtës, në stadet e para të krijmit të saj; krijohen dy degë të pavarura: e drejta publike dhe e drejta private. Për të drejtën publike, shoqëria ishte e vetëdijsuar që rregullon raportin mes shtetit dhe qytetarit, pra rregullat e sferës së intersit më të gjerë, interesit publik. `` *Publicium jus est quod statum rei romanae spectat, privatum, quad ad singularum utilitatem.* ``[739]E drejta private, qysh prej të drejtës romake ka hyrë në kategorin e të drejtave që rregullon sferën private të qytetarëve romak. Mund thuhet që është dega më e vjetër e së drejtës, por edhe më e gjerë; falë objektit të gjerë të rregullimit. Kur thuhet që është dega më e vjetër e së drejtës, tregohet rruga që ka kaluar për tu përsosur si degë e pavarur e së drejtës. Juristët romak me analizën e themeltë që i`a kanë bërë të drejtës private, bënë që thuktësia dhe thellsia e studimit tyre të jetësohej edhe me legjeslacionin bashkëkohorë në fushën e të drejtës private. Jehonën më të madhe, i` a dha Revolucioni Borgjez Francezë- në krye me Napoleon Bonopartën. Autonomia e lirë e vullnetit është parimi bazë që i identifikon raportet nga sfera private. Parim që i mundëson qytetarëve që të jenë të aftë të vendosin për subjektin, objektin të drejtat dhe detyrimet që dalin nga e drejta private. Kur thuhet objekti më i gjerë i rregullimit të një sfere të drejtës, tregon sistematizimi që i është bërë të drejtës civile: Sistemi institucional dhe Sistemi Pandekt. Sistemi institutcional të drejtën private e ndanë në tri kategori në Persona,[740] Sende dhe Padi, ndërkaç sistemi Pandekt të drejtën private e ndanë në të drejtën Civile- pjesa e përgjithshme, E drejta Sendore, E drejta Trashëgimore, E drejta Familjare dhe e drejta Obligacioneve. Nga këtu shihet objekti i gjerë i rregullimit që hynë edhe e drejta e Punës, e drejta Tregtare, e drejta ekomomike, gjitha të drejtat që kanë përbazë iniciativën e lirë të vullnetit dhe barabartësinë e palëve dhe të vullnetit të tyre. Është kjarësishtë e dallueshme se e drejta civile, gati gjithmonë e kodifikuar në kode civile, është më e ngushtë për nga objekti i rregullimit, pasi që hynë në pjesën e të drejtës private. Shifet që nuk është e lehtë për një sistem juridik, procedimi me çështjet e të drejtës private, falë gjerësisë dhe primatit të autonomis së vullnetit për krijimin e raporteve nga kjo fushë, por nëse raportit të drejtës privat i` a shtojmë edhe elemntin e huaj për këto marrdhënje; sigurisht që çështja del shumë më e vështir për t`u zgjidhur. Elementi i huaj është karakteristikë dhe aryeja e ekzistencës së të drejtës nderkombetare private. Elementi huaj mund të shfaqet në subjekt, objekt dhe të drejta e detyrime nga fushat e të drejtës private. Ajo ashtu si edhe e objekti i të drejtës civile, rregullon marrdhënjët nga fusha familjare dhe trashëgimore, marrdhënjet ekonomike e të punës por me një risi me elementin e huaj. [741]

[739] Digesta- l. 1. 1
[740] Latifi Dr, Juliana, E drejta Civile- Pjesa e përgjithëshme, Tiranë 2007, fq 14
[741] Bilalli, Dr Asllan; Kuçi, Dr Hajredin, ` E drejta ndërkombëtare Private `, Prishtinë 2009, fq 103

Nevoja për rregullimin e këtyre marrdhënjeve juridike me element të huaj, paraqitet fillimisht si çështje të trajtuara nga shkollat teorike të shek XII- të dhe të XII- të.[742] Si edhe për çdo degë tjetër të së drejtës që është e kushtëzuar nga realiteti i forcave shoqërore, për të drejtën ndërkombëtare private faktor shtytës zhvllimi i forcave prodhuese, marrdhënjet në prodhim, migrimet e popullsisë; jehona që bëri Revulucioni borgjez Francez, zbulimet e mëdha, zhvillimi i industrisë janë janë faktorë në rradhë të parë që nxisin nevojen e komunikimit të qytetarëve të shetetëve të ndryshme, e që si rezultat mund të jetë i shprehur në subjektin e marrdhënjës, objektin apo të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ekziston primati se çdo shtetë i mbështetur në iden e nacionalizmit dinë më së miri dhe është më kompetenti për zgjidhjen e çështjeve që paraqiten para gjykatave të tyre; por ideja dhe premisa e nacionalitetit nënkupton se subjekti i mardhënjës juridike private me element të huaj; mund të ketë nacionalitet të shtetit tjetër; edhe nëse një Italian krijon martesë në shtetë tjetër me një shtetase të vendit; shtrohet qështja se cila gjykatë është kompetente dhe në bazë cilit ligj rregullohen fushat e të drejtave personale, faktet vendimtare tregojnë se aplikohet ligji i shtetësisë dhe kështu lind çështja e konflikteve të ligjit.

E drejta ndërkombëtare private u krijua si degë e pavarur e së drejtës në kohën e revulucioneve borgjeze. Nuk mund të paramendohet trendi i transnacionalizmit, globalizimit, tregut të përbashket të njerëzve, mallrave, sherbimeve e kapitalit në BE- por edhe në nivel lokal, pa një degë të veçantë pozitive të quajtur e drejta ndërkombëtare private. Këtë degë të drejtës e gjejmë të rregulluar me dispozita të veçanta në kode Civile por edhe me Ligje siç është edhe në Rrepublikën e Shqipërisë[743], Maqedonisë (gati në shumicën e legjislacione të Europës). Ekzistencën e një legjislacioni të drejtës ndërkombëtare private e dëshmon se pasojat e raporteve private me element të huaj, shtrihen në nivel shtetëror por edhe në atë ndërkombëtarë.[744] Për shumë arsye, e kërkon realiteti kosovarë; një Kodifikim të drejtës private, ani pse shumica e pjesëve të saj janë të rregulluara me ligje të veçanta, por mbi të gjitha kërkon rregullim të drejtës ndërkombëtare private me ligj të veçantë që mundëson stabilitet dhe siguri më të madhe për qytetarët e huaj për të krijuar raporte juridike private të nduarndryshme, por edhe për të tërhequr investimet e huaja, si imperativ pët ngritjen e nivelit të standartit jetësor e ekonomik të vendit. Kosova normalisht është në rrugë të mirë të harmonizimit të legjslacionit, falë udhëheqjes ndërkombëtare drejtë proceseve të integrimeve të vendit në rajonë por edhe atë Europian.[745]

Metodat që përdorën për rregullimin e të drejtës ndërkombëtare privatë; janë metoda e drejtëpërdrejtë dhe e tërthortë. Metoda e drejtëpërdrejtë është metod më e sofistikuar e rregullimit të

[742] Kalia, Dr Ardian, `` E drejta Ndërkombëtare private``, Sejko, fq 10
[743] ProjektLigji Nr.10 428, datë 2.6.2011 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Rrepulikës së Shqipërisë
[744] Jezdic, Dr M, Meduradno privatno pravo, Beograd, 1983, fq 3
[745] Për rregullimin e mardhenjëve juridike private në Kosovë është në fuqi legjslacioni para 89- tës që nuk posedon karakter diskriminues; e që është Ligji Federativ për të drejtën ndërkombëtare private; 15. IV. 1078

marrdhënjëve private me element të huaj pasi që këto raporte i rregullon në mënyr aubsatnciale dhe materiale, duke i autorizuar oganet kompetente që të zbatojnë vetëm të drejtën e vendit duke i zgjidhur qështjet në mënyr meritore dhe të drejtëpërdrejtë. Nuk e thash rasishtë se është metod më e sofistikuar e rregullimit pasi krijon iden e një të drejtë univerzale që eliminon apo zgogëlon munësin e konfliketeve me shteteve për të drejtën kompetente. Kështu edhe në ligjet e veçanta të Rrepublikës së Kosovës përcaktohen p.sh se të huajt mund të fitojn të drejtë pronësorëe në Kosovë me kushtë që kjo e drejtë ushtrohet me reciprocitet, po ashtu edhe në Ligjin për Investimet e huaja përcaktohet se të huajt mund të investojnë kapitaline tyre në Rr. Kosovës qoftë si pronarë të vetëm apo bashkëpronarë. Mënyren e tillë të rregullimit parashihet edhe në traktatet ndërshtetrore apo ndërkombëtare duke unifikuar rregullat për të marrdhënjet private me element të huaj.[746]

Metod tjetër e rregullimit të marrdhënjeve juridike private të akceptuar edhe nga legjislacioni shqipëtar paraqitet mënyra indirekte e rregullimit e quajtur metod kolizive duke zgjidhur qështjen juridiko- private me element të huaj jo në mënyr meritore apo direkte por duke zgjidhur atë në bazë të pikave të lidhjes se a do zbatohet e drejta e vendit apo e huaj për çështjen juridike pirvate. Neni 12 i Ligjit për të drejtën Ndërkombëtare Private. Zotësia për të vepruar e personit fizik dhe kufizimi apo heqja e zotësisë për të vepruar rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka. Nëse zotësia për të vepruar është fituar një herë, ajo nuk humbet për shkak të ndryshimit të shtetësisë. Kjo metod paraqitet më e thjeshtë dhe më e akceptuar prej shteteve sepse lenë mundësi më të mëdha për të përcaktuar se cila e drejtë apo mbrenda cilit sistem do gjendet zgjidhja. Normat e te Drejtes Nderkombetare Private nuk mund ti shohim jashtë zhvillimit ekonomiko- shoqëror e politik. Andaj ato duhet ti studjojm në aspect komporative në mënyr që ndihmojnë në harmonizim më të mirë të të drejtës ndërkombëtare private, qoftë me Kod Civil, konventa apo traktate. Mënyra kolizive që aplikohet në zgjidhjen e marrdhënjës juridike- private me element të huaj, shërbejnë për të përcakuar normat juridike që do zbatohen për rregullimin e marrdhënjës me element të huaj, jo duke e zgjidhur qështjen në mënyr të drejtëpërdrejtë[747], e kjo falë dallimit që paraqitet mes normave materiale dhe procedurale. Normat e Lex Forit në kuptimin Formal (Ligji i gjykatës) – përcaktojnë se në çështjet juridike- private me elementë të huaj kompetente është gjykata para të cilës paraqitet marrdhënja juridike private me element të huaj dhe rregullat procedurale të saj; që gjykatësi i referohet të drejtës ndërkombëtare private të territorit të gjykatës para të cilës zhvillohet procesi.[748] Kështu edhe në Projekt ligjin për të drejtën ndërkombëtare private të Rrepublikës së Shqipërisë përcaktohet objektivat e ligjit dhe për caktohet

[746] Bilalli, Dr Asllan; Kuçi, Dr Hajredin, ` E drejta ndërkombëtare Private `, Prishtinë 2009, fq 103

747 Normat e Lex Forit ne Kuptimin Material- Paraqesin ato norma të cilat apikohen per tu dhene zgjidhje direkte problemeve te ceshtjeve te ndryshme- normat e brendshme te pergjithshme.

[748] Kalia, Dr Ardian, `` E drejta Ndërkombëtare private``, Sejko, fq 103

efekti koliziv dhe efekti i Lex Forit në nenin 1; a) rregullat, lidhur me ligjin që zbatohet në marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja; b) juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare, lidhur me marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja. Bazuar në këtë ne arrijmë në përfundim se normat kolizikve, janë norma instrumentale, që si detyrë e kanë referimin herë tek norma e vendit (lex Fori) e herë tek e drejta e huaj.

Rregullimi i të drejtës ndërkombëtare private me konventa ndërkombëtare

Çështjet e të drejtës private, e sidomos ato me element të huaj, paraqiten qështje që ofrojnë zgjidhje të ndryshme për rastet e njejta. Mos aplikimi i rregullave të njejta për raste të njejta ofron shumë zgjidhje, bilez edhe konflikt mes shteteve për të drejtën kompetente. Me qëllim të eleminimit të këtyre konflikteve edhe për të përmbushur objektivat e një globalizmi gjithëpërfshirës ku si primat shërben eliminimi i konflikteve të shteteve, unifikimi apo harmonizimi i normave juridike do shërbente që të jepeshin përgjigje të njejta apo afërsishtë të njejta, pavarsisht vendit ku ka ardhur në pytje rasti i rregullimit të të drejtës private me element të huaj. Qysh në vitin 1874 Pasquale Manqini përmes një raporti, paraqiti para Institutit për të drejten Ndërkombëtare Private, nevojën e domosdoshme të zgjedhjes së njejta për çështjet që lindin nga e drejta ndërkombtare private; dhe propozoj që kjo zgjidhje uniforme të jetë bërë me anë të Konventave Ndërkombëtare. Në periudha të pothuajse të njejta por në vende të ndryshme u organizua Konferenca e Hages për rregullimin e të drejtës private me element të huaj.[749]

Konferenca e Hages duke e parë karakterin e përheshëm të Konferencës së Hages mbi të drejtën ndërkombëtare private; si qëllim i përhershëm i saj paraqitet njehëimi progresiv i rregullave të drejtës Ndërkombëtare Private[750]. Puna e Konferencës së Hages është jashtëzakonisht produktive për rregullimin e çështjeve nga kjo fushë. Vlenë të theksohet pjesmarrja e gjerë e shteteve, përfshinë edhe Rrepublikën e Shqipërisë.[751]Përveç nga numri i shteteve që kanë akceptuar statutin e Konferencës së Hages, konsiderohet si qendër botërore për të intesifikuar bashkpunimin si gjygjësor dhe administrativ për të unifikuar të drejtën ndërkombëtare private me shtrije univerazale dhe atë duke përdorur mënyren indirekte te qujatur me metod kolizive se ado apikohet e drejta e vendit apo e hauj për të rregulluar marrdhënjen me element të huaj. Një mori konventa ndërkombëtare janë produkt i punës qindra vjeçare të konferencës së Hages.[752] Deri tani janë

[749] Bilalli, Dr Asllan; Kuçi, Dr Hajredin, ` E drejta ndërkombëtare Private `, Prishtinë 2009, fq 77
[750] Statuti I Konferencës së Hages mbi të Drejtën Ndërkombëtre Private, 31. 1951, ndyshuar 30. 06. 2005; neni 1.
[751] Mirtimi i Statutit të Konferencës së Hages për të Drejtën Ndërkombëtare Private nga Rrepublika e Shqipërise. Miratuar më 12.05.2005
[752] Statute of the Hague Conference on Private International Law;Convention of 1 March 1954 on civil procedureConvention of 15 June 1955 on the law applicable to international sales of goods; Convention of 15 April 1958 on the law governing transfer of title in

miratuar 39 konventa.[753] Rrepublika e Kosovës, Shqipërisë[754], Maqedonisë, Malit të Zi në dispozita kushtetuese e kanë të përcaktuar se konventat që i kanë ratifikuar kanë fuqi më të lartë se ligji nacionale. Kështu në nenin 19 të Kushtetutës së Rrepublikës së Kosovës përcakton se Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.[755] Konferenca e Hages me punën e saj, kontribon shumë edhe në zhvillimin e shkencës juridike.[756]

Përveç kësaj iniciative univerzale për të unifikuar të drejtën ndërkombëtare private e gjejmë të ralizoj; Instituti për unifikimin e të drejtës private dhe të drejtës ndërkombëtare private me seli në Romë. Është themeluar si organ ndihmë i Kombeve të Bshkuara më 1926, por me një marrëveshje multilaterale u rithemelua me statutin e UNDROIT më 1940.[757] Pjesmarrja shtetërore është e kufizuar, por pjesarrjen e shteteve për krahasim të mirëfilltë të instituteve e realizon nga pesë kontinentet, që posedojnë dallime kulturore, politike, shoqërore e ekonomile. Edhe puna e këtij institutit vlenë të çmohet shumë, falë rezulatateve të arritura, bile edhe për metodën e përdorur për unifikimin e të drejtës private ndërkombëtare, të quajturën metod të drejtëpërdrejtë apo të unifikimit materiale,[758]fillimisht duke krahasuar zgjidhjet e instituteve të sistemeve të ndryshme, dhe në momentin e gjetjes së tyre si të përafërta ju propozon shteteve për ti përfshir ato në sistemin e tyre juridik. [759] Puna e Institutit është më tepër teknike, jo shumë e ndikuar nga çështjet politike.

---

international sales of goods; Convention of 5 October 1961 concerning the poëers of authorities and the laë applicable in respect of the protection of infants; Convention of 5 October 1961 on the Conflicts of Laws Relating to the Form of Testamentary Dispositions; Convention of 1 August 1989 on the Laë Applicable to Succession to the Estates of Deceased Persons; Convention of 29 May 1993 on Protection of Children and Co-operation in Respect of Intercountry Adoption; Convention of 19 October 1996 on Jurisdiction, Applicable Laë, Recognition, Enforcement and Co-operation in Respect of Parental Responsibility and Measures for the Protection of Children; Convention of 13 January 2000 on the International Protection of Adults; Convention of 5 July 2006 on the Laë Applicable to Certain Rights in Respect of Securities held ëith an Intermediary; Convention of 30 June 2005 on Choice of Court Agreements; Convention of 23 November 2007 on the International Recovery of Child Support and Other Forms of Family Maintenance; Protocol of 23 November 2007 on the Laë Applicable to Maintenance Obligations.

[753] http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.listing

[754] Statuti i Hagës i Konferencës për të drejtën ndërkombëtare private, 31 tetor 1951 Nënshkruar:4.6.2002. Në fuqi më: 4.06.2002.

2. Konventa për heqjen e kërkesave për legalizimin e dokumenteve publike të huaj, 5 tetor 1961 Aderuar: 3.09.2003. Në fuqi: 9.05. 2004.

3. Konventa për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, 19 tetor 1996 Aderuar më 18.05. 2006. Në fuqi: 1.04. 2007.

4. Konventa për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, 25 tetor 1980 Aderuar: 4.05.2007. Në fuqi: 10.10. 2007.

5. Konventa për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimit në lidhje me birësimet ndërshtetërore, 29 maj 1993 Nënshkruar: 12.09. 2000. Në fuqi: 1.01.2001.

8. Konventa për shërbimet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore të dokumenteve në çështjet civile dhe tregtare, 15 nëntor 1965 Aderuar: 1.11.2006. Në fuqi: 1.7.2007.

9. Konventa për akses ndërkombëtar në drejtësi, 25 tetor 1980 Aderuar: 15.10.2007. Në fuqi: 1.1.2008.

[755] Kushtetuta e Rrepublikës së Kosovës; e cila hynë në fuqi 15 qershor 2008.

[756] Hetemi, Dr Mehdi, E drejta nderkombëtare tregtare- afariste, Prishtinë, 2007

[757] http://www.unidroit.org/dynasite.cfm?dsmid=103284

[758] Bilalli, Dr Asllan; Kuçi, Dr Hajredin, ` E drejta ndërkombëtare Private `, Prishtinë 2009, fq 96

[759] 1964 Convention relating to a Uniform Laë on the Formation of Contracts for the International Sale of Goods (The Hague); 1964 Convention relating to a Uniform Laë on the International Sale of Goods (The Hague);

Megjithatë duhet cekuar se unifikimi paraqet procesë të vështirë sepse realizon shkrirjen (apo zëvendësimin) e më shumë sistemeve në një të vetëm; si vizion i eleminimit të dallimeve dhe duke ofruar zgjidhje në formë të standarteve minimale.

Harmonizimi i të drejtës ndërkombëtare private në BE

Nuk mund të paramendohet krijimi i legjeslacionit të ri, qoftë i Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë e më gjerë; pa u njohur me proceset që udhëheq Bashkimi Europian në krijimin e të drejtës së përbashkët e quajtura Aqcuis Communautaire. E quajtëm të domsdoshëm ndjekjen e këtij procesi jo rastësishtë pasi që vendet e lartëcekura për të qenë pjesë e kësaj superstrukuture duhet të plotësojnë `` *kriteret e Kopenhangës* " ku shprehimisht nga shtetet me aspirata për t'u anëtarësuar në BE kërkohet "ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësia për të përballuar presionin konkurrruës dhe forcat e tregut brenda unionit". Edhe Kosova përcakton në bazë të Kushtetutës së saj, Neni 10 i Kushtetutës së Kosovës "Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Një Europ pa kufij dertimonon qarkullim të lirë të njerëzve, shërbimeve, mallit e kapitalit prej një vendi në vendin tjetër. Liria e lëvizjes nënkutpon krijimin e marrdhënjeve juridike- private, me element të huaj, të shprehura qoftë në subjekt, objekt apo në të drejta e detyrime.

Duke u bazuar në këto marrdhënje të shumta dhe të pashmangshme, dalin iniciativa për të rregulluar të drejtën private në BE. Krijimi i të cilës shmang konflikte edhe për të drejtën ndërkombëtare private mbrenda BE për të drejtën kompetente. Legjeslacioni i Bashkimit Europian për rregullimin e fushave të ndryshme përbëhet kryesisht përmes traktateve, rregulloreve dhe direktivave të Këshillit Europian si dhe prej vendimeve të Komisionit Europian.[760]

Në fushat tjera të drejtës unifikimi i të drejtës është në nivel më të lartë. Në çështjet e të drejtës private dhe të drejtës ndeërkombëtare private, nuk mund të themi rezultate të knaqshme, edhe pse duke filluar prej iniciativave të strukturës akademike universitare të profesorësve Ole Lando dhe Christin V. Bar, punë e udhëhequr nga Komosioni Europian, fillimisht të pjesët e

---

1970 International Convention on the Travel Contract (Brussels);
1973 Convention providing a Uniform Laë on the Form of an International Ëill (Ëashington);
1983 Convention on Agency in the International Sale of Goods (Geneva);
1988 UNIDROIT Convention on International Financial Leasing (Ottaëa);
1988 UNIDROIT Convention on International Factoring (Ottaëa);
1995 UNIDROIT Convention on Stolen or Illegally Exported Cultural Objects (Rome);2001 Convention on International Interests in Mobile Equipment and Protocol to the Convention on Matters specific to Aircraft Equipment (CapeTown);2002 Model Franchise Disclosure Law 2007 Luxembourg Protocol on Matters specific to Railway Rolling Stock to the Convention on International Interests in Mobile Equipment.
2008 UNIDROIT Model Law on Leasing
2009 UNIDROIT Convention on Substantive Rules for Intermediated Securities
2012 Protocol to the Convention on International Interests in Mobile Assets on Matters Specific to Space Assets.

[760] Fondacioni Soros,`` Konkurrenca: Korniza ligjore dhe praktika ne Kosovë krahas standardeve Evropiane``, Prishtinë 2010

veçanta të drejtës private, e që është e drejta kontraktore. Puna e bërë rezultoj që prej 1982- 2003 të publikohen tri pjesë të parimeve të drejtës kontraktore, punë e gjatë por e rezultuar me mjaftë suksesë, duke ditur dallimet e legjslacioneve për të drejtën kontraktore, punë në të cilën morën pjesë një numër i gjerë i juristeve të të gjitha vendeve antare të BE-së. Por ideja e Kodit Unik Civil nuk rezultoj të jetë e sukseshme, falë dallimeve të sistemeve juridike mbrenda BE. Parimet e publikuara aplikohen vetëm si unifikim i të drejtës kontraktore mbrenda BE-së e që për këtë unifikim vlenë të ceket rezulatiti jashtëzakonishtë pozitiv vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, si të detyrueshme për vendet anëtare. Por unifikimi vetëm si i të drejtës kontraktore vetëm si alternativ ndaj të drejtës nacionale normalisht që nuk është për tu lavdruar pasi që më tepër është dokument akdemik dhe jo praktike pasi që konsiderohet që më mirë iniciativa për unifikimin e të drejtës private të vije nga parlamentet nacionale (që me traktatin e Lisbones kanë zgjerim kompetncashë për iniciativa) apo edhe nga parlamenti Europian e nga Komisionet. Kritikat e bëra për këtë mënyr të unifikimit janë të mirëseardhura dhe i` a lehtësojnë punën idesë për një Kod Unik Civil. Normalisht krijimi i një kodi Unik Civil dhe të drejtës ndërkombëtare private nuk është vetëm çështje e iniciatives private, pasi që ka të bëjë me raportin e qytetarëve të BE-së me qytetarët, objketin apo të drejtat dhe detyrimet e shtetit tjetër dhe zgjidhja tij ka edhe përgjegjësi politike.[761]

Hyrja në fuqi e traktatit të Lisbonës ëndrrën e Europës të konsuliduar të unifikuar e bënë realitet, falë ngritjes së pozitës të qytetarit europian, duke i dhënë iniciativë dhe të drejta qytetare më të larta; kështu duke krijaur institucione moderne, dhe atë në shërbim të qytetarit Europës; duke i dhënë mundësi edhe parlementeve vendore, në shqyrtimin e iniciativave ligjvëbëse. [762]Bazën për një hamonizim dhe unifikim të drejtës në BE e gjejmë edhe në preambulen e Traktatit të Lisbones: DUKE KUJTUAR rëndësinë historike të dhënies fund të ndarjes së kontinentit të Europës dhe nevojën për të krijuar baza të forta për ndërtimin e Europës së të ardhmes.[763] Koncepti i harmonizimit është objektivë parësore që siguron tregtinë e lirë dhe të përbaahshkët dhe në këtë mënyr ju ofron siguri qytetarëve; duke krahasuar sistemet judike dhe duke ofruar zgjidhje të përafërta; duke eliminuar dallimet e mëdha mes sitemeve juridike të shteteve për të drejtën private. Nga kjo rezultatit i harmonizimit është se gjykatat e shteteve europiane; ofrojnë zgjidhje

[761] Universiteti Leiden `` Proponents of the harmonization of European private law are taking the debate to appalling levels``
Posted on March 11, 2013 in Private Laë

[762] Parlamentet nacionale tani mund të kontrollojnë edhe përputhjen me parimet e subvencionimit dhe proporcionalitetit. Për këtë arsye, është futur një sistem i njoftimit të hershëm, i cili u lejon parlamenteve nacionale të japin qëndrim të argumentuar, tetë javë pas transmetimit të propozimit legjislativ, ku do të qartësojnë pse propozimi legjislativ në fj alë, nuk plotëson kërkesat e subvencionimit dhe proporcionalitetit.
http://eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/publications/abc_of_european_laë_sq.pdf

[763] Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, 13 December 2007

përafësishtë të njejta; pavarsisht a kanë aplikuar të drejtën e vendit apo të huaj, pavarsisht provedurave që kanë aplikuar.

Iniciativat për harmonizim të drejtës private dhe ndërkombëtare private, paraqet vizion që paraqitet qysh moti. Finesat e tij gjejmë në tek Profesori O. Lando (siç është cekur më lartë), por megjithatë punen e madhe që është bërë ende nuk kemi arritur në nxerrjen jo vetëm të një Kodi Unik Civil po as të drejtës ndërkombëtare Private.[764]

Të drejtat privat që kanë të bëjnë me statusin e personit fizik e juridik, dallojnë prej një sistemi juridik në tjetrin dhe konsiderohet kategori e veçantë dhe shumë e rëndësishme për shtetin, nacionalitetin e të cilës e kanë, në këtë pjesë të drejtës private, dhe atë pronësore e komerciale, shifen rezistencat më të mëdha për të gjetur zgjidhjet e përafërta pavarsisht vendit se ku shqyrtohet çështja jurdike- private. Megjithë bartjen e një sërë kompetencave në BE; vërehet tendenca e dy fuqive botërore për të prolonguar apo më mirë të themi për të imponuar zgjidhjet edhe për më teper për të ngritur çështjen e nacionalizmit duke ofruar si zgjidhje më të mireë atë të Kodit Civil Gjerman dhe Kodit Civil Francez.

Puna e filluar mbrenda BE-së për harmonizimin e të drejtës ndërkombëtare private me gjithë problematikën e çështjeve të hulumtuara për të gjetur pika të përbashkëta, ka rezuluar me një mori direktivash që shtrijnë efekt mbrenda BE-së por edhe jashtë saj. [765] Direktivat për përgjegjësin civile për mjetet motorike; Sigurimit të jetës; Teknologjia e informacionit / E-Commerce (tregtia elektonike); Insolvenca; Pronave; Pronësia Intelektuale; Prokurimit Publik; Punës; përgjegjësia jashtkontraktore nga dëmi; Konkurrencës; Konsumatorit; kontratës; Konsumatorit; Mbrojtja e të dhënave. [766] Edhe në çështjet që kanë të bëjnë për bashkpunimin ndërgjygjësor dhe tregtarë është arritur të krijohen rregulla të harmonizuara mbrenda BE- së.[767]

---

[764] The Codification of Private International Law in Europe: Could the Community Learn from the Experience of Mixed Jurisdictions? Aude Fiorini; EJCL

[765] **Insurance Law** Council Directive 64/225/EEC of 25 February 1964 on the abolition of restrictions on freedom of establishment and freedom to provide services in respect of reinsurance and retrocession, *Official Journal* L 56, 04/04/1964,

[766] ***Civil liability motor vehicles*** Council Directive 72/166/EEC of 24 April 1972 on the approximation of the laës of Member States relating to insurance against civil liability in respect of the use of motor vehicles, and to the enforcement of the obligation to insure against such liability, Official Journal L 103, 02/05/1972, p. 1; as amended by Directives 72/430 and 84/5; consolidated version available: http://europa.eu.int/eur-lex/en/consleg/main/1972/en_1972L0166_index.html

Life insurance **;** DIRECTIVE 2002/83/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 5 November 2002 concerning life assurance, O.J. 2002 L 345/1

Non-life insurance First Council Directive 73/239/EEC of 24 July 1973 on the coordination of laës, regulations and administrative provisions relating to the taking-up and pursuit of the business of direct insurance other than life assurance, Official Journal L 228, 16/08/1973, p. 3

Data Protection Directive 95/46/EC of the European Parliament and of the Council of 24 October 1995 on the protection of individuals with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, *Official Journal* L 281, 23/11/1995, p. 31

Regulation (EC) No 45/2001 of the European Parliament and of the Council of 18 December 2000 on the protection of individuals ëith regard to the processing of personal data by the Community institutions and bodies and on the free movement of such data, Official Journal L 8, 12/01/2001, p.1

Information Technology/E-Commerce Law [see also Data protection] Directive 97/7/EC of the European Parliament and of the Council of 20 May 1997 on the protection of consumers in respect of distance contracts, O.J. 1997 L 144/19 [see Consumer Law]

Intellectual Property Council Directive 87/54/EEC of 16 December 1986 on the legal protection of topographies of semiconductor products, Official Journal L 024, 27/01/1987 , p. 36

Me gjithë harmonizimin e pjesëve të veçanta të drejtës private mbrenda BE- së; çështja e procedurës gjygjësore civile paraqet problematikë në vete, pasi që është sferë që i takon kompetencës së Lex Forit, dhe ka të bëjë më sovranitetin e vendit. Me gjithë se shtetet anëtare me rastin e hyrjes në BE- i japin prioritet me rastin e krijimit dhe zbatimit legjislacionit primar dhe sekondarë të krijuar te BE-së, po pse dhe si ka arritur ta ruaj këtë pozitë të prioritetit e drejta e Bashkimit Europian?! Edhe këtë përparsi të ligjit Europian e siguron kjo përparësi mund të themelohet vetëm nëse është e vetë-kënaqshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave themelore me fuqinë e njëjtë ligjore si me atë të kushtetutave nacionale.[768]Ideja qysh prej Shumanit e deri se fndi me traktatin e Lisbonës qëëndron në një Europ të konsoliduar, në qender të të cilës do jenë liritë dhe të drejtat e qytetarit, të drejtat e qytetarit Europian, ambientë të gërshtimit dhe harmonisë reciproke mes shteteve anëtare, e gjithë objektiv të relizuarë me *Nenin 4* (3) i Traktatit të Lisbonës të shprehur qartë: ‘‘Sipas parimit të bashkëpunimit të sinqertë, Unioni dhe Shtetet Anëtare do të ndihmojnë njëri tjetrin me respekt të ndërsjelltë, në realizimin e detyrave që dalin nga Traktatet. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme, të përgjithshme ose të veçanta, të garantojnë plotësimin e obligimeve që dalin nga Traktatet ose që rezultojnë nga aktet e institucioneve të Unionit. Shtetet Anëtare do të lehtësojnë realizimin e detyrave të Unionit dhe do të përmbahen nga masat që mund të rrezikojnë arritjen e synimeve të Unionit.’

Çështja e zbatimit të ligjit të huaj nga gjakatat dhe arbitrazhet e BE-së, si dhe bashkëpunimi në çështjet procedurale dhe të njohjes së vendimeve të huaja hynë në grupin e rregullave të Lex Fori. Edhe pse pjesë të cakutara të drejtës ndërkombëtare private janë hamronizuara me anë të direktivave të BE- së, kjo çështje ende nuk ka rezulutat me harmonizim mbrenda BE- së, e mungesa e këtoj harmonizimi shkakton problemin e lartë cekur të prioritetit të drejtave nacionale apo ato të BE- së. Kosiderohet që zbatimi i ligjit të huaj nga gjykatat nacionale konsideohet thelbë i konfliktit

---

Labour Law Council Directive 75/117/EEC of 10 February 1975 on the approximation of the laës of the Member States relating to the application of the principle of equal pay for men and ëomen, Official Journal L 045, 19/02/1975, p. 19
Law of Property Council Directive 93/7/EEC of 15 March 1993 on the return of cultural objects unlaëfully removed from the territory of a Member State, Official Journal L 74, 27/03/1993, p. 74 165.
Public Procurement Council Directive 89/665/EEC of 21 December 1989 on the coordination of the laës, regulations and administrative provisions relating to the application of revieë procedures to the aëard of public supply and public ëorks contracts, Official Journal L 395, 30/12/1989, p. 33**Tort/Non-Contractual Liability** Council Directive 84/450/EEC of 10 September 1984 concerning misleading and comparative advertising, O.J. 1984 L 250/17 amended by Directive97/55/EC of the European Parliament and of the Council of 6 October 1997 (OJ L 290, 23.10.1997, p. 18); consolidated version at: http://europa.eu.int/eur-lex/en/consleg/main/1984/en_1984L0450_index.html
Competition law Green Paper: Damages actions for breach of the EC antitrust rules, Brussels, 19.12.2005, COM(2005) 672 final
Consumer law Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on the harmonisation of the laës, regulations and administrative provisions of the Member States concerning credit for consumers, Brussels, 11.9.2002, COM(2002) 443 final; 2002/0222 (COD)
Contract law European Commission | DG Health and Consumer Protection | Consumer Affairs | European Contract laë
[767] http://www.eulaw.soton.ac.uk/europriv/Lex_europriv_July06.htm#_Private_International_Law
[768] Në rastin Costa v ENEL, Gjykata kishte dy observime të rëndësishme lidhur me marrëdhënien midis të drejtës së Unionit dhe të drejtës nacionale. Shtetet Anëtare kanë transferuar definitivisht të drejtat sovrane në Komunitetin e krijuar nga vet ato dhe masat pasuese unilaterale nuk do të ishin në përputhje me konceptin e ligjit të BE-së.

të ligjeve.[769] E drejta e huaj trejtohet në dy aspekte në atë të se ajo konsiderohet si fakt apo konsiderohet si e drejtë.[770] Parimishtë e drejta e huaj koniderohet e drejte, dhe i jep gjygjtarit detyrë që të kujdeset për njohjen e të drejtë së huaj ex- oficio, ose në rast se e drejta e huaj kosiderohet si faktë, atëher gjykatiësi është pasiv dhe barra e të provuarit i takon palëve. Nuk kemi harmonizim mbrenda BE-së për qëndrimin që i jepet të drejtës së hauj si e drejtë apo si faktë dhe një pjesë e legjislacionit e kosnideron si fakt ndërkaç pjesa tjetër si e drejtë. Mënyra më e mirë e njohjes së të drejtës së huaj do ishte nëse gjykatësi do ishte realisht aktiv në njohjen e të drejtës së huaj, duke përdoruar mjetet më ekonomizuese dhe ekekt i saj do ishte numri më i vogël i rishikimeve dhe ankesave nga gjykatat më të larta. Gjykatësit nuk mund të thirren `` *iura novit curia* ``. Mbrenda BE-së në çështjet e aplikimit të drejtës së huaj nga gjykata e vendit, bëhet vetëm nëse gjykatësit kanë përdorur gjitha mjetet juridike, dhe e drejta e mbrendshme aplikohet vetëm si mundësi e fundit e mosnjohjes së të drejtës së huaj me gjithë përpjekjet e bëra.

Nuk mund të paramendohet rendi i ri botëror, pa bashkpunim në shumë fusha dhe atë ndërgjygjësor, e sidomos kur shumica e gjykatave udhëhiqen nga parime të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Bazuar në këtë vendimet e huaja njihen edhe ekzekutohen në vendin tjetër. E vetmja procedurë që i nënshtrohen këto akte është perocedura e njohjes së përmbajtjes së vendimit të gjykatës së huaj (por edhe akteve tjera noteriale), se mos është në kundërshtim me rendin publik të vendit ku ekzekutohet vendimi i tillë. Edhe çështja e ekzekutimit të vendimeve të huaja në BE- nuk është harmonizuar apo unifikuar.

Gjendja aktuale në BE- është edhe në kundërshtim me qëllimet e BE- së *Nenin 3, pika 2 i Traktatit të Lisbonës për BE-në.* Unioni do t'u ofrojë qytetarëve të vet liri, siguri dhe drejtësi pa kufi j të brendshëm, ku lëvizja e lirë e personave garantohet në pajtim me masat e duhura, për sa i përket kontrollit të kufijve të jashtëm, azilit, imigracionit dhe parandalimit dhe luftimit të krimit.

Për qështjen e të drejtës ndërkombëtare është menduar që procesi të mbetë aty në situatën aktuale me këto probleme të aplikimit të drejtës së huaj. Propozimi i dytë qëndron në harmoizimin e të drejtës private mbrenda BE- së dhe në këtë mënyr nuk do paraqiten mardhënjë me element të huaj, propzimi i tillë është zgjidhje e përkohshme vetëm për shtetet e BE- së, por tash me subjektivitetin e ri të qytetarit Europian dhe me raportet e tij me shtetasit jashtë Europe, cila e drejtë do aplikohej?!. Propozimi i tretë është objektivi jo i një kodi unik privat, por i drejtimit të objektivave drejtë njohjes dhe aplikimit të drejtës së huaj. Propozimi më i mirëseardhur dhe më

[769] Harmonization of Private International Law in Europe and Application of Foreign Law: The Madrid Principales of 2010 University Valencia- Faculty of Law; July 25 2011 Yearbool of International Law, Vol. 13, pp. 273-297, 2011
[770] Kalia, Dr Ardian, `` E drejta Ndërkombëtare private``, Sejko, fq 106

shpresëdhënës është i ligjit të harmonizuar të kolizionit mbrenda BE- së të propozuar në Madrit më 2010, si zgjidhje duke e parë realitetin e pasigurisë së qytetarëve në fushat e të drejtës private.[771]

Qëllimet e parimeve të Madridit qëndrojnë në luftimin e kësaj pasigurie të qytetarit, dhe këtë në mënyr krejtsisht relaliste. Duke hulumtuar ligjet nacionale, dhe bazuar në këtë duke zgjidhur një standart minimal që ushtron efekt të drejtëpërdrejtë në BE për fushën e kolizionit të ligjeve. Pikrishtë efekti i rregullurove në legjislacionin nacional si i drejtëpërdrejtë por edhe në të drejtat e qytetarit na bënë të besojmë për efektin që do ketë në eliminimin e kundërthënjëve për mardhënjet juridike private me element të huaj. Efekti i drejtërdrejtë i kësaj rregullore synon që të ofroj përgjigje të saktë e që e ofron zbatimi i të drejtës së huaj ex officio. Por edhe palëve gjygjësore mund të ju kërkohet ndihmë juridike dhe atë duke i`u siguruar mbështetje financiare. Lex Fori është kompetent për të përcaktuar të drejtën e huaj. Shtetet nacionale që e njohin efektin e vendimeve të huaja sipas parimeve të Madridit mund të rezultojnë aplikimin e vendimit të huaj nëse është në kundërshtim me rendin publik. Gjithsejtë që të njëmbëdhjetë parimet e Madridit kërkojn bashkpunim si me institucionet vendore ashtu edhe ato të Konventave të Hages, bashkpunim me autoritetet nacionale, ndihmë edhe të ekspertëve. Por mbi gjitha inkurajimi i i rrjetit Europian të Gjykatave si organi më i pavarur që i mundëson qytetarëve zgjidhje fleksibile e të harmonizuara. Puna e Gjykatës Europiane të Drejtësisë është padyshim suksesi dhe shtytësi kryesor për të realizuar vizionin e një Europe të bashkuar me institucione të mirëfillta me siguri maksimale të drejtave të qytetarit Europian, dhe mbi gjitha vendimet e saj shërbejnë si shembull shtytës se mund të arrihet një Kod Unik i të drejtës Private por edhe i të drejtës ndërkombëtare private.[772]

Përfundime dhe rekomandime

- Qëllimi i Unionit është promovimi i paqes, vlerave të veta dhe mirëqenies së popujve të vet, siguria e qytetarëve. Unioni do të themelojë një treg të brendshëm. Tregu i mbrendshëm ju ofron siguri qytetarëve të BE-së në lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Këto liri që janë si rrjedhojë e autonomisë së vullnetit të qytetarit, e që krijojnë mundësi që të krijojnë raporte nga kjo fushë me elementë të huaj. Duke u mbështetur në nenin 95 të BE- së dhe në trendet bashkëkohore është e dmosdoshme dhe jo një vizion i pamundshëm për të krijuar një kod Unik Civil, në pjesë e të cilit sistematizimë; do e zinte pjesë marrdhënjet juridike private me element të huaj.

[771] Harmonization of Private International Law in Europe and Application of Foreign Law: The Madrid Principales of 2010 University Valencia- Faculty of Law; July 25 2011 Yearbool of International Law, Vol. 13, pp. 273-297, 2011, fq 13

[772] Dy gjëra janë të qarta: së pari, gjykatat në Shtetet Anëtare duhet të mbikqyrin dhe të zbatojnë ligjin e Unionit; dhe së dyti, interpretimi i ligjit të Unionit dhe deklaratat lidhur me vlefshmërinë e tij janë rezervat e vetme të Gjykatës së Drejtësisë.

- Traktati i Lisbonës, i jep fuqi më të madhe dhe prerogativa institucioneve të BE- së, sidomos për iniciativën e krijimit dhe të zbatimit të legjislacionit të BE-së. Ky traktat jep bazë të sigurtë se E drejta e BE-së nuk paraqet të drejtë të huaj por është bashkpunim apo partnitet mes parlamenteve nacionale dhe institucioneve, si partnitet i mbështetut në solidaritet të BE- së për të realizuar vizionin e një fuqie të bashkuar, si fuqi ekonomike botërore dhe kjo shërben për t`i jep garanci qytetarit se gjatë bashveprimit të tyre të drejtat nacionale zbatohn njejtë në gjithë Europen.
- Hramonizimi i njëkohsishëm edhe i të drejtës private dhe ndërkombëtare privatë është procesë i gjatë dhe i vështirë, falë dallimeve të kulturave, instituteve të shteteve anëtare të BE-së. Metodat që ka përdorur BE- ja për rregullimin e sferës privatë ndërkombëtare kanë shkuar si në rrafshin unifikues ashtu edhe harmonizuesë. Që të dy metodat e unifikimit kanë jep rezultate pozitve, bile harmonizimi shifet si metod më e pranueshme nga shtetet nacionale dhe kështu si rrugë që hap mundësi për një peridh të shpejtë edhe në sistematizimin më të lartë që e më thuktë e sigurtë i quajturi Kod Civil. Cila do metod që do përdoret do i shërbente intensifikimit të marrdhënjëve juridike private me qytetarëve europian dhe me shtetet tjera jashtë BE- se. Kështu do e realizonin liri të mirëfilltë të qytetarëve për lëvizur, për tëqarkulluar me mallra, shërbime e kapitale, pa pasur frikë se do gjenin rregulla të ndryshme, përkundrazi ata do shërbehen me të njejtat rregulla, për zgjidhur çështjet kontestuese pavarsishtë vendit ku ndodhen.
- Edhe për shtetin e Kosovës, për t`i ofruar stabilitet qytetarit të saj, për tërheqje edhe të invvestimeve të huaja konsiderohet se pjesa më e madhe e të drejtës private është e rregulluar me ligje të veçanta, edhe çështjet e shtetësisë së Kosovës janë rregulluar me ligj të veçantë, miratimi i Konventave, hapin rrugen për një KOD Civil të Rrepublikës së Kosovës, me dispozita edhe të normave kolizive.

Bibliografia

Universiteti Leiden `` Proponents of the harmonization of European private law are taking the debate to appalling levels`` Posted on March 11, 2013 in Private Law

Profesor Klaus-Diter Borçard, 2010; ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian;

Harmonization of Private International Law in Europe and Application of Foreign Law: The Madrid Principales of 2010 University Valencia- Faculty of Law; July 25 2011 Yearbool of International Law, Vol. 13, pp. 273-297, 2011

Bastiaan Van Zelst Article the Development of European Private Laë: A Short History, 2010; Volume I

Konrad Osajda, The Experiences, Methods, Objectives and Perspectives of Unification of Private Law in the European Union Introduction; 2006

The Codification of Private International Laë in Europe: Could the Community Learn from the Experience of Mixed Jurisdictions? Aude Fiorini; EJCL

The Development of European Private Laë: A short history ....Burgerlijk Recht, (Deventer: Kluwer, 2001). Volume I. Laë and Policy Reëiev.

Fondacioni Soros,`` Konkurrenca: Korniza ligjore dhe praktika ne Kosovë krahas standardeve Evropiane``, Prishtinë 2010

Latifi Dr, Juliana, E drejta Civile- Pjesa e përgjithëshme, Tiranë 2007, fq 14

Bilalli, Dr Asllan; Kuçi, Dr Hajredin, ` E drejta ndërkombëtare Private `, Prishtinë 2009, fq 103

Kalia, Dr Ardian, `` E drejta Ndërkombëtare private``, Sejko, fq 10

Jezdic, Dr M, Meduradno privatno pravo, Beograd, 1983, fq 3

Hetemi, Dr Mehdi, E drejta nderkombëtare tregtare- afariste, Prishtinë, 2007

Ligjet (Direktivat)

Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, signed at Lisbon, 13 December 2007.

Digesta- l. 1. 1.

Projektligji Nr.10 428, datë 2.6.2011 për të Drejtën Ndërkombëtare Private të Rrepulikës së Shqipërisë.

Ligji Federativ për të drejtën ndërkombëtare private i ish RSFJ; 15. IV. 1078.

Statuti i Konferencës së Hages mbi të Drejtën Ndërkombëtre Private, 31. 1951, ndyshuar 30. 06. 2005; neni 1.

Miratimi i Statutit të Konferencës së Hages për të Drejtën Ndërkombëtare Private nga Rrepublika e Shqipërisë. Miratuar më 12.05.2005.
http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.listing.
Statuti i Hagës i Konferencës për të drejtën ndërkombëtare private, 31 tetor 1951 Nënshkruar: 4. 6. 2002. Në fuqi më: 4.06.2002.
Kushtetuta e Rrepublikës së Kosovës; e cila hynë në fuqi 15 qershor 2008.
http://www.unidroit.org/dynasite.cfm?dsmid=103284

IYRCL

Address Jordan Misja, Tirana , Albania
Contact: Phone: + 355 4 24 12 222 **e-mail:** iyrcl@beder.edu.al

SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË BEDËR

ISBN 9928-4120-4-9